50	Të lexuarit e teksteve letrare	Tre muskëterët	Pse më pëlqejnë filmat dhe librat me aventura?	-bisedë; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje- përgjigje; -dallo-trego; -ditari dypjesësh; -dramatizim; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën	Për: -leximin e tekstin teatror duke mbajtur shënime për dialogjet që i duken interesante; -përgjigjet për pyetjet rreth pjesës teatrale; -tregimin ku duket në tekst roli i musketierëve në ndihmë të njerëzve të thjeshtë dhe të pambrojtur para kërcënimeve të ndryshme; -analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre, duke treguar edhe ndjesitë që përcjellin ata nëpërmjet batutave të tyre; -formulimin e mesazhit që	-njohuritë dhe shkathësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me aventura; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.

						<p>përcjell pjesa; -interpretimin e një prej roleve në pjesën teatrale; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve.</p>	
51	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme			Pse na pëlqejnë gazmoret?	<p>-diskutim për njohuritë paraprake; -dëgjim i drejtuar; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -diskutim; -lojë në role; bashkëbisedim; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.</p>	<p>Për: -ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje; -tregimin pse i pëlqejnë gazmoret; -shprehjen e ndjesive që provon kur dëgjon një gazmore; -interpretimin e gazmoreve; -bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre; -vlerësimin që i bëjnë njëritjetrit.</p>	<p>-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -gazmore; -CD, magnetofon. -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre; -fletë A4.</p>
52	Të folurit për të komunikuar dhe mësuar			Paraqitja në monitor e fotove nga "Festa e Abetares".	<p>-shikim i organizuar; -lexo-diskuto; bashkëbisedim; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.</p>	<p>Për: -diskutimin në grupe për temën "Albumet me fotografi të familjes sime"; -prezantimin e albumit të vet personal; -demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë; -shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesitë e tij/saj rreth një albumi fotografish personal dhe familjar; -përdorimin e një fjalori të</p>	<p>-foto që nxënësit/et kanë bërë me familjen; -video e "Festës së Abetares"; -videoprojektor; -material i shkurtër filmik ku jepet foto të nxënësve gjatë festës së abetares; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -tabakë letre;</p>

					përshtatshëm rreth temës; -respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.	-fletë A4.
53	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Shkruajmë për verën	Material i shkurtër filmik për natyrën në stinën e verës.	-shikim i organizuar; -diskutim; bashkëbisedim; -shkrim i lirë; -punë individuale; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -përgjigjet e pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e verës, duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine; -përshkrimin për verën, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë; -shkrimin për stinën e verës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit; -qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; -vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga natyra në stinën e verës; -mjete shkrimi; -lapustila; -fletore; -fletë A4.
54	Të lexuarit e teksteve letrare		Leximi i librave jashtëklase	-diskutim; -bisedë; -punë në çift; -punë në grup; -punë me gjithë klasën.	Për: -rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.	-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es; -libra jashtëklase; -fletë A4; -mjete shkrimi.
55	Të shkruarit	Vlerësim	Vlerësim njohurish 3	-bisedë;	Për: -plotësimin e kërkesave të	-njohuritë dhe shkathhtësitë

	për qëllime personale dhe funksionale	njothurish 3		-punë individuale e pavarur.	ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.	paraprake të nxënësit/es; -fletët e testit, -mjetet e shkrimit.
56	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Projekt 3 “Teatri ynë”	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-diskutim; -bisedë; -lojë me role; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -shkrimin e batutave të përzgjedhura; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; -bashkëpunimin në grup.	-maska ose veshje për personazhet; -bllok shënimesh; -foto; -karton letër; -lapustila; -CD; -magnetofon; -skenë e improvizuar.
57	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekt 3 “Teatri ynë”	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-diskutim; -bisedë; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; -bashkëpunimin në grup.	-maska ose veshje për personazhet; -bllok shënimesh; -foto; -videoprojektor; -karton letër; -lapustila; -CD; -magnetofon; -skenë e improvizuar.
58	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekt 3 “Teatri ynë”	Si mund të luajmë një pjesë teatrore?	-diskutim; -bisedë; -hulumtim; -punë në grup.	Për: -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -shkrimin e batutave të përzgjedhura; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit;	-maska ose veshje për personazhet; -bllok shënimesh; -foto; -karton letër; -lapustila; -CD; -magnetofon.

59	Të lexuarit e teksteve letrare	Projekt 3 “Teatri ynë”	Si mund të luajmë një pjesë teatrale?	-diskutim; -bisedë; -hulumtim; -lojë me role; -punë në grup.	-bashkëpunimin në grup. -leximin sipas roleve; -interpretimin e pjesës sipas roleve; -shkrimin e batutave të përzgjedhura; -shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit; -bashkëpunimin në grup.	-maska ose veshje për personazhet; -bllok shënimesh; -foto; -karton letër; -lapustila; -CD; -magnetofon; -skenë e improvizuar.
----	--------------------------------	---------------------------	---------------------------------------	--	--	---

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Dëgjojmë Për pushime te gjyshërit		Situata e të nxënit Ku i kaluat pushimet?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan si i ka kaluar pushimet verore;– ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje;– demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe ndërton fjali me to;– diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;– ndërton një vazhdim për historinë që dëgjon;– bën lidhjen e tekstit që dëgjon me ditën më të bukur të pushimeve të tij/saj;– tregon për një ditë të pushimeve verore që e kujton me kënaqësi;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: pushime verore gjyshër det aromë shijoj kredhje erë shiroku portik	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fjalor i gjuhës shqipe; foto ku nxënësit/et kanë dalë me gjyshërit e tyre gjatë pushimeve verore; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte; edukim fizik, sporte dhe shëndet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore; mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- dëgjim i drejtuar;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- shkrim i lirë- bashkëbisedim;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë se ku i kanë kaluar pushimet verore duke e fokusuar bisedën te pushimet verore që nxënës të ndryshëm mund t’i kenë kaluar te gjyshërit e tyre. Gjatë bisedës nxiten nxënësit të tregojnë edhe foto ku kanë dalë me gjyshërit e tyre gjatë pushimeve dhe orientohen që të shprehin qartë, lirshëm dhe me fjali të plota. Mësuesi/ja mund t’u drejtojë pyetjet: <i>Kush nga ju i ka kaluar pushimet verore në shtëpinë e gjyshërve?</i> <i>Ku jetojnë ata?</i> <i>A ju pëlqen t’i kaloni pushimet pranë tyre?</i> <i>Si e kaloni kohën kur jeni me ta?</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit: “Për pushime te gjyshërit”.			

Veprimtaria e dytë

Dëgjim i drejtuar: Komentohen fotoja në libër nga nxënësit.

Mësuesi/ja fton nxënësit të dëgjojnë tekstin në magnetofon.

Orientohen nxënësit që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime për fjalët e reja dhe për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje.

*Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe për të gjetur në fjalor kuptimin e fjalëve me ngjyrë të kuqe dhe t'i shpjegojnë ato. Nxënësit/et ndërtojnë fjali me fjalët e reja.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie-pyetje-përgjigje: Ushtrimi 1 synon që nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve rreth tekstit:

Për çfarë flitet në këtë tregim?

Si e përshkruan autori fillimin e ditës?

Çfarë kishte të veçantë ajo ditë?

Cila ishte biseda që fëmijët bënë me gjyshërit?

Ç'mendim keni për pushimet e fëmijëve në tekst?

Ushtrimi 2. Nxiten nxënësit/ët të tregojnë tregimin, duke e ilustruar me hollësi nga teksti.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Nxënësit punojnë individualisht për të ndërtuar një vazhdim për këtë histori.

Në përfundim, nxënësit lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 4. Nxënësit/et tregojnë një ditë nga pushimet e tyre verore që e kujtojnë me kënaqësi, duke u ndihmuar nga pyetjet: *Ku ishe? Kush ishte me ty? Çfarë bëtë?*

Ushtrimi 5. Nxënësit/et krahasojnë pushimet e tyre me pushimet e fëmijëve të tregimit.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin si i ka kaluar pushimet verore;
- demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja duke ndërtuar fjali me to;
- diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;
- ndërtimin e një vazhdimi për historinë që dëgjon;
- lidhjen e tekstit që dëgjon me ditën më të bukur të pushimeve të tij/saj;
- tregimin për një ditë të pushimeve verore që e kujton me kënaqësi;
- bashkëpunimin në grup, vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Përqaftimi		Situata e të nxënit Sa herë në ditë e përqafton mamin, babin, motrën apo vëllain?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– tregon përmbajtjen e pjesës;– lidh tregimin me ngjarje nga jeta e tij/saj, në lidhje me komunikimin me prindërit e tij/saj, vëllezërit apo motrat;– lexon në role tregimin;– formulon mesazhin që përcjell tregimi;– diskuton rreth komunikimit në familje dhe ndërtimit të raporteve të mirëkuptimit prindër-fëmijë;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe përqaftim unik kruspull komunikim	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; foto të nxënësve/eve ku kanë dalë me prindërit e tyre dhe me anëtarë të tjerë të familjes; mjete shkrimi, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">– vëzhgo-diskuto;– diskutim;– marrëdhënie pyetje-përgjigje;– ditari dypjesësh;– bashkëbisedim;– punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Vëzhgo-diskuto: Nxënësit paraqesin fotot ku kanë dalë me prindërit e tyre dhe anëtarë të tjerë të familjes, për të cilat janë porositur nga mësuesi/ja një orë më parë. Diskutim me nxënësit rreth tyre. Komentoni fotot tuaja. <i>Çfarë ju bën që të jeni të lumtur në këto foto?</i> <i>A e doni shumë familjen tuaj?</i> <i>Sa herë në ditë e përqafton mamin, babin, motrën apo vëllain?</i> <i>Po kur jeni vetëm, si ndjeheni?</i>			
Veprimtaria e dytë Diskutim: Nxënësit njihen me titullin e pjesës “Përqaftimi” dhe autorin David Grosman. Ata vëzhgojnë dhe komentojnë ilustrimin në libër.			

Orientohen nxënësit të lexojnë në heshtje pjesën dhe të nënvizojnë fjalët dhe shprehjet e reja si dhe gjërat që i duken më interesante.

Punohet fjalori me fjalët dhe shprehjet e reja. Nxënësit ndërtojnë fjali me to.

*Nxënësit tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj (*tregim që trajton një problem social, siç është ai i komunikimit të prindërve me fëmijët, i vetmisë dhe i harmonisë familjare*).

*Nxiten nxënësit të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre rreth tregimit:

A ju pëlqeu tregimi? Pse?

Si u ndjetë pas leximit të këtij tregimi?

Çfarë ju bën më tepër përshtypje në këtë tregim?

Nxënësit/et lexojnë tregimin zinxhir.

Veprimtaria e tretë

***Marrëdhënie pyetje-përgjigje:** Punohet rubrika: “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit të lexojnë pyetjet rreth përmbajtjes së pjesës dhe t’u përgjigjen atyre.

*Lexim i tregimit nga nxënësit zinxhir dhe në role.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës.

Veprimtaria e katërt

Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në dyshe do të gjejnë se ç’lloj tregimi është ky, duke qarkuar alternativën e saktë.

Ditari dypjesësh: Nxënësit/et punojnë në grupe për të plotësuar ditarin dypjesësh dhe për të gjetur mesazhin që përcjell tregimin.

Fragmenti	Komenti
...s’të gjendet shoku... secili nga ne është unik dhe i veçantë...	Njeriu ka në jetë shumë tipare, shprehi, mënyra të foluri e të konceptuari, paraqitje të jashtme etj., që e bëjnë atë të veçantë, të dallueshëm nga të tjerët apo siç thuhet ndryshe unik. Këto cilësi krijojnë atë që quhet individualiteti i njeriut.

Mesazhi: Shprehja e dashurisë për njëri-tjetrin në familje na bën më të lumtur, më të bashkuar dhe më të motivuar në jetën e përditshme.

Përfaqësuesit/et e çdo grupi prezantojnë punën e grupit para klasës.

*Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë të përbashkëtat që ata kanë me Benin.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre rreth pyetjeve të dhëna që kanë të bëjnë me komunikimin me prindërit, çfarë i bën ata të ndjehen të lumtur dhe të bashkuar në familje, këshillat që ata mund t’i jepnin Benit etj.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës;
- leximin në role të tregimit;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimin;
- bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre;
 - vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Përdorimi i shkronjës së madhe		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për përdorimin e shkronjës së madhe.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon raste të përdorimit të shkronjës së madhe, në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe të emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve etj.;zbaton rregullat drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe të emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve etj.;shkruan fjali në të cilat përdor fjalë që tregojnë tituj librash, këngësh, filmash dhe emra shkollash, rrugësh, institucioneve etj.;bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: shkronjë e madhe emra të përgjithshëm emra të përveçëm tituj librash, filmash, këngësh emra rrugësh, institucioneve thonjëza	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me emra shkollash, rrugësh, institucioneve etj.;fisha me tituj librash, këngësh, filmash etj.;mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - diskutim për njohuritë paraprake; - rishikim në dyshe; - shkrim i lirë; - lojë; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja u shpërndan në çdo dyshe nga një fletë në të cilën është shkruar një fjali. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë dhe të identifikojnë rastet e përdorimit të shkronjës së madhe në to. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth njohurive që nxënësit/et kanë për përdorimin e shkronjës së madhe, duke u mbështetur edhe në rubrikën “Kujtoj”. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.			
Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit do të punojnë ushtrimin 1, i cili synon shkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve, kafshëve, vendeve, institucioneve, rrugëve dhe titujt e librave, filmave. Ushtrimin 2 synon rishkrimin e fjalëve që duhet të shkruhen me shkronjë të madhe, duke përcaktuar dhe llojin e secilës prej tyre. Ushtrimin 3 synon plotësimin e tekstit të dhënë me fjalët që mungojnë dhe përdorimin e saktë të shkronjës së madhe në këto fjalë.			

Nxënësit/et do të punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Nxënësit/et ndahen në dy grupe. Grupi i parë do të punojë ushtrimin 5 (nxënësit/et mund të ndahen edhe sipas niveleve) dhe grupi i dytë ushtrimin 6.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të krijojnë fjali me emra njerëzish, kafshësh, vendesh apo tituj librash, filmash, emra institucionesh, rrugësh, duke përdorur drejt shkronjën e madhe.

Pas përfundimit të punës, mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë fjalitë e krijuara me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore nëse ka.

Veprimtaria e katërt

Lojë: Me nxënësit/et në minutat e fundit mund të zhvillohet një lojë.

Nxiten të shkruajnë në fleta, fjalë e fjali ku nuk është përdorur saktë shkronja e madhe tek emrat e njerëzve, kafshëve, vendeve, institucioneve, rrugëve apo titujt e librave, filmave dhe t'i shkëmbejnë me shokët/shoqet që kanë fqinjë për t'i korrigjuar.

Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e rasteve të përdorimit të shkronjës së madhe;
- zbatimin e rregullave drejtshkrimore në shkrimin e titujve të librave, filmave, këngëve dhe emrave të shkollave, rrugëve, institucioneve etj;
- shkrimin e fjalive në të cilat përdor fjalë që tregojnë tituj librash, filmash, këngësh dhe emra shkollash, rrugësh, institucionesh etj;
- qortimet drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- bashkëpunimin në grup, vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi: 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Shtëpia në pemë		Situata e të nxënit Mbresat gjatë vizitës në shtëpinë e të moshuarve.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen në tregim;– tregon përmbajtjen e pjesës, sipas rrjedhës së ngjarjes;– tregon se çfarë vlerëson më shumë të gjyshërit e tij/saj;– lidh pjesën që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, në lidhje marrëdhëniet që ka me gjyshërit e tij/saj;– pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth tregimit.		Fjalë kyçe: gjyshe gjysh shtëpi pemë	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; foto të nxënësve/eve ku kanë dalë me gjyshërit e tyre; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut bashkëjetesa paqësore	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">– bisedë;– diskutim;– rishikim në dyshe;– hulumtim;– bashkëbisedim;– punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve

Veprimtaria e parë

Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë rreth veprimtarisë së zhvilluar me rastin e 1 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të Gjyshërve, vizitës në shtëpinë e të moshuarve.
Nxiten nxënësit/et të shprehin mbresat e tyre nga vizita në shtëpinë e të moshuarve.

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Nxënësit njihen me titullin e pjesës “Shtëpia në pemë”.
*Ata/ato vëzhgojnë dhe komentojnë ilustrimin në libër.
*Orientohen nxënësit të lexojnë në heshtje pjesën dhe të nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken më interesante.

*Nxënësit tregojnë llojin e pjesës, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj (*tregim*).

*Nxiten nxënësit të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre rreth tregimit:

- *A ju pëlqeu tregimi? Pse?*

- *Si u ndjetë pas leximit të këtij tregimi?*

- *Çfarë ju bën më tepër përshtypje në këtë tregim?*

*Nxënësit/et lexojnë tregimin zinxhir.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth tregimit, duke përzgjedhur alternativën e saktë. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrit, më pas diskutojnë me gjithë klasën.

Veprimtaria e katërt

Hulumtim: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit të punojnë në grupe për të dalluar llojin e tregimit, hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tij, si dhe për personazhin e tregimit që nuk jeton më duke treguar se nga e kupton këtë.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit, sipas rrjedhës së ngjarjes.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë marrëdhënien që kanë me gjyshen apo gjyshin e tyre, çfarë vlerësojnë tek ata dhe të tregojnë ndonjë cilësi që kanë trashëguar prej tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit në mënyrë të rrjedhshme dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth tregimit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- lidhjen e pjesës që lexon me ngjarje nga jeta e tij/saj, në lidhje marrëdhëniet që ka me gjyshërit e tij/saj;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Shprehim ndjenja dhe emocione		Situata e të nxënit: Cilat janë përjetimet e tua emocionale kur lexon librin e preferuar apo kur shikon filmin e parapëlqyer?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– tregon karakteristikat që ka një tekst shprehës;– u përgjigjet pyetjeve me shkrim, rreth përmbajtjes së një tekstit shprehës të shkruar;– shkruan një tekst shprehës sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke ndjekur udhëzimet përkatëse;– zbaton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: tekst shprehës ndjenja emocione opinione ngjarje histori	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; skema e ndërtimit të një teksti shprehës me udhëzimet përkatëse; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- rishikim në dyshe;- diskutim;- shkrim i lirë;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit rreth emocioneve dhe ndjenjave që ata përjetojnë kur lexojnë librin e preferuar apo kur shikojnë filmin e parapëlqyer.			
Veprimtaria e dytë Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tekstin që ka shkruar Ivesti, pasi ka lexuar tregimin “Shtëpia në pemë”, në të cilin ka shprehur ndjenjat dhe emocionet që i ka shkaktuar ajo. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë tekstin me fjalët ndihmëse të dhëna. Nxënësit punojnë individualisht. Në përfundim të punës ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe korrigjojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin e plotësuar. Ushtrimi 2. Nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve me shkrim rreth tekstit shprehës dhe më pas i lexojnë ato.			
Veprimtaria e tretë Diskutim: Nën drejtimin e mësuesit/es diskutohet rreth udhëzimeve të dhëna në libër, që duhet të ndiqen për të shkruar një tekst shprehës.			

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që duke u bazuar në modelin e mësipërm, të shkruajnë një tekst në të cilin të shprehin ndjenjat dhe emocionet që i ngjall pjesa letrare “Përqafimi”. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim të punës nxiten nxënësit të lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- plotësimin e tekstit shprehës së Ivestit me fjalët ndihmëse;
- përgjigjet e pyetjeve të dhëna me shkrim rreth përmbajtjes së një teksti shprehës të shkruar;
- shkrimin e një teksti shprehës sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke ndjekur udhëzimet për ndërtimin e tij;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Historia e lojës së futbollit (ora I)		Situata e të nxënit Album me foto dhe kuriozitete për futbollin dhe topin e futbollit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon pjesën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së pjesës ose rreth fjalëve të panjohura për të;– tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;– ndan tekstin në pjesë të vogla, duke krijuar nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– flet për historikun e futbollit;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– bashkëpunon në grupe për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: futboll topi i futbollit ndeshje lojtarë informacione internet origjinë argëtohem	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; foto të fëmijëve duke luajtur futboll, foto të futbollistëve dhe skuadrave të preferuara të futbollit vendase apo të huaja, material filmik, videoprojektor; informacione nga interneti për lojën e futbollit; mjete shkrimi, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi edukim fizik, sporte dhe shëndet teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">– bisedë;– lexim dhe mendim i drejtuar;– lexim zinxhir;– marrëdhënie pyetje-përgjigje;– bashkëbisedim;– punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të prezantojnë albumin e përgatitur prej tyre me foto dhe kuriozitete që lidhen me futbollin dhe topin e futbollit dhe të flasin rreth tyre. Më pas nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve: <i>Ç’dini për lojën e futbollit?</i> <i>Sa lojtarë ka çdo skuadër në futboll?</i> <i>Ku luhet ajo?</i> <i>Kush dëshiron të bëhet futbollist?</i> <i>Cilët janë futbollistët apo skuadrat e futbollit që ju pëlqeni më shumë?</i>			

Veprimtaria e dytë

Lexim dhe mendim i drejtuar: Nxënësit njihen me titullin e pjesës “Historia e lojës së futbollit”. Udhëzohen nxënësit për leximin e tekstit në paragrafë.

Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Më pas, ata iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja.

Ndalesa I Ishim ulur familjarisht...deri te... pyetjen tënde kaq interesante.

Pyetje:

Çfarë po ndiqnin në televizor prindërit dhe fëmijët e tyre?

Çfarë pyetje i shkrepiti djalit në kokë?

Cili ishte propozimi i motrës për të gjetur përgjigjen e kësaj pyetjeje?

Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa II Sapo mbaroi ndeshja... deri te... po komentoja unë.

Pyetje:

Çfarë zbuloi motra në internet për lojën e futbollit?

Po djali çfarë zbuloi?

Ndalesa III Lexo këtu... deri tek... Ishujt Britanikë.

Pyetje:

Cila ishte “shtëpia” e futbollit?

Për sa kohë kishte lulëzuar atje?

Ndalesa IV Ky fragmenti qenka... deri tek... m’u përgjigj mami.

Pyetje:

Në cilin shekull u bë mjaft e përhapur loja e futbollit?

Ndalesa V Ne të gjithë po argëtoheshim... deri në fund.

Pyetje:

Çfarë donin të dinin më tepër fëmijët?

A gjetën informacione për topin e futbollit? Pse?

A ju pëlqeu pjesa?

Ç’gjë ju bëri më shumë përshtypje?

**Lexim me zë: Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et.*

Veprimtaria e tretë

***Marrëdhënie pyetje-përgjigje:** Punohet rubrika: “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit.

Veprimtaria e katërt

Diskutim: Punohet rubrika: “Analizoj”. Punë në grupe. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se me kë ka lidhje tregimi duke dalluar alternativën e saktë, si dhe të gjejnë se ç’lloj teksti është ky duke dhënë edhe 2-3 karakteristika të tij.

Nxiten nxënësit/et të ndajnë tekstin në pjesë të vogla dhe të shkruajnë nga një fjali përmbledhëse për to. Pas përfundimit të punës, ftohen nxënësit të lexojnë fjalitë përmbledhëse dhe disa prej tyre të tregojnë përmbajtjen e pjesës.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;
- tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;
- ndarjen e tregimit në pjesë dhe krijimin e fjalive përmbledhëse për secilën prej tyre;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- bashkëpunimin në grupe, vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Kërko në internet për të gjetur informacione në lidhje me topin e futbollit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Historia e lojës së futbollit (ora II)		Situata e të nxënit: Informacione në lidhje me topin e futbollit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon pjesën rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– tregon përmbajtjen e pjesës;– shpjegon pse Anglia është “shtëpia” e lojës së futbollit;– diskuton për preferencat e tij për lojën e futbollit, lojtarët e futbollit, sa e ndjek këtë lojë dhe sa sportdashës është;– interpreton në role pjesën;– bashkëpunon në grupe për kryerjen e një detyre;– pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth tregimit.		Fjalë kyçe futboll topi i futbollit ndeshje lojtarë informacione internet origjinë argëtohem	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; informacione nga interneti për lojën e futbollit; mjete shkrimi, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi edukim fizik, sporte dhe shëndet teknologjia dhe TIK-u Lidhja me temat ndërkurrikulare të drejtat e njeriut	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- lexim zinxhir;- bashkëbisedim;- lexim në role;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Nxënësit lexojnë informacione në lidhje me topin e futbollit, të gjetura në internet.			
Veprimtaria e dytë Lexim zinxhir: Lexim i tregimit zinxhir nga nxënësit. Nxiten nxënësit të tregojnë përmbajtjen e tregimit në mënyrë të përmblodhur.			

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika: “Reflektoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit t’u përgjigjen pyetjes: Pse Anglia është quajtur “shtëpia” e lojës së futbollit?

*Nxiten nxënësit të shprehin pëlqimet e tyre për lojën e futbollit dhe lojtarët e futbollit, si dhe të tregojnë njohuritë e tyre për futbollin, sa e ndjekin atë dhe sa sportdashës janë.

Veprimtaria e katërt

Lexim në role: Nxënësit të organizuar në grupe lexojnë tregimin sipas roleve (djali, mami, babi, motra). Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e pjesës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
 - shpjegimin pse Anglia është “shtëpia” e lojës së futbollit;
 - diskutimin për preferencat e tij për lojën e futbollit, lojtarët e futbollit dhe sa e ndjek lojën e futbollit;
 - interpretimin në role të pjesës;
 - bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre;
 - vlerësimin e shokëve/shoqeve.
-

Detyrës shtëpie: Rubrika “Detyrë”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Flasim Veprimtaritë sportive		Situata e të nxënit Pjesëmarrja në veprimtari sportive	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– flet për veprimtaritë sportive në të cilat ka marrë pjesë;– u përgjigjet pyetjeve për veprimtaritë sportive që zhvillojnë fëmijët në fotot e paraqitura duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– tregon për veprimtaritë sportive që zhvillohen në shkollën e tij/saj;– nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për veprimtaritë sportive që ata pëlqejnë më shumë;– shpjegon rëndësinë që ka pjesëmarrja në veprimtaritë e ndryshme sportive;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– vlerëson përgjigjet e shokëve dhe shoqeve.		Fjalë kyçe: veprimtari sportive; maratonë vrapimi; ushtrime stërvitore.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- foto apo filmime të nxënësve/eve në veprimtari të ndryshme sportive ku ata kanë marrë pjesë;- mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi edukim fizik, sporte dhe shëndet Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- mendo-zbulo;- bisedë;- rrjeti i diskutimit;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Nxënësit tregojnë para klasës foto të tyre ku kanë dalë gjatë zhvillimit të veprimtarive të ndryshme sportive dhe flasin rreth tyre.			
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tregojnë sportet në të cilat kanë marrë pjesë dhe emocionet që kanë përjetuar kur kanë qenë fitues, për shpirtin e garës dhe frymën e punës në skuadër.			
Diskutim: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë figurat në tekst dhe të diskutojnë rreth tyre duke iu përgjigjur pyetjeve:			
Çfarë po bëjnë fëmijët?			
Për cilat sporte bëhet fjalë? Nga e kuptoni këtë?			
Në cilat mjedise po luhen sportet që paraqesin në këto fotografi? Nga e kuptoni këtë?			
Cilin prej sporteve të paraqitura në fotot e mëposhtme të pëlqen të ushtrosh? Pse?			

Veprimtaria e dytë


Mendo-zbulo: Ushtrimi 2. Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin dhe të zbulojnë se cili mund të ketë qenë shkaku i qëndrimit të Klestit, duke i dhënë edhe një këshillë atij, në qoftë se do ta kishin shok.

Veprimtaria e tretë

Bisedë: Ushtrimi 3, 4. Nxënësit/et tregojnë për veprimtaritë sportive që zhvillohen në shkollë të cilat u pëlqejnë më shumë.

Veprimtaria e katërt

Rrjeti i diskutimit: Punë në grupe. Ushtrimi 6.



Nxënësit ndajnë mendimet e tyre rreth pyetjes dhe grupohen sipas përgjigjeve që kanë dhënë, duke treguar arsyet e përzgjedhjes së tyre dhe dalin në një përfundim:

Pjesëmarrja në sporte jo vetëm që na forcon fizikisht, por na e forcon shpirtin e garës, ndjenjën e fitores dhe durimin për të përballuar çdo vështirësi.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- diskutimin për veprimtaritë sportive në të cilat ka marrë pjesë;
- përgjigjet e pyetjeve duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- bisedën rreth veprimtarive sportive që zhvillohen në shkollën e tij/saj;
- shpjegimin e rëndësisë që ka pjesëmarrja në veprimtaritë e ndryshme sportive;
- vlerësimin e përgjigjeve të shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Shkrimi i datave		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e numra për shkrimin e datave.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– rendit rregullat për shkrimin e datave të ndryshme;– zbaton rregullat drejtshkrimore në shkrimin e datave;– shkruan fjali në të cilat përdor datat e ngjarjeve historike të Shqipërisë;– demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: shkrimi i datave shenja pikësimi shifra arabe shifra romake	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; tabelë ka janë paraqitur rregullat për shkrimin e datave; fisha me fjali ku janë përdorur datat e ngjarjeve të ndryshme historike; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim për njohuritë paraprake;- analizë;- rishikim në dyshe;- shkrim i lirë;- lojë;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tregojnë datën e sotme dhe ta shkruajnë atë në fletë. Ngrihen nxënës/e të ndryshëm/me në tabelë për të shkruar datën. Diskutohet me nxënësit rreth mënyrës së shkrimit të tyre. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimi.			
Veprimtaria e dytë <i>Analizë:</i> Lexohet rubrika “Mbaj mend” e cila në mënyrë të përmblodhur i njeh nxënësit/et me rregullat që duhet të kenë parasysh gjatë shkrimit të datave.			

- ❖ Kur në datat e plota muaji shkruhet me shkronja, nuk vihet shenjë pikësimi ndërmjet ditës, muajit dhe vitit. (2 tetor 2019).
- ❖ Kur në datat e plota muaji shkruhet me shifra arabe ose romake, pas shënimit të datës dhe të muajit vihet nga një pikë. (9.X.2019).
- ❖ Kur data shkruhet pas fjalës që tregon një vend gjeografik, para saj shkruhet fjalëza **më**. (Tiranë, më 9 tetor 2019).

*Diskutohen nën drejtimin e mësuesit/es rregullat për shkrimin e datave.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et do të punojnë ushtrimin 1 i cili synon shkrimin e saktë të datave të dhëna.

Ushtrimin 2 synon shkrimin e datave.

Nxënësit/et do të punojnë individualisht në libër.

Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimin 3. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë në fleta tri fjali, e në të cilat të përdorin datat e ngjarjeve historike të Shqipërisë.

Në përfundimit të punës, mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë, duke shpjeguar mënyrën e shkrimit të datave të përdorura në fjali.

Veprimtaria e pestë

Lojë: Me nxënësit/et në minutat e fundit mund të zhvillohet një lojë. Nxiten të shkruajnë në fleta fjali në të cilat janë përdorur data të ngjarjeve historike të shkruara jo saktë dhe t'i shkëmbejnë me shokët/shoqet që kanë fqinjë për të bërë qortimin e gabimeve.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- zbatimin e rregullave drejtshkrimore në shkrimin e datave;
- dallimin e datave të shkruara jo saktë dhe korrigjimin e tyre;
- shkrimin e fjalive në të cilat përdor datat e ngjarjeve historike të Shqipërisë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Panairi i librit (ora I)		Situata e të nxënit Biblioteka e klasës sonë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;– përshkruan bibliotekën e klasës së tij/saj;– shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja, duke ndërtuar fjali me to;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;– dallon llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;– tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes;– shpjegon rëndësinë që ka krijimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i bibliotekës së klasës;– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tregimin;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup.		Fjalë kyçe: bibliotekë stendë buxhet sipërmarrje panair arsim i mesëm i ulët	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- lexim dhe mendim i drejtuar;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- analizë;- ditari dypjesësh;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të flasin rreth bibliotekës së klasës së tyre, që ata e kanë krijuar vetë. Veprimtaria e dytë Lexim dhe mendim i drejtuar: Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “Panairi i librit”. Udhëzohen nxënësit për leximin e tekstit në paragrafë. Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Më pas iu përgjigjen pyetjeve të bëra nga mësuesi/ja. Ndalesa I Klasa e pestë... deri te... nga më të ndryshmet. Pyetje: Si ndiheshin fëmijët e klasës së pestë? Pse? Ndalesa II Një nga këto veprimtari... deri te... do të ekspozojmë në panair. Pyetje: Cila ishte një nga këto veprimtari? Si do të zhvillohej panairi këtë vit? Pse? Çfarë librash do të ekspozonin nxënësit në panair?v			

Ndalesa III Dita e panairit erdhi... deri te... titujt, autorët etj.

Pyetje:

*Çfarë bënë nxënësit e çdo klase?**Ç'bënin nxënësit para stendave?***Ndalesa IV Teksa vizitonim... deri tek... shtova unë.**

Pyetje:

*Si u shpreh Sindi për këtë panair?**Po Joni, çfarë mendonte për këtë panair?**Cila ishte ideja që i pëlqeu Ejonës?***Ndalesa V Në fund të kësaj veprimtarie... deri në fund.**

Pyetje:

*Çfarë përfituan nxënësit nga ky panair?**Ç'gjë ju bëri më shumë përshtypje në këtë pjesë?*

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje”, për shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe ndërtimin e fjalive me to.

*Lexim me zë: Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit i tregimit.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth tregimit. Ata diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Nxënësit tregojnë përmbajtjen e tregimit me fjalët e tyre.

Veprimtaria e katërt

Analizë: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit tregojnë llojin e tekstit, duke dhënë disa karakteristika të tij.

Nxiten nxënësit të japin argumentin e tyre pse çdo klasë duhet të ketë bibliotekën e saj.

Veprimtaria e pestë

Ditari dypjesësh: Punë në grupe. Nxiten nxënësit të lexojnë me vëmendje fjalinë dhe të zbërthejnë kuptimin e saj.

Fjalja	Komenti
Rrjedha e saj dhe realizimi me sukses i sipërmarrjes sonë na bëri të kuptonim se tashmë ishim vërtet fare pranë kapërcimit në arsimin e mesëm të ulët.	Pas katër viteve ne kishim hyrë në klasën e pestë. Emocionet tona janë të mëdha pasi po mbyllnim një cikël të rëndësishëm të arsimimit tonë. Përfundimi me sukses i minipanairit të librit, aftësive që treguam në menaxhimin e stendës sonë dhe suksesi që patëm me rritjen e buxhetit të klasës nga shitja e librave tregoi se ne tashmë ishim rritur dhe kishim përfituar shumë duke u bërë të gatshëm që në fund të klasës së pestë të hidheshim në arsimin e mesëm të ulët.

Nxënësit dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja, duke ndërtuar fjali me to;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- shpjegimin e rëndësisë që ka krijimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i bibliotekës së klasës;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyre shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Plotëso një skedë për një libër që ke lexuar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Panairi i librit (ora II)		Situata e të nxënit Titujt e librave të lexuar. Skeda e librit të preferuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon përmbajtjen së pjesës, sipas rrjedhës së ngjarjes;– shpjegon rëndësinë që ka krijimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i bibliotekës së klasës;– vlerëson organizimin e një minipanairi të librit në shkollë me pjesëmarrjen e të gjitha klasave me stendat përkatëse;– interpreton në role tregimin;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve.		Fjalë kyçe: bibliotekë stendë buxhet sipërmarrje panair arsim i mesëm i ulët	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- dora e pyetjeve;- bashkëbisedim;- lexim me role;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë titujt e librave që kanë në bibliotekën e tyre personale. *Më pas secili nxënës/e prezanton skedën e përgatitur në shtëpi për librin e preferuar, para klasës.			
Veprimtaria e dytë Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë tregimin zinxhir. Nxënësit tregojnë përmbajtjen e tregimit me anë të organizuesit grafik: Dora e pyetjeve.			
Veprimtaria e tretë Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit/et rreth bibliotekës së klasës së tyre dhe panairit të librit që është zhvilluar në shkollën e tyre dhe nxiten të tregojnë një detaj që i pëlqeu më shumë në mënyrën se si u organizua panairi i librit të fëmijëve.			

Veprimtaria e katërt

Lexim me role: Nxënësit ndahen në grupe, përcaktojnë rolet dhe bëjnë dramatizimin e pjesës. Vihet theksi në leximin me intonacion. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- dallimin e llojit të tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;
- shpjegimin e rëndësisë që ka kontributi i nxënësve për krijimin dhe pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës së klasës;
- vlerësimin e organizimit të një minipanairi të librit në shkollë me pjesëmarrjen e të gjitha klasave me stendat përkatëse;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- interpretimin në role;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Theksi i fjalës (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulim me fjalë me theks të ndryshëm.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon fjalë të ndryshme duke vënë theksin aty ku duhet;– bën dallimin me anë të theksit, të kuptimit të fjalëve të njëjta nga forma;– dallon theksin parafundor, fundor dhe tejfundor në fjalë të ndryshme;– shkruan fjalë me theks fundor, parafundor, tejfundor;– demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: theksi fjalë rrokje e theksuar rrokje e patheksuar toni i zërit theks fundor theks parafundor theks tejfundor	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me fjalë të ndryshme; tabela e ushtrimit 1; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim për njohuritë paraprake;- analizë;- rishikim në dyshe;- diskutim;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë Diskutim për njohuritë paraprake: Mësuesi/ja i orienton nxënësit të vërejnë figurën në libër dhe ta komentojnë atë. Nxiten nxënësit të lidhin fjalët me objektet përkatëse dhe të lexojnë dhe shqiptojnë saktë fjalët. Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjen: Çfarë vini re kur shqiptoni këto fjalë? Zhvillohet një diskutim në klasë rreth njohurive që nxënësit/et kanë për rrokjet, duke u mbështetur edhe në rubrikën “Kujtoj”. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit.			
Veprimtaria e dytë Analizë: Lexohet rubrika “Mbaj mend” e cila në mënyrë të përmblodhur i njeh nxënësit/et me theksin e fjalës, theksin parafundor, fundor dhe tejfundor, duke i ilustruar edhe me shembuj. *Diskutohen rastet kur disa fjalë janë të njëjta nga forma, por ndryshojnë nga theksi. Kur ndryshon theksi, ndryshon edhe kuptimi i fjalëve.			

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimin 1. Nxënësit/et do të emërtojnë çdo figurë në libër dhe më pas do të vendosin theksin në çdo fjalë që do të përdorin.

Ushtrimin 2. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve fleta ku është paraqitur tabela e U. 2 dhe i udhëzon ta plotësojnë atë, duke i shkruar fjalët të vendosura në tri shtylla sipas theksit të tyre.

Nxënësit/et do të punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë fletat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es për të dalluar fjalët me theks parafundor, fundor dhe tejfundor.

Veprimtaria e katërt

Diskutim - Punë në grupe: Grupet u kërkojnë njëri-tjetrit të shkruajnë fjalë me theks fundor, parafundor dhe tejfundor. Pas përfundimit të punës, ata shkëmbejnë fletat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e fjalëve të ndryshme duke vënë theksin aty ku duhet;
- dallimin me anë të theksit të kuptimit të fjalëve të njëjta nga forma;
- dallimin e theksit parafundor, fundor dhe tejfundor në fjalë të ndryshme;
- shkrimin e fjalëve me theks fundor, parafundor, tejfundor;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Theksi i fjalës (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulim me fjalë me theks të ndryshëm.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon fjalë të ndryshme duke vënë theksin aty ku duhet;– dallon theksin parafundor, fundor dhe tejfundor në fjalë të ndryshme;– bën dallimin me anë të theksit të kuptimit të fjalëve të njëjtë nga forma;– shkruan fjalë me theks fundor, parafundor, tejfundor;– krijon fjali me fjalë që kanë formë të njëjtë, por që u ndryshon kuptimi në rast se u ndryshon theksi;– demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: theksi fjalë rrokje e theksuar rrokje e patheksuar toni i zërit theks fundor theks parafundor theks tejfundor	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- shkrim i drejtuar;- diskutim;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalët me theks fundor, parafundor dhe tejfundor dhe të diskutojnë rreth tyre.			
Veprimtaria e dytë Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalët; <i>infirmieri, para, drejtori, polici, stoli</i> dhe të tregojnë nëse ndryshon kuptimi i këtyre fjalëve, në rast se u ndryshon theksi. Nxënësit diskutojnë në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. *Individualisht nxënësit do të ndërtojnë nga dy fjali me secilën prej këtyre fjalëve, në të cilat të dalë qartë kuptimi i tyre. Pas përfundimit të punës, nxënësit lexojnë fjalitë e krijuara dhe diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth tyre.			

Veprimtaria e tretë

Diskutim - Punë në grupe: Grupet u kërkojnë njëri-tjetrit të shkruajnë fjalë me theks fundor, parafundor dhe tejfundor. Pas përfundimit të punës, ata shkëmbejnë fletat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e fjalëve të ndryshme duke vënë theksin aty ku duhet;
- dallimin theksin parafundor, fundor dhe tejfundor në fjalë të ndryshme;
- dallimin me anë të theksit të kuptimit të fjalëve të njëjtë nga forma;
- shkrimin e fjalëve me theks fundor, parafundor, tejfundor;
- krijimin e fjalive me fjalë që kanë formë të njëjtë, por që u ndryshon kuptimi në rast se u ndryshon theksi;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Dhjetat (ora I)		Situata e të nxënit: Cila lëndë të pëlqen më shumë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon pjesën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së pjesës ose rreth fjalëve të panjohura për të;– shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja, krijon fjali me to;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;– shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me tregimin;– tregon përmbajtjen e pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes;– analizon cilësitë e personazheve të tregimit;– formulon mesazhin që përcjell tregimi;– sjell shembuj nga përvoja vetjake e komunikimit me prindërit, rreth nxitjes për të patur rezultate të larta njësoj në të gjitha lëndët;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth pjesës.		Fjalë kyçe: jurist mornica më ra tavani në kokë	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; teksti mësimor; krijime të nxënësve si: poezi, tregime, vizatime, kolazhe etj.; mjete shkrimi, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare të drejtat e njeriut.	
Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - veprimtari e leximit të drejtuar; - harta e personazheve; - mendo-zbulo; - bashkëbisedim; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë me nxënësit ku secili tregon talentin dhe prirjet që ka për lëndë të ndryshme, duke treguar edhe lëndën që u pëlqen më shumë.			
Veprimtaria e dytë			
Veprimtari e leximit të drejtuar: Nxënësit njihen me titullin e pjesës “Dhjetat” dhe autoren e saj Zh. Demi. Lexim me ndalesa i pjesës nga nxënësit. Mësuesi/ja orienton nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve të bëra prej saj për secilën ndalesë, duke u kujdesur të punohen të gjitha pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”. Nisur nga titulli dhe ilustrimi, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo pjesë?			
Ndalesa I Për ca ditë mbyllej... deri te... pas orëve të mësimit.			
Pyetje:			
Çfarë i kishte premtuar djali nënës së tij?			
Cila lëndë i pëlqente më shumë Enisit, shokut të djalit?			
Çfarë i pëlqente djalit?			
Cila ishte dëshira e djalit?			
Çfarë vizatonte ai?			
Si mendoni se do të vazhdojë pjesa?			

Ndalesa II Çdo pasdite luaja pak futboll... deri te... kisha përfituar pak nga situata.

Pyetje:

Si e kalonte kohën djali?

Çfarë notash merrte ai në shkollë?

Po për matematikën, a mund të thuhej e njëjta gjë si për lëndët e tjera për të?

A ia kishte treguar ai prindërve notat që kishte marrë në matematikë? Pse?

Ndalesa III Më vinte mirë... deri te... por koha nuk premtonte.

Pyetje:

Pse Klevisi nuk ua kishte treguar prindërve notat që kishte marrë në matematikë?

Si titullohej vjersha që ai kishte shkruar për vëllain e tij?

Si i dukeshin Klevisit problemat e matematikës?

A mundi ai të sqaronte të gjitha paqartësitë që kishte me Enin në klasë?

Ndalesa IV Mësuesja shpërndau testet... deri te... Dorëzova fletën i bërë kuq në fytyrë.

Pyetje:

Si u ndie Klevisi ditën e provimit?

Ndalesa V Të nesërmen mësuesja na dha vlerësimin... deri te... në shkollë.

Pyetje:

Çfarë note kishte marrë Klevisi në provimin e matematikës?

Si reagoi mami i Klevisit kur mësoi notën e provimit?

Ndalesa VI Të nesërmen mami takoi mësuesen... deri në fund.

Pyetje:

Çfarë bisedoi mami me mësuesen?

Pse mami i kërkoi falje Klevisit?

A ju pëlqeu kjo pjesë? Pse?

Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese?

*Nxënësit lexojnë në heshtje, nënvizojnë fjalët e shprehjet që nuk kuptojnë.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje” në libër. Nxënësit shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe ndërtojnë fjalë me to.

*Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Harta e personazheve: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit dallojnë llojin e pjesës duke dhënë 2-3 karakteristika të saj, si dhe tregojnë dy cilësi për personazhin kryesor dhe gjejnë në tekst fragmentin apo fjalinë ku shprehen këto cilësi.

Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e sipas rrjedhës së ngjarjes.

Veprimtaria e katërt

Mendo-zbullo: Nxiten nxënësit/et të tregojnë pse mami i Klevit ndryshoi qëndrim dhe se çfarë mund t'i ketë thënë mësuesi/ja asaj.

*Nxënësit në grupe do të gjejnë mesazhin që përcjell tregimi si dhe do të dallojnë fjalitë e sakta dhe të gabuara.

Mesazhi: Prindërit duhet të mbështesin prirjet dhe talentin e fëmijëve të tyre, në mënyrë që ata të bëhen të dobishëm për familjen dhe shoqërinë, pa paragjykime dhe standardizime.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Të nxitur nga tregimi ftohen nxënësit në një bashkëbisedim rreth dy çështjeve kryesore: 1. Sa ju motivojnë prindërit tuaj për të arritur rezultate të larta në shkollë?

2. A ndodh që ata e teprojnë më presion për të marrë nota të mira në të gjitha lëndët pa marrë parasysh talentin dhe prirjet tuaja individuale për lëndë të caktuara?

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;
- shpjegimin e fjalëve të reja dhe krijimin e fjalive me to;
- tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes;
- analizën e cilësive të personazheve të tregimit;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;
- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Dhjetat (ora II)		Situata e të nxënit Ç’mendim ke për personazhet e tregimit?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes; – jep mendimin e tij/saj për personazhin kryesor të tregimit; – mban qëndrimin e tij ndaj veprimeve të personazheve në tregim; – lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tij shkollore; – interpreton pjesën në role; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: matematika futboll vizatim nota	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit teksti mësimor; krijime të nxënësve si: poezi, tregime, vizatime, kolazhe etj.; mjete shkrimi, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - dora e pyetjeve; - bashkëbisedim; - lexim me role; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit lexojnë këshillat që u japin Klevisit dhe mamit të tij. Lexim zinxhir i tekstit nga nxënësit. Mësuesi/ja drejton pyetjen: Ç’mendim ke për personazhet e tregimit? Nxiten nxënësit të japin mendimet e tyre.			
Veprimtaria e dytë Dora e pyetjeve: Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e pjesës sipas organizuesit grafik: Dora e pyetjeve.			
Veprimtaria e tretë Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”, ku nxënësit tregojnë ngjarje nga jeta e tyre që kanë lidhje me këtë pjesë.			

Veprimtaria e katërt

Lexim me role: Ndahet klasa në grupe me ndihmën e mësuesit/es. Caktohen rolet brenda grupit. Interpretim i tregimit nga nxënësit në role. Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et vlerësojnë interpretimet e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
 - tregimin e përmbajtjes sipas rrjedhës së ngjarjes;
 - mendimin e tij/saj për personazhin kryesor të tregimit;
 - qëndrimin e tij/saj ndaj veprimeve të personazheve në tregim;
 - lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tij shkollore;
 - interpretimin e pjesës në role;
 - vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.
-

Detyrë shtëpie: Shkruaj në fletore përmbajtjen e pjesës në mënyrë të përmbledhur.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Shkruajmë për vjeshtën		Situata e të nxënit: Material i shkurtër filmik për natyrën në stinën e vjeshtës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– flet për natyrën në stinën e vjeshtës;– u përgjigjet pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e vjeshtës duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;– shkruan për stinën e vjeshtës, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;– shpjegon preferencën e tij/saj për stinën e vjeshtës;– përshkruan se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë;– shkruan për stinën e vjeshtës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: përshkruaj vjeshta natyra njeriu frutat e perimet	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; pamje nga natyra në stinën e vjeshtës; videoprojektor, CD; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim i organizuar;- diskutim;- bashkëbisedim;- shkrim i lirë;- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë Shikim i organizuar: Mësuesi/ja paraqit me anë të videoprojektorit një material të shkurtër filmik për stinën e vjeshtës. Në mungesë të videoprojektorit paraqiten pamje nga natyra në stinën e vjeshtës. Nxiten nxënësit t’i përshkruajnë ato, duke treguar edhe karakteristikat e kësaj stine.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit të shkruajnë përgjigjet e pyetjeve për stinën e vjeshtës duke përzgjedhur në fjalët në kllapa, fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine.

Nxënësit punojnë individualisht në libër. Mësuesi/ja nxit nxënësit të lexojnë përgjigjet e pyetjeve dhe të diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 2. Nxënësit përshkruajnë stinën e vjeshtës, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë. Disa nxënës lexojnë përshkrimet e tyre.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 3. Nxënësit bashkëbisedojnë rreth preferencave të tyre për stinën e vjeshtës, duke i shpjeguar ato me dy fjali. Nxënësit përshkruajnë se ku u pëlqen të shkojnë dhe çfarë u pëlqen të bëjnë në këtë stinë.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 4. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e vjeshtës në vendin ku jetojnë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke respektuar këshillat e dhëna në libër për përshkrimin e kësaj stine. Ata/ato punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- përgjigjet e pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e vjeshtës duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;
- shkrimin për stinën e vjeshtës, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;
- përshkrimin se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë;
- shkrimin për stinën e vjeshtës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj stinën e vjeshtës në fshat.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme		Situata e të nxënit: Manipulim me shkronja, tinguj, rrokje e fjalë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – identifikon shkronjat e thjeshta dhe të përbëra; – vë në dukje se të gjitha shkronjat që paraqesin tingujt e të folurit të gjuhës shqipe përbëjnë alfabetin e saj; – dallon bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme; – demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: fonema shkronja alfabet bashkëtingëllore të zëshme bashkëtingëllore të pazëshme	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; alfabeti i gjuhës shqipe; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - diskutim për njohuritë paraprake; - diskutim; - rishikim në dyshe; - shkëmbe një problemë; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë Diskutim për njohuritë paraprake: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë alfabetin e gjuhës shqipe. Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et. Mësuesi/ja u drejton pyetjet: - Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe? - Sa prej tyre janë zanore? Cilat janë ato? - Sa janë bashkëtingëllore? Cilat janë ato? - Provoni të shqiptoni bashkëtingëlloret. Vini re ndonjë ndryshim gjatë shqiptimit të tyre? Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. Veprimtaria e dytë Punë në dyshe: Orientohen nxënësit të lexojnë pjesën letrare të shkruar nga shkrimtari Odhise Grillo dhe të identifikojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret. Më pas do t'i vendosin ato në tabelën e dhënë. Në përfundim, nxënësit lexojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret që kanë shkruar. Diskutim: Nxiten nxënësit të lexojnë dhe të diskutojnë rreth materialit teorik. Nën drejtimin e mësuesit/es zhvillohet një diskutim rreth tij. Nxiten nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve: <i>Si i quajmë tingujt? Nga e kanë marrë këtë emër?</i> <i>Nga se përbëhet alfabeti i gjuhës shqipe?</i>			

Sa shkronja të përbëra dhe sa shkronja të thjeshta ka gjuha shqipe? Cilat janë ato?

Si i prodhojmë tingujt?

Ç'janë bashkëtingëlloret?

Si klasifikohen bashkëtingëlloret?

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Ftohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe të dallojnë numrin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve që ka fjalia e parë, numrin e shkronjave që ka fjalia e dytë, numrin e shkronjave të thjeshta dhe të përbëra që ka fjalia e fundit, duke plotësuar tabelën në tekst.

Ushtrimin 2. Në tekstin e dhënë në këtë ushtrim, nxënësit do të dallojnë bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme dhe do t'i vendosin në tabelë.

Nxënësit do të punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e katërt

Punë në grupe - Shkëmbe një problemë: Nxënësit në fleta shkruajnë fjali të ndryshme dhe i shkëmbejnë me grupet fqinje për të gjetur bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme që ndodhen në këto fjali.

Pas përfundimit të punës ata diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e shkronjave të thjeshta dhe të përbëra;
- dallimin e bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pazëshme;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie

Gjej dhe shkruaj në fletore një tekst të shkurtër (me 4-5 fjali), dallo në të bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme dhe vendosi në tabelë.

Bashkëtingëllore të zëshme	Bashkëtingëllore të pazëshme

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Vlera e parasë (ora I)		Situata e të nxënit: Si i përdorni paratë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët që nuk kupton dhe gjëra që i duken interesante; – tregon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; – u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit; – dallon protagonistin dhe personazhet e tjera të tregimit, duke vënë në dukje edhe lidhjen që ekziston ndërmjet tyre; – tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në veprimet e personazheve; – formulon mesazhin që përcjell tregimi; – paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; – demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup.		Fjalë kyçe: - para - kartëmonedhë - vlerë	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - procedura: pyet sërish; - marrëdhënie pyetje-përgjigje; - rishikim në dyshe; - mendo-nxirr mesazhin; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth marrëdhënies që kanë me paranë. A ju japin prindërit apo gjyshërit para për të blerë lodra, çokollata apo ëmbëlsira? Si i shpenzoni ju ato? Ju ka ndodhur të qerasni me paratë që ju kanë dhënë prindërit shokët apo shoqet tuaja? Pse nuk duhet t'i shpërdorjmë paratë?			
Veprimtaria e dytë Procedura: pyet sërish: Mësuesi/ja paraqet temën e mësimi dhe fton nxënësit të vërejnë ilustrimin. Nxënësit në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tij. *Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken më interesante dhe më të rëndësishme.			

*Pas leximit të çdo paragrafi, diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri i përgjigjet pyetjeve.

Për çdo paragraf të ri, nxënësit ndërrojnë rolet.

*Nxënësit tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tregim).

Lexim me zë: Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

Cilët janë personazhet e këtij tregimi?

Çfarë kishte ndodhur që babai i dha një kartëmonedhë Nikolasit?

Si reagoi nëna e tij?

Si reagues shokët kur Nikolasi u tregoi kartëmonedhën?

Po mësuesja e tij?

Si reagoi shitësja e çokollatave kur Nikolasi i drejtoi kartëmonedhën?

Çfarë bëri nëna e Nikolasit kur mësoi reagimin e saj?

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në veprimet e personazheve.

Veprimtaria e katërt

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et punojnë individualisht për të treguar protagonistin dhe personazhet e tjera të tregimit, duke vënë në dukje edhe lidhjen që ekziston ndërmjet tyre. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e pestë

Mendo-nxirr mesazhin: Nxënësit/et në grupe nxjerrin mesazhin e pjesës dhe gjejnë në tekst fjalinë që lidhet me të. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Mesazhi: *Duhet t’ia dimë vlerën parasë dhe t’i përdorim ato në mënyrë sa më të arsyeshme.*

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët që nuk kupton dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- dallimin e protagonistit dhe personazheve të tjera të tregimit, duke vënë në dukje edhe lidhjen që ekziston ndërmjet tyre;
- tregimin përmbajtjen së pjesës duke u mbështetur në veprimet e personazheve;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup, vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Vlera e parasë (ora II)		Situata e të nxënit Çfarë këshille i jep Nikolasit për mënyrën se si duhen përdorur paratë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse;– shkruan nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf të tregimit;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– gjykon rreth veprimeve të protagonistit dhe personazheve të tjerë në tregim;– lidh ngjarjen me histori të ngjashme nga jeta e tij/saj;– interpreton pjesën në role;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: para kartëmonedhë vlerë	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; matematikë; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- mendo-diskuto;- bashkëbisedim;- lexim me role;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë ku nxënësit i japin këshilla Nikolasit për mënyrën se si duhen përdorur paratë. Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir.			
Veprimtaria e dytë			
Punë në grupe: Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të krijuar nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf të tregimit. Lexim i tyre nga nxënësit.			
1. Babi i fali Nikolasit një kartëmonedhë meqë kishte dalë mirë në provimin e Historisë.			
2. Babai ishte i bindur se Nikolasi do t'i shpenzonte paratë në mënyrë të arsyeshme.			
3. Nikolasi mendonte të blinte një aeroplan me to.			
4. Ryfysi propozoi që të blinin një top futbollit që të luanin të gjithë.			
5. Mësuesja e këshilloi Nikolasin që të mos i shpenzonte paratë duke blerë kotësira.			
6. Alcesti i propozoi të blinte çokollata.			
7. Shitësja nuk e besoi Nikolasin dhe e urdhëroi ta dorëzonte kartëmonedhën ku e kishte marrë.			
8. Nikolasi ia tregoi ngjarjen nënës së tij.			

9. *Me monedhën njëzetqindarkëshe që i dha mami, Nikolasi mendoi të blinte një çokollatë dhe ta ndante me shokun e tij, Alcestin.*

*Nxënësit tregojnë përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Veprimtaria e tretë

Mendo-diskuto: Punohet rubrika “Reflektoj”.

Mësuesi/ja fton nxënësit të japin mendimin e tyre rreth veprimit të babait që i dhuroi Nikolasit një kartëmonedhë dhe fjalëve të nënës se ajo kartëmonedhë ishte tepër për Nikolasin.

Nxënësit/et në fillim diskutojnë në dyshe. Më pas diskutojnë me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Zhvillohet një bashkëbisedim në klasë, ku nxënësit tregojnë nëse prindërit u kanë dhuruar ndonjëherë ndonjë kartëmonedhë dhe përse e kanë përdorur atë.

Veprimtaria e pestë

Lexim me role: Nxënësit ndahen në grupe, përcaktojnë rolet dhe bëjnë dramatizimin e pjesës. Vihet theksi në leximin me intonacion. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe në mënyrë shprehëse;
- shkrimin e fjalive përmbledhëse për çdo paragraf;
- tregimin e përmbajtjes së tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- gjykimin rreth veprimeve të protagonistit të tregimit dhe personazheve të tjerë;
- interpretimin e pjesës në role;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj në fletore shkurtimisht përmbajtjen e pjesës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Flasim Shokë të mirë		Situata e të nxënit Kush është shoku/shoqja më e mirë që ke në klasë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– flet për vlerën e miqësisë;– u përgjigjet pyetjeve duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– tregon rreth sjelljeve dhe qëndrimeve që e forcojnë miqësinë;– nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për ngjarje të ngjashme si ajo në tekst dhe të tregojnë se si e kanë zgjidhur atë;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj rreth krijimit, ruajtjes dhe forcimit të miqësisë;– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve rreth miqësisë së mirë, mirëkuptimit dhe zgjidhjes me dialog dhe tolerancë të çdo mosmarrëveshjeje që mund të cenojë miqësinë e mirë;– vlerëson përgjigjet e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: shok shoqe miqësi ndihmoj shoqërohem	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; foto ku nxënësit kanë dalë me shokët ose shoqet e tyre; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë- mendo-zbulo- diskutim- bashkëbisedim- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth marrëdhënieve shoqërore që ata kanë me njëri-tjetrin, grindjeve, mosmarrëveshjeve që kanë pasur ndërmjet tyre. Cili është shoku apo shoqja juaj më e mirë që ke në klasë? A i ndihmoni ju shokët apo shoqet tuaja?			
Ju ka ndodhur të jeni grindur ndonjëherë me ndonjë shok apo shoqe? Jeni pajtuar më pas apo keni qëndruar larg njëri-tjetrit? Pse thuhet se miku i mirë njihet në ditë të vështira?			

Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë diskutimet e nxënësve/eve të klasës së Jehonës për vlerën e miqësisë.

Veprimtaria e dytë

Mendo-zbullo: Ushtrimi 1. Nxiten nxënësit të shprehin mendimin e tyre për diskutimin që është zhvilluar në klasën e Jehonës dhe të tregojnë se te fjalët e cilit prej tyre e gjen më shumë veten.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Ushtrimi 2, 3. Nxënësit tregojnë për marrëdhëniet që kanë me shokët dhe shoqet e klasës, ndihmën që ata/ato i japin njëri-tjetrit për të kryer detyrat shkollore.

Nxiten nxënësit të tregojnë se si janë ndier pas bashkëpunimit që kanë pasur.

Ushtrimi 4. Nxënësit diskutojnë rreth fjalëve të Jehonës, se si i kuptojnë ato.

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Ushtrimi 5. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit rreth ndonjë ngjarje të pakëndshme që ka ndodhur në klasën e tyre dhe se si e kanë zgjidhur atë.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përgjigjet e pyetjeve duke u shprehur saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota;
- tregimin rreth sjelljeve dhe qëndrimeve që e forcojnë miqësinë;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj rreth krijimit, ruajtjes dhe forcimit të miqësisë;
- vlerësimin për përgjigjet e shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Gjej dhe shkruaj 2 fjalë të urta për miqësinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Deni dhe shoku i tij i ri (ora I)		Situata e të nxënit Ç’ mendim keni për kafshët?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;– pyet dhe përgjigjet rreth përmbajtjes së tregimit;– përcakton hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit, duke ndërtuar nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– formulon mesazhin që përcjell tregimi;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve/ shoqeve.		Fjalë kyçe: keci i vogël gjuetarë të paligjshëm injeksion i babëzitur	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; ilustrime të dhisë dhe kecape; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - procedura: pyet sërish; - marrëdhënie pyetje-përgjigje; - dallo-trego; - ditari dypjesësh; - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit në një bisedë ku të japin mendimin e tyre për kafshët, preferencat e tyre për to Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimi “Deni dhe miku i tij”. *Koment nga nxënësit i ilustrimit në libër.			
Veprimtaria e dytë Procedura - pyet sërish: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tregimin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken më interesante e më të rëndësishme. *Pas leximit të çdo paragrafi nxënësit diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri/a i përgjigjet pyetjeve.			

Për çdo paragraf të ri nxënësit ndërrojnë rolet.

*Në përfundim të punimit të të gjithë pjesës, nxënësve/eve u lihet kohë për ta rilexuar për ta kuptuar më mirë.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje” në libër. Nxiten nxënësit të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe të ndërtojnë fjali me to.

*Lexohet tregimi nga nxënësit zinxhir.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Në rubrikën “Analizoj”, mësuesi/ja nxit nxënësit të tregojnë llojin e tekstit, duke dhënë disa karakteristika të tij. Nxënësit punojnë në grupe për të përcaktuar hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tregimit dhe të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Veprimtaria e pestë

Ditari dypjesësh: Ftohen nxënësit që të punojnë në grupe për të zgjedhur një fragment në tregim dhe ta komentojnë atë.

Fragmenti	Komenti
Kafsha i pëlqente pa masë. Po t’ia linin atij në kujdestari, mendonte, do të bënte të pamundurën t’ia zëvendësonte nënën, duke e ushqyer me biberon derisa të shërohej dhe do ta mbronte nga tërë rreziqet.	Deni e ndihmoi kecin e vogël të ushqehet. Ai fitoi një përvojë të panjohur më parë e cila i përforcoi idenë se mund ta ushqente atë derisa keci të ushqehet nga e ëma. Sjellja e tij është një shembull i mirë se si duhet të sillemi ndaj kafshëve në raste të tilla.

Nxënësit dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre.

Nxiten nxënësit që në grupe të nxjerrin mesazhin e tregimit.

Mesazhi: Të kujdesemi për kafshët dhe t’i mbrojmë ato.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;
- pyetjet dhe përgjigjet rreth përmbajtjes së tregimit;
- përcaktimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së tregimit, duke ndërtuar nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre dhe tregimin e përmbajtjes;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrës shtëpie: Gjej informacione për gjuetinë e paligjshme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Deni dhe shoku i tij i ri (ora II)		Situata e të nxënit Ç' qëndrim keni ndaj gjuetisë së paligjshme?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon përmbajtjen e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes;– analizon veprimet e personazheve të tregimit;– jep mendimin e tij për pasojat që shkakton gjuetia e paligjshme;– shkruan një vazhdim për tregimin;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve.		Fjalë kyçe: keci i vogël gjuetarë të paligjshëm injeksion i babëzitur	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; informacione nga interneti për gjuetinë e paligjshme; foto të kafshëve dhe shpendëve të rralla; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- dora e pyetjeve;- mendo-gjyko;- shkrim i lirë;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësimi nis me leximin e informacione për gjuetinë e paligjshme. Mësuesi/ja fton nxënësit të japin mendimet e tyre për gjuetinë e paligjshme. *Lexim i tregimit zinxhir nga nxënësit. Veprimtaria e dytë <i>Dora e pyetjeve:</i> Nxënësit tregojnë përmbajtjen e tregimit sipas organizuesit grafik: Dora e pyetjeve. Veprimtaria e tretë <i>Mendo-gjyko:</i> Në rubrikën “Reflektoj” nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve nxënësit analizojnë veprimet e Denit dhe të babait të tij, si dhe japin mendimin e tyre për gjuetinë e paligjshme.			

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Rubrika “Reflektoj”. Nxënësit do të punojnë individualisht për të shkruar vazhdimin e kësaj historie me 5-6 fjali.

Pas përfundimit të punës, mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë krijimet e tyre me zë para klasës.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- tregimin e përmbajtjes së tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes;
- analizën e veprimeve të personazheve të tregimit;
- mendimet e dhëna për pasojat që shkakton gjuetia e paligjshme;
- shkrimin e vazhdimin të tregimit;
- vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Një vizitë në fermë (ora I)		Situata e të nxënit Pamje filmike nga një vizitë në fermë. (ose fotografi)	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan një fermë që ka vizituar;– plotëson një tregim të shkurtër për një vizitë në fermë, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përzgjedhur fjalët në kllapa;– shkruan një tregim të shkurtër për një vizitë në fermë, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: tregim personazhe vend kohë fermë vizitoj kafshë shpendë ngastra të mbjella me perime pemë frutore përshtypje emocione	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; pamje nga ferma; pamje filmike për një vizitë në fermë; CD, videoprojektor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; mjedisi; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: -shikim i organizuar;bisedë; - rishikim në dyshe; - shkrim i drejtuar; - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Shikim i organizuar, bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin me anë të videoprojektorit një material të shkurtër filmik për një vizitë në fermë. (Në mungesë paraqiten foto.) Zhvillohet një bisedë rreth tyre. *Nxiten nxënësit të tregojnë për mbresat e tyre nga një vizitë në fermë. - A keni vizituar ndonjë fermë? - Çfarë keni parë atje? - Ç’gjë ju ka bërë përshtypje? - Çfarë punësh bëjnë fermerët?			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Njihen nxënësit me temën e mësimit.

Mësuesi/ja fton nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër për një vizitë në fermë, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përzgjedhur fjalët në kllapa.

Udhëzohen nxënësit të vërejnë ilustrimet dhe t'i përshkruajnë ato.

Mësuesi/ja u kujton nxënësve se:

- a) *një tregim i vërtetë duhet të ketë personazhe, vend dhe kohë të përcaktuar që në hyrje;*
- b) *gjatë zhvillimit ngjarjet duhet të renditen siç kanë ndodhur në të vërtetë;*
- c) *në mbyllje trego përshtypjet që të la vizita në fermë.*

Nxënësit punojnë individualisht në libër. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Mësuesi/ja nxit nxënësit të lexojnë përgjigjet e pyetjeve dhe të diskutojnë rreth tyre.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Nxënësit shkruajnë të plotë tregimin në fletore, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje.

Pas përfundimit të punës, nxënësit lexojnë shkrimet e tyre.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.


Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e një ferme që ka vizituar;
- plotësimin e një tregimi të shkurtër për një vizitë në fermë, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përzgjedhur fjalët në kllapa;
- shkrimin e një tregimi të shkurtër për një vizitë në fermë, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Një vizitë në fermë (ora II)		Situata e të nxënit Përshkrim i vendeve të vizituara.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan një vend që ka vizituar duke treguar edhe përshtypjet e tij/saj dhe emocionet që ka përjetuar;– shkruan një tregim të shkurtër sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, për një vend që ka vizituar;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime të gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalët kyçe: tregim personazhe vend kohë përshtypje emocione	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; skema e ndërtimit të një tregimi; pamje nga qyteti, pamje nga një fabrikë qelqi, pamje nga muzeu i Krujës; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; mjedisi; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- shkrim i lirë;- konkurs;- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë për vendet që kanë vizituar, përshtypjet dhe emocionet që kanë përjetuar, duke i ilustruar me foto.			
Veprimtaria e dytë Shkrim i lirë: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër, duke organizuar punën me shkrim sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje. Mund të zgjedhin njërën nga temat: <i>Një vizitë në qytet.</i> <i>Një vizitë në fabrikën e qelqit.</i> <i>Një vizitë në muzeun e Krujës.</i>			

Nën drejtimin e mësuesit/es, nxënësit rikujtojnë strukturën e ndërtimit të tregimit.



Ngjarjet duhet të renditen siç kanë ndodhur në të vërtetë.

Nxënësit punojnë individualisht në fletore. Në përfundim të punës lexojnë detyrën para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es qortohen gabimet drejtshkrimore.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin për shkrimin e tregimit sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, fjalorin e përdorur, ndërtimin e fjalisë, përjetimet e tyre etj.

Veprimtaria e tretë

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri shkrimet më të mira. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e një vendi që ka vizituar duke treguar përshtypjet e tij/saj dhe emocionet që ka përjetuar;
- shkrimin e një tregimi të shkurtër sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Përzgjidh një temë tjetër në ushtrimin 3 dhe shkruaj një ndodhi personale.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Gjuha jonë Kuptimi i parë dhe kuptimi i figurshëm i fjalëve		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">dallon fjalët kur janë përdorur në kuptimin e tyre të parë dhe kur janë përdorur në kuptime të figurshme;tregon fjalë kur janë përdorur në kuptimin e tyre të parë dhe kur janë përdorur në kuptime të figurshme;krijon fjali me fjalë ku t’i përdorë ato në kuptimin e tyre të parë dhe në kuptime të figurshme;demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalët kyçe: kuptimi i parë i fjalës kuptimi i figurshëm i fjalës	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fjalor i gjuhës shqipe; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">diskutim;rishikim në dyshe;shkrim i drejtuar;punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë <p>Diskutim: Njihen nxënësit me temën e mësimin. Orientohen të vërejnë figurat në libër dhe të diskutojnë rreth tyre. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë në heshtje dhe të dallojnë kuptimin që ka fjala “grykë” në secilën prej fjalive.</p> <p>Zhvillohet një diskutim me nxënësit nën drejtimin e mësuesit/es për të dalluar kuptimin e parë të fjalës (gryka e njeriut), si dhe kuptimet e figurshme (gryka e trikos, gryka e shishes, gryka e malit etj.). Nxiten nxënësit të lidhin shprehjet me kuptimin e fjalës “grykë”.</p>			
Veprimtaria e dytë <p>Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit të dallojnë fjalët kur janë përdorur në kuptimin e tyre të parë dhe kur janë përdorur në kuptime të figurshme.</p> <p>Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Diskutohet me gjithë klasën rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.</p>			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Nxiten nxënësit të kërkojnë në fjalorin e gjuhës shqipe fjalët: *këmbë, kokë, kafshë*. Të shkruajnë nga dy fjali për secilën prej tyre, ku t'i përdornin në kuptime të ndryshme. Nxënësit/et të ndihmuar nga mësuesi/ja përdorin fjalorin e gjuhës shqipe për të gjetur kuptimet e ndryshme të këtyre fjalëve.

Pas përfundimit të punës, nxënësit lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e fjalëve kur janë përdorur në kuptimin e tyre të parë dhe kur janë përdorur në kuptime të figurshme;
- krijimin e fjalive me fjalë ku t'i përdorë ato në kuptimin e tyre të parë dhe në kuptime të figurshme;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3

Pse ishte e lumtur pema?

Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa e dytë: Por koha kaloi... deri te... pema ishte e lumtur.

Pyetje:

Pse ngeli pema e vetmuar? / Çfarë i ofroi pema djalit? / Çfarë i sugjeroi pema djalit që ai të fitonte para? / Po djali a e dëgjoji pemën? / Pse u ndie e lumtur pema? / Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa e tretë: Pastaj një ditë tjetër... deri te... Dhe pema u lumturua.

Pyetje:

Për çfarë e ftoi pema djalin një ditë tjetër? / Çfarë dëshirash kishte djali? / Çfarë i kërkoi ai tani pemës? / Çfarë i ofroi pema djalit që ai të ndërtonte shtëpinë? / Po djali si veproi? Si u ndie pema? Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa e katërt: Por djali ndenji larg për shumë kohë... deri te... po jo dhe aq.

Pyetje:

Çfarë dëshirë kishte djali kësaj here? / Përse e donte ai barkën? / Çfarë e këshilloi pema? Ku shkoi djali me barkën që ndërtoi? / Përse pema kësaj radhe nuk ishte shumë e lumtur?

Ndalesa e pestë: Kaloi shumë kohë... deri te... tha djali.

Pyetje:

A i kishte mbetur gjë tani pemës për t'ia ofruar djalit?

Po djali a mund t'i hante tashmë mollët, të kolovitej në degë, të kacavirrej në trungjet e saj? Pse?

Ndalesa e gjashtë: Më vjen keq... deri në fund.

Pyetje:

Çfarë kërkonte djali në fund prej pemës? Pse?

Çfarë i ofroi pema? Po djali si veproi?

A u lumturua pema? Pse?

Çfarë ju bëri përshtypje në këtë pjesë?

*Punohet rubrika “Fjalor” në libër. Nxiten nxënësit të shpjegojnë fjalët e reja dhe të ndërtojnë fjali me to. Lexim zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

***Marrëdhënie pyetje-përgjigje:** Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth protagonistëve të këtij tregimi dhe përmbajtjes së tij.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika: “Analizoj”, nxënësit do të dallojnë se ç’personazh është pema dhe ç’lloj tregimi është, duke qarkuar alternativën e saktë.

*Nxënësit u përgjigjen pyetjeve në rubrikën: “Reflektoj”.

Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen sipas rrjedhës së ngjarjes.

Veprimtaria e pestë

Lexim me role: Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ndahen rolet për çdo grup (djali, pema, autori) dhe kërkon që nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit ushtrohen në lexim me zë, sipas roleve. Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- parashikimet e dhëna në lidhje me tregimin;
- tregimin e llojit të tekstit duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij;
- përgjigjet e pyetjeve rreth protagonistëve të tregimit dhe përmbajtjes së tij;
- tregimin e përmbajtjen sipas rrjedhës së ngjarjes;
- interpretimin në role;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyre shtëpie: Shkruaj në fletore pjesën që të pëlqen më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes.

Fusha: Gjuhët dhe Komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Gjuha jonë Sinonimet, antonimet dhe homonimet (ora I)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë për të dalluar si- nonimet, antonimet dhe homonimet.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon fjalët me kuptim të njëjtë ose afërsisht të njëjtë;– dallon fjalët me kuptim të kundërt;– vë në dukje që homonimet janë fjalë që kanë formë të njëjtë, por kuptime të ndryshme;– gjen sinonime (antonime) të fjalëve (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);– demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalët kyçe: fjalë me kuptim të njëjtë ose të përafërt fjalë me kuptim të kundërt fjalë që kanë formë të njëjtë, por kuptime të ndryshme sinonime antonime homonime	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me fjalë me kuptim të njëjtë dhe të afërt, me fjalë me kuptim të kundërt, me fjalë që kanë formë të njëjtë por kuptime të ndryshme; figura; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskuto-nxirr përfundimin;- rishikim në dyshe;- shkrim i drejtuar;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Diskuto-nxirr përfundimin: Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimit. Orientohen nxënësit që në rubrikën “Kujtoj” të vëzhgojnë figurat, të lexojnë dialogët, duke u përqendruar te fjalët me shkronja të zeza. U drejtohen nxënësve pyetjet: Për figurën e parë: - Si mendoni për fjalët apartament dhe shtëpi , a kanë kuptim të njëjtë? Për figurën e dytë: - Fjalët majtas dhe djathtas , ç’kuptim kanë? Për figurën e tretë: - Çfarë vini re te fjalët e nënvizuara? Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë rreth sqarimeve që jepen në tekst për sinonimet, antonimet dhe homonimet.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë individualisht në libër ushtrimet 1, 2, 4.

Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Diskutohet me gjithë klasën rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimet 3. Mësuesi/ja fton nxënësit të përdorin në fjali 4 nga grupet e fjalëve sinonime që gjetën në ushtrimin 1.

Pas përfundimit të punës, nxënësit lexojnë fjalitë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e fjalëve me kuptim të njëjtë ose afërsisht të njëjtë, si dhe fjalëve me kuptim të kundërt;
- vënien në dukje që homonimet janë fjalë që kanë formë të njëjtë, por kuptime të ndryshme;
- gjetjen e sinonimeve (antonimeve) të fjalëve (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Gjuha jonë Sinonimet, antonimet dhe homonimet (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulim me fjalë për të dalluar sinonimet, antonimet dhe fjalë me kuptime homonimike.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– gjen sinonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);– gjen antonime të fjalëve të dhëna (emra, folje, mbiemra, ndajfolje);– tregon larmishmëri të shprehuri dhe pasuri të leksikut, duke përdorur sinonimet;– shpjegon kuptimin e homonimeve të përdorura në fjali;– përdor në fjali sinonime, antonime si dhe fjalë me kuptime homonimike;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalët kyçe: fjalë me kuptim të njëjtë ose të përafërt fjalë me kuptim të kundërt fjalë që kanë formë të njëjtë, por kuptime të ndryshme sinonime antonime homonime	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me fjalë me kuptim të njëjtë dhe të afërt, me fjalë me kuptim të kundërt, me fjalë që kanë formë të njëjtë por kuptime të ndryshme; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - diskutim; - dallo-trego; - shkrim i drejtuar; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Diskutim: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit lexojnë fjalitë e krijuara me grupet e fjalëve antonime, duke rikujtuar edhe njohuritë e marra për sinonimet, antonimet dhe homonimet. <div><div><div>sinonime</div><div>fjalë me kuptim të njëjtë ose afërsisht të njëjtë (rrugë-udhë)</div></div><div><div>antonime</div><div>fjalë me kuptim të kundërt (i bardhë- i zi)</div></div><div><div>Homonimet</div><div>Fjalë që kanë formë të njëjtë, por kuptime të ndryshme.</div></div></div>			

Nxiten nxënësit që të punojnë në grupe për të shkruar fjalë sinonimike dhe antonimike dhe të krijojnë fjali me to.

Veprimtaria e dytë

Dallo-trego: Ushtrimi 7 synon që nxënësit të shpjegojnë kuptimin e çdo homonimi të dhënë në fjali.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 8 synon që nxënësit të përdorin në fjali fjalët: *ballë, bankë, verë, bel*, në kuptime homonimike.

Nxënësit punojnë individualisht. Në përfundim lexojnë fjalitë para klasës. Zhvillohet një diskutim rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- gjetjen e sinonimeve (antonimeve) të fjalëve të dhëna;
- shpjegimin e kuptimit të homonimeve të përdorura në fjali;
- përdorimin në fjali të sinonimeve dhe antonimeve si dhe fjalëve me kuptime homonimike;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpi: Ushtrimi 6

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Roboti Norbi (ora I)		Situata e të nxënit Lodra e preferuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon pjesën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;– shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe ndërton fjali me to;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;– dallon elementet reale dhe elementet fantastike të tregimit;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në veprimet e personazheve;– përshkruan karakterin e personazhit të Norbit;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: robot flije mendjen zverk nuk bëri gëk filloi ta humbte durimin i përçarë ujk i vjetër mos të të gënjejë mendja; makut i kalamendur	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- procedura pyet sërish;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit në një bisedë rreth lodrave me të cilat luajnë. - Cilat janë lodrat me të cilat luani? Cila ka qenë lodra juaj më e preferuar? - Luani me robotë-lodër? Përshkruaje atë.			
Veprimtaria e dytë Procedura - pyet sërish: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tregimin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken më interesante e më të rëndësishme. *Pas leximit të çdo paragrafi nxënësit diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri/a i përgjigjet pyetjeve.			

Për çdo paragraf të ri nxënësit ndërrojnë rolet.

*Në përfundim të punimit të gjithë pjesës, nxënësve u lihet kohë për ta rilexuar për ta kuptuar më mirë.

*Nxënësit diskutojnë ndërmjet tyre dhe tregojnë llojin e pjesës (tregim), duke vënë në dukje disa nga karakteristikat.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje” në libër. Nxiten nxënësit të shpjegojnë kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe të ndërtojnë fjali me to.

*Lexohet tregimi nga nxënësit zinxhir.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth protagonistëve të këtij tregimi dhe përmbajtjes së tij.

Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës në mënyrë të përmbledhur.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit punojnë në dyshe të gjejnë elementet reale dhe fantastike të këtij tregimi dhe më pas i diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit të përshkruajnë karakterin e Norbit.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe ndërtimin e fjalive me to;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- dallimin e elementeve reale dhe fantastike të tregimit;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës në mënyrë të përmbledhur;
- përshkrimin që bëjnë për karakterin e personazhit të Norbit;
- vlerësimin për shokët e shoqet.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Roboti Norbi (ora II)		Situata e të nxënit Imagjinatë e një dite me Norbin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon nëse do të donte të kishte një robot si Norbin dhe arsyen e përzgjedhjes;– përcakton pjesën që pëlqen më shumë duke treguar arsyen e përzgjedhjes;– interpreton në role pjesën;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve.		Fjalë kyçe: robot Norbi Xhefi karakter i veçantë	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- bashkëbisedim;- lexim me role;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit lexojnë përshkrimet që kanë bërë sipas imagjinatës së tyre, sikur kalojnë një ditë me Norbin. Lexim i tregimit nga nxënësit. Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tij.			
Veprimtaria e dytë Bashkëbisedim: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit të tregojnë nëse ata do të donin të kishin një robot si Norbi dhe pse. Nxiten nxënësit të shkruajnë pjesën që u pëlqen më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes.			

Veprimtaria e tretë

Lexim me role: Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ndahen rolet për çdo grup (Xhefi, roboti Norbi, autori) dhe kërkon që nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës.

Më pas, nxënësit ushtrohen në lexim me zë, sipas roleve. Vihet theksi në leximin me intonacion. Nxënësit vlerësojnë interpretimet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- përcaktimin e pjesës që i pëlqen më shumë duke treguar edhe arsyen e përzgjedhjes;
- interpretimin në role të pjesës;
- bashkëpunimin në grupe si edhe vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Tedi kërkon... (ora I)		Situata e të nxënit Fantazia ime.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan veçoritë e një tregimi fantastik;– përdor imagjinatën dhe fantazinë e tij/saj për të plotësuar një tregim fantastik;– plotëson një tregim fantastik, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përzgjedhur fjalët në kllapa;– shkruan një tregim fantastik sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalët kyçe: tregim fantastik personazhe fantastike elemente fantastike situata problematike jashtëtokësorë galaktika hyrja zhvillimi mbylla fantazi	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; tregime fantastike; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; diskutim; shkrim i lirë; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë: Nxiten nxënësit të tregojnë filma fantastikë që kanë parë, apo tregime fantastike për fëmijë që kanë lexuar. Nxiten nxënësit të tregojnë pse i tërheqin tregimet fantastike dhe filmat fantastikë.			
Veprimtaria e dytë			
Diskutim: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit “Tedi kërkon...”. *Njihen nxënësit me kërkesën e ushtrimit 1. *Komentohen figurat. Nxiten nxënësit të diskutojnë në dyshe rreth figurave dhe më pas me gjithë klasën. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit si të shkruajnë një tregim të shkurtër fantastik, duke pasur parasysh që në një tregim fantastik duhet të ketë vend, kohë dhe ngjarje fantastike. Tregimi fillon duke prezantuar personazhet dhe duke përshkruar ambientin ku zhvillohet ngjarja. Më pas, gjatë zhvillimit, shkruaj çfarë ndodh, me çfarë duhet të përballen personazhet. Në mbyllje të historisë tregohet si përfundon ngjarja. Nxënësit punojnë individualisht në libër për të plotësuar tregimin fantastik duke iu përgjigjur pyetjeve, duke përzgjedhur fjalët në kllapa. Në fund lexohen nga nxënësit përgjigjet e shkruara prej tyre.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 2. Udhëzohen nxënësit/et të shkruajnë të plotë tregimin e U.1 në fletore, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje.

Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit të lexojnë tregimin fantastik me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Nxënësit vlerësojnë krijimet e njëri-tjetrit.

Vlerësohen nxënësit për plotësimin e tregimit fantastik.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e veçorive të një tregimi fantastik;
- plotësimin e një tregimi fantastik, duke u mbështetur te figurat dhe duke iu përgjigjur pyetjeve;
- shkrimin e një tregimi fantastik sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj përmbajtjen e një filmi fantastik për fëmijë që ke parë.


Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Tedi kërkon... (ora II)		Situata e të nxënit Fantazia ime.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon karakteristikat e një tregimi fantastik;– përdor elementet fantastike për të shkruar një tregim të shkurtër fantastik;– shkruan një tregim të shkurtër fantastik sipas fantazisë së tij, duke përdorur elementet fantastike;– shkruan duke respektuar strukturën: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalët kyçe: tregim fantastik elemente fantastike personazhe fantastike situata problematike struktura: hyrje-zhvillim-mbyllje fantazi	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; tregime fantastike; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: -bisedë; - shkrim i lirë; - konkurs; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Bisedë: Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të bashkëbisedojnë rreth përfytyrimeve të tyre për ngjarje dhe personazhe fantastike. -Të nisur nga përralla me elemente fantastike, nga tregime fantastike apo filma të kësaj natyre që keni parë, a ju është nxitur frymëzimi për të krijuar ju vetë tregime fantastike të shkurtra me këto personazhe apo me personazhe të reja? -A ju pëlqen që të fantazoni për gjëra që e bëjnë më zbavitëse jetën rreth jush, pa prishur orientimin realist ndaj jetës? -Flisni për momente krijuese ku keni pasur dëshirë që të fantazoni.			
Veprimtaria e dytë			
Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Orientohen nxënësit që nëpërmjet një shkrimi të lirë të shkruajnë një tregim fantastik me një nga temat e dhëna:			

“Shoku im: histori miqësie me jashtëtokësorë.”

“Kalorësit trima-histori me mbretëreshë dhe kalorës.”

“Aventurat gjatë një ekskursioni. Ja çfarë ndodh kur humbet rrugën në pyll.”

Nën drejtimin e mësuesit/es, nxënësit rikujtojnë strukturën e ndërtimit të tregimit fantastik.



*Prezantohen personazhet,
përshkruhet mjedisi
ku zhvillohet ngjarja.*

Tregojmë si përfundon ngjarja.

*Shkruajmë çfarë ndodh,
me çfarë duhet të përballen personazhet.*

Mësuesi/ja jep udhëzimet e duhura për shkrimin e një tregimi të shkurtër fantastik ku subjekti të jetë tërheqës, personazhet interesante, rrëfimin e ngjarjes të jetë mbresëlënëse dhe me të papritura, fjalori i përdorur t’i përshtatet temës, ndërtimi i fjalive të bëhet duke respektuar rregullat gramatikore, si dhe duke respektuar strukturën: hyrje-zhvillim-mbyllje.

Veprimtaria e tretë

Konkurs: Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit të lexojnë me zë para klasës tregimet e tyre fantastike të krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Nxënësit vlerësojnë tregimet e njëri-tjetrit.

Një juri e përbërë nga dy nxënës/e dhe mësuesi/ja jep çmimet për tri vendet e para.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e karakteristikave të një tregimi fantastik;
- përdorimin e elementeve fantastike për të shkruar një tregim fantastik;
- shkrimin e një tregimi fantastik sipas fantazisë së tij/saj, duke përdorur elementet fantastike;
- shkrimin duke respektuar strukturën: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyre shtëpie

Përzgjidh një temë tjetër në ushtrimin 3 dhe shkruaj një tregim të shkurtër fantastik.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Mika (ora I)		Situata e të nxënit Film i shkurtër me personazhe nga kozmosi.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalë dhe shprehje që i duken interesante;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tregimit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– vë në dukje personazhet dhe cilësitë e tyre;– dallon llojin e tregimit, duke treguar 2-3 karakteristika të tij;– tregon përmbajtjen e tregimit, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– vlerëson rëndësinë e pyetjes për të shprehur inteligjencë dhe vizion për të ardhmen;– pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth mënyrës së jetesës dhe zakoneve që vijnë nga një tjetër përvojë njerëzore;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: Mika Joakini forca e rëndësës udhëtim planet tjetër	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; CD, videoprojektor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore; mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim i organizuar;- procedura pyet sërish;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Shikim i organizuar: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin disa sekuenca të një filmi me personazhe nga kozmosi.			
Veprimtaria e dytë			
Procedura - pyet sërish: Njihen nxënësit me titullin e pjesës “Mika”. Komentohet figura në libër. Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tregimin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken më interesante e më të rëndësishme. *Pas leximit të çdo paragrafi nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri/a i përgjigjet pyetjeve. Për çdo paragraf të ri nxënësit ndërrojnë rolet. *Në përfundim të punimit të të gjithë pjesës, nxënësve u lihet kohë për ta rilexuar për ta kuptuar më mirë. Lexohet tregimi nga nxënësit zinxhir.			

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje–përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth protagonistëve të këtij tregimi dhe përmbajtjes së tij.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego - Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/ të plotësojnë tabelën me mbiemrat që tregojnë cilësitë e secilit personazh. Në përfundim përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

*Nxiten nxënësit që në grupe ta ndajnë tekstin në pjesë dhe të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse për to. Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e tregimit, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

*Nxënësit diskutojnë ndërmjet tyre dhe tregojnë llojin e pjesës (tregim fantastik), duke treguar se nga cilat elemente e kupton këtë.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalë dhe shprehje që i duken interesante;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tregimit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- dallimin e personazheve dhe cilësive të tyre;
- dallimin e llojit të tregimit, duke treguar 2-3 karakteristika të tij;
- ndarjen e tregimit në pjesë dhe krijimin e fjalive përmbledhëse për to;
- tregimin e përmbajtjes duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- vlerësimin për shokët dhe shoqet.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Mika (ora II)		Situata e të nxënit Personazhi fantastik i preferuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon se si ka vepruar kur u ka ndodhur të takojë ndonjë fëmijë që duket dhe sillet ndryshe nga ai/ajo;– formulon mesazhin që përcjell tregimi;– vlerëson rëndësinë e pyetjes për të shprehur inteligjencë dhe vizion për të ardhmen;– interpreton në role tregimin;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve.		Fjalë kyçe: Mika Joakini forca e rëndësës udhëtim planet tjetër	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; tregime fantastike; pamje të jashtëtokësorëve; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore; mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- bashkëbisedim;- ditari dypjesësh;- lexim me role;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Nxënësit flasin rreth personazhit të tregimit që i ka tërhequr me sjelljet dhe veprimet e tij. Lexim i tregimit nga nxënësit. Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës.			
Veprimtaria e dytë Bashkëbisedim: Rubrika “Reflektoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bashkëbisedojnë rreth marrëdhënies që krijohet ndërmjet Joakinit dhe Mikës. *Nxiten nxënësit të tregojnë se si kanë vepruar kur u ka ndodhur të takojnë fëmijë që janë ndryshe nga ata.			
Veprimtaria e tretë Ditari dypjesësh: Ndahen klasa në gjashtë grupe. Tri grupe komentojnë frazën: <i>Në emër të të gjithë planetit mbi të cilin banoja, ndjeva detyrën që të tregohesha mikpritës.</i>			

Fjalja	Komenti
Në emër të të gjithë planetit mbi të cilin banoja, ndjeva detyrën që të tregohesha mikpritës.	Në çdo rast duhet të dëshmojmë me përgjegjësi se kush jemi dhe çfarë përfaqësojmë, duke iu përgjigjur me miqësi çdo miqësie pavarësisht se nga vjen ajo.

Tri grupe të tjera do të komentojnë thënien e Mikës.

Fragmenti	Komenti
Një përgjigje është vetëm një pjesë e rrugës që ke lënë prapa shpine. Vetëm një pyetje mund të synojë përpara.	Qëndrimi kritik në jetë, etja për të zbuluar të panjohurat ka bërë shoqërinë njerëzore të ecë përpara.

Përfaqësuesit e grupeve lexojnë komentet.

Nxënësit dëgjojnë dhe vlerësojnë komentet e shokëve/shoqeve të tyre.

Nxiten nxënësit që në grupe të nxjerrin mesazhin e tregimit.

Mesazhi: *Pyetja tregon inteligjencë dhe vizion për të ardhmen, në të gjitha kohërat dhe në të gjitha shoqëritë.*

Veprimtaria e katërt

Lexim me role: Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ndahen rolet për çdo grup (Mika, Joakini, autori) dhe kërkon që nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës.

Më pas, nxënësit ushtrohen në lexim me zë, sipas roleve. Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit vlerësojnë interpretimet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- formulimin e mesazhit që përcjell tregimi;
- interpretimin në role të pjesës;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve dhe të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike		Situata e të nxënit Lojë: fjalë të urta dhe shprehje frazeologjike.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon kuptimin e fjalëve të urta;– lidh shprehjet frazeologjike me kuptimin e tyre;– gjen dhe komenton fjalë të urta sipas tematikave të caktuara;– gjen shprehje frazeologjike që lidhen me fjalë të caktuara;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e të tjerëve;– demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit.		Fjalë kyçe: fjalë të urta shprehje frazeologjike	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; libra me fjalë të urta; fjalor i shprehjeve frazeologjike; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- lojë;- diskutim;- mendo, puno në dyshe, shkëmbe;- diskutim;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve Veprimtaria e parë Lojë: Mësuesi/ja ka vendosur në një shportë shirita letre në të cilat ka shkruar fjalë të urta dhe shprehje të ndryshme frazeologjike. Ftohen nxënësit të marrin nga shporta nga një shirit letre dhe të lexojnë fjalët e shkruara në to. Nxiten nxënësit të tregojnë se çfarë janë këto fjalë, duke dalluar me ndihmën e mësuesit/es fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike. Njihen nxënësit me temën e mësimit “Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike”.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim në dyshe: Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë për fjalët e urta, në rubrikën “Mbaj mend”. Ata bëjnë pyetje rreth këtij informacioni.

*Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë rreth fjalëve të urta të grupuara sipas tematikës: për punën, mençurinë, miqësinë, koprracinë.

*Orientohen nxënësit të zëvendësojnë me një ose shumë fjalë shprehjet: *shend e verë, var buzët*.

Nxënësit/et u përgjigjen pyetjes; A kanë ruajtur kuptimin e tyre të pavarur fjalën “*verë*” dhe “*var*”?

Nxënësit lexojnë informacionin e dhënë për shprehjet frazeologjike në rubrikën “Mbaj mend”.

Ata/ato diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es dhe bëjnë pyetje rreth këtij informacioni.

Veprimtaria e tretë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Punohet ushtrimi 1, 2, 3. Mësuesi/ja i le nxënësit të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, plotësojnë përgjigjet.

Veprimtaria e katërt

Diskutim: Punë në grupe: Ushtrimi 4. Nxënësit punojnë në grupe për të gjetur fjalë të urta për miqësinë, zgjuarsinë, punën, dembelizmin.

Ushtrimi 6. Nxënësit lidhin shprehjen frazeologjike me kuptimin e saj.

Ushtrimi 7. Nxënësit në grupe do të gjejnë shprehje frazeologjike që lidhen me fjalët: *zemër, dorë, këmbë*.

Në përfundim, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë para klasës punën e bërë.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e kuptimit të fjalëve të urta;
- lidhjen e shprehjeve frazeologjike me kuptimin e tyre;
- gjetjen dhe komentimin e fjalëve të urta sipas tematikave të caktuara;
- gjetjen e shprehjeve frazeologjike që lidhen me fjalë të caktuara;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Lulja dhe natyra		Situata e të nxënit Përshkrim i një dite të zakonshme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit; – tregon llojin e pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj; – tregon përmbajtjen e pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes; – dallon cilësitë e personazheve, duke u mbështetur në veprimet e tyre në tregim; – përcakton të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet personazheve të tregimit; – shpjegon me cilin personazh gjen të përbashkëta; – interpreton tregimin në role; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: lulja natyra dielli dallëndyshja bleta	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; informacione rreth jetës dhe krijimtarisë së rilindësit Naim Frashëri; poezi, tregime të poetit Naim Frashëri; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - lexim-diskutim në dyshe; - dallo-trego; - mendo-zbulo; - dramatizim; - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Ftohen nxënësit të flasin rreth agjendës së tyre ditore. Mësuesi/ja shkruan në tabelë temën e mësimiit “Lulja dhe natyra” dhe autorin e tij Naim Frashëri. Njihen nxënësit nga mësuesi/ja me jetën dhe krijimtarinë e poetit Naim Frashërit. Naim Frashëri (25 maj 1946 – 20 tetor 1900). Lindur në Frashër të Përmetit. Rilindës i shquar, poet kombëtar, shkrimtar, hartues i teksteve, veprimtar i shquar i arsimit kombëtar. Krijimtaria Vëllimi poetik “Lulet e verës” Përmbledhja poetike “Parajsa dhe fjala fluturake” Poema “Bagëti dhe bujqësi” Poema “Histori e Skënderbeut”			

*Qerbelaja**Vjersha për mësonjëtoreset e para**Dituritë për mësonjëtoreset e para etj.***Koment nga nxënësit i ilustrimit në libër.***Veprimtaria e dytë****Lexim-diskutim në dyshe:** Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët dhe fjalitë që i duken interesante. Diskutojnë rreth tekstit në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.**Lexohet i tregimit zinxhir nga nxënësit.***Veprimtaria e tretë****Dallo-trego:** Punë në dyshe: Rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Ftohen nxënësit të lexojnë fjalitë rreth tregimit dhe të dallojnë fjalitë e vërteta nga ato të gabuara, si dhe të ndërtojnë saktë fjalitë e gabuara. Në përfundim të punës përfaqësuesit e disa dysheve tregojnë punën e bërë.

Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës.

Veprimtaria e katërt**Mendo-zbulo:** Rubrika “Analizoj”. Nxënësit tregojnë llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij, si dhe të përshkruajnë arsyen pse lulja e falënderoi natyrën.

Plotësohet kolona e parë e tabelës, duke renditur veprimet e personazheve.

Më pas plotësohet kolona e dytë e tabelës duke shkruar dy cilësi për secilin personazh.

Nxënësit tregojnë të përbashkëtat dhe ndryshimet midis personazheve.*Nxiten nxënësit në grupe që të gjejnë në tekst mesazhin që përcjell tregimi.***(Të gjithë punojnë, prandaj edhe unë do të punoj dhe do të mësoj shumë).****Rubrika “Reflektoj”. Nxënësit tregojnë personazhin në tregim me të cilin gjejnë të përbashkëta.***Veprimtaria e pestë****Lexim me role:** Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi/ja u cakton rolet secilit dhe kërkon që nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas, nxënësit ushtrohen në leximin me zë sipas roleve. Vihet theksi në leximin me intonacion. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit.**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e rrjedhshëm të tregimit, duke respektuar shenjat e pikësimit;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- dallimin e cilësive të personazheve, duke u mbështetur në veprimet e tyre;
- përcaktimin e të përbashkëtave dhe ndryshimeve ndërmjet personazheve të tregimit;
- interpretimin e tregimit në role;
- bashkëpunimin në grup si dhe vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Dialektet e gjuhës shqipe		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar dialektet e gjuhës shqipe.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon dialektet e gjuhës shqipe nga gjuha standarde shqipe (gjuha e njësuar letrare);– vë në dukje se ndryshimet kryesore ndërmjet dy dialekteve janë në shqiptimin e tingujve dhe në fjalor;– kthen fjalë nga njëri dialekt në tjetrin;– kthen një tekst të shkurtër të shkruar në dialekt, në gjuhën standarde shqipe;– bën lidhjen e gjuhës së folur në familjen e tij/saj me njërin prej dialekteve të gjuhës shqipe;– vlerëson dialektet si pasuri e gjuhës shqipe;– demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit.		Fjalë kyçe: gjuhë letrare dialekti gegë dialekti toskë shqiptoj	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fjalor i gjuhës shqipe; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- rishikim në dyshe;- shkrim i drejtuar;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Diskutim: Nxënësit ftohen të lexojnë dialogun ndërmjet Elës dhe Bledit dhe të diskutojnë duke iu përgjigjur edhe pyetjeve në tekst. Mësuesi/ja tregon se gjuha shqipe ka dy dialekte gegë dhe toskë që i përkasin pjesës veriore dhe jugore të Shqipërisë, duke iu referuar edhe rubrikës “Kujtoj”. Duke shqyrtuar fjalët e dhëna në tekst në të dy dialektet, theksohet se ndryshimet kryesore ndërmjet dy dialekteve janë në shqiptimin e tingujve dhe në fjalor.			
Veprimtaria e dytë Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e kolonës së dytë dhe të tretë të tabelës. Më pas shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2, nxënësit punojnë individualisht në fletore.

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tekstin e shkruar nga Migjeni dhe të tregojnë se në ç' dialekt është shkruar. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit rreth tekstit të shkruar në dialektin geg. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë tekstin në gjuhën standarde.

Në përfundim të punës, mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të lexojnë tekstin me zë para klasës.

Bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore nëse ka, me ndihmën e mësuesit/es.

Nxiten nxënësit të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e dialekteve të gjuhës shqipe nga gjuha standarde shqipe (gjuha e njësuar letrare);
- shpjegimin se ndryshimet kryesore ndërmjet dy dialekteve janë në shqiptimin e tingujve dhe në fjalor;
- kthimin e fjalëve nga njëri dialekt në tjetrin;
- kthimin e një teksti të shkurtër të shkruar në dialekt, në gjuhën standarde shqipe;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe Komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Sa shumë zbaviteshin dikur! (ora I)		Situata e të nxënit Si do ta imagjinoni shkollën pas rreth 150 vitesh, duke pasur parasysh futjen e teknologjisë në shkollë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– shpjegon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe krijon fjali me to;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse të tij;– krahason mësuesin robot me mësuesin/en e tij/saj;– përzgjedh në tekst fjali që përshkruajnë shkollën e së ardhmes, duke dhënë komentin e tij/saj në lidhje me të;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalët kyçe: inspektori halë në sy transistorë mësuesi mekanik çmontoj reduktoj	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- imagjinatë e drejtuar;- procedura: pyet sërish;- rishikim në dyshe;- dallo-trego;- diagrami i Venit;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Mësuesi/ja u thotë nxënësve: Mbyllni sytë dhe mendoni për një çast si do ta imagjinonit ju shkollën pas rreth 150 vjetësh, duke pasur parasysh futjen e teknologjisë në shkollë? Nxënësit hapin sytë dhe tregojnë atë çfarë imagjinuan.			

Veprimtaria e dytë

Procedura - pyet sërish: Mësuesi/ja njih nxënësit me titullin e pjesës “Sa shumë zbaviteshin dikur!”.

*Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në paragrafë, duke nënvizuar fjalët e reja dhe fjalitë më interesante. Në përfundim të çdo paragrafi, nxënësit diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton pyetje rreth tij dhe tjetri u përgjigjet pyetjeve. Për çdo paragraf të ri, nxënësit ndërrojnë rolet.

Paragrafi I Pyetje: *Çfarë gjeti Tomi? Kujt ia tregoi atë? Si ishte libri?*

Paragrafi II Pyetje: *Çfarë vunë re ata teksa shfletonin faqet e zverdhura dhe të zhubrosura të librit?*

Paragrafi III Pyetje: *Pse Margi tani e urrente më shumë shkollën?*

Pse thirri mami i Margit inspektorin?

Paragrafi IV Pyetje: *Si ishte mësuesi robot i Margit? Çfarë tha inspektori?*

Paragrafi V Pyetje: *Çfarë i tha Tomi Margit në lidhje me mësuesit dhe shkollën në të kaluarën?*

Paragrafi VI Pyetje: *Ku bënte mësim Margi? Çfarë nisi të mendonte Margi për fëmijët e dikurshëm?*

*Shpjegim i fjalëve të reja: Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje”. Nxënësit shpjegojnë fjalët dhe shprehjet e reja dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit punojnë individualisht për të plotësuar fjalitë rreth tekstit, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

Më pas, ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë para klasës.

Disa nxënës tregojnë përmbajtjen e tregimit.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit tregojnë llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij (tregim fantastik).

Veprimtaria e pestë

Diagrami i Venit: Nxënësit punojnë në grupe për të krahasuar mësuesin robot me mësuesen e tyre, duke treguar të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre.

Përfaqësuesit e çdo grupi prezantojnë punën e bërë.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe krijimin e fjalive me to;
- dallimin e llojit të tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës;
- krahasimin e mësuesit robot me mësuesin/en e tij/saj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe Komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Sa shumë zbaviteshin dikur! (ora II)		Situata e të nxënit Përshkrim i jetës shkollore.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan jetën e tij/saj shkollore;– lexon tregimin rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;– tregon përmbajtjen e tregimit duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse të tij;– përzgjedh në tekst fjali që përshkruajnë shkollën e së ardhmes, duke dhënë komentin e tij/saj në lidhje me të;– jep preferencat e tij/saj për shkollën e së ardhmes dhe të së tashmes, duke dhënë argumente;– pranon me respekt mendimet dhe idetë e të tjerëve;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalët kyçe: shkolla e ditëve të sotme shkolla e së ardhmes mësuesi mekanik	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- dora e pyetjeve.- ditari dypjesësh;- trego-argumento;- lexim me role;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë jetën e tyre shkollore. *Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit.			
Veprimtaria e dytë Organizuesi grafik - Dora e pyetjeve: Disa nxënës tregojnë përmbajtjen e tregimit sipas organizuesit grafik: Dora e pyetjeve.			

Veprimtaria e tretë

Ditari dypjesësh: Rubrika “Reflektoj”. Nxënësit në grupe zgjedhin në tekst fjali që përshkruajnë shkollën e së ardhmes dhe japin komentin e tyre lidhur me to.

Në përfundim të punës, përfaqësuesit e çdo grupi lexojnë komentet e bëra.

Veprimtaria e katërt

Trego-argumento: Nxiten nxënësit që të tregojnë nëse u pëlqen shkolla e së ardhmes apo e ditëve të sotme, duke dhënë argumentin e tyre.

Veprimtaria e pestë

Lexim me role: Nxënësit ndahen në grupe. Mësuesi/ja u cakton rolet secilit dhe kërkon që nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas, nxënësit ushtrohen në leximin me zë sipas roleve. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe duke respektuar shenjat e pikësimit;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse të tij;
- përzgjedhjen në tekst të fjalive që përshkruajnë shkollën e së ardhmes, duke dhënë komentin e tij/saj në lidhje me të;
- preferencat e tij/saj për shkollën e së ardhmes dhe të së tashmes, duke dhënë argumente;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Intervistë gjyshes		Situata e të nxënit Intervista ime	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – përshkruan se ç’janë intervistat; – shkruan pyetjet e një interviste, duke u ndihmuar nga përgjigjet e bashkëfolësit; – interviston shokun/shoqen e tij/saj; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalët kyçe: intervistë pyetje përgjigje informacion	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; magnetofon; intervista të ndryshme me njerëz të spikatur në fushën e letërsisë, artit, sportit etj.; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - dëgjim i drejtuar; - diskutim; - shkrim i drejtuar; - intervistë; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Dëgjim i drejtuar: Nxënësit/et ftohen të dëgjojnë incizime të një interviste që një gazetar i ka bërë një personaliteti në fushën e letërsisë, artit, sportit etj. Nxiten nxënësit të diskutojnë me njëri-tjetrin se ç’është intervista. Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë.			
<div><div>Komunikim në formë pyetje-përgjigjesh. midis dy individëve.</div><div>Njohim mendimet, përvojat, karakteristikat e personit të intervistuar.</div><div>intervista</div></div>			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë intervistën e Jehonës e zhvilluar me gjyshen e saj. Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth intervistës nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë pyetjet që Ivi ia ka drejtuar gjyshit të tij, duke u ndihmuar nga përgjigjet e gjyshit.

Në përfundim nxiten nxënësit të lexojnë para klasës pyetjet që kanë shkruar.

Veprimtaria e katërt

Intervistë: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja fton nxënësit të intervistojnë shokun ose shoqen e tyre.

U jepen udhëzime nxënësve që të mendojnë temën për të cilën dëshirojnë të mbledhin informacion, të përgatisin pyetjet dhe të zhvillojnë intervistën.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- shkrimin e pyetjeve të një interviste, duke u ndihmuar nga përgjigjet e bashkëfolësit;
- intervistën që zhvillon me shokun/shoqen e tij/saj;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Përbërësit e fjalës (ora I)		Situata e të nxënit Shqyrtim i fjalëve për të dalluar përbërësit e tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – përkufizon ç’është rrënja, tema, mbaresa, parashtesa, prapashtesa e fjalëve; – dallon temën dhe mbaresën e fjalëve; – dallon parashtesën dhe prapashtesën në fjalët e prejardhura; – vë në dukje se çfarë tregon mbaresa tek fjalët; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalët kyçe: përbërësit e fjalës rrënja tema mbaresa parashtesa prapashtesa	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; fisha me fjalë; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - diskuto-nxirr përfundimin; - rishikim në dyshe; - mendo, puno në dyshe, shkëmbe; - shkëmbe një problemë; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Diskuto-nxirr përfundimin: Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e mësimin dhe nxit ata/ato të lexojnë fjalitë e dhëna në tekst të cilat i ka shkruar edhe vetë në tabelë. Klesti i do shumë qentë. Ai luan çdo pasdite me qenin e tij. Qeni i tij e ka emrin Poki. Nxiten nxënësit të tregojnë se çfarë kanë të përbashkët dhe ku ndryshojnë fjalët e nënvizuara. Shqyrtohen skemat që paraqesin nga se përbëhen këto fjalë.			
<div><div><div>qeni</div><div>qen + i</div></div><div><div>qenin</div><div>qen + in</div></div><div><div>qentë</div><div>qen + të</div></div></div> <div><p>pjesa e pandryshueshme tema mbaresa pjesa e ndryshueshme (-i, -in,-të)</p><p>Nxënësit lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për përbërësit e fjalës (tema dhe mbaresa) në rubrikën “Mbaj mend”.</p><p>Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve, duke vënë në dukje se mbaresat tregojnë tiparet gramatikore të fjalës (Mbaresat tek emri mund të tregojnë gjininë, numrin, rasën).</p><p>Tema e fjalës qen nuk vjen nga ndonjë temë tjetër, pra ajo është rrënja e fjalës.</p><p>Diskutohet me nxënësit rreth përbërjes së fjalëve: pranveror, nëntokësor, ku dallohen në to parashtesa, prapashtesa dhe rrënja.</p><p>Nxënësit lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për rrënjën, parashtesën, prapashtesën e fjalëve, në rubrikën “Mbaj mend”.</p></div>			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë individualisht në libër për të shkruar fjalët, duke ndarë mbaresën nga secila fjalë.

Nxënësit shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të nënvizojnë rrënjën në fjalët e dhëna, të ndajnë temën nga mbaresat, të qarkojnë parashtesat dhe prapashtesat.

Mësuesi/ja i le nxënësit të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, plotësojnë përgjigjet.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe. Nxënësit shkruajnë në fleta nga 2 fjalë dhe ia japin grupit fqinjë për të dalluar rrënjën, parashtesën, prapashtesën në to.

Pas përfundimit të punës zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e temës dhe mbaresës së fjalëve;
- dallimin e parashtesës dhe prapashtesës në fjalët e prejardhura;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Përbërësit e fjalës (ora II)		Situata e të nxënit Shqyrtim i fjalëve për të dalluar përbërësit e tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – dallon temën dhe mbaresën e fjalëve; – dallon parashtesën dhe prapashtesën në fjalët e prejardhura; – formon fjalë me parashtesa ose prapashtesa dhe i përdor ato në fjali; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalët kyçe: përbërësit e fjalës rrënja tema mbaresa parashtesa prapashtesa	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti shkollor; fisha me fjalë; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - diskutim; - rishikim në dyshe; - shkëmbe një problemë; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Diskutim: Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë nga nxënësit. Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë nga një fishë ku janë shkruar nga dy fjalë. Udhëzon nxënësit të punojnë në dyshe për të dalluar në to rrënjën, të ndajnë temën nga mbaresa, si dhe të dallojnë parashtesën, prapashtesën. Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit e dysheve tregojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit rreth përbërësve të fjalëve.			
Veprimtaria e dytë Rishikim në dyshe: Ushtrimi 4. Udhëzohen nxënësit të formojnë tri fjalë që fillojnë me parashtesën -për dhe t'i përdorin ato në fjali. Ushtrimi 5. Nxënësit të formojnë tri fjalë që të kenë pjesë të tyre edhe prapashtesën -ar dhe t'i përdorin ato në fjali. Nxënësit punojnë individualisht në fletore. Në përfundim shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë me zë para klasës. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimeve nën drejtimin e mësuesit/es.			
Veprimtaria e tretë Shkëmbe një problemë: Punë në grupe. Nxënësit u kërkojnë grupeve fqinje të formojnë fjalë me parashtesa dhe prapashtesa dhe t'i përdorin në fjali. Pas përfundimit të punës, grupet kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, diskutojnë rreth fjalëve të formuara dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.			

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e temës dhe mbaresës së fjalëve;
- dallimin e parashtesës dhe prapashtesës në fjalët e prejardhura;
- formimin e fjalëve me parashtesa, ose prapashtesa duke i përdorur ato në fjali;
- bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Formo tri fjalë që të kenë parashtesën pa. Përdori ato në fjali.

Formo tri fjalë që të kenë pjesë të tyre edhe prapashtesën **-je**. Përdorin ato në fjali.

Fusha: Gjuhët dhe Komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Kur ndërrohen vendet		Situata e të nxënit: Ndërtim i një tregimi duke u mbështetur në terma paraprake.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tregimin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;– dallon llojin e tekstit, duke përmendur elementet fantastike të tregimit;– shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj rreth tregimit;– diskuton për rëndësinë që ka komunikimi fëmijë-prindër për të kuptuar më mirë preokupimet e njeri-tjetrit dhe për të gjetur zgjidhjet më të mira dhe më të pëlqyeshme sidomos për fëmijët;– ndërton një mbyllje tjetër për tregimin;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalët kyçe: fëmijët prindërit zana shkopi magjik e llahtaritur hata	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; teksti mësimor; tregime fantastike; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- parashikim me terma paraprakë;- lexo-përmbledh në dyshe;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- bashkëbisedim;- shkrim i shpejtë;- shkrim i shpejtë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Parashikim me terma paraprakë: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: <i>fëmijët, prindërit, shkopi magjik, ndryshoi</i> . Ftohen nxënësit të bëjnë parashikimin për përmbajtjen e pjesës, duke punuar në dyshe. Ata i shkruajnë parashikimet e tyre në fletë (me katër fjali ku t’i përdorin këto fjalë). Nxiten nxënësit të lexojnë parashikimet e tyre.			

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Nxënësit njihen me titullin e pjesës “Kur ndërrohen vendet” dhe autoren e saj Natasha Poroçani. Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit në dyshe përmbledhin me 3-4 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

*Punohet rubrika “Fjalor”. Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ata i diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim me shokun/shoqen e bankës më pas me gjithë klasën.

*Disa nxënës/e thonë përmbajtjen e pjesës në mënyrë të përmbledhur.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për të dalluar llojin e tekstit (*tregim fantastik*) duke përmendur elementet fantastike të tregimit.

*Nxiten nxënësit të punojnë në grupe për të dhënë mendimin e tyre se si do të rridhte ngjarja nëse shkopi magjik nuk do të funksiononte herën e dytë dhe se çfarë mësojnë nga ky tregim.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit bashkëbisedojnë rreth emocioneve dhe ndjesive që i shkakton leximi i këtij tregimi.

*Nxiten nxënësit të japin mendimin e tyre se si do të vepronin nëse do të ishin njëri nga personazhet e tregimit, duke e shpjeguar veprimin e tij.

*Nxënësit diskutojnë për rëndësinë që ka komunikimi fëmijë-prindër për të kuptuar më mirë preokupimet e njeri-tjetrit dhe për të gjetur zgjidhjet më të mira dhe më të pëlqyeshme sidomos për fëmijët.

Veprimtaria e gjashtë

Shkrim i shpejtë: Nxënësit punojnë individualisht për të ndërtuar një mbyllje tjetër për tregimin.

Ftohen nxënësit të lexojnë shkrimet e tyre.

Nxiten nxënësit të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tregimit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit;
- dallimin e llojit të tekstit, duke përmendur elementet fantastike të tregimit;
- ndërtimin e një mbyllje tjetër për tregimin;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Flasin Filmi që më pëlqen		Situata e të nxënit Cili film të pëlqen më shumë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – përshkruan filmin e tij/saj të preferuar; – plotëson skedën për filmin “I vetëm në shtëpi” si dhe për filmin e preferuar; – demonstroi siguri kur flet në klasë; – shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth filmit të tij/saj të preferuar, duke shpjeguar përse e tërheq kaq shumë ky film; – nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për filmat e tyre të preferuar; – përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; – respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: film i preferuar skeda e filmit personazhi kryesor i filmit i pasionuar pas filmit	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; videoprojektor; CD; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - diskutim; - lexo-diskuto; - punë e drejtuar; - trego-diskuto; - punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit të flasin rreth filmave për fëmijë që kanë parë. Njihen nxënësit me temën e mësimit.			
Veprimtaria e dytë Diskutim: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të vërejnë fotot dhe të diskutojnë në grupe rreth tyre duke iu përgjigjur pyetjeve në tekst.			

Veprimtaria e tretë

Lexo -diskuto: Ushtrimi 2. Orientohen nxënësit të lexojnë materialin e përgatitur rreth përmbajtjes së filmit “I vetëm në shtëpi” dhe u kërkohet atyre të tregojnë nëse përputhet ky përshkrim me ato që mbajnë mend nga filmi dhe me ato që dinë rreth filmit.

Nxiten nxënësit të japin informacione të tjera rreth këtij filmi nëse dinë.

Veprimtaria e katërt

Punë e drejtuar: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë individualisht për të plotësuar skedat në tekst për filmin “I vetëm në shtëpi” dhe për filmin e preferuar të tyre.

Në përfundim, nxënësit lexojnë skedat e plotësuara me zë para klasës.

Veprimtaria e pestë

Trego-diskuto: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit që duke u bazuar në skedën e plotësuar të tregojnë filmin e tyre të preferuar, duke shpjeguar përse e tërheq kaq shumë ky film.

*Ushtrimi 5. Pasi dëgjojnë përshkrimet e shokëve për filmin e preferuar, nxënësit diskutojnë për të përbashkëtat dhe ndryshimet për dy prej tyre, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrit.

*Në minutat e fundit nëse është e mundur, nxënësit shikojnë sekuenca të një filmi për fëmijë me anë të videoprojektorit.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e filmit të tij/saj të preferuar;
- plotësimin e skedës për filmin “I vetëm në shtëpi” si dhe për filmin e preferuar;
- shprehjen e opinioneve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth filmit të tij/saj të preferuar, duke shpjeguar përse e tërheq kaq shumë ky film;
- bashkëpunimin në grup dhe vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Fjalë të parme dhe jo të parme (ora I)		Situata e të nxënit Shqyrtimi i fjalëve për të dalluar fjalët e parme dhe jo të parme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon fjalët e parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;jep shembuj të fjalëve të parme, të përbëra, të prejardhura, të përngjitura;shpjegon formimin e fjalëve të prejardhura të formuara me parashtesim, prapashtesim, parashteso-prapashtesim;formon fjalë të prejardhura me parashtesat dhe prapashtesa;respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.		Fjalë kyçe: fjalë të parme fjalë jo të parme fjalë të prejardhura fjalë të përngjitura fjalë të përbëra me parashtesim me prapashtesim me parashteso-prapashtesim	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">diskuto-nxirr përfundimin;rishikim në dyshe;diskutim;punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Diskuto-nxirr përfundimin: Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe nxit të lexojnë tekstin dhe të qarkojnë atë çfarë kanë të përbashkët fjalët e nënvizuara. Nxënësit diskutojnë në fillim në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es dhe dilet në përfundimin se të tria këto fjalë kanë të përbashkët rrënjën (punë). Fjala punë është e parme. Fjalët punëtori dhe punonim janë fjalë jo të parme. *Nxënësit lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për fjalët e parme, dhe jo të parme (të prejardhura, të përbëra, të përngjitura) duke i ilustruar me shembuj, në rubrikën “Mbaj mend”. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve dhe nxit nxënësit të japin shembuj të tjerë të fjalëve të parme, të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.			

Gjithashtu diskutohet me nxënësit nën drejtimin e mësuesit/es për fjalët e prejardhura të formuara me parashtesim, prapashtesim, parashteso-prapashtesim, duke i ilustruar me shembujt përkatës.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit të lidhin me shigjetë fjalën e prejardhur me rrënjën. Ushtrimi 2 synon që nxënësit të identifikojnë fjalët e parme dhe jo të parme të shkruara me të zeza në tekstin e dhënë dhe të plotësojnë tabelën.

Ushtrimi 3 synon formimin e fjalëve të prejardhura, duke lidhur temën me parashtesat dhe prapashtesat e dhëna.

Nxënësit punojnë individualisht në libër. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimeve nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Diskutim - Punë në grupe: Mësuesi/ja u shpërndan çdo grupi fisha me fjali dhe u kërkon të dallojnë në fjalët e nënvizuara, fjalët e parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e fjalëve të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;
- shpjegimin e formimit të fjalëve të prejardhura të formuara me parashtesim, prapashtesim, parashteso-prapashtesim;
- formimin e fjalëve të prejardhura me parashtesat dhe prapashtesa;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Gjej dhe shkruaj 3 fjalë të parme, 3 fjalë të përngjitura, 3 fjalë të përbëra, 3 fjalë të prejardhura.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Fjalë të parme dhe jo të parme (ora II)		Situata e të nxënit Shqyrtimi i fjalëve për të dalluar fjalët e parme dhe jo të parme.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">jep shembuj të fjalëve të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;bën dallimin ndërmjet fjalëve të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;bën analizën fjalëformuese të fjalëve, duke dalluar rrënjën, mbaresat, parashtesat, prapashtesat, temën e tyre;respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.		Fjalë kyçe: fjalë të parme fjalë jo të parme fjalë të prejardhura fjalë të përngjitura fjalë të përbëra me parashtesim me prapashtesim me parashteso-prapashtesim.	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fjalor i gjuhës shqipe; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fisha, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- harta e konceptit;- diskutim;- punë e drejtuar;- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Harta e konceptit: Mësuesi/ja fton nxënësit që në grupe të krijojnë hartën e konceptit për fjalëformimin. Diskutohet me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth saj. Mësuesi/ja e paraqet atë në tabelë. Studion mënyrat e formimit të fjalëve të një gjuhe. <div><div><div>Fjalëformimi</div><div><div>Fjalët përbëhen nga:</div><div>tema, rrënja, mbaresa, parashtesa, prapashtesa</div></div><div><div>Fjalët mund të jenë:</div><div><div>të prejardhura</div><div>të përngjitura</div><div><div>të përbëra</div><div>të parme</div><div>jo të parme</div></div></div></div><div><div>Të formuara me:</div><div>parashtesa, prapashtesa, parashtesa dhe prapashtesa</div></div></div></div>			

Nxiten nxënësit të japin shembuj të fjalëve të parme, të përbëra, të përngjitura, të prejardhura.

Veprimtaria e dytë

Diskutim - Punë në dyshe: Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë fisha me fjali dhe u kërkon të dallojnë në fjalët e nënvizuara, fjalët e parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra.

Përfaqësuesit e dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Punë e drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit të gjejnë në tekstin e shkruar nga I. Kadare, në fjalët e shkruara me të zeza mbaresat, temën, parashtesat, prapashtesat dhe rrënjën.

Mësuesi/ja i lë nxënësit të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës. Pasi binden për përgjigjet e sakta, punojnë në fletore.

Në përfundim, zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- shembujt e dhënë të fjalëve të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;
- dallimin ndërmjet fjalëve të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe të përbëra;
- analizën fjalëformuese të fjalëve, duke dalluar rrënjën, mbasesat, parashtesat, prapashtesat, temën e tyre;
- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Tomori		Situata e të nxënit Film i shkurtër për malin e Tomorit (foto).	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit që lexon duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– shpjegon domethënien e shprehjeve të tekstit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– ndërton një fjali përmbledhëse për çdo paragraf të tekstit;– tregon arsyet që na jep autori për të vizituar malin e Tomorit;– pranon idetë dhe mendimet e të tjerëve rreth pëlqimeve të tyre për udhëtimet në malin e Tomorit apo në malet e tjera të Shqipërisë;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj.		Fjalë kyçe: mali i Tomorit i vete kryet të mërgjër tekdo të moçmit	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; harta e Shqipërisë; pamje nga mali i Tomorit; informacione për malin e Tomorit; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim i organizuar;- lexim-diskutim në dyshe;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- bashkëbisedim;- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Shikim i organizuar: Me anë të videoprojektorit paraqiten një material i shkurtër filmik për malin e Tomorit. Në mungesë paraqiten pamje të ndryshme nga mali i Tomorit. Zhvillohet një bisedë me nxënësit rreth tyre. Mësuesi/ja u tregon nxënësve në hartë pozicionin gjeografik të malit të Tomorit dhe nxiten nxënësit të tregojnë se ç’ dinë për të.			

Veprimtaria e dytë

Lexim-diskutim në dyshe: Njihen nxënësit me titullin e pjesës “Tomori” dhe autorin e saj Lumo Skëndo.

Njihen nxënësit me jetën dhe krijimtarinë e autorit.

Mit’hat Frashëri, njohur me emrin letrar Lumo Skëndo, i biri i patriotit të madh të Rilindjes Abdyl Frashëri dhe nipi i rilindësve të shquar Naim Frashëri dhe Sami Frashëri.

25 mars 1880 - 3 tetor 1949. Ka qenë shkrimtar, kritik, përkthyes, publicist, albanolog, botues dhe politikan shqiptar. Ka qenë nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë.

Veprat

Këndimet

Këndimet për shkollat e para

Shkurtabiqi i verdhë

Hi dhe shpuzë

Rilindja e Shqipërisë etj.

*Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje”. Nxënësit shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja. Nxiten nxënësit të krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës.

Ata diskutojnë rreth përgjigjeve të pyetjeve në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego - Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit të gjejnë alternativën e saktë për të dalluar llojin e tekstit, duke vënë në dukje karakteristikat e tij dhe më pas të shpjegojnë kuptimin e shprehjeve të tekstit: *i vete kryet gjer në qiell, më lart se retë*

mali plak i Shqipërisë

ay mal sheh gjithë Shqipërinë

veriu i freskët

jugë e vakët

Mësuesi/ja i udhëzon të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf të tregimit.

Nxënësit nëpërmjet një bashkëbisedimi tregojnë arsyet që na jep autori për të vizituar malin e Tomorit.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nëpërmjet bashkëbisedimit, nxënësit tregojnë për udhëtimet e tyre në malin e Tomorit apo malet e tjera të vendit tonë.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- shpjegimin e domethënies së shprehjeve të tekstit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;
- ndërtimin e fjalive përmbledhëse për çdo paragraf të tekstit;
- bashkëpunimin në grup, vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Punë në grup: Krijoni një album me foto nga malet e Shqipërisë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Shkruajmë Pogradeci im		Situata e të nxënit: Film i shkurtër për Pogradecin (fotografi).	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan qytetin e Pogradecit;– plotëson një përshkrim për qytetin e Pogradecit, duke u mbështetur te figurat dhe fjalët ndihmëse;– u përgjigjet pyetjeve me shkrim për vendin ku jeton;– shkruan për vendbanimin e tij/saj, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e të tjerëve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: Pogradeci liqeni i Ohrit shëtitore plazh	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- videoprojektor, CD;- pamje, informacione nga interneti për qytetin e Pogradecit;- mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim i organizuar;- diskutim;- shkrim i drejtuar;- shkrim i lirë; konkurs;- punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të shikojnë me anë të videoprojektorit, një material të shkurtër filmik për qytetin e Pogradecit. Në mungesë të tij, mësuesi/ja paraqet pamje nga qyteti i Pogradecit dhe diskutohet rreth tyre. Njihen nxënësit me temën e mësimit.			
Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> Ushtrimit 1. Nxiten nxënësit të vëzhgojnë dhe të komentojnë figurat në libër. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të plotësojnë me fjalët ndihmëse përshkrimin për vendbanimin e Klestit. Në përfundim lexohet teksti i plotësuar me zë para klasës nga nxënësit. Zhvillohet një bisedë rreth tij nën drejtimin e mësuesit/es.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë individualisht për të përshkruar vendin ku jetojnë duke iu përgjigjur me shkrim pyetjeve në tekst.

Në përfundim, nxiten nxënësit të lexojnë me zë para klasës përgjigjet e pyetjeve.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Ky ushtrim synon shkrimin për vendbanimet e tyre, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje.

Nxënësit lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkrimore nëse ka.

Veprimtaria e pestë

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri shkrimet më të mira. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- plotësimin e një përshkrimi për qytetin e Pogradecit, duke u mbështetur te figurat dhe fjalët ndihmëse;
- përgjigjet e pyetjeve me shkrim për vendin ku jeton;
- shkrimin për vendbanimin e tij/saj, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve dhe bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj një qytet që ke vizituar.

Veprimtaria e dytë

Analizë: Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë fjalitë në tekst, të cilat i ka paraqitur edhe vetë në tabelë dhe të tregojnë se çfarë tregojnë emrat e nënvizuar.

Mësuesja ectë me shpejtësi për në shtëpi. Kënga e fëmijëve e ndiqte edhe tani që ishte larguar nga shkolla. Ata fëmijë i falnin shumë kënaqësi dhe dashuri.

Mësuesi/ja jep sqaron se emrat: *shkolla, fëmijë, kënga* janë **emra konkretë** dhe emrat si: *kënaqësi, shpejtësi, dashuri* janë **emra abstraktë**.

*Lexohet rubrika “Mbaj mend”. Tërhiqet vëmendja se *emrat konkretë tregojnë qenie të gjalla dhe gjëra që arrin t’i perceptosh nëpërmjet shqisave, ndërsa emrat abstraktë tregojnë emocione, ndjenja, sjellje, karakteristika, gjëra që nuk perceptohen nëpërmjet shqisave.*

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve.

*Mësuesi/ja fton nxënësit të thonë emra të tjerë konkretë dhe abstraktë.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin e dhënë dhe të dallojnë emrat konkretë dhe abstraktë. Nxënësit punojnë individualisht në libër. Ata shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxiten nxënësit të lexojnë emrat konkretë dhe emrat abstraktë dhe të diskutojnë se çfarë tregojnë ata.

Veprimtaria e katërt

Diskutim - Ushtrimi 2. Ftohen nxënësit të punojnë në grupe për të plotësuar tabelën me emrat e ushtrimit 1, duke i klasifikuar sipas llojit (të përgjithshëm/të përveçëm) dhe konkret/abstrakt.

Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e emrave konkretë dhe emrat abstraktë;
- shpjegimin se çfarë tregojnë emrat konkretë dhe emrat abstraktë;
- shkrimin e emrave konkretë dhe abstraktë;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj 3 emra konkretë dhe 3 emra abstraktë. Krijë fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Emrat konkretë dhe emrat abstraktë (ora II)		Situata e të nxënit Vizatim i objekteve, sendeve, etj., duke u nisur nga emrat e tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon emrat konkretë dhe emrat abstraktë;shpjegon se çfarë tregojnë emrat konkretë dhe emrat abstraktë;shkruan emra konkretë dhe emra abstraktë;krijon fjali me emra konkretë dhe abstraktë;analizon emrat sipas kategorive gramatikore;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: emra konkretë emra abstraktë	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; etiketa me emra; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- punë e drejtuar;- shkrim i drejtuar, diskutim;- shkëmbe një problemë;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Punë e drejtuar: Mësuesi/ja u jep nxënësve një listë me emra të ndryshëm konkretë dhe abstraktë (pa i përcaktuar ata) dhe i udhëzon që t’i vizatojnë sendet, objektet dhe frymorët që u korespondojnë këtyre emrave. Pas përfundimit të punës, nxënësit nën drejtimin e mësuesit/es bëjnë listën e emrave që u vizatuan dhe atyre që nuk mundën t’i vizatonin. Nxiten nxënësit të tregojnë se <i>emrat që vizatuan janë emra konkretë sepse secili prej tyre tregon diçka që mund ta prekësh, ta shohësh apo ta ndiesh.</i> <i>Emrat që nuk mundën t’i paraqesnin me një vizatim përkatës janë emra abstraktë, sespse secili prej tyre tregon diçka që nuk mund ta perceptosh me anët të shqisave.</i>			

Veprimtaria e dytë

Shkrim i drejtuar, diskutim: Ushtrimi 3. Ftohen nxënësit të punojnë individualisht për të shkruar 3 emra konkretë, të paraqesin me vizatim se ç'tregojnë këta emra dhe të krijojnë fjali me to.

Ushtrimi 4. Ftohen nxënësit të shkruajnë 3 emra abstraktë dhe të tregojnë nëse mund të paraqesin me vizatim atë çka tregojnë ato. Nxënësit të krijojnë fjali me to.

Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim nën drejtimin e mësuesit/es rreth emrave konkretë dhe abstraktë. Nxënësit tregojnë se cilët emra i kanë paraqitur me vizatim dhe cilët emra nuk kanë mundur t'i paraqesin me vizatim.

Nxiten nxënësit të lexojnë emrat konkretë dhe abstraktë si edhe fjalitë e krijuara me to.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Nxënësit në grupe shkruajnë në fleta nga një fjali dhe i shkëmbejnë me grupet fqinje për të nënvizuar emrat në fjali dhe për të bërë analizën e tyre.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e emrave konkretë dhe emrave abstraktë;
- shkrimin e emrave konkretë dhe emrave abstraktë;
- krijimin e fjalive me emra konkretë dhe abstraktë;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve dhe bashkëpunimin në grup.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexojmë Anës liqenit		Situata e të nxënit: Album me foto nga liqenet e Shqipërisë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– shpjegon domethënien e shprehjeve të tekstit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– tregon se për cilin liqen bën fjalë autori;– përshkruan ndjesitë që ka provuar kur ka qëndruar pranë një liqeni;– vlerëson përgjigjet e shokëve/shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: liqen tjegulla e epët mbasandaj tej-këtej zhubavit	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; harta e Shqipërisë; pamje nga liqene të vendit tonë; mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: - bisedë; - lexim-diskutim në dyshe; - marrëdhënie pyetje-përgjigje; - dallo-trego; - bashkëbisedim; - punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë Bisedë: Mësuesi/ja ka porositur nxënësit disa ditë më parë të punojnë së bashku për të përgatitur një album me foto nga liqenet e Shqipërisë dhe t’i emërtojnë ato. Prezantohet albumi nga nxënësit para klasës.			
Veprimtaria e dytë Lexim-diskutim në dyshe: Njihen nxënësit me titullin e pjesës “Anës liqenit” dhe autorin e saj, Faik Konicën. Mësuesi/ja njeh nxënësit shkurtimisht me jetën dhe krijimtarinë e autorit. Faik Konica: 15 mars 1875 -15 dhjetor 1942. Ka qenë shkrimtar, botues, publicist, diplomat shqiptar, studiues i historisë dhe gjuhës shqipe, themelues i gazetës “Albania”.			

Titujt e veprave*Dr Gjilpëra**Ç'është liria**Shqipëria si m'u duk**Përralla e tregtarit dhe e xhindit*

Komentohen fotot në tekst nga nxënësit.

*Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që i duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje”.

Nxiten nxënësit të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja dhe t'i përdorin ato në fjali.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës.

- *Cili moment i ditës përshkruhet në paragrafin e parë?*

- *Çfarë përshkruhet në dy paragrafët e fundit?*

- *Çfarë të veçantë ka ky liqen?*

Ata/ato diskutojnë rreth përgjigjeve të pyetjeve në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit të gjejnë alternativën e saktë për të dalluar llojin e tekstit, duke vënë në dukje karakteristikat e tij dhe më pas të shpjegojnë kuptimin e shprehjeve të tekstit të dhëna në ushtrim.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nëpërmjet bashkëbisedimit, nxënësit tregojnë për ndjesitë që kanë provuar kur kanë qëndruar pranë një liqeni.

Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën se për cilin liqen bëhet fjalë në këtë tregim.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- shpjegimin e domethënies së shprehjeve të tekstit, me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;
- përshkrimin e ndjesive që ka provuar kur ka qëndruar pranë një liqeni;
- bashkëpunimin në grup, vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Drejtshkrimi i emrave të gjinisë mashkullore në numrin shumës		Situata e të nxënit Manipulime me emrat: shkëmb, lepur etj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">dallon emrat e gjinisë mashkullore në numrin shumës që mbarojnë me –j ose –nj;shkruan drejt emra të gjinisë mashkullore në numrin shumës që mbarojnë me –j ose –nj;kthen emrat e gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –j ose –nj, nga numri njëjës në shumës dhe anasjelltas;përdor drejt në fjali emrat e gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –j ose –nj;respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;vlerëson punën e shokëve/shoqeve;demonstron besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit.		Fjalë kyçe: emri gjinia mashkullore gjinia femërore numri njëjës numri shumës	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; etiketa me emra; mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; arte Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">analizë;rishikim në dyshe;shkrim i drejtuar, diskutim;lojë;punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve			
Veprimtaria e parë			
Analizë: Mësuesi/ja fton nxënësit të komentojnë ilustrimet në tekst dhe të lexojnë fjalët e shkruara poshtë tyre, të cilat edhe vetë i ka paraqitur në tabelë. <div><div>një shkëmb disa shkëmbinj</div><div>një lepur disa lepuj</div></div> Nxiten nxënësit/et të tregojnë se në ç’gjini dhe numër janë këto emra dhe të dallojnë mbaresat e emrave të numrit shumës. Mësuesi/ja sqaron se disa emra të gjinisë mashkullore në numrin shumës mbarojnë me –j dhe disa të tjerë me –nj. Tërhiqet vëmendja në shkrimin e saktë të këtyre emrave duke diskutuar rastet e dhëna të shkrimit të tyre, në rubrikat “Kujdes”.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit të lidhin me shigjetë emrat e numrit njëjës me emrat e numrit shumës.

Ushtrimi 2. Nxënësit do të kthejnë emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me –j ose –nj nga numri njëjës në shumës dhe anasjelltas.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit të gjejnë fjalët e shkruara gabim dhe t'i korrigjojnë ato.

Pas përfundimit të punës nxënësit shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e të tjerëve.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimeve nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar, diskutim: Ushtrimi 4. Ftohen nxënësit të punojnë individualisht për të kthyer emrat e dhënë në numrin shumës dhe të krijojnë fjali me to.

Pas përfundimit të punës, nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore në se ka.

Veprimtaria e katërt

Lojë: Në minutat e fundit zhvillohet një lojë me nxënësit në dyshe. Udhëzohen nxënësit që njëri të shqiptojë jo saktë një emër të gjinisë mashkullore në shumës që mbaron me –j ose –nj, nxënësi/ja tjetër ta gjejë gabimin dhe ta korrigjojë atë. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- shkrimin e drejtë të emrave të gjinisë mashkullore në numrin shumës që mbarojnë me –j ose –nj;
- kthimin e emrave të gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –j ose –nj, nga numri njëjës në shumës dhe anasjelltas;
- përdorimin e drejtë në fjali të emrave të gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –j, ose –nj;
- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj pesë emra të gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –j dhe pesë emra të gjinisë mashkullore që në shumës mbarojnë me –nj. Krijo fjali me to.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Lexim jashtëklase (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe: Përshtypjet prej leximit të librave jashtëklase	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza etj.;– (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja)– përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive;– (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja)– përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara;– tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;– shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;– ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.		Situata e të nxënit Leximi i librave jashtëklase	
Burimet dhe materialet didaktike: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; libra jashtëklase.		Lidhja me fushat e tjera: Lidhja me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">• Prezantimi i titullit të librit dhe autori.• Leximi i pjesës.• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.• Tregimi i përmbajtjes së pjesës.• Personazhet dhe cilësitë e tyre.• Mesazhi që përcjell pjesa.• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.• Ilustrim i pjesës me vizatim. Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.			
Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do zgjedhë mësuesi/ja për të punuar.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuha shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore: Vlerësim njohurish 1		Fjalë kyçe: vlerësim njohurish test përcakto kthej shkruaj	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.		Situata e të nxënit Vlerësim njohurish 1	
Burimet dhe materialet didaktike njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; fletët e testit, mjetet e shkrimit.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur.			
Veprimtaritë e nxënësve Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur. Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit.			
Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none">- plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst;- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.			

Projekti 1 (4 orë)

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT					
Titulli i projektit	Panairi i librit		Kohëzgjatja	1 orë ---gjuhë shqipe (të shkruarit)	
				1 orë ----gjuhë shqipe (të lexuarit)	
Lënda: Gjuhë shqipe		Mësuesi:		1 orë ---gjuhë shqipe (të lexuarit)	
				1 orë ---gjuhë shqipe (të lexuarit)	
Lidhja fushat e tjera:	Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi		Klasa:	E pestë	
Ideja e projektit:	Fëmijët pëlqejnë të lexojnë libra e revista. Shumëllojshmëria e informacionit dhe e pjesëve letrare apo jo letrare te librat dhe revistat bëjnë që ata t'i lexojnë ato me dëshirë. Gjithashtu librat dhe revistat i përdorin si burime informacioni në lëndë të ndryshme. Organizimi nga vetë nxënësit i “Panairit të librit” do të jetë një veprimtari interesante. Kjo iniciativë do të përmbushte të gjitha interesat e fëmijëve për të hulumtuar, lexuar e sipërmarrë. Ata do të dhurojnë libra por dhe do të tregtojnë me një çmim të arsyeshëm disa prej tyre. Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të kërkuar e gjetur libra dhe revista të ndryshme, aftësitë për të rivlerësuar librat e bibliotekës së klasës, aftësitë bashkëpunuese dhe sipërmarrëse.				
Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve	Dëshira për të lexuar libra e revista, për të hulumtuar dhe nxjerrë informacione prej tyre si dhe dëshira për të dhuruar libra, për të zëvendësuar librat me libra të rinj, shfrytëzohen si nxitje për zotërimin e disa kompetencave.				
Kompetencat kyçe që zhvillohen	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale		x
	Kompetenca e te menduarit	x	Kompetenca qytetare		x
	Kompetenca e të nxënit	x	Kompetenca digjitale		x
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	x			
Temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit	Lexim dhe diskutim i librave të lexuar		Klasifikimi i librave		
	Organizimi i panairit të librave		Përzgjedhja e titujve të librave të rinj		

Rezultatet e të nxënit	rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide kur diskuton për rëndësinë e librave dhe të leximit; ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij për temën; shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjalë të plota, kur diskuton për një panair; klasifikon librat dhe revistat e bibliotekës së klasës; shkruan skedat dhe çmimet për librat e revistat e paraqitura në panair; kontribuon në ndërtimin e standës së panairit; përzgjedh librat apo revistat që do të lexohen ditën e panairit; nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme; tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje; fotografon ose filmon momente nga ky aktivitet; liston titujt e librave të rinj që do të blihen me të ardhurat e siguruar nga ky aktivitet; lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera; paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij; demonstron pavarësi në mendime dhe veprime; respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; mbledh informacion nga burime të ndryshme; demonstron besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit.				
Metodologjia	(Individuale, në grup ose e gjithë klasa)	Diskutim	x	Hulumtim	x
		Bisedë	x	Punë në grup	x
			x		x
Burimet e nevojshme	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi, nxënësit, prindërit, nxënësit e klasave të tjera (1-4) të ftuar në panair.			
	Mjetet:	Libra, revista, karton, letër, lapustila, bllok shënimesh etj.			
	Materiale dhe burime	Materiale të ndryshme nga interneti që kanë lidhje me panairin, foto dhe CD.			
Pyetja kërkimore	A keni marrë pjesë në ndonjë panair?				
Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit.	Mësuesi/ja i nxit nxënësit që me anë të bisedave të lirshme me njëri-tjetrin të zbulojnë interesat e tyre dhe të shokëve/shoqeve për të lexuarin, titujt e librave që kanë në bibliotekën e klasës, titujt e librave që do të dëshironin të kishin në bibliotekën e klasës etj. Gjuhë shqipe Mësuesi/ja dhe nxënësit zhvillojnë një bisedë ku vihet në dukje rëndësia e të lexuarit si dhe vlera e një biblioteke. Mësuesi/ja e orienton bisedën te organizimi i një “panairi librash”. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe i drejtojnë pyetje mësuesit/es, dhe prindërve të ftuar në klasë. Pasi përfundojnë diskutimet, nxënësit ftohen të klasifikojnë librat dhe revistat që kanë në bibliotekën e klasës sipas llojit, moshës dhe sipas gjendjes (pak të përdorur, shumë të përdorur). Shkruajnë skeda për to.				

	<p>Nën kujdesin e mësuesit/es, nxënësit do të ndërtojnë standin e panairit ku në një vend të dukshëm do të vendosin librat që do të dhurohen. Librat që janë përdorur më shumë do t'i dhurohen nxënësve të klasave të tjera që do të marrin pjesë në panair.</p> <p>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të vendosin çmimet përkatëse për librat që do shiten. Për librat që janë në gjendje të mirë apo për librat që janë në disa kopje do të vendosen çmime që do të jenë më të ulëta se çmimi i kopertinës. Prindërit shpërndahen nëpër grupe dhe ndihmojnë për të përzgjedhur librat që do të shiten dhe për të përcaktuar çmimet e tyre. Shkruajnë në etiketa çmimin.</p> <p>Nxënësit diskutojnë në grupe të vogla dhe më pas me gjithë klasën në lidhje me librat apo revistat që do të zgjedhin për të lexuar ditën e panairit. Ata do tregojnë pse zgjedhën pikërisht atë libër apo revistë; do të tregojnë llojin e librit, autorin e tij dhe përshtypjen e parë që u la.</p> <p>Nxënësit janë të pranishëm të gjithë ditën e panairit. Disa dhurojnë libra, disa lexojnë libra, disa shesin libra, disa fotografojnë ose filmojnë. Mësuesi/ja dhe prindërit monitorojnë aktivitetin.</p> <p>Mbyllet aktiviteti duke pare fotot apo filmimet e bëra gjatë ditës së panairit por dhe gjatë përgatitjeve paraprake. Nxënësit bashkë me mësuesin/en renditin titujt e librave të rinj që do të blejnë me të ardhurat që siguruan nga ky aktivitet.</p>	
Produktet kryesore	Në grup:	Panairi i librit-stenda përkatëse
	Individualisht:	Skedat për çdo libër. Etiketat me çmimet e librave.
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit	Shkollë	X
	Klasë	X
Vlerësimet	Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)	Vlerësimi bëhet për: ndarjen me të tjerët e përvojave rreth leximit; pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve të nxënësve në lidhje me temën; demonstrimin e pavarësisë së mendimeve dhe veprimeve; demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.
	Vlerësime përmblledhëse (Në fund të projektit)	Panairi i librit Stenda e panairit Skedat dhe etiketat e librave Leximi i pjesëve të përzgjedhura
Buxheti	Buxheti i detajuar Përse? Nga kush?	Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme, letrave, tabakëve dhe lapustilave me ngjyra.

Shënim: Ky projekt mund të përshtatet nga mësuesit sipas nivelit të klasës;
mund të kombinohet edhe me matematikën (të bëhet projekt ndërlëndor);
mund të kombinohet edhe me artet (të bëhet projekt ndërlëndor) etj.

Test 1

KUSH ËSHTË NË PORTË?

Alberti nuk ka luajtur kurrë futboll, dhe si zakonisht po e ndjek ndeshjen e skuadrës së tij nga një bordurë guri.

- Kush do ta gjuajë njëmbëdhjetëmetërshin? - thirri fort arbitri. Por në atë çast Tonini ia mbathi nga porta, portieri i skuadrës sime nuk ishte dakord për njëmbëdhjetëmetërshin, kështu që kaptoi murin dhe u largua drejt shtëpisë duke e lënë portën të zbrazët!

Atëherë unë zbrita nga bordura dhe renda drejt arbitrit.

-Do të rri unë në portë, - i thashë.

Shokët e mi tundën kokën të pajtuar me situatën dhe thanë me gjysmë zëri:

-E kur ke luajtur ndonjëherë portier ti?

Por unë renda drejt portës dhe zura vend në qendër me sytë ngulur tek topi. E ndava mendjen të hidhesha djathtas, të bëhej ç'të bëhej. Mendova ta ndaloj, ta spraps, të hidhem mbi topin me çdo mënyrë, ta shndërroja trupin në një mburojë të pakalueshme që rrjeta të mos tundej kurrësi. U përkula përpara dhe prita.

Kundërshtari mori vrull dhe lëshoi gjuajtjen. Dhe ja ku u gjenda përdhe, në të djathtë, me topin rrasur në bark dhe duart ngulur fort pas topit që të mos më shpëtonte.

-E di? - më tha kapiteni. - Ti duhet të jesh portieri i parë i skuadrës.

Shokët e tjerë më rrihnin supet dhe dikush më puthi.

1. Pjesa e mësipërme është tregim:

(1 pikë)

- a) realist
- b) përshkrues
- c) fantastik

2. Alberti ka luajtur rolin e portierit:

(1 pikë)

- a) gjithmonë
- b) ndonjëherë
- c) asnjëherë

3. Tonini u largua nga porta ngaqë:

(1 pikë)

- a) u ndie i sëmurë
- b) nuk ishte dakord për njëmbëdhjetëmetërshin
- c) s'kishte besim se do e priste topin

4. Alberti arriti ta priste topin sepse:

(1 pikë)

- a) kishte besim te vetja
- b) ndoqi një plan të caktuar
- c) kishte besim te vetja dhe ndoqi një plan të caktuar

5. Shkruaj një titull tjetër për këtë pjesë:

(1 pikë)

6. Shkruaj mesazhin e pjesës:

(1 pikë)

7. Shkruaj dy karakteristika të tekstit përshkrues:

(2 pikë)

8. Gjej gabimin. Shkruaj drejt emërtimet e mëposhtme: (3 pikë)

filmi avatar	
rruga muhamet gjollesha	
ministra e arsimit	

9. Shkruaj si duhet datat e mëposhtme. (2 pikë)

Tiranë më 10, 11-2019 _____
10/17/2019 _____

10. Përcakto llojin e theksit në fjalët me shkronja të zeza.
“**Kundërshtari** mori vrull dhe lëshoi **gjuajtjen**. Dhe ja ku u gjenda **përdhe**.” (3 pikë)

11. Shkruaj dy fjali ku ta përdorësh fjalën **grykë**, në kuptimin e parë dhe në atë të figurshëm. (2 pikë)

12. Shkruaj një fjali ku të përdorësh sinonimin e fjalës **picirruk**. (1 pikë)

13. Shkruaj një fjali ku të përdorësh antonimin e fjalës **qaj**. (1 pikë)

14. Shkruaj 2 fjali ku të përdorësh fjalën **faje** në kuptime homonimike. (2 pikë)

15. Shkruaj një fjalë të urtë për miqësinë. (1 pikë)

16. Përdor në fjali shprehjen frazeologjike: **shes mend**. (1 pikë)

17. Shkruaj në gjuhë standarde fjalinë: (2 pikë)

Nana e mërzitun e kqyrte hanën e zvogëlueme përmes pemëve të oborrit.

18. Nënvizoi rrënjën; ndaj temën nga mbaresat; qarko parashtesat dhe prapashtesat e fjalës: **përpunimin** (5 pikë)

19. Shkruaj një fjalë të parme dhe një fjalë jo të parme. Për fjalën jo të parme shkruaj si është formuar. (2 pikë)

20. Ndërto fjali me emrin **shkëmb** në numri shumës. (1 pikë)

21. Në fjalinë e dhënë nënvizo me një vijë një emër konkret dhe me dy vija një emër abstrakt.
Në festën që organizoi Edlira kishte shumë fëmijë. (2 pikë)

22. Përshkruaj me 6-7 fjali vendbanimin tënd.

(5 pikë)

Vlerësimi	AP	ANP	AK	ASHK	ASH
Pikët	0-11	12-23	24-29	30-37	38-41

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Lexojmë Një verë në kodër		Situata e të nxënit: Koment i pamjeve të zonave kodrinore në stinën e verës	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;– dallon llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– vë në dukje stinën në të cilën autori përshkruan mjedisin, duke treguar detaje nga teksti;– ndërton nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf;– përshkruan ndjesitë që provon nga leximi i këtij teksti;– bashkëbisedon me të tjerët për pëlqimet e tij/saj për të vizituar një kodër si ajo që përshkruhet në tekst, duke treguar se çfarë do të bënte atje;– vlerëson përgjigjet e shokëve/shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- kodër;- stina e verës;- zijosh;- i nginjur.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor; harta e Shqipërisë;- pamje nga natyra në stinën e verës në zonat kodrinore;- mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-Mjedis.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- lexim-diskutim në dyshe;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- bashkëbisedim;- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja ka porositur nxënësit/et sjellin pamje të natyrës në zonat kodrinore në stinën e verës. Ftohen nxënësit/et t'i prezantojnë ato para klasës. Zhvillohet një bisedë rreth tyre. Veprimtaria e dytë <i>Lexim-diskutim në dyshe:</i> Njihen nxënësit/et me titullin e tekstit “Një verë në kodër”. Nxënësit/et komentojnë fotografitë në libër. <i>*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje. Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante. Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit.</i>			

*Punohet rubrika “Fjalë të reja”. Shpjegohen fjalët e reja. Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.

Ata/ato diskutojnë rreth përgjigjeve të pyetjeve në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të diskutojnë në grupe për të dalluar stinën në të cilën autori e ka përshkruar këtë mjedis, duke treguar detaje nga teksti..

Nxiten nxënësit/et të dallojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje karakteristikat e tij dhe të ndërtojnë në grupe nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf.

Në përfundim përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë fjalitë përmbledhëse të tekstit.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nëpërmjet bashkëbisedimit nxiten nxënësit/et të flasin e të tregojnë ndjesitë që u sjell leximi i këtij teksti.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit, duke vënë në dukje disa karakteristika të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- ndërtimin nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf;
- përshkrimin për ndjesitë që provon nga leximi i këtij teksti;
- diskutimin për pëlqimet e tij/saj për përshkrimin e figurës së tekstit;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Klasifikimi i emrave sipas lakimit (ora I)		Situata e të nxënit: Harta e konceptit për emrin.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – dallon emrat e lakimit të parë, të dytë, të tretë; – lakon emrat në trajtën e shquar dhe të pashquar, në numrin njëjës dhe në shumës; – përdor në fjali emrat në rasën e duhur; – kthen emrat në trajtën, numrin dhe rasën e kërkuar në fjali; – klasifikon emrat sipas lakimit të tyre; – demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; – vlerëson punën e të tjerëve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - klasifikim; - emra të lakimit I, II, III; - emra që mbarojnë me -i, -u, -a, -ja; 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve:

Metodologjia:


- harta e konceptit;
- diskuto-nxirr përfundimin;
- rishikim në dyshe;
- diskutim;
- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.

Veprimtaritë e nxënësve/eve:

Veprimtaria e parë

Harta e konceptit: Nxënësit/et krijojnë në grupe hartën e konceptit për emrin.

Mësuesi/ja e plotëson atë në tabelë, duke u mbështetur te puna e nxënësve/eve.



Veprimtaria e dytë

Diskuto-nxirr përfundimin: Mësuesi/ja njih nxënësit/et me temën e mësimit. Orientohen ata/ato të komentojnë figurën, të lexojnë tekstin e dhënë në libër dhe të kthejnë në trajtën e shquar, numri njëjës, rasa emërore, emrat me ngjyrë blu duke treguar se me çfarë shkronjash përfundojnë ato.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit/et se emrat grupohen në tri lakime.

Nxënësit/et lexojnë rubrikën “Mbaj mend”, diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se:

- emrat e lakimit të parë janë emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me -i;
- emrat e lakimit të dytë janë emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me -u;
- emrat e lakimit të tretë janë emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me -a, -ja.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë emra të lakimit I, II, III.

*Ndahen nxënësit/et në grupe dhe u jepet detyrë të lakojnë emrat: *lapsi, shoku, shoqja* - në trajtën e shquar dhe të pashquar, në njëjës dhe shumës.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1. Nxënësit/et punojnë individualisht për të vendosur në rasën e duhur emrat në kllapa.

Në përfundim, nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Diskutim në grup: Ushtrimi 2. Nxënësit/et punojnë në grupe për të klasifikuar emrat në tekst sipas lakimit të tyre, duke i kthyer më parë në trajtën e shquar, numri njëjës, rasa emërore.

Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e grupit. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e emrave të lakimit të parë, të dytë, të tretë;
- kthimin e emrave në trajtën, numrin dhe rasën e kërkuar;
- klasifikimin e emrave sipas lakimit të tyre;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Klasifikimi i emrave sipas lakimit (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për t'i klasifikuar emrat sipas lakimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon emrat e lakimit I, II, III;– klasifikon emrat sipas lakimit të tyre;– analizon emrat sipas kategorive të tyre gramatikore;– krijon fjali me emra në gjininë femërore dhe mashkullore, në numrin e njëjës dhe shumës;– demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- klasifikim;- emra të lakimit I, II, III;- emra që mbarojnë me -i, -u, -a, -ja.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe Veprimtaritë e nxënësve/eve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- analizë;- shkrim i drejtuar:- punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutimin e tyre. <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve fisha në të cilat janë shkruar nga dy fjali. Fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë, të dallojnë emrat dhe t'i klasifikojnë ato sipas lakimit të tyre. Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.			
Veprimtaria e dytë <i>Analizë:</i> Punë në grupe: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit/et që në dyshe të zgjedhin 5 emra në ushtrimin 1 dhe t'i analizojnë sipas shembullit të dhënë, duke treguar kategoritë e tyre gramatikore. Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit/et e disa dysheve prezantojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.			
Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i drejtuar:</i> Ushtrimi 5. Nxënësit/et punojnë individualisht për të krijuar fjali në të cilën të përdorin emrat <i>gëzimi, fiku, dhurata</i> , në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë e krijuara. Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore, nëse ka. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.			

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e emrave të lakimit I, II, III;
- klasifikimin e emrave sipas lakimit të tyre;
- analizën e emrave sipas kategorive të tyre gramatikore;
- krijimin e fjalive me emra të gjinisë femërore dhe mashkullore, në numrin njëjës dhe shumës;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj nga 3 emra për çdo lakim, krijo fjali me ta.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Katër muzikantët (ora I)		Situata e të nxënit: Përse na pëlqejnë përrallat?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon pjesën, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;– shpjegon fjalët e fjalorit duke krijuar fjali me to;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;– shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, në lidhje me përrallën;– krijon nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesë të përrallës;– tregon përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– analizon personazhet sipas veprimeve të tyre;– diskuton për personazhin që i pëlqen më shumë;– formulon mesazhin që përcjell përralla;– vlerëson punën e shokëve dhe të shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-muzikant;-gomar;-langua;-dac;-gjel;-lahutë;-trumbetë;-bujnë;-kusar;	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit-teksti mësimor;-përralla nga vëllezërit Grim;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-Të drejtat e njeriut;-Vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe Veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-bisedë;-veprimtari e leximit të drejtuar;-të nxënësit me këmbime;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Veprimtaria e parë			
<i>Bisedë:</i> Bisedë me nxënësit/et rreth pëlqimeve që ata/ato kanë për përrallat.			
<ul style="list-style-type: none">-Pse na pëlqejnë përrallat?-Cilat janë përrallat që ju kanë pëlqyer më shumë?			
Veprimtaria e dytë			
<i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e përrallës “Katër muzikantët” dhe autorët, vëllezërit Grim.			
*Vëzhgim dhe komentim i ilustrimit në libër nga nxënësit/et.			
*Lexim me ndalesa i pjesës nga nxënësit/et. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve të bëra prej saj për secilën ndalesë, duke u kujdesur të punohen të gjitha pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kup-toj”.			
<ul style="list-style-type: none">-Nisur nga titulli dhe nga ilustrimi, për çfarë mendoni se bën fjalë kjo përrallë?			
Ndalesa I Një burrë... deri te... pa u lodhur!			
Pyetje: - Pse vendosi gomari të largohej nga i zoti i tij? <ul style="list-style-type: none">- Çfarë mendonte gomari të bënte në qytet?			
Ndalesa II Udhës na takon... deri te... u nisën bashkë.			
Pyetje: - Cilin takoi gomari rrugës? <ul style="list-style-type: none">- Çfarë shqetësimi kishte langoi?- Ç’propozim i bëri atij gomari?- Si mendoni se do të vazhdojë pjesa?			

Ndalesa III *Më tej na takojnë... deri te... u nis me ta.* Pyetje: - Kë takuan ata gjatë rrugës?

- Pse ishte i mërzhitur daci?
- Çfarë propozimi iu bë daci?

Ndalesa IV *Ec e ec... deri te... vazhduan udhën.* Pyetje: - Cilin panë ata majë portës së oborrit?

- Pse ishte i shqetësuar gjeli?
- Çfarë propozimi i bënte gjelit?

Ndalesa V *Qyteti ishte... deri te... për të kaluar natën.*

Pyetje: -Ku i zuri nata miqtë?

- Çfarë pa gjeli?
- Çfarë vendosën të bëjnë miqtë?
- Si mendoni se do të vazhdojë ngjarja?

Ndalesa VI *Ashtu bënë... deri te... do thoni ju.* Pyetje: - Ku arritën miqtë?

- Çfarë pa gomari nga dritarja e shtëpisë?
- Çfarë vendosën të bënin miqtë?
- Si mendoni se do t'i dëbonin ata kusarët?

Ndalesa VII *Ja se si... deri te... me të katra në pyll.* Pyetje: - Si arritën katër shokët të trembnin kusarët?

Ndalesa VIII *Të katër miqtë... deri te... trarët e shtëpisë.* Pyetje: - Ç'bënë të katër shokët?

Ndalesa IX *Nga mesi i natës... deri te... ia nisi kikirikisë.*

Pyetje: -Çfarë ndodhi nga mesi i natës?

Ndalesa X *tmerruar... deri te... s'i hidhnin andej.*

Pyetje: Pse u kthye i tmerruar njëri prej kusarëve të shokët e tij?

- A u kthyen më kusarët në shtëpi? Pse?

Ndalesa XI *Kështu... deri në fund.*

Pyetje: -Kujt i mbeti shtëpia?

*Punohet rubrika "Fjalë dhe shprehje". Nxiten nxënësit/et të shpjegojnë fjalët dhe shprehjet e reja dhe të ndërtojnë fjali me to.

*Punohet rubrika "Mësoj më shumë", në të cilën nxënësit/et njihen me krijimtarinë e vëllezërve Jakob dhe Vilhelm Grim.

*Lexim i përrallës zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Të nxënësit me këmbime, grupet e ekspertëve: Punohet rubrika: "Analizoj".

Nxënësit/et grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit u caktohet nga një numër nga 1-4.

Nxënësit/et ndahen detyrat:

Nxënësit/et me numrin 1 do të zgjedhin dy prej personazheve të përrallës dhe do t'i krahasojnë ato.

Nxënësit/et me numrin 2 do të gjejnë se cila është arsyeja që i bën personazhet të bashkëveprojnë.

Nxënësit/et me numrin 3 do të ndërtojnë për çdo pjesë nga një fjali përmbledhëse.

Nxënësit/et me numrin 4 do të formulojnë mesazhin që përcjell përralla.

Nxënësit/et sipas numrave që kanë do të rigrupohen dhe do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve.

Pas kryerjes së detyrave, ata/ato do të shkojnë në grupet fillestare ku do t'ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit.

Në fund diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

*Disa nxënës/e tregojnë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e përrallës.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;
- shpjegimin e fjalëve të fjalorit, duke krijuar fjali me to;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;
- krijimin nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesë të përrallës;
- tregimin e përmbajtjes së përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- analizën e personazheve sipas veprimeve të tyre;
- formulimin e mesazhit që përcjell përralla;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Katër muzikantët (ora II)		Situata e të nxënit: Fragmenti nga përralla që më ka pëlqyer më shumë.	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– përshkruan personazhin që i pëlqen më shumë;– tregon përmbajtjen e përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes;– shkruan një mbyllje tjetër për përrallën;– interpreton përrallën në role;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-muzikant;-gomar;-langua;-dac;-gjel;-lahutë;-trumbetë;-bujnë;-kusar;	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-përralla nga vëllezërit Grim;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe Veprimtaritë e nxënësve/eve: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-bashkëbisedim;-shkrim i shpejtë;-lexim në role;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve			
Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fragmentin e shkëputur nga përralla që u ka pëlqyer më shumë dhe të tregojnë arsyen e përzgjedhjes së tyre. *Lexim zinxhir i përrallës nga nxënësit/et. * Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes.			
Veprimtaria e dytë <i>Bashkëbisedim:</i> Punohet rubrika “Reflektoj“. Nxënësit/et flasin për personazhin që u pëlqen më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes. Nxiten ata/ato të tregojnë se ç’kuptojnë nga kjo përrallë, duke përzgjedhur njërën nga alternativat e dhëna.			
Veprimtaria e tretë <i>Shkrim i shpejtë:</i> Nxënësit/et individualisht do të shkruajnë një mbyllje tjetër për përrallën. Pas përfundimit të detyrës, nxiten nxënësit/et ta lexojnë atë me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/et bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore nëse ka.			

Veprimtaria e katërt

Lexim në role: Nxënësit/et të organizuar në grupe lexojnë përrallën në role.

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e përrallës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- tregimin e përmbajtjes së përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- diskutimin për personazhet që i pëlqejnë më shumë;
- shkrimin e një mbyllje tjetër për përrallën;
- interpretimin në role të përrallës;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një titull tjetër për këtë përrallë. Pse mendon se ky është titulli i duhur?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Shkruajmë përmbledhje		Situata e të nxënit: Si mund të përmbledhim një përrallë?	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– krijon nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesëz të përrallës “Katër muzikantët”;– shkruan përmbledhjen e përrallës, duke ndjekur udhëzimet;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -përrallë; -përmbledhje.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tabelë me udhëzime për shkrimin e një përmbledhje përralle; -libra me përralla; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: -bisedë; -punë e drejtuar; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja u drejton pyetjen nxënësve/eve: <i>-Çfarë mbani parasysh ju kur u tregoni të tjerëve përrallat që keni lexuar?</i> Nxënësit/et japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja sqaron: <i>të përmbledhësh një përrallë do të thotë të paraqesësh shkurtimisht përmbajtjen e saj. Në fillim lexo përrallën e mbaj shënim çështjet kryesore. Kontrolllo gjithmonë kuptimin e fjalëve të reja, për ta kuptuar më mirë.</i> Veprimtaria e dytë <i>Punë në grupe:</i> Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë përrallën “Katër muzikantët” të ndarë në pjesëza dhe më pas punojnë në grupe për të krijuar nga një fjali përmbledhëse për secilën pjesëz. Lexohen fjalitë nga nxënësit/et me zë para klasës. Zhvillohet një diskutim rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es.			

Veprimtaria e tretë

Punë në grupe: Ushtrimi 2. Nxiten nxënësit/et të grupojnë fjalitë përmbledhëse, duke shënuar numrin përkatës poshtë pyetjeve:

- *Si u bënë miq katër muzikantët?*
- *Çfarë të papriturash u ndodhën?*
- *Ku shkuan ata?*
- *Si u ndien personazhet?*
- *Si përfundon historia?*
- *Çfarë fat patën kusarët?*

Nxënësit/et diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth grupimit të fjalive përmbledhëse, duke dhënë shpjegimet përkatëse.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Lexohen dhe diskutohen nga nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es, udhëzimet e nevojshme për shkrimin e përmbledhjes së një përralle.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë në fletore përmbledhjen e përrallës, duke ndjekur udhëzimet.

Në përfundim të punës nxënësit/et shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrit dhe lexojnë përmbledhjen e përrallës para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.


Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- krijimin e fjalive përmbledhëse për çdo pjesëz të përrallës “Katër muzikantët”;
- shkrimin e përmbledhjes së përrallës duke ndjekur udhëzimet;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Mbiemri: gjinia, numri dhe rasa e tij (ora I)		Situata e të nxënit: Harta e konceptit për mbiemrin.	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon llojin, gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm në fjali;– përshtat mbiemrin me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;– kthen grupet e fjalëve (emër + mbiemër) nga numri njëjës në shumës ose anasjelltas;– shkruan mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm për emrat e dhënë;– krijon fjali me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit; -rasa e mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -harta e konceptit të mbiemrit; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe Veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -harta e konceptit; -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Harta e konceptit:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja fton nxënësit/et që në grupe të plotësojnë hartën e konceptit të mbiemrit. përshtaten me emrin që cilëson tregon cilësi të njerëzve, kafshëve, sendeve, vendeve			



Veprimtaria e dytë

Diskutim: Nxiten nxënësit/et që në dyshe të lexojnë tekstin në libër, të nënvizojnë mbiemrat dhe t'i klasifikojnë ato në të nyjshëm dhe të panyjshëm.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit/et për kuptimin e mbiemrave dhe rolin e tyre për të treguar cilësitë e emrit që përcakton, duke studiuar edhe rubrikën “Mbaj mend”.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të shoqërojnë secilin emër me mbiemrat që i përshtaten.

Ushtrimi 2 synon kthimin e grupeve të fjalëve emër + mbiemër nga numri njëjës në shumës dhe anasjellas.

Ushtrimi 3 synon shkrimin e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm që përftohen prej emrave të dhënë, sipas modelit në libër.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit/et për paqartësitë që kanë. Nxënësit/et punojnë individualisht në libër.

Në përfundim të punës shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Diskutohet në klasë rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Nxënësit/et krijojnë fjali me 3 nga mbiemrat e nyjshëm dhe me 3 nga mbiemrat e panyjshëm të ushtrimit 3. Nxënësit/et lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore, nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e llojit, gjinisë, numrit dhe rasës së mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm në fjali;
- përshtatjen e mbiemrit me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;
- shkrimin e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm për emrat e dhënë;
- krijimin e fjalive me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie:

Shkruaj 5 fjali ku të përdorësh mbiemra të ndryshëm. Trego numrin, gjininë dhe rasën e tyre.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Mbiemri: gjinia, numri dhe rasa e tij (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon llojin, gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave në fjali;– përshtat mbiemrin me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;– krijon fjali, duke përdorur mbiemra në llojin, numrin, gjininë dhe rasën e kërkuar;– analizon mbiemrat në kategoritë gramatikore të mësuara;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: -mbiemri; -cilësi; -i nyjshëm; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit; -rasa e mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra; -harta e konceptit të mbiemrit; -tabela e ushtrimit 5; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: -diskutim; -rishikim në dyshe; -analizë; konkurs; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë nga një fletë ku ka shkruar tri fjali. U lë detyrë nxënësve që në dyshe të dallojnë mbiemrat në fjali dhe të tregojnë llojin, gjininë, numrin dhe rasën e tyre. Në përfundim, përfaqësuesit e disa dysheve prezantojnë punën e bërë. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 4. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të rishkruajnë tekstin duke përshtatur mbiemrat me emrat që shoqërojnë. Pasi përfundojnë punën, nxënësit shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.			

Veprimtaria e tretë

Analizë, konkurs: Ushtrimi 5. Nxënësit/et punojnë në grup për plotësimin e tabelës së ushtrimit 5 ku do të shënojnë llojin, gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave.

Pas përfundimit të punës, secili grup prezanton tabelën e tij me përgjigjet përkatëse. Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpall grupin fitues.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 6. Nxënësit/et punojnë individualisht për të krijuar fjali me pesë nga mbiemrat të vendosura në tabelën e ushtrimit 5. Në përfundim ata/ato lexojnë fjalitë me zë.

Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et bëjnë qortime drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e llojit, gjinisë, numrit dhe rasës së mbiemrave në fjali;
- përshtatjen e mbiemrit me emrin që cilëson në gjini, numër dhe rasë;
- krijimin e fjalive duke përdorur mbiemra në llojin, numrin, gjininë dhe rasën e kërkuar;
- analizën e mbiemrave në kategoritë gramatikore të mësuara;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie:

Shkruaj një tregim të shkurtër me temë “Vizitë në një muze”, ku të përdorësh mbiemra.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Hipopotami kërkon një shok		Situata e të nxënit: A duhet t'i nënvlerësojmë të tjerët për faktin se mund të jenë më të vegjël dhe më të pafuqishëm se ne?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– parashikon rreth përmbajtjes së përrallës, duke u mbështetur tek titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe;– lexon përrallën, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth përrallës;– u përgjigjet pyetjeve rreth përrallës;– shkruan nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesë të përrallës;– tregon përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– analizon personazhet, duke u mbështetur në veprimet e tyre;– tregon se çfarë vlerëson te shoku/shoqja e tij/saj;– interpreton përrallën në role;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: -hipopotami; -majmuni; -iriqi; -shok.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me përralla; -fotografi dhe informacione për hipopotamin, majmunin, iriqin; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet; Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: -parashikim me anë të titullit, ilustrimit dhe fjalëve kyçe; -diskutim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -harta e personazheve; -bashkëbisedim; -lexim me role; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë Mësuesi/ja shtron pyetjen: A duhet t'i nënvlerësojmë të tjerët për faktin se mund të jenë më të vegjël dhe më të pafuqishëm se ne? -Kësaj pyetje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës. <i>*Parashikim me anë të titullit, ilustrimit dhe fjalëve kyçe:</i>			

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: *hipopotam, majmun, iriq, ankohet, shok*.

Nxënësit/et shohin ilustrimin, lexojnë titullin dhe fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e përrallës, duke punuar në dyshe. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë (me katër fjali ku t'i përdorin këto fjalë). Nxiten nxënësit/et të lexojnë parashikimet e tyre.

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Lexohet përralla nga nxënësit/et në heshtje.

Më pas, diskutohet në dyshe rreth përmbajtjes së saj.

*Nxënësit/et tregojnë ndryshimet rreth përmbajtjes së saj dhe parashikimit që kanë bërë.

*Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme.

*Në përfundim të punimit të të gjithë pjesës, u lihet kohë nxënësve/eve ta rilexojnë atë.

*Zhvillohet leximi zinxhir i përrallës.


Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et tregojnë ç’lloj teksti është dhe në disa karaktersitika të tij.

Veprimtaria e katërt

Rubrika “Analizoj”: nxënësit tregojnë ç’lloj teksti është materiali i dhënë, dhënë disa karakteristika të tij.

Punë në grupe: Harta e personazheve: Për majmunin gjenden dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet nga një pjesë ilustruese nga teksti.



*Udhëzohen nxënësit/et të ndajnë tekstin në pjesë dhe të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse.

Më pas disa nxënës tregojnë përmbajtjen, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Në rubrikën “Reflektoj” nxënësit/et tregojnë se për çfarë njëjti iriqi, duke e shoqëruar me hollësi nga teksti. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë vlerësojnë te shoku apo shoqja e tyre.

Veprimtaria e gjashtë

Lexim me role: Nxënësit/et ndajnë rolet në grupe dhe lexojnë përrallën.

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- parashikimin rreth përmbajtjes së përrallës, duke u mbështetur tek titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe;
- leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përrallës;
- tregimin e përmbajtjes së përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre;
- interpretimin e përrallës në role;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Drejtshkrimi i mbiemrave të panyjshëm në numrin shumës		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të shkruar saktë mbiemrat e panyjshëm në numrin shumës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – tregon se mbiemrat e panyjshëm të gjinisë femërore dhe mashkullore e formojnë shumësin: <i>njësoj si njëjës</i> in dhe <i>me mbaresë</i> ; – shkruan saktë mbiemrat e panyjshëm në numrin shumës; – kthen grupet e fjalëve (emër + mbiemër i panyjshëm) nga numri njëjës në numrin shumës; – krijon fjali, duke përdorur mbiemra të panyjshëm në numrin shumës; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: -mbiemri; -i panyjshëm; -gjinia e mbiemrit; -numri i mbiemrit.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me mbiemra të panyjshëm; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: -diskuto-nxirr përfundimin; -rishikim në dyshe; -diskutim; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin:</i> Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me temën e mësimit dhe i fton të lexojnë në tekst grupet (emër + mbiemër), të cilat vetë i ka paraqitur në tabelë. Nxiten nxënësit/et të vërejnë dhe të diskutojnë se si e kanë formuar shumësin mbiemrat e panyjshëm, në fillim në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. Lexohet dhe diskutohet rubrika “Mbaj mend”.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të lidhin mbiemrat e panyjshëm me emrat përkatës.

Ushtrimi 2 synon kthimin e grupeve të fjalëve (emër + mbiemër i panyjshëm) nga numri njëjës në shumës.

Nxënësit/et punojnë individualisht . Në përfundim të punës shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxënësit/et diskutojnë në klasë rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es, duke theksuar se mbiemrat e panyjshëm e formojnë shumësin: *njësoj si njëjës* dhe *me mbaresë*.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të shndërrojnë fjalitë sipas modelit të dhënë në ushtrim, duke diskutuar ndryshimet që pëson mbiemri kur kalon nga numri njëjës në numrin shumës.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4. Nxënësit/et punojnë individualisht për të krijuar fjali, ku të përdorin mbiemrat e panyjshëm *çapkën, fisnik, trupmadh* në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Në përfundim, nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Bëhen qortimet e gabimeve drejtshkimore, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- shkrimin e saktë të mbiemrave të panyjshëm në numrin shumës;
- kthimin e grupeve të fjalëve (emër + mbiemër i panyjshëm) nga numri njëjës në numrin shumës;
- krijimin e fjalive, duke përdorur mbiemra të panyjshëm në numrin shumës;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie:

Krijohet fjali ku të përdorësh mbiemrat e panyjshëm *shumëngjyrëshë, vezullues, lridashës, shekullor* në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Dy gratë		Situata e të nxënit A është mirë që të kursejmë çdo ditë dhe a dimë të kursejmë aty ku duhet?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;– tregon përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;– përshkruan ndjesitë që përcjellin personazhet nëpërmjet veprimeve të tyre;– dallon ndryshimet midis dy karaktereve të përfaqësuar nga dy gratë, duke ilustruar me detaje nga teksti;– shpjegon me fjalët e tij se ç’tregon autori me këtë ngjarje;– shkruan si vazhdon historia në familjen e Chaos;– diskuton për rëndësinë që ka përdorimi i parasë dhe kursimi i saj;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-nikoqire;-sojë;-kanistër;-qilar;-qyp	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-përralla për fëmijë;-mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-pyetja e ditës;-lexim-diskutim në dyshe;-mendo-zbulo;-dallos-trego;-diskutim;-shkrim i shpejtë;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve:			

Veprimtaria e parë

Pyetja e ditës: Mësuesi/ja shtron pyetjen:

-A mendoni se është mirë që të kursejmë çdo ditë dhe a dimë të kursejmë aty ku duhet kursyer?

-Kësaj pyetje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës.

Veprimtaria e dytë

Lexim, diskutim në dyshe: Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës “Dy gratë”.

Orientohen nxënësit/et të vështrojnë ilustrimin në libër dhe të diskutojnë rreth tij.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë pjesën në heshtje.

*Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante.

Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en.

*Shpjegojnë kuptimin e fjalëve të reja dhe krijojnë fjali me to.

*Zhvillohet leximi zinxhir i pjesës.

Veprimtaria e tretë

Mendo-zbulo: Punë në dyshe: Rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Ftohen nxënësit/et që në fjalitë përmbledhëse rreth përrallës të dallojnë fjalitë e vërteta nga ato të gabuara, si dhe të ndërtojnë saktë fjalitë e gabuara. Në përfundim të punës, përfaqësuesit/et e disa dysheve tregojnë punën e bërë.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punë në grupe: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et, nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve, tregojnë se ç’lloj teksti është duke treguar edhe disa karakteristika të tij.

*Nxiten ata/ato të krahasojnë dy karakteret e përfaqësuar nga dy gratë në tekst, duke i ilustruar me detaje nga teksti dhe të tregojnë ndjesitë që përcjellin personazhet nëpërmjet veprimeve të tyre.

Veprimtaria e pestë

Diskutim: Rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth mendimeve që ata/ato kanë për veprimet dhe qëndrimet e personazheve në përrallë (Caoja dhe gruaja e tij), si dhe të shpjegojnë me fjalët e tyre se çfarë tregon autori me këtë ngjarje.

Nxënësit/et në grupe nxjerrin dhe mesazhin e përrallës:

Që të fitosh, duhet të mësosh si të kursesh çdo ditë nga pak.

Veprimtaria e gjashtë

Shkrim i shpejtë: Nxiten nxënësit/et që me 3-4 fjali të tregojnë se si vazhdon historia në familjen e Caos. Në përfundim të punës, disa nxënës/e lexojnë shkrimet e tyre.

*Në minutat e fundit nxënësit/et diskutojnë për rëndësinë që ka përdorimi i parasë dhe kursimi i saj. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e përrallës, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;

-shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;

-tregimin e përmbajtjes së përrallës mbi bazën e fjalive përmbledhëse;

-përshtkrimin e ndjesive që përcjellin personazhet nëpërmjet veprimeve të tyre;

-dallimin e ndryshimeve midis dy karaktereve të përfaqësuar nga dy gratë, duke ilustruar me detaje nga teksti;

-formulimin e mesazhit që përcjell përralla;

-shkrimin e vazhdimet të historisë në familjen e Caos;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika: “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Krahasonjmë personazhet që duam më shumë (ora I)		Situata e të nxënit Cilët janë personazhet e librave më të dashura për ju?	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan personazhet e dashura të librave që i pëlqejnë më shumë;– lexon një tekst në të cilin krahasohen dy personazhe të pëlqyeshme të librave, duke nënvizuar cilësitë, interesat, sjelljet e tyre, mendimin që ka për to etj;– krahason dy personazhe të dashura të librave, duke u bazuar në modele dhe duke ndjekur udhëzimet;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">-personazhe të dashura;-përshkrim;-krahasim;-Nina de Nobili;-Hermionë Grenxher;-prezantimi;-paraqitja e jashtme;-paraqitja e brendshme;-interesat;-lidhja me shokët dhe me miqtë;-shkolla, shtëpia;-mendimi yt.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti shkollor;-libra për fëmijë;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-bisedë;-diskutim;-shkrim i lirë;-punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Bisedë me nxënësit/et rreth personazheve të librave që u pëlqejnë më shumë. -Cilët janë personazhet e librave më të dashura për ju? Tregoni për to. Mësuesi/ja njeh nxënësit/et me temën e mësimin. Veprimtaria e dytë <i>Diskutim:</i> <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tekstin në të cilin krahasohen dy personazhe të pëlqyeshme të librave “Vogëlushja e Hënës së Gjashtë” dhe “Herri Poter”: Nina de Nobili dhe Hermionë Grenxher.			

Nxiten nxënësit/et të lexojnë tekstin duke nënvizuar cilësitë, interesat, sjelljet e tyre, mendimin që ka për to etj.;

Nxënësit/et diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth këtyre dy personazheve të librave, shumë të dashura për fëmijët.

Ushtrimi 1. Udhëzohen nxënësit/et të plotësojnë tabelën për personazhet e përshkruara në tekst. Nxiten ata/ato të krahasojnë personazhet sipas paraqitjes së jashtme, paraqitjes së brendshme, interesave, lidhjen me shokët, shkollën, shtëpinë, si e kalon kohën e lirë dhe mendimin që kanë për to, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna.

Përfaqësuesit/et e disa dysheve prezantojnë tabelën e plotësuar para klasës.

Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: 2. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të krahasojnë sipas modelit personazhet e paraqitura në ilustrim, duke ndërtuar dhe plotësuar një tabelë si në ushtrimin 1, ose duke ndjekur hapat:

-Prezantim i karakteristikave të përgjithshme.

-Përshkrim i ndonjë karakteristike fizike të veçantë.

-Sjellja e personazheve.

-Trego shkurt si e kalojnë kohën, çfarë u pëlqen të bëjnë.

-Shkruaj çfarë mendon për personazhet.

Në përfundim të punës, nxiten nxënësit/et të shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, të kontrollojnë punën e njëri-tjetrit dhe të lexojnë detyrën para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e një teksti në të cilin krahasohen dy personazhe të dashura të librave, duke nënvizuar cilësitë, interesat, sjelljet e tyre, mendimin që ka për to etj;

-krahasimin e dy personazheve të dashura të librave që ka lexuar, duke u bazuar në modele dhe duke ndjekur udhëzimet e dhëna;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Zgjidh dy personazhe të tjera të paraqitura në ilustrim dhe krahasoji ato.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Krahasonjmë personazhet që duam më shumë (ora II)		Situata e të nxënit Krahasonim i personazheve të dashura të librave	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – përshkruan personazhet e librave që i pëlqejnë më shumë; – krahason dy personazhe të dashura të librave për fëmijë që ka lexuar, duke u bazuar në modele dhe duke ndjekur udhëzimet; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë proceset të të shkruarit; – bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -personazhe të dashura; -krahasonim; -prezantim; -paraqitja e jashtme; -paraqitja e brendshme; -interesat; -lidhja me shokët dhe me miqtë; -shkolla, shtëpia; -mendimi yt.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit -teksti mësimor; -libra për fëmijë; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare - Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -shkrim i lirë; -konkurs; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë. <i>Bisedë:</i> Nxiten nxënësit/et të tregojnë rreth librave për fëmijë që kanë lexuar, të përshkruajnë dy nga personazhet më të dashura për to dhe t’i krahasojnë. Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i lirë:</i> Ushtrimi 3. Nxiten nxënësit/et të zgjedhin dy personazhe nga lista dhe t’i krahasojnë sipas modelit të dhënë në ushtrimin 1 ose duke ndjekur hapat e dhënë në ushtrimin 2 të librit. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Në përfundim të punës lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es qortohen gabimet drejtshkrimore nëse ka. Veprimtaria e tretë <i>Konkurs:</i> Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri shkrimet më të mira.			

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e personazheve të librave që i pëlqejnë më shumë;
- krahasimin e dy personazheve të dashura të librave për fëmijë që ka lexuar, duke u bazuar në modele;
- qortimet drejtshkimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e shkrimeve të shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Zgjidh dy personazhe të tjera nga lista e ushtrimit 3 dhe krahasoji ato.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i përemrit vetor (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e përemrave vetorë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lakon përemrat vetorë sipas rasave; – vë në dukje se gjatë lakimit përemrat vetorë në rasat dhanore dhe kallëzore dalin me dy forma (trajtë e plotë + trajtë e shkurtër); – dallon trajtat e plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë; – tregon me anë të shembujve pozicionin që zënë trajtat e shkurtra në raport me foljen; – vendos në rasën e duhur përemrat vetorë në fjali; – krijon fjali duke përdorur përemra vetorë në rasa të ndryshme; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: -përemra vetorë; -lakim; -trajta të plota; -trajta të shkurtra.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tabela e lakimit të përemrave vetorë; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: -tryezë rrethore; -diskuto-nxirr përfundimin; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. <i>Tryezë rrethore:</i> Nxënësit/et janë vendosur në grupe, në formë rrethore: Ftohen të shkruajnë në fletë nga një fjali, ku të përdorin përemra vetorë. Secili e palos fletën si fizarmonikë dhe ia pason shokut. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et hapin fletat dhe i lexojnë fjalitë. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për përemrat vetorë, duke u mbështetur në rubrikën “Kujtoj”.			

Veprimtaria e dytë

Diskuto-nxirr përfundimin: Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë fjalitë në libër të cilat mësuesi/ja i ka shkruar në tabelë dhe të tregojnë fjalët me ngjyrë të gjelbër.

Mësuesi/ja sqaron se këto fjalë tregojnë “vetën që flet”, pra vetën e parë. Ato janë format e ndryshme që merr përemri vetor i vetës së parë njëjës dhe shumës gjatë lakimit. Përemri vetor lakohet ashtu si emri.

*Ftohen nxënësit/et të lexojnë në dyshe tabelën e lakimit të përemrave vetorë dhe të diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es për ndryshimet që pësojnë përemrat vetorë gjatë lakimit.

Tërhiqet vëmendja se përemrat vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore dalin me dy forma (trajtë e plotë + trajtë e shkurtër).

Nxënësit/et lexojnë shpjegimet që jepen në rubrikën “Mbaj mend” për trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në rasën dhanore dhe kallëzore, pozicionin që zënë trajtat e shkurtra në raport me foljen, duke i ilustruar me shembuj përkatës.

Zhvillohet një diskutim rreth tyre në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të nënvizojnë trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në fjalitë e dhëna.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të vendosin në rasën e duhur përemrat në kllapa.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Më pas ata/ato punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrit.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Nxiten nxënësit/et të punojnë individualisht për të krijuar fjali me përemrat vetorë në rasën rrjedhore.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- lakimin e përemrave vetorë sipas rasave;
- dallimin e trajtave të plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë;
- tregimin me anë të shembujve të pozicionit që zënë trajtat e shkurtra në raport me foljen;
- vendosjen në rasën e duhur të përemrave vetorë në fjali;
- krijimin e fjalive, duke përdorur përemra vetorë në rasa të ndryshme;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një tekst të shkurtër me temë “Shoku im më i mirë”, ku të përdorësh përemra vetorë në rasa të ndryshme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lakimi i përemrit vetor (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar rasën e përemrave vetorë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lakon përemrat vetorë sipas rasave; – dallon trajtat e plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë në fjali; – përcakton vetën, numrin, rasën e përemrave vetorë në fjali (për vetën e tretë edhe gjininë); – shkruan fjali duke përdorur përemra vetorë në vetën, numrin, rasën e kërkuar; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -përemra vetorë; -lakim; -trajta të plota; -trajta të shkurtra.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -tabela e lakimit të përemrave vetorë; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -rishikim në dyshe; -diskutim; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë fleta në të cilat ka shkruar 2-3 fjali dhe i udhëzon nxënësit/et që në dyshe të nënvizojnë trajtat e plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë dhe të përcaktojnë vetën, numrin dhe rasën e tyre (për vetën e tretë edhe gjininë). Përfaqësuesit/et e disa dysheve prezantojnë punën e bërë para klasës. <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 3. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë individualisht në tekst për të nënvizuar përemrat vetorë (trajtat e shkurtra dhe trajtat e plota), të përcaktojnë vetën, numrin dhe rasën e tyre. Pas përfundimit të punës nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Nxënësit/et diskutojnë rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të lakojnë përemrat vetorë: *unë, ne, ti, ju*. Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimit.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e bërë para klasës.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5. Nxënësit/et individualisht punojnë në fletore për të krijuar nga një fjali me përemrat e ushtrimit 4, në rasën dhanore dhe kallëzore.

Në përfundim të punës lexojnë detyrën para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es qortohen gabimet drejtshkrimore nëse ka.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- lakimin e përemrave vetorë sipas rasave;
- dallimin e trajtave të plota dhe të shkurtra të përemrave vetorë në fjali;
- përcaktimin e vetës, numrit, rasës së përemrave vetorë (për vetën e tretë edhe gjininë);
- shkrimin e fjalive duke përdorur përemra vetorë në vetën, numrin, rasën e kërkuar;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj nga një fjali me përemrat vetorë të vetës së tretë, të gjinisë femërore dhe mashkullore, në rasën dhanore dhe kallëzore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë I ati, i biri dhe gomari (ora I)		Situata e të nxënit A mendoni se ne gjithnjë duhet të bëjmë gjënë e duhur, apo atë që u pëlqen të tjerëve?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante; – shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja, duke krijuar fjali me to; – shpreh ndjenjat dhe emocionet e tij/saj rreth përrallës; – u përgjigjet pyetjeve rreth përrallës; – analizon veprimet e djalit dhe babait; – tregon si ndryshojnë veprimet e personazheve pas fjalëve të njerëzve; – vlerëson përpjekjet individuale dhe ato në grup; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: -i ati; -i biri; -gomari; -zdripim; -kështu punuan.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -përralla për fëmijë; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare -Të drejtat e njeriut.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: - pyetja e ditës; - veprimtari e leximit të drejtuar; - marrëdhënie pyetje-përgjigje; - analizë; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Pyetja e ditës:</i> Mësuesi/ja shtron pyetjen: <i>-A mendoni se ne gjithnjë duhet të bëjmë gjënë e duhur, apo atë që u pëlqen të tjerëve?</i> Kësaj pyetje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës. Veprimtaria e dytë <i>Veprimtari e leximit të drejtuar:</i> Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës “I ati, i biri dhe gomari” dhe autorin Luigj Gurakuqi. -A ju pëlqeu kjo pjesë? Pse? -Si u ndjetë pas leximit të kësaj pjese? *Njihet nxënësit shkurtimisht me jetën dhe krijimtarinë e Luigj Gurakuqit, duke lexuar rubrikën “Mësoj më shumë”. *Nxënësit/et lexojnë në heshtje, nënvizojnë fjalët e shprehjet që nuk kuptojnë. *Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje” në libër. Nxiten nxënësit/et të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve dhe të ndërtojnë fjali me to.			

*Lexim i pjesës zinxhir nga nxënësit/et.

*Vëzhgim dhe komentim i ilustrimit në libër nga nxënësit/et.

*Lexim me ndalesa i pjesës nga nxënësit/et.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve të bëra prej saj për secilën ndalesë.

Ndalesa I *Një atë shkonte një ditë... deri te... të humbur që janë!*

Pyetje: -Ku po shkonte ati me djalin e tij?

-Kush po i shoqëronte ata?

-Çfarë thanë njerëzit me njëri-tjetrin kur i panë?

-Si mendoni se do të reagojë babai prej fjalëve që dëgjoi?

Ndalesa II *I ati u mërzi shumë... deri te... si nuk të dhëmb fare zemra për të?*

Pyetje: -Çfarë i tha i ati të birit pasi dëgjoi fjalët e njerëzve?

-Ç'bëri djali?

-Çfarë thanë njerëzit kur panë djalin mbi gomar?

-Si mendoni se do të veprojë djali pasi dëgjoi këto fjalë?

Ndalesa III *Djali u turpërua... deri te... Mjaft keq!*

Pyetje: -Si u ndie djali kur dëgjoi fjalët e njerëzve?

-Ç'bëri ai?

-Çfarë thanë njerëzit kur panë atin mbi gomar?

Ndalesa IV *Bota nuk është e kënaqur...deri te... atë shtazë të mjerë.*

Pyetje: -Çfarë vendosën të bëjnë ati dhe djali pasi dëgjuan sërish fjalët e botës?

-Çfarë thanë njerëzit kur i panë ty dy duke udhëtuar mbi gomar?

Ndalesa V *Të zdropim të dy... deri në fund.*

Pyetje: -Ç'bënë atë e bir pasi dëgjuan fjalët e njerëzve?

-Si menduan njerëzit kur i panë ata me gomarin mbi shpinë?

-Çfarë kuptuan në fund ata?

-Si e bënë ata udhën që mbeti?

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Ftohen nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të rreth përrallës dhe të tregojnë përrallën sipas rrjedhës së ngjarjes.

Veprimtaria e katërt

Analizë: Punë në grupe: Rubrika “Analizoj”. Ftohen nxënësit të plotësojnë tabelën me veprimet e personazheve para dhe pas fjalëve të botës dhe të tregojnë se çfarë vënë re.

Pas përfundimit të punës përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e përrallës, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;

-shpjegimin e fjalëve dhe shprehjeve të reja, krijimin e fjalive me to;

-shprehjen e ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj rreth përrallës;

-analizën e veprimeve të djalit dhe babait;

-tregimit si ndryshojnë veprimet e personazheve pas fjalëve të njerëzve;

-aktivizimin gjatë orës së mësimi;

-bashkëpunimin në grupe;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika: “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë I ati, i biri dhe gomari (ora II)		Situata e të nxënit A duhet të ndikohemi gjithmonë nga të tjerët në vendimet tona?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon përrallën rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – diskuton rreth mesazhit që përcjell kjo përrallë; – tregon përmbajtjen e përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes; – jep mendimin e tij/saj për vendimet e babait dhe të djalit; – interpreton pjesën në role; – jep shembuj nga jeta e tij/saj të rasteve kur është ndikuar nga të tjerët dhe arsye përse është ndikuar; – shpreh ndjesitë që provon kur lexon këtë pjesë; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -i ati; -i biri; -gomari; -pse vemi; -shkon kaluar; -zdripim; -kështu punuan.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -përralla për fëmijë; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare -Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -lexim zinxhir; -trego-argumento; -bashkëbisedim; -lexim me role; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja u drejton nxënësve/eve pyetjen: <i>-A duhet të ndikohemi gjithmonë nga të tjerët në vendimet tona?</i> Nxiten nxënësit/et t’i përgjigjen pyetjes dhe të lexojnë mesazhin që kanë formuluar për pjesën. Veprimtaria e dytë <i>Lexim zinxhir:</i> Lexim i përrallës zinxhir nga nxënësit/et. Nxiten nxënësit të tregojnë përmbajtjen e përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes. Veprimtaria e tretë <i>Trego-argumento:</i> Rubrika “Reflektoj”. Ftohen nxënësit të japin mendimin e tyre për veprimet e babait dhe të djalit. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.			

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Nëpërmjet një bashkëbisedimi nxënësit/et tregojnë nga përvoja e tyre nëse ndikohen apo jo nga fjalët e të tjerëve si dhe tregojnë ndjesitë që provojnë kur lexojnë këtë pjesë.

Veprimtaria e pestë

Lexim me role: Nxënësit/et ndahen në grupe. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et ushtrohen në leximin me zë sipas roleve.

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit vlerësojnë interpretimet e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e përrallës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur
- tregimin e përmbajtjes së përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- mendimet e tij/saj për vendimet e babait dhe të djalit;
- interpretimin e pjesës në role;
- shprehjen e ndjesive që provon kur lexon pjesë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Elefanti trazovaç		Situata e të nxënit A duhet të ndihemi keq kur të tjerët e nënvlerësojnë dhe e paragjykojnë ndihmën tonë të sinqertë?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante; – shpjegon fjalët dhe shprehjet e reja, duke krijuar fjali me to; – rendit fjalitë përmbledhëse rreth përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes; – tregon përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse; – gjykon rreth sjelljes së personazhit kryesor të përrallës, pavarësisht nga këshillat e nënës dhe reagimit të të tjerëve ndaj gatishmërisë së tij për të ofruar ndihmë; – formulon mesazhin që përcjell përralla; – interpreton pjesën në role; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> -kaptoj; -punëbosh; -zërrhallem; -i ndërkryer; -shkarpa; -vëngër; -kaploi; -i paudhë; -shpërfillshëm; -ligështohet. 	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare -Të drejtat e njeriut.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -pyetja e ditës; -procedura: “pyet sërish”; -diskutim; -analizë; -lexim me role; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Pyetja e ditës:</i> Mësuesi/ja shtron pyetjen:			

- A duhet të dekurajohemi kur të tjerët e nënvlerësojnë dhe e paragjykojnë ndihmën tonë të singertë?

-Kësaj pyetjeje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës.

Veprimtaria e dytë

Procedura: "pyet sërish": Mësuesi/ja njih nxënësit/et me titullin e përrallës "Elefanti trazovaç" dhe autorin e saj Xhani Rodari. Komentohen ilustrimet në libër nga nxënësit/et.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë, duke nënvizuar fjalët e reja dhe fjalitë më interesante. Në përfundim të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton pyetje rreth tij dhe tjetri/a u përgjigjet pyetjeve. Për çdo paragraf të ri, nxënësit/et ndërrojnë rolet.

*Punohet rubrika "Fjalor". Shpjegohen fjalët e reja. Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali me to.

*Lexim i përrallës zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Punë në grupe: Në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe për të dalluar në fjalitë përmbledhëse të përrallës, fjalitë e vërteta dhe të gabuara, të ndërtojnë saktë fjalitë e gabuara dhe t'i renditin ato sipas rrjedhës së ngjarjes.

Nxënësit/et diskutojnë në grupe, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

Veprimtaria e katërt

Analizë: Punë në grupe: Rubrika "Analizoj". Ftohen nxënësit/et të punojnë në grupe për të shpjeguar shprehjen: "S'linte vend pa i futur hundët".

*Nxënësit/et tregojnë se cilët janë personazhet e kësaj përralle, duke qarkuar alternativën e saktë dhe çfarë mësojnë nga përralla.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bashkëbisedojnë rreth ndonjë rasti që mund t'u ketë ndodhur, kur ndihma e tyre nuk është pranuar, duke treguar se si janë ndier dhe si kanë vepruar në këtë rast.

Nxiten nxënësit/et të tregojnë nëse ndiejnë gëzim kur ndihmojnë të tjerët dhe të tregojnë arsyen përse.

Veprimtaria e gjashtë

Lexim me role: Nxënësit/et të organizuar në grupe, lexojnë tregimin sipas roleve. Vihet theksi në leximin me intonacion. Nxënësit/et vlerësojnë interpretimet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e përrallës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- shpjegimin e fjalëve dhe të shprehjeve të reja, duke krijuar fjali me to;
- renditjen e fjalive përmbledhëse rreth përrallës sipas rrjedhës së ngjarjes;
- tregimin e përmbajtjes së përrallës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse;
- grykimin rreth sjelljes së personazhit kryesor të përrallës, pavarësisht nga porositë e nënës dhe reagimit të të tjerëve ndaj gatishmërisë së tij për të ofruar ndihmë;
- formulimin e mesazhit që përcjell përralla;
- interpretimin e pjesës në role;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika: "Shkruaj"

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Shkruajmë për dimrin		Situata e të nxënit Material i shkurtër filmik për natyrën në stinën e dimrit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – flet për natyrën në stinën e dimrit; – u përgjigjet pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e dimrit duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine; – shkruan për stinën e dimrit, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë; – shpjegon preferencën e tij/saj për stinën e dimrit; – përshkruan se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë; – shkruan për stinën e dimrit në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -përshkruaj; -dimri; -natyra; -njeriu; -frutat e perimet.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga natyra në stinën e dimrit; -videoprojektor, CD; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -shikim i organizuar; -diskutim; -bashkëbisedim; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja paraqit me anë të videoprojektorit një material të shkurtër filmik për stinën e dimrit. Në mungesë të videoprojektorit paraqiten pamje nga natyra në stinën e dimrit. Nxiten nxënësit/et t’i përshkruajnë ato, duke treguar edhe karakteristikat e stinës së dimrit.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë përgjigjet e pyetjeve për stinën e dimrit duke përzgjedhur në fjalët në kllapa ato që tregojnë karakteristikat e kësaj stine.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të lexojnë përgjigjet e pyetjeve dhe të diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 2. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e dimrit, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë.

Disa nxënës/e lexojnë përshkrimet e tyre.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 3. Nxënësit/et bashkëbisedojnë rreth preferencave të tyre për stinën e dimrit, duke i shpjeguar ato me dy fjali.

Ushtrimi 4. Nxënësit/et përshkruajnë se ku u pëlqen të shkojnë dhe çfarë u pëlqen të bëjnë në këtë stinë.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 5. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e dimrit në vendin ku jetojnë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke respektuar këshillat e dhëna në libër për përshkrimin e kësaj stine.

Ata/ato punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

-përgjigjet e pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e dimrit, duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;

-shkrimin për stinën e dimrit, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;

-shpjegimin e preferencave të tij/saj për stinën e dimrit;

-përshkrimin se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë;

-shkrimin për stinën e dimrit në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve.

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj stinën e dimrit në një vend malor.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Gjuha jonë Përemrat pronorë (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrat pronorë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – dallon përemrin pronor në fjali, duke treguar funksionin e tij; – përshtat përemrin pronor me emrin në fjali; – përcakton vetën, numrin dhe gjininë e përemrit pronor; – krijon fjali me përemra pronorë; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: -përemri pronor; -gjinia; -numri; -veta.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e përemrave pronorë; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -lexo-komento; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për përemrin pronor, duke u mbështetur edhe në rubrikën “Kujtoj”. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë dhe të thonë çfarë tregojnë fjalët e ngjyrosura (<i>im, ime, e mia, jote</i>). Ani: Biçikleta <u>ime</u> është e kuqe. Po biçikleta <u>jote</u> ? <div><div></div><div>Tregon se kujt i përket biçikleta.</div><div></div></div> Emi: Blu. Ani: Timoni <u>im</u> është i lehtë. Po biçikleta <u>jote</u> si e ka timonin? <div><div></div><div>Gjinia mashkullore</div><div></div><div>Gjinia femërore</div></div>			

Emi: *Shumë të lehtë.*

Ani: *Rrotat e mia janë të reja. Po biçikleta jote si i ka rrotat?*

Numri shumë Numri njëjës

Emi: *Të reja i ka. Kjo është biçikleta ime e parë.*

Veta e parë

*Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet dhe paqartësitë që mund t'u lindin nxënësve/eve. Nxënësit/et diskutojnë lirshëm dhe dalin në përfundimin që përemri pronor tregon pronarin, ndërsa emri që e shoqëron, tregon pronën (biçikleta ime). Ato zakonisht vendosen pas emrit dhe përshtaten me të.

Përemrat pronorë im/ime dhe yt/jote kur përdoren me emra farefisnie, vendosen edhe para emrave. Përemri pronor merr formë të ndryshme sipas vetave, në njëjës dhe në shumës, si dhe sipas gjinisë e numrit të emrit që përcakton.

*Lexo-komento: Lexohet dhe komentohet tabela e përemrave pronorë nga nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë përemrat pronorë në grupin e përemrave të dhënë dhe t'i shoqërojnë ata me emra.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të shndërrojnë fjalitë sipas modelit të dhënë dhe të nënvizojnë përemrat pronorë në të dyja fjalitë.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Secili grup shkruan përemrat pronorë në fletë dhe i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali me to.

Pas përfundimit të punës, përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë fjalitë e krijuara.

Nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth punës së secilit grup dhe të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e përemrit pronor në fjali, duke treguar funksionin e tij;
- përshtatjen e përemrit pronor me emrin në fjali;
- përcaktimin e vetës, numrit dhe gjinisë së përemrit pronor;
- krijimin e fjalive me përemra pronorë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj 5 fjali ku të përdorësh përemra pronorë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat pronorë (ora II)		Situata e të nxënit: Harta e konceptit për përemrin pronor	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon përemrat pronorë në fjali;– përcakton vetën, numrin dhe gjininë e përemrit pronor;– krijon fjali me përemrat pronorë;– paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– demonstroi besim dhe vullnet në arrijtjen e rezultateve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-përemri pronor;-gjinia;-numri;-veta.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-tabela e përemrave pronorë;-fisha me fjali;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Metodologjia:

- harta e konceptit;
- diskutim;
- shkrim i drejtuar;
- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

Veprimtaria e parë

*Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë.

Punë në grupe: Nxiten nxënësit/et të krijojnë në grupe hartën e konceptit për përemrin pronor.

Tregon se kujt i përket ajo për të cilën flasim.

```
graph TD
    P([Përemri]) --> V[veta]
    P --> N[numri]
    P --> G[gjinia]
    V --> P1[e parë]
    V --> P2[e dytë]
    V --> P3[e tretë]
    N --> N1[njëjës]
    N --> N2[shumës]
    G --> G1[femërore]
    G --> G2[mashkullore]
```

Zakonisht vendoset pas emrit dhe përshtaten me të.

*Mësuesi/ja shpërndan fisha në të cilat janë shkruar fjali. Orientohen nxënësit/et të punojnë në dyshe për të dalluar përemrat pronorë, duke treguar edhe numrin, gjininë dhe vetën e tyre.

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Punë në grupe: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të nënvizojnë në tekst përemrat pronorë dhe gjejnë emrin që përcaktojnë dhe cilës vetë i përkasin.

Në përfundim diskutohet me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali në të cilat të përdorin përemrat pronorë: *e saj, tuaja, e atyre, ime, e tu, juaj, ynë*.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim, nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara.

Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:


- dallimin e përemrave pronorë në fjali;
- përcaktimin e vetës, numrit dhe gjinisë së përemrit pronor;
- krijimin e fjalive me përemrat pronorë;
- tregimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie:

Bëj një shkrim me temë “Shtëpia ime”, me 7-8 fjali, ku të përdorësh përemra pronorë. Trego vetën, numrin dhe gjininë e tyre.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjurmët e kalit të Skënderbeut (ora I)		Situata e të nxënit: Diskutim rreth figurës së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeu, duke u bazuar në historitë që kanë dëgjuar dhe lexuar, filmat që kanë parë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan heroin tonë kombëtar, Skënderbeun, mbi bazën e fotografive dhe njohurive që ka për të;– lexon pjesën, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së pjesës ose rreth fjalëve të panjohura për të;– tregon llojin e pjesës që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– lidh pjesën që lexon me tregime, përralla, legjenda rreth bëmave të Skënderbeut;– bashkëpunon në grupe për kryerjen e një detyre;– pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-Skënderbeu;-kalaja e Varoshit;-bedena;-gjurmë.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit-teksti mësimor;-përralla, tregime, legjenda, rrëfenja, gojëdhëna për Skënderbeun;-skica, piktura, skulptura të vogla, fotografi të ndryshme të Skënderbeut;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none">-Edukimi atdhetar;-Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim paraprak;-lexim dhe mendim i drejtuar;-lexim zinxhir;-marrëdhënie pyetje-përgjigje;-pesëvargësh;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim paraprak:</i> Nxënësit/et prezantojnë skica, piktura, skulptura të vogla, fotografi të ndryshme të Skënderbeut <i>*Nxënësit/et të diskutojnë rreth figurës së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeu, duke u bazuar në historitë që kanë dëgjuar dhe lexuar, filmat që kanë parë.</i>			

Ata/ato në grupe plotësojnë një kllaster për Skënderbeun dhe e prezantojnë atë.



Veprimtaria e dytë

Lexim dhe mendim i drejtuar: Mësuesi/ja njih nxënësit/et me titullin e pjesës “Gjurmët e kalit të Skënderbeut” dhe autorin e saj Naum Prifti.

Nxiten nxënësit/et të vëzhgojnë dhe të komentojnë ilustrimin në libër.

Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin të ndarë në paragrafë.

Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante.

Nën drejtimin e mësuesit/es punohet fjalori, pyetjet rreth përmbajtjes dhe bëhet parashikimi nga nxënësit/et për pjesën në vazhdim. Nxënësit/et krahasojnë parashikimet e tyre me tekstin.

*Lexim zinxhir i pjesës nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve rreth pjesës. Në fillim i diskutojnë përgjigjet në dyshe, më pas me gjithë klasën.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës sipas rrjedhës së ngjarjes.

Veprimtaria e katërt

Pesëvargësh: Nxiten nxënësit që në grupe të krijojnë pesëvargësja për Skënderbeun.

Në përfundim të punës, përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë pesëvargësat e krijuar.

Skënderbeu
trim udhëheqës
udhëheq lufton fiton
Zguarsia dhe trimëria e Skënderbeut mposhti turqit.
prijës

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e heroit tonë kombëtar, Skënderbeun, mbi bazën e fotove dhe njohurive që ka;
- leximin e pjesës duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;
- tregimin e llojit të pjesës që lexon duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e saj;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës;
- lidhjen e pjesës që lexon me tregime, përralla, legjenda rreth bëmave të Skënderbeut;
- bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre.

Detyrës shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjurmët e kalit të Skënderbeut (ora II)		Situata e të nxënit: Cilët janë elementet reale dhe imagjinare në tekst?	
Rezultatet e të nxënit – lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – tregon llojin e pjesës, duke dhënë karakteristikat e saj; – shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij/saj rreth legjendës; – dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen në tekst; – analizon personazhet në legjendë, duke u mbështetur në veprimet e tyre; – formulon nga një fjali përmbledhëse për çdo paragraf; – tregon legjendën, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse; – tregon legjenda të tjera për Skënderbeun dhe kalin e tij; – bashkëpunon në grupe për kryerjen e një detyre; – pranon me respekt idetë dhe mendimet e të tjerëve.		Fjalë kyçe: -Skënderbeu; -kalaja e Varoshit; -bedena: -gjurmë; -elemente reale dhe imagjinare.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -përralla, tregime, legjenda, rrëfenja, gojëdhëna për Skënderbeun; -skica, piktura, skulptura të vogla, fotografi të ndryshme të Skënderbeut; -mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare -Edukimi atdhetar; -Të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -harta e personazheve; -dallos-trego; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë elementet reale dhe imagjinare që kanë gjetur në tekst. Lexim zinxhir i tekstit nga nxënësit/et.			

Veprimtaria e dytë

Harta e personazheve: Nxiten nxënësit/et që në grupe të punojnë për të analizuar personazhet e legjendës, duke u mbështetur në veprimet e tyre (Skënderbeu, Zefiri, punëtori, ushtarët turq).

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et që të punojnë në grupe për të ndarë tekstin në pjesë dhe të krijojnë nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre.

Përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë fjalitë përmbledhëse.

*Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës, duke u mbështetur në fjalitë përmbledhëse.

*Nxënësit/et punojnë në dyshe për të dalluar në tekst hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen dhe i lexojnë me zë para klasës.

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të japin mendimin e tyre pse punëtori u tregoi turqve të fshehtë e kalasë së Varoshit dhe çfarë ndodhi më pas me punëtorin.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke dhënë 2-3 karakteristika për të.

*Në rubrikën “Mësoj më shumë” mësuesi/ja i fton ata/ato të diskutojnë rreth katër karakteristikave kryesore të legjendës, duke i ilustruar me shembuj nga legjenda “Gjurmët e kalit të Skënderbeut”.

*Ftohen nxënësit/et të tregojnë ndjenjat dhe emocionet që ata përjetojnë kur lexojnë këtë legjendë dhe të tregojnë legjenda të tjera që kanë dëgjuar apo lexuar për Skënderbeun dhe kalin e tij.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve të tij/saj rreth legjendës;
- dallimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes në tekst;
- analizën e personazheve në legjendë, sipas veprimeve të tyre;
- formulimin e fjalive përmbledhëse dhe tregimin e legjendës mbi bazën e tyre;
- bashkëpunimin në grupe për kryerjen e një detyre;
- aktivizimin gjatë orës së mësimi;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Shkruaj në mënyrë të përmbledhur, një legjendë që ke dëgjuar apo lexuar për Skënderbeun.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat pyetës (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrat pyetës	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – identifikon përemrat pyetës në fjali; – dallon rastet kur përemrat pyetës Ç’? dhe Çfarë? nuk janë shkruar si duhet në fjali; – plotëson fjalitë pyetëse me përemra pyetës; – krijon fjali pyetëse për fjalitë dëftore, duke përdorur përemra pyetës; – tregon besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: - Përemri pyetës; - Kush? - Cili? Cila? - Ç’? - Çfarë? - Sa? - I sati? - Me se?	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me përemrat pyetës; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimi. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të komentojnë figurën dhe të lexojnë fjalitë pyetëse. Nxiten nxënësit/et të dallojnë se me cilat fjalë fillojnë dhe të tregojnë ç’ndodh nëse i heqim ato. Çfarë po thua? Nuk arrij ta besoj! Kush ta tha? Mësuesi/ja shpjegon se fjalët Çfarë? dhe Kush? janë përemra pyetës. Lexohet dhe diskutohet rubrika “Mbaj mend”. Mësuesi/ja jep sqarime rreth përemrave pyetës dhe specifikave që kanë në përdorimin e tyre përemrat pyetës: Kush? Cili?			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë përemrat pyetës në fjali.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të gjejnë rastet në fjali kur përemrat pyetës Ç'?' dhe Çfarë? nuk janë shkruar si duhet dhe t'i korrigjojnë ato.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me përemrin pyetës që mungon.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Grupet shkruajnë fjali dëftore dhe i shkëmbejnë me grupe fqinje për të ndërtuar pyetje për secilën prej tyre, duke përdorur përemra pyetës.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë pyetëse dhe tregojnë përemrat pyetës të përdorur në to.

Grupet diskutojnë rreth punës së shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-identifikimin e përemrave pyetës në fjali;

-dallimin e rasteve kur përemrat pyetës Ç'?' dhe Çfarë? nuk janë shkruar si duhet në fjali;

-krijimin e fjalive pyetëse për fjalitë dëftore, duke përdorur përemra pyetës;

-demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ndërto 6 fjali pyetëse, ku të përdorësh përemra pyetës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat pyetës (ora II)		Situata e të nxënët: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrat pyetës	
Rezultatet e të nxënët Nxënësi/ja: – dallon përemrat pyetës në fjali; – krijon fjali pyetëse për fjalitë dëftore, duke përdorur përemra pyetës; – paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – tregon besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.		Fjalë kyçe: - Përemri pyetës; - Kush? - Cili? - Çfarë? - Sa? - I sati?	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me përemra pyetës; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -diskutim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. <i>Diskutim: Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja shpërndan fisha në të cilat janë shkruar fjali pyetëse. Orientohen nxënësit/et të punojnë në dyshe për të dalluar përemrat pyetës. Mësuesi/ja nxit diskutimin me nxënësit/et për të treguar rastet kur përdoren përemrat pyetës <i>Kush? Cili?</i> duke dhënë shembuj të përdorimit të tij në fjalitë pyetëse. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit/et të punojnë individualisht për të krijuar fjali pyetëse për fjalitë dëftore, duke përdorur përemra pyetës. Në përfundim nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.			

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Punë në grupe: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et për çdo fjali të paragrafit të parë në tekstin “Gjurmët e kalit të Skënderbeut” të ndërtojnë pyetje duke përdorur përemra pyetës.

Nxënësit/et punojnë në tabakë letre.

Në përfundim përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë punën e bërë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es korrigjohen gabimet drejtshkrimore. Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e përemrave pyetës në fjali;
- krijimin e fjalive pyetëse për fjalitë dëftore, duke përdorur përemra pyetës;
- tregimin e vetëbesimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Për çdo fjali të paragrafit të dytë në tekstin “Gjurmët e kalit të Skënderbeut”, ndërto pyetje duke përdorur përemra pyetës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Qeni dhe njeriu		Situata e të nxënit: Lidhja e njeriut me qenin si kafshë shtëpiake.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;– tregon llojin e tekstit, duke dhënë disa karakteristika të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së pjesës, duke përzgjedhur alternativën e duhur për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth saj;– dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e pjesës;– ndërton nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesëz;– lidh tekstin me përvojën e tij/saj për kujdesin ndaj qenve;– vlerëson besnikërinë e qenit ndaj njeriut;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup.		Fjalë kyçe: -qeni; -ujku; -ariu; -njeriu; -kollofis.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mjetet shkrimi, lapustila, fletore, fletë A ₄ .		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet; - Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -përvijim i të menduarit; -lexo, përmbledh në dyshe; -hulumtim; -trego-argumento; -diskutim; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Përvijim i të menduarit:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë se ç’dinë për qentë dhe lidhjen e tyre me njeriun.			
<div><div><div><div><div></div><div>ushqimi</div></div><div><div></div><div>racat</div></div></div><div><div><div></div><div>qeni</div></div><div><div></div><div>pamja</div></div><div><div></div><div>jetesa</div></div><div><div></div><div>sjellja</div></div></div></div></div>			

Veprimtaria e dytë

Lexo, përmbledh në dyshe: Njihen nxënësit/et me titullin e pjesës “Qeni dhe njeriu”.

Orientohen nxënësit/et të vështrojnë figurën dhe të diskutojnë rreth saj.

Nxënësit/et, duke punuar në dyshe, lexojnë dhe e përmbledhin çdo paragraf me 1-2 fjali. Njëri prej nxënësve/eve lexon dhe tjetri përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo paragrafi.

*Diskutohet me gjithë klasën për llojin e tekstit duke vënë në dukje 2-3 karakteristika të tij.

*Zhvillohet leximi zinxhir i pjesës nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Hulumtim: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të punojnë në dyshe për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes, duke përzgjedhur alternativën e saktë.

Veprimtaria e katërt

Trego-argumento: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et tregojnë pse është legjendë ky tekst duke përzgjedhur alternativën e saktë.

Punë në grupe: Nxënësit/et punojnë në grupe për të dalluar në tekst hyrjen, zhvillimin, mbylljen dhe të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesë.

Veprimtaria e pestë

Diskutim: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimet e tyre në lidhje të shoqërisë së njeriut me qentë, duke sjellë edhe përvojën e tyre nëse mbajnë qen në shtëpi.

Komentohet nga nxënësit/et në grupe thënia: “Qeni është kafshë besnike”.

Nxënësit/et lexojnë komentet e tyre.

Veprimtaria e gjashtë

Punë në grup: Pesëvargësh: Nxënësit/et në grupe krijojnë pesëvargësha për qenin.

Qeni
i shpejtë, zbulues
vrapon, leh, nuhat
Qeni është besnik i njeriut.
Kafshë shtëpiake

Përfaqësuesit e grupeve lexojnë pesëvargëshat e krijuar.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;

-tregimin e llojit të tekstit, duke dhënë disa karakteristika të tij;

-demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së pjesës, duke përzgjedhur alternativën e duhur për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth saj;

-dallimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes së pjesës;

-ndërtimin nga një fjali përmbledhëse për çdo pjesëz;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat dëftorë (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrat dëftorë	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – identifikon përemrat dëftorë në fjali; – përshtat përemrin dëftor me emrin që tregon në fjali; – tregon rastet kur përemrat ai, ajo, ata, ato përdoren si përemra vetorë dhe kur përdoren si përemra dëftorë; – krijon fjali duke përdorur përemra dëftorë; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: -përemri dëftor	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me përemra dëftorë; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të komentojnë figurën dhe të lexojnë fjalinë: Këta libra i mora në bibliotekë. <div><div></div><div>Tregon se librat ndodhen pranë folësit.</div></div> Mësuesi/ja sqaron se fjala këta është përemër dëftor. Nxiten nxënësit/et të lexojnë rubrikën “Mbaj mend“ ku jepet kuptimi për përemrat dëftorë.			

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Mësuesi/ja sqaron rastet kur përemrat *ai, ajo, ata, ato*, përdoren edhe si përemra vetorë edhe si përemra dëftorë, duke i ilustruar me shembuj për çdo rast.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të dallojnë në fjali, përemrat dëftorë që përdoren për afër dhe për larg.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin.

Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të zgjedhin përemrin dëftor që duhet në fjalitë e dhëna. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Pas përfundimit të punës lexojnë fjalitë, duke treguar përemrin dëftor të përzgjedhur prej tyre në çdo fjali dhe duke shpjeguar arsyen e përzgjedhjes.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et punojnë në grupe. Grupet shkruajnë përemra dëftorë dhe i shkëmbejnë me grupe fqinje për të krijuar fjali me to.

Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara, diskutojnë rreth punës së shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e përemrave dëftorë në fjali;
- përshtatjen e përemrit dëftor me emrin që tregon, në fjali;
- dallimin e rasteve kur përemrat *ai, ajo, ata, ato* përdoren si përemra vetorë dhe kur përdoren si përemra dëftorë;
- krijimin e fjalive duke përdorur përemra dëftorë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo fjali duke përdorur përemrat dëftorë: *ky, kjo, këta, këto, i këtëllë, e këtëllë*.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Përemrat dëftorë (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar përemrat dëftorë	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon përemrat dëftorë në fjali;përshtat përemrin dëftor me emrin që tregon në fjali;dallon rastet kur përemrat <i>ai, ajo, ata, ato</i> përdoren si përemra vetorë dhe kur përdoren si përemra dëftorë;krijon fjali duke përdorur përemrat <i>ai, ajo, ata, ato</i>, herë si vetorë, herë si dëftorë;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: -përemri dëftor; -ky, kjo, këta, këto, i këtillë, e këtillë, të këtillë, të këtilla, i tillë, e tillë; -ai, ajo, ata, ato, i atillë, e atillë, të atillë, të atilla.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me përemra dëftorë; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin nga nxënësit/et të detyrave të shtëpisë. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve/eve në çdo bankë fisha me fjali ku janë përdorur përemra dëftorë dhe udhëzon nxënësit/et të punojnë në dyshe për t'i nënvizuar ato. Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es rreth përemrave dëftorë. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të dallojnë përemrat vetorë dhe përemrat dëftorë në fjali. Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim, shkëmbejnë librat për të kontrolluar njëri-tjetrin. Diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth përemrave vetorë dhe dëftorë që janë përdorur në fjali.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të krijojnë fjali duke i përdorur përemrat *ai, ajo, ata, ato*, herë si vetorë dhe herë si dëftorë.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës lexojnë fjalitë, diskutojnë rreth punës së shokëve/shoqeve.

Bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es, nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-identifikimin e përemrave dëftorë në fjali;

-përshtatjen e përemrit dëftor me emrin që tregon, në fjali;

-dallimin e rasteve kur përemrat *ai, ajo, ata, ato* përdoren si përemra vetorë dhe kur përdoren si përemra dëftorë;

-krijimin e fjalive duke përdorur përemrat *ai, ajo, ata, ato*, herë si vetorë, herë si dëftorë;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijë fjali duke përdorur përemrat dëftorë: *të këtillë, të këtilla, i tillë, e tillë, të atillë, të atilla*.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Një dhuratë për hënën		Situata e të nxënit: Film i shkurtër dokumentar për ujqit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;– tregon llojin e tekstit, duke e argumentuar atë;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes;– përcakton elementet kryesore të pjesës: vendin, kohën, personazhet dhe ndodhinë.– tregon legjendën me fjalët e tij/saj;– shpreh ndjesitë që përcjell tek ai/ajo secili nga personazhet, nëpërmjet veprimeve që kryen;– gjen një titull tjetër për legjendën duke argumentuar zgjedhjen e tij;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: -hëna; -zana; -ujqër; -drapër; -harmoni; -pikë e vrer; -e harlisur.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet; - Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -trego-argumento; -mendo-zbulo; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Nxiten nxënësit të flasin rreth dokumentarëve dhe filmave që kanë parë për jetën e ujqërve dhe për legjendën e ulërimës së tyre nën dritën e hënës.			

Veprimtaria e dytë

Ndërveprim me tekstin: Mësuesi/ja prezanton temën “Një dhuratë për hënën”.

*Nxënësit/et vërejnë ilustrimet dhe diskutojnë rreth tyre në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Nxënësit/et lexojnë tekstin në paragrafë, në heshtje.

Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante.

*Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja dhe nxënësit/et ndërtojnë fjali me to.

*Lexim zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës.

Veprimtaria e katërt

Trego-argumento: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et tregojnë duke e argumentuar ç’lloj teksti është (legjendë indiane), duke treguar disa karakteristika të legjendës.

*Nxiten nxënësit/et të plotësojnë elementet kryesore të legjendës: koha, vendi, personazhet, ngjarja dhe të tregojnë legjendën me fjalët e tyre.

Veprimtaria e pestë

Mendo-zbulo: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë do të ndodhte nëse hëna do të vazhdonte të vallëzonte midis reve.

U kërkohet atyre të zgjedhin një titull tjetër për legjendën, duke treguar edhe arsyen e përzgjedhjes së tyre. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

*Lexohet nga nxënësit/et kurioziteti “Ujku dhe hëna”.


Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së legjendës;
- përcaktimin e elementeve kryesore të pjesës: vendin, kohën, personazhet dhe ndodhinë;
- tregimin e legjendës me fjalët e tij/saj;
- shprehjen e ndjesive që përcjell tek ai/ajo secili nga personazhet, nëpërmjet veprimeve që kryen;
- gjetjen e një titulli tjetër për legjendën duke argumentuar përzgjedhjen;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Historia e xixëllonjës (ora I)		Situata e të nxënit: Ç' dini për xixëllonjat?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan xixëllonjat; – plotëson një tekst për legjendën pse xixëllojnë xixëllonjat, duke iu përgjigjur pyetjeve; – shkruan të plotë historinë pse xixëllojnë xixëllonjat sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe: - legjendë; - përshkruaj; - xixëllonja; - xixëllon; - kandra të zeza.	
Burimet dhe materialet didaktike: - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - teksti mësimor; - fotografi të xixëllonjave, informacione nga interneti për to; - mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Shkencat e natyrës; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - Mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -stuhi mendimesh; -rishikim në dyshe; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë			

Stuhi mendimesh: Mësuesi/ja paraqit fotografi të xixëllonjave dhe fton nxënësit/et të tregojnë se ç'dinë për to.



Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Komentohen ilustrimet në libër.

Ushtrimi 1. Mësuesi/ja u drejton pyetjen nxënësve/eve:

-A ke menduar ndonjëherë pse xixëllojnë xixëllonjat?

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë një legjendë që i jep përgjigje kësaj pyetjeje, duke plotësuar tekstin e dhënë në libër. Orientohen nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër.

Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë para klasës tekstin e plotësuar dhe të diskutojnë rreth tij nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 2. Nxënësit/et shkruajnë të plotë historinë e xixëllonjës në fletore, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri shkrimet më të mira.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin për xixëllonjat;
- plotësimin e një teksti për legjendën pse xixëllojnë xixëllonjat, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna;
- shkrimin e plotë të historisë pse xixëllojnë xixëllonjat, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Sillni në klasë foto, informacione të një vendi/bime/lule/kafshe që pëlqeni më shumë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Historia e xixëllonjës (ora II)		Situata e të nxënit: Përshkrimi i një vendi, bime, luleje, kafshe të preferuar	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan një vend/bimë/lule/kafshë;– tregon preferencat e tij/saj për një vend/bimë/lule/kafshë;– shkruan një legjendë të ngjashme me atë të xixëllonjës, në qendër të së cilës mund të jetë një vend/bimë/lule/kafshë sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- përshkruaj;- legjendë;- vend;- bimë;- kafshë;- lule.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-fotografi të vendeve/bimëve/luleve/kafshëve të ndryshme;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Shkencat e natyrës;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">- Mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-bisedë-shkrim i lirë;-konkurs;-punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përshkruajnë një vend/bimë/lule/kafshë që ata pëlqejnë më shumë, duke paraqitur edhe fotografi të tyre. Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i lirë:</i> Ushtrimi 3. Nxënësit/et do të shkruajnë një legjendë të ngjashme me legjendën e xixëllonjës, në qendër të së cilës mund të jetë një vend, një lule, një bimë ose një kafshë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje. Jepen udhëzime për punë të pavarur nga mësuesi/ja. Nxënësit/et do të punojnë individualisht në fletore. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës. Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es, nëse ka.			

Veprimtaria e tretë

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri shkrimet më të mira.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e një vendi/bime/lule/kafshe;
- tregimet për preferencat e tij/saj për një vend/bimë/lule/kafshë;
- shkrimin e një legjende të ngjashme me atë të xixëllonjës, në qendër të së cilës mund të jetë një vend/bimë/lule/kafshë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një legjendë tjetër për një vend/bimë/lule/kafshë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Shumë njerëz ... shumë ngjyra		Situata e të nxënit: Album me fotografi të njerëzve të racave të ndryshme të botës	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;– tregon llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së pjesës, duke përzgjedhur alternativën e duhur për t’iu përgjigjur pyetjeve rreth saj;– diskuton rreth mitit të krijimit të racave njerëzore;– dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen në tekst;– krijon nga një fjali përmbledhëse për secilën prej pjesëve;– gjykon se njerëzit pavarësisht racës, ngjyrës, etnisë janë të gjithë të barabartë;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj.		Fjalë kyçe: -njerëz; -perëndia e lëkurëkuqe; -lëkurëzi; -lëkurëverdhe; -lëkurëbardhë; -katastrofë;	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mite të tjera për lindjen e njerëzimit; -enciklopedi; -foto, informacione të marra nga interneti për racat njerëzore; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare -Të drejtat e njeriut; -Bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -veprimtari, bisedë; -lexim, diskutim në dyshe; -rishikim në dyshe; -trego-argumento; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve			

Veprimtaria e parë

Veprimtari, bisedë: Nxënësit/et janë porositur më parë nga mësuesi/ja të sjellin në klasë fotografi të njerëzve të racave të ndryshme të botës. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të punojnë së bashku për të përgatitur një album me to. Prezantohet albumi nga nxënësit/et duke përcaktuar racat kryesore njerëzore, tiparet fizike të tyre, si dhe rajonet ku ata kryesisht jetojnë.

Veprimtaria e dytë

Lexim, diskutim në dyshe: Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës “Shumë njerëz...shumë ngjyra”.

*Orientohen nxënësit/et të vështrojnë ilustrimet dhe të diskutojnë rreth tyre.

Nxënësit/et diskutojnë në fillim në dyshe, më pas me gjithë klasën.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje.

*Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante.

Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth tekstit.

*Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et individualisht gjejnë alternativat e sakta rreth përmbajtjes së tekstit. Shkëmbejnë librat me shokun e bankës dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit. Më pas, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Trego-argumento: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në grupe, tregojnë duke e argumentuar ç’lloj teksti është duke dhënë disa karakteristika të tij, si dhe të tregojnë se çfarë do të shpjegojë ky mit i indianëve të Amerikës, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

*Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e pjesës në mënyrë të përmbledhur.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Rubrika “Reflektoj”. Nëpërmjet një bashkëbisedimi, nxënësit të japin mendimin e tyre rreth ngjyrave të lëkurës së njerëzve, nga ku del dhe mesazhi: *Njerëzit pavarësisht ngjyrës, racës dhe etnisë janë të gjithë të barabartë.*

Veprimtaria e gjashtë

Punë në grupe: Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et punojnë në grupe për të dalluar hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e tekstit dhe për secilën pjesë të tyre do të ndërtojnë nga një fjali përmbledhëse.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

*Në minutat e fundit nxënësit/et lexojnë mite dhe legjenda të shkurtra rreth prejardhjes së njeriut.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë;
- tregimin e llojit të tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij;
- dallimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes në tekst dhe krijimin nga një fjali përmbledhëse për secilën prej tyre;
- tregimin e përmbajtjes në mënyrë të përmbledhur;
- gjykimin se njerëzit pavarësisht racës, ngjyrës, etnisë janë të gjithë të barabartë;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Bëj një shkrim të shkurtër për tolerancën mes njerëzve, me temë “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Klasifikimi i foljeve sipas zgjedhimit (ora I)		Situata e të nxënit: Shqyrtimi i foljeve për t'i klasifikuar ato sipas zgjedhimit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – dallon foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë; – klasifikon foljet sipas zgjedhimit; – tregon foljet e parregullta; – zgjedhon foljet në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; – krijon fjali me foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalë kyçe: -zgjedhimi I, II, III; -foljet që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore; -folje të parregullta; -foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> ; -kohën e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer të thjeshtë; -koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelat e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -analizë; -dallo-trego; -diskutim; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Analizë:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimi. Komentohet figura në libër nga nxënësit/et. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë tekstin në libër dhe në dyshe të nënvizojnë foljet. Nxiten nxënësit/et të tregojnë foljet e përdorura në këtë tekst dhe të kthejnë në kohën e tashme, veta e parë, numri njëjës, foljet me ngjyrë të gjelbër. Nxënësit/et lexojnë rubrikën “Mbaj mend“. Shkëmbejnë mendimet e tyre në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Diskutojnë në grupe nën drejtimin e mësuesit/es për klasifikimin e foljeve sipas zgjedhimit. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke theksuar se foljet kur ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit, quhen <i>folje të parregullta</i> .			

*Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të plotësojnë tabelat e zgjedhimit të parë (folja *mësoj*) të zgjedhimit të dytë (folja *kap*), të zgjedhimit të tretë (folja *zë*). Nxiten nxënësit/et të punojnë në grupe. Pas përfundimit të punës, zhvillohet një diskutim nën drejtimin e mësuesit/es për zgjedhimin e foljeve në kohë të ndryshme.

Veprimtaria e dytë

Dallo-trego: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të klasifikojnë foljet në tekst sipas zgjedhimit.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et t'i kthejnë më parë foljet në kohën e tashme, veta e parë, numri njëjës.

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Punë në grupe: Ushtrimi 2. Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të zgjedhjnë në katër kohët e mësuara, nga një folje prej secilës kolonë të tabelës së ushtrimit 1.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta folje të zgjedhimit I, II, III në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat janë përdorur këto folje.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-dallimin e foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë;

-klasifikimin e foljeve sipas zgjedhimit;

-zgjedhimin e foljeve në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-krijimin e fjalive me foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo fjali me nga një folje të zgjedhimit I, II, III, të përdorura në kohët e mësuara.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Klasifikimi i foljeve sipas zgjedhimit (ora II)		Situata e të nxënit: Shqyrtimi i foljeve për t'i klasifikuar ato sipas zgjedhimit.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - dallon foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë; - klasifikon foljet sipas zgjedhimit; - analizon foljet në kategoritë gramatikore të mësuara; - krijon fjali me foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; - vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; - demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalë kyçe: -zgjedhimi I, II, III; -foljet që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore, me zanore; -folje të parregullta; -foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> ; -kohën e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer të thjeshtë; -koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelat e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre. *Punë në dyshe: Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 4-5 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të gjejnë në to foljet dhe t'i klasifikojnë ato sipas zgjedhimit. Nxënësit/et punojnë në dyshe.			

Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të analizojnë foljet e tekstit të ushtrimit 1 në libër sipas modelit, duke treguar kohën, vetën, numrin dhe zgjedhimin e tyre.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit. Më pas, zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4. Nxiten nxënësit/et të krijojnë fjali në të cilat të përdorin foljet e dhëna në libër në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar.

Në përfundim nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara. Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es nëse ka. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta folje të ndryshme dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali me to dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin dhe zgjedhimin e tyre.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-dallimin e foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë;

-klasifikimin e foljeve sipas zgjedhimit;

-zgjedhimin e foljeve në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-analizën e foljeve në kategoritë gramatikore të mësuara;

-krijimin e fjalive me foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj fjali ku të përdorësh nga një folje të zgjedhimit I, II, III në:

- kohën e tashme, veta e parë, numri shumës;
- kohën e pakryer, veta e dytë, numri njëjës;
- kohën e kryer të thjeshtë, veta e parë, numri njëjës;
- kohën e ardhme, veta e tretë, numri shumës.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Prometeu dhe zjarri (ora I)		Situata e të nxënit: Si kanë lindur mitet? Zbulimi i zjarrit, një moment i rëndësishëm për njerëzimin	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante; – shpjegon fjalët e shprehjet e reja, duke ndërtuar fjali me to; – dallon llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij; – demonstroi të kuptuarit e pjesës, duke plotësuar fjalitë e paplota të përmbledhjes së mitit të Prometeut; – tregon kohën dhe vendin ku zhvillohet ngjarja, ç’lloj ngjarjesh janë, çfarë shpjegon ky mit duke përzgjedhur alternativat e sakta; – diskuton rreth mitit të rrëmbimit të zjarrit nga Prometeu për t’ia dhuruar njerëzve; – demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; – vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: -dhunti; -titan; -grabit; -Zeusi; -pikas.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -Shoqëria dhe mjedisi; - Artet; -Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut; -Vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -lexim, diskutim në dyshe; -diskutim; -rishikim në dyshe; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Bisedë: Bisedë me nxënësit/et rreth jetës së hershme të njeriut në tokë, jetës primitive, zbulimet e para të rëndësishme siç është zjarri, mënyrën se si evoluoi jeta në tokë etj.			

Nxitet diskutimi rreth miteve që e kanë shpjeguar lindjen e kësaj jete dhe sidomos atë të Prometeut dhe zjarrit që ua grabiti Zotave dhe ua dhuroi njerëzve.

Veprimtaria e dytë

Lexim, diskutim në dyshe: Mësuesi/ja prezanton temën “Prometeu dhe zjarri”.

*Orientohen nxënësit/et të vështrojnë ilustrimin në libër dhe diskutojnë rreth tij.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në heshtje.

*Nënvizojnë fjalët që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken interesante.

*Punohet fjalori me fjalët e shprehjet e reja, nxiten nxënësit/et ndërtojnë fjali me to.

Diskutohet rreth llojit të tekstit (mit), duke dhënë 4 karakteristikat kryesore të mitit.

*Organizohet lexim zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

**Diskutim* : Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që në dyshe të plotësojnë në tekst vendet bosh të përmbledhjes së mitit të Prometeut.

Nxënësit/ët punojnë në dyshe. Pas përfundimit të punës përfaqësuesit/et e disa dysheve lexojnë përmbledhjen e mitit të Prometeut të plotësuar.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth mitit të Prometeut.

Veprimtaria e katërt

Rishikim në dyshe: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et punojnë individualisht të plotësojnë fjalitë duke përzgjedhur alternativën e saktë. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth kohës dhe vendit ku zhvillohet ngjarja, si janë ngjarjet reale apo fantastike dhe çfarë shpjegon ky mit.

*Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që u duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit e pjesës, duke plotësuar fjalitë e paplota të përmbledhjes së mitit të Prometeut;
- tregimin e kohës dhe vendit ku zhvillohet ngjarja, ç’lloj ngjarjesh janë, çfarë shpjegon ky mit duke përzgjedhur alternativat e sakta;
- diskutimin rreth mitit të rrëmbimit të zjarrit nga Prometeu për t’ia dhuruar njerëzve;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyre shtëpie: Shkruaj pjesën që të pëlqen më shumë në këtë mit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Prometeu dhe zjarri (ora II)		Situata e të nxënit: Koment rreth veprimeve të Prometeut	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – dallon hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen në tekst; – u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; – gjykon rreth veprimeve të personazheve kryesore në tekst; – shpjegon kuptimin e shprehjeve: “përpjekje titanike“, “luftoi si një Promete“; – formulon mesazhin që përcjell ky mit; – shkruan si mund të vazhdojë ky mit; – demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup; – vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: -dhunti; -titan; -grabit; -Prometeu; -Epimeteu; -Zeusi; -pikas.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -Shoqëria dhe mjedisi; -Artet; -Shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut; -Vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -analizë; -mendo-diskuto; -dallo-trego; -mendo- nxirr mesazhin; -shkrim i shpejtë; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Lexim i tekstit nga nxënësit/et zinxhir. <i>Analizë:</i> Nxiten nxënësit/et të gjykojnë rreth veprimeve të personazheve kryesore në tekst. -Cilët janë personazhet në këtë tekst?			

-Si e komentoni qëndrimin e Prometeut? Po të Zeusit?

-A bëri mirë Zeusi që e dënoi Prometeun?

-Nga leximet tuaja cili ka qenë ky dënim i tmerrshëm?

Veprimtaria e dytë

Mendo-diskuto: Rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre rreth shprehjeve: “Përpjekje titanike” dhe “Luftoi si një Promete”.

Nxënësit/et diskutojnë në grupe të vogla më pas me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxiten nxënësit/et të flasin për njohuritë që mund të kenë nga leximet apo dokumentarë të ndryshëm për veprën e Eskilit, “Prometeu i mbërthyer”, si e dënoi Zeusi Prometeun për dhuratën që u bëri njerëzve dhe si qëndroi ai për të mirën e njerëzimit në botë.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Rubrika “Shkruaj”. Nxiten nxënësit/et që të punojnë në grupe për të dalluar hyrjen, zhvillimin, mbylljen e pjesës, duke i ngjyrosur me ngjyrat e kërkuara në libër dhe më pas i lexojnë ato.

Veprimtaria e katërt

Mendo-nxirr mesazhin: Nxënësit/et në grupe gjejnë mesazhin që përcjell ky tekst:

Veprat e mëdha në dobi të njerëzimit dhe shoqërisë kërkojnë gjithmonë sakrifica të mëdha.

Veprimtaria e pestë

Shkrim i shpejtë: Udhëzohen nxënësit/et të shkruajnë vazhdimin e kësaj historie, duke punuar individualisht në fletore. Nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre.

*Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësit/et diskutojnë për mite të tjera që kanë lexuar.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-dallimin e hyrjes, zhvillimit dhe mbylljes në këtë mit;

-përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;

-gjykimin rreth veprimeve të personazheve kryesore në tekst;

-shpjegimin e kuptimit të shprehjeve: “përpjekje titanike”, “luftoi si një Promete”;

-formulimin e mesazhit që përcjell ky mit;

-shkrimin si mund të vazhdojë ky mit;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj në mënyrë të përmbledhur një mit tjetër që ke lexuar.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhshmë foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali, për të dalluar ndryshimet që pësojnë foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – zgjedhon folje <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; – tregon se foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit; – vë në dukje se foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e kryer të thjeshtë dalin në format <i>mora</i> dhe <i>dhashë</i> ; – analizon foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre; – krijon fjali me foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> duke i përdorur ato, në kohët e mësuara; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalë kyçe: -foljet: <i>marr</i> , <i>jap</i> ; -folje të parregullta; -kohën e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer të thjeshtë; -koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelat e zgjedhimit të foljeve <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohët e mësuara; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -dallos-trego; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimi. Komentohet figura në libër nga nxënësit/et. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë në libër dhe të dallojnë foljet.			

Unë mora edhe qenin në ekskursion. Disa nga shokët e mi i dhanë nga një lodër

Nxiten nxënësit/et të tregojnë se në çfarë kohe janë përdorur këto folje dhe se ku e vënë re këtë.

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe e në grupe dhe u japin përgjigje pyetjeve.

Mësuesi/ja thekson se foljet *marr* dhe *jap* zgjedhohen në mënyrë të veçantë.

*Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelat e zgjedhimit të foljeve *marr* dhe *jap* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.

Zhvillohet një diskutim në klasë, nën drejtimin e mësuesit/es për ndryshimet që pësojnë këto folje në kohën e kryer të thjeshtë: *marr- mora* dhe *dal- dola*, duke iu referuar rubrikës “Kujdes”.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 ka karakter plotësues. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljen *jap* në kohët e kërkuara, duke i përshtatur ato me kryefjalën në fjali.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të përcaktojnë vetën, numrin dhe kohën e foljes *marr* në fjalitë e dhëna.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të nënvizojnë foljet *marr* dhe *jap* në tekst dhe të përcaktojnë kohën në të cilën janë përdorur ato në fjali. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Në përfundim nxiten nxënësit/et që të diskutojnë rreth kohës në të cilën janë përdorur në fjali foljet *marr* dhe *jap*.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljet *marr* dhe *jap* në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat janë përdorur foljet.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-zgjedhimin e foljeve *marr* dhe *jap* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;

-analizën e foljeve *marr* dhe *jap* në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;

-krijimin e fjalive me foljet *marr* dhe *jap* duke i përdorur ato, në kohët e mësuara;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijë nga dy fjali me foljet *marr* dhe *jap*, të përdorura në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhshmë foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndryshimet që pësojnë foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– zgjedhon folje <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;– tregon se foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit;– analizon foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;– shkruan fjali me foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> duke i përdorur ato, në kohën, vetën dhe numrin e caktuar;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-foljet: <i>marr</i>, <i>jap</i>;-folje të parregullta;-kohën e tashme;-koha e pakryer;-koha e kryer të thjeshtë;-koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-tabelat e zgjedhimit të foljeve <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohët e mësuara;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-shkrim i drejtuar;-shkëmbe një problemë;-punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre. <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 4-5 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të dallojnë foljet <i>marr</i> dhe <i>jap</i> në kohën e kryer të thjeshtë dhe të përcaktojnë vetën dhe numrin e tyre.			

Nxënësit/et punojnë në dyshe. Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

Veprimtaria e dytë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4, 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali me foljet *marr* dhe *jap* në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime drejtshkimore, nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljet *marr* dhe *jap* në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat janë përdorur foljet.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- zgjedhimin e foljeve *marr* dhe *jap* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
- analizën e foljeve *marr* dhe *jap* në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;
- shkrimin e fjalive me foljet *marr* dhe *jap* duke i përdorur ato, në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar;
- respektimin e rregullave drejtshkimore gjatë të shkruarit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo një tekst të shkurtër me temë “Në supermarket” ku të përdorësh foljet *marr* dhe *jap*, në kohët e mësuara.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Dëgjojmë Pëllumbi dhe milingona		Situata e të nxënit: A duhet t’i ndihmojmë të tjerët kur gjenden në rrezik?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime për çështjet më interesante;– demonstroi të dëgjuar të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;– diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së fabulës që dëgjon;– gjykon për veprimet e personazheve të fabulës;– formulon mesazhin e fabulës;– gjen një mbyllje tjetër për fabulën;– bën lidhjen e përmbajtjes së fabulës që dëgjon me atë të një libri apo filmi që trajton të njëjtën temë;– tregon për histori të ngjashme që i kanë ndodhur kur ka ndihmuar një shok apo shoqe, apo kur është ndihmuar prej tyre;– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve rreth pjesës që dëgjojnë.		Fjalë kyçe: -fabul; -pëllumbi; -milingona; -gjahtari; -dyfek; -ndihmë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -CD; -libra me fabula; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut; -Bashkëjetesa paqësore; -Vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -dëgjo-komento; -mendo-nxirr mesazhin; -shkrim i shpejtë; -bashkëbisedim;			

-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve

Veprimtaria e parë

Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit t'u përgjigjen pyetjes: A duhet të ndihmojmë të tjerët kur ata gjenden në rrezik?

Veprimtaria e dytë

**Dëgjo-komento:* Komentohen ilustrimet në libër nga nxënësit/et.

Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të dëgjojnë ose të lexojnë pjesën e parë të fabulës. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për elementet kryesore të fabulës.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet. Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth ndodhisë së milingonës, se si u gjend ajo e pashpresë në pellgun me ujë, kush e ndihmoi të dilte dhe në ç'mënyrë.

**Dëgjohe*t pjesa e dytë e fabulës. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për kthesën që merr zhvillimi i fabulës.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre.

Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth rrezikut që i kërcënohet pëllumbit nga gjahtari.

**Dëgjohe*t pjesa e fundit e fabulës. Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre. Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth rolit të milingonës për të neutralizuar gjahtarin, i cili ishte bërë gati të vriste pëllumbin, dhe shpëtimit të pëllumbit.

Veprimtaria e tretë

Mendo-nxirr mesazhin: Mësuesi/ja fton nxënësit/et që në grupe të formulojnë mesazhin e fabulës. Përfaqësuesit e grupeve lexojnë mesazhet.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i shpejtë: Nxiten nxënësit/et të gjejnë një mbyllje tjetër për fabulën. Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë shkrimet e tyre.

**Nxënësit/et* tregojnë fabulën duke ilustruar me hollësi nga teksti.

**Punohet* rubrika "Mësoj më shumë", për të specifikuar karakteristikat e fabulës.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bëjnë lidhjen e fabulës që dëgjuan me atë të një libri apo filmi që trajton të njëjtën temë.

**Nxënësit* tregojnë histori ku ata kanë ndihmuar shokun apo shoku i ka ndihmuar ata.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-demonstrimin e të dëgjuarit të qëllimshëm në kryerjen e detyrave;

-diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënime të mbajtura prej tij/saj;

-përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së fabulës që dëgjon;

-gjykimin për veprimet e personazheve të fabulës;

-formulimin e mesazhit të fabulës;

-gjetjen e një mbyllje tjetër për fabulën;

-vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndryshimet që pësojnë foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – zgjedhon folje <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme; – tregon se foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit; – vë në dukje se foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e kryer të thjeshtë dalin në format <i>dola</i> dhe <i>pashë</i>; – analizon foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre; – krijon fjali me foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> duke i përdorur ato në kohët e mësuara; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; – bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave. 		Fjalë kyçe: -foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> ; -folje të parregullta; -kohën e tashme; -koha e pakryer; -koha e kryer të thjeshtë; -koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabelat e zgjedhimit të foljeve <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohët e mësuara; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shqëria dhe mjedisi; - Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -dallo-trego; -shkëmbe një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.			

Veprimtaritë e nxënësve/eve**Veprimtaria e parë**

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Komentohet figura në libër nga nxënësit/et.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë në libër dhe të dallojnë foljet.

Unë dola shëtitje në parkun e qytetit. Atje pashë disa shokët e mi të klasës.

Nxiten nxënësit/et të tregojnë se në çfarë kohe janë përdorur këto folje dhe se ku e vënë re këtë.

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe e grupe dhe u japin përgjigje pyetjeve.

Mësuesi/ja thekson se foljet *dal* dhe *shoh* zgjedhohen në mënyrë të veçantë.

*Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë tabelat e zgjedhimit të foljeve *dal* dhe *shoh* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.

Zhvillohet një diskutim nën drejtimin e mësuesit/es për ndryshimet që pësojnë këto folje në kohën e kryer të thjeshtë. *dal-* *dola* dhe *shoh-* *pashë*, duke iu referuar edhe rubrikës “Kujdes”.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 ka karakter plotësues. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me foljen *shoh* në kohët e kërkuara, duke i përshtatur ato me kryefjalën në fjali.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të përcaktojnë vetën, numrin dhe kohën e foljes *dal* në fjalitë e dhëna.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Në përfundim shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të nënvizojnë foljet *dal* dhe *shoh* në tekst dhe të përcaktojnë kohën në të cilën janë përdorur ato në fjali. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Në përfundim nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth kohës në të cilën janë përdorur në fjali foljet *dal* dhe *shoh*.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljet *dal* dhe *shoh* në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat janë përdorur foljet *dal* dhe *shoh*.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- zgjedhimin e foljeve *dal* dhe *shoh* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
- analizën e foljeve *dal* dhe *shoh* në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;
- krijimin e fjalive me foljet *dal* dhe *shoh* duke i përdorur ato, në kohët e mësuara;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo nga dy fjali me foljet *dal* dhe *shoh*, të përdorura në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Gjuha jonë Zgjedhjmë foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndryshimet që pësojnë foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e kryer të thjeshtë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– zgjedhon folje <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;– tregon se foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> ndryshojnë rrënjën gjatë zgjedhimit;– vë në dukje se foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohën e kryer të thjeshtë dalin në format <i>dola</i> dhe <i>pashë</i>;– analizon foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i>, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;– shkruan fjali me foljet <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> duke i përdorur ato, në kohën, vetën dhe numrin e caktuar;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e detyrave.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-foljet: <i>dal</i> dhe <i>shoh</i>-folje të parregullta;-kohën e tashme;-koha e pakryer;-koha e kryer të thjeshtë;-koha e ardhme.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-tabelat e zgjedhimit të foljeve <i>dal</i> dhe <i>shoh</i> në kohët e mësuara;-mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shqëria dhe mjedisi;- Artet.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-shkrim i drejtuar;-shkëmbe një problemë;-punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë, ku nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara prej tyre.			

Punë në dyshe: Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 4-5 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të dallojnë foljet *dal* dhe *shoh* në kohën e kryer të thjeshtë dhe të përcaktojnë vetën dhe numrin e tyre.

Nxënësit/et punojnë në dyshe. Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

Veprimtaria e dytë

Shkrim i drejtuar: Ushtimi 4, 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë fjali me foljet *dal* dhe *shoh* në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, lexojnë fjalitë me zë para klasës. Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime drejtshkrimore nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe: Orientohen nxënësit/et të punojnë në grupe. Ata/ato do të shkruajnë në fleta foljet *dal* dhe *shoh* në kohët e mësuara, në veta dhe në numra të ndryshëm dhe do t'i shkëmbejnë me grupet fqinje për të krijuar fjali dhe për të dalluar kohën, vetën, numrin në të cilat janë përdorur foljet.

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- zgjedhimin e foljeve *dal* dhe *shoh* në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
- analizën e foljeve *dal* dhe *shoh* në fjali, duke përcaktuar vetën, numrin dhe kohën e tyre;
- shkrimin e fjalive me foljet *dal* dhe *shoh* duke i përdorur ato, në kohën, vetën dhe numrin e kërkuar;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e detyrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo një tekst të shkurtër me temë “Një shëtitje në pyll” ku të përdorësh foljet *dal* dhe *shoh*, në kohët e mësuara.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Luani dhe derri i egër		Situata e të nxënit: Pse nuk është mirë që të kemi zënka dhe sherre ndërmjet njëri-tjetrit?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon fabulën rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – përcakton dy-tre tipare të fabulave; – dallon personazhet, vendin, kohën ku zhvillohet ngjarja; – tregon si fillon, çfarë u ndodh protagonistëve dhe si përfundon fabula; – shkruan një titull për secilën pjesëz të fabulës dhe tregon se çfarë ndodh në to; – vë në dukje se mesazhi që përcjell fabula është i shprehur në tekst apo i nënkuptuar; – parashikon se çfarë do t’i kishte ndodhur luanit dhe derrit të egër, nëse ata do të vazhdonin dyluftimin; – bashkëbisedon me të tjerët për ndodhi nga jeta e tij/saj kur i ka dhënë fund ndonjë zënke; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalë kyçe -fabul; -luani; -derri i egër; -zënkë; -sherre.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -libra me fabula; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut; -Vendimmarrja morale; -Mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -pyetja e ditës; -lexim, diskutim në dyshe; -dallo-trego; -diskutim; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve			

• **Veprimtaria e patë**

Pyetja e ditës: Mësuesi/ja shtron pyetjen:

-Pse nuk është mirë që të kemi zënka dhe sherre ndërmjet njëri-tjetrit?

-Kësaj pyetje do t'i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës.

Veprimtaria e dytë

Lexim, diskutim në dyshe: Mësuesi/ja prezanton titullin e pjesës "Luani dhe derri i egër".

Orientohen nxënësit/et të vështrojnë ilustrimin në libër dhe të diskutojnë rreth tij.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë pjesën në heshtje. Nënvizojnë fjalitë që u duken interesante.

Pyesin njëri-tjetrin dhe mësuesin/en. Diskutojnë rreth pjesës.

*Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës duke vënë në dukje 2-3 karakteristika të saj.

*Zhvillohet leximi zinxhir.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Punë në dyshe. Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Nxiten nxënësit/et të punojnë në dyshe për të treguar personazhet e fabulës, vendin dhe kohën ku zhvillohet ngjarja, si fillon, çfarë u ndodh protagonistëve, si përfundon ngjarja. Përfaqësuesit/et e disa dysheve prezantojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

*Mësuesi/ja fton nxënësit/et të gjejnë mesazhin e fabulës dhe të tregojnë se ky mesazh është i shprehur në tekst apo i nënkuptuar.

Veprimtaria e katërt

Diskutim: Punë në grup: Punohet rubrika "Analizoj". Nxënësit/et do të punojnë në grupe për të gjetur një titull për çdo pjesë të fabulës dhe për treguar çfarë ndodh në to.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Rubrika "Reflektoj". Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre se çfarë mund të kishte ndodhur nëse luani dhe derri i egër do ta vazhdonin dyluftimin.

Nxiten nxënësit/et të tregojnë ndodhi nga jeta e tyre kur kanë pasur zënka me shokët apo shoqet dhe si i kanë dhënë fund këtyre zënkave.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e fabulës rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;

-dallimin e personazheve, vendit, kohës ku zhvillohet ngjarja;

-tregimin se si fillon, çfarë u ndodh protagonistëve dhe si përfundon fabula;

-shkrimin e një titulli për secilën pjesë të fabulës duke treguar se çfarë ndodh në to;

-parashikimin se çfarë do t'i kishte ndodhur luanit dhe derrit të egër, nëse ata do të vazhdonin dyluftimin;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika "Shkruaj"

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ndajfolja (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndajfoljen.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – dallon ndajfoljen në fjali; – përdor pyetjet: <i>Si? Kur? Ku? Sa?</i> për të gjetur ndajfoljen në fjali, duke ia drejtuar foljes; – klasifikon ndajfoljet sipas llojit të tyre (vendi, kohe, sasi, mënyre); – kthen mbiemrat në ndajfolje; – shkruan ndajfolje me kuptim të kundërt; – krijon fjali duke përdorur ndajfolje vendi, kohe, sasi, mënyre; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 		Fjalë kyçe -ndajfolje vendi, -ndajfolje kohe; -ndajfolje mënyre; -ndajfolje sasi; -pyetjet: <i>Si? Kur? Ku? Sa?</i>	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -tabela e klasifikimit të ndajfoljeve; -etiketa me ndajfolje; -mjete shkrimi, lapustila, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -dallosje-tregje; -rishikim në dyshe; -shkëmbeje një problemë; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimin. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë në dyshe dhe të diskutojnë rreth kuptimit për ndajfoljen në rubrikën “Kujtoje”.			

Mësuesi/ja jep sqarime se *për* të gjetur ndajfoljet, i drejtojmë foljes pyetjet: Kur? Ku? Sa? Si?

Nëpërmjet tyre marrim më shumë informacion për vendin, kohën, sasinë dhe për mënyrën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë tabelën e klasifikimit të ndajfoljeve dhe të diskutojnë rreth saj në fillim në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e dytë

Dallo-trego: Punë në grupe: Ushtrimi 1. Synon që nxënësit/et të klasifikojnë ndajfoljet e dhëna sipas llojit të tyre. Në përfundim përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të kthejnë mbiemrat në ndajfolje, sipas modelit.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të shkruajnë ndajfoljet me kuptim të kundërt.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Ata/ato shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe korrigjojnë gabimet. Në fund zhvillohet një diskutim në klasë për mënyrën se si kanë punuar, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Secili grup shkruan në fleta 8 ndajfolje (nga 2 ndajfolje për secilin lloj) dhe ia jep grupit fqinjë të krijojë fjali me to. Lexohen fjalitë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkimore.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e ndajfoljeve në fjali;
- klasifikimin e ndajfoljes sipas llojit të tyre (vendi, kohe, sasi, mënyre);
- kthimin e mbiemrave në ndajfolje;
- shkrimin e ndajfoljeve me kuptim të kundërt;
- krijimin e fjalive duke përdorur ndajfolje vendi, kohe, sasi, mënyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave;
- bashkëpunimin në grupe.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Ndajfolja (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar ndajfoljen.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon ndajfoljet e vendit, kohës, sasisë, mënyrës në fjali;– zëvendëson ndajfoljet në fjali me ndajfolje të tjera pa i ndryshuar kuptimin fjalive;– formon fjali duke përdorur çifte ndajfoljesh me kuptim të kundërt;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">-ndajfolje vendi,-ndajfolje kohe;-ndajfolje mënyre;-ndajfolje sasi;-pyetjet: Si? Kur? Ku? Sa?	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-tabela e klasifikimit të ndajfoljeve;-etiketa me ndajfolje;-mjete shkrimi, lapustila, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">të drejtat e njeriut;bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-rishikim në dyshe;-shkrim i drejtuar;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi nis me leximin e detyrave të shtëpisë nga nxënësit/et dhe diskutimin rreth tyre. <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 4-5 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të dallojnë ndajfoljet dhe t'i klasifikojnë ato sipas llojit të tyre (vendi, kohe, sasi, mënyre).			

Nxënësit/et punojnë në dyshe. Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth kuptimit për ndajfoljen.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të gjejnë ndajfoljet në tekstin e dhënë dhe t'i zëvendësojnë ato me të tjera, pa i ndryshuar kuptimin fjalive.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Nxiten nxënësit/et të lexojnë fjalitë para klasës.

Zhvillohet një diskutim për mënyrën se si kanë punuar, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 6. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të formojnë fjali në të cilat të përdorin tri nga çiftet e ndajfoljeve të ushtrimit 3. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore.

Në përfundim lexojnë fjalitë. Në drejtimin e mësuesit/es bëhet qortimi i gabimeve drejtshkrimore nëse ka.

Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e ndajfoljeve të vendit, kohës, sasisë, mënyrës në fjali;
- zëvendësimin e ndajfoljeve në fjali me ndajfolje të tjera pa i ndryshuar kuptimin fjalive;
- formimin e fjalive duke përdorur çifte ndajfoljesh me kuptim të kundërt;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- bashkëpunimin në grupe.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një shkrim të shkurtër me temë: Përshkruaj një ditë pranvere në fshat, në të cilin të përdorësh ndajfolje të ndryshme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Gjuhë shqipe		Situata e të nxënit: Pse jemi krenarë për gjuhën tonë të bukur shqipe?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – flet për përpjekjet e shqiptarëve për ruajtjen e gjuhës shqipe, si element kryesor i identitetit kombëtar, gjatë pushtimeve shekullore; – identifikon dialektin në të cilin është shkruar kjo poezi; – shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; – tregon në cilat vargje shprehet dashuria e poetit për gjuhën shqipe; – dallon llojin e rimës së poezisë; – shpjegon me fjalë të thjeshta, domethënien poetike të vargjeve të poezisë; – tregon vargjet që i pëlqejnë më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes; – paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; – vlerëson interpretimin e shokut/shoqes për poezinë; – demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Gjuhë shqipe; - Za; - Tash sa mot; - U del; - Jallia; - Fund e majë; - A; - Qet ngatrrime; - Çka; - Përpoq. 	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -informacione për jetën dhe krijimtarinë e Ndre Mjedës; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: -identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; -Të drejtat e njeriut.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -lexim dhe diskutim; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të zhvillojnë një bisedë për dashurinë që kemi ne për gjuhën tonë dhe pse jemi krenarë për gjuhën tonë të bukur shqipe.			

Njihen nxënësit/et me titullin e poezisë “Gjuhë shqipe” dhe autorin e saj Ndre Mjeda.

Veprimtaria e dytë

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë foton në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Nxiten ata/ato të flasin për përpjekjet e rilindësve tanë për gjuhën shqipe dhe veçanërisht të poetëve të shquar të cilët i kushtuan vargje gjuhës sonë.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Për çdo strofë u drejtohen nxënësve pyetje që nxisin diskutim.

Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë.

-Si u ndjetë pas leximit të kësaj poezie?

-A ju pëlqeu poezia? Pse?

Njihen nxënësit/et shkurtimisht me jetën dhe krijimtarinë e Ndre Mjedës, në rubrikën “Mësoj më shumë”.

*Punohet rubrika “Fjalë dhe shprehje”. Nxiten nxënësit/et të shpjegojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve dhe të ndërtojnë fjali me to.

*Në rubrikën “Mësoj më shumë”, nxiten nxënësit/et të lexojnë dhe të diskutojnë, nën drejtimin e mësuesit/es për rimën dhe llojet e saj, duke u ilustruar me vargje të poezive të ndryshme.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve rreth numrit të strofave të poezisë, numrit të vargjeve për çdo strofë, dialektit në të cilën është shkruar, për çfarë flitet në të, përcaktimit të elementeve që mbizotërojnë në çdo strofë dhe funksionin e tyre në poezi.

Veprimtaria e katërt

Diskutim; Punë në grupe: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në grupe gjejnë dhe tregojnë vargjet ku shprehet dashuria e poetit për gjuhën shqipe.

Nënvizojnë rrokjen e fundit në secilin varg, tregojnë si rimojnë vargjet duke qarkuar përgjigjen e saktë dhe përcaktojnë llojin e rimës.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të shpjegojnë vargjet e strofës së fundit, të recitojnë vargjet e strofës që pëlqejnë më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes.

Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- identifikimin e dialektit në të cilin është shkruar kjo poezi;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;
- tregimin se në cilat vargje shprehet dashuria e poetit për gjuhën shqipe;
- dallimin e llojit të rimës së poezisë;
- shpjegimin me fjalë të thjeshta, të domethënies poetike të vargjeve të poezisë;
- tregimin e vargjeve që i pëlqejnë më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e interpretimit të shokut/shoqes për poezinë.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Letër shokut		Situata e të nxënit: Si ndihesh kur gabon? Ndjesa si një mënyrë reflektimi për gabimet tona.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– flet për ndjesën si një mënyrë reflektimi për gabimet tona ndaj shokëve, miqve, prindërve, të afërmeve;– dallon strukturën e një letre ndjese;– u përgjigjet me shkrim pyetjes rreth një letre ndjese;– shkruan një letër ndjese drejtuar një shoku, shoqeje, të afërmi, familjari, duke iu përmbajtur modelit të dhënë;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -letër jozyrtare; -letër ndjese; -vendi dhe data, marrësi, hyrja, qëllimi për të cilin është shkruar letra, shpjegimi i dhënë, përshëndetja e mbylljes, formula e mbylljes, dërguesi.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -rishikim në dyshe; -diskutim; -shkrim i lirë; -konkurs; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja drejton pyetjen: si ndihesh kur gabon? Ajo fton nxënësit/et të flasin për ndjesën si një mënyrë reflektimi për gabimet tona ndaj shokëve, miqve, prindërve, të afërmeve. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Nxënësit/et punojnë individualisht për të lidhur me shigjetë sipas modelit, elementet e strukturës së letrës me pjesët përkatëse. Nxënësit/et shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin, zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth strukturës së një letre ndjese drejtuar shokut.			

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Ushtrimi 2. Udhëzohen nxënësit/et t'u përgjigjen me shkrim pyetjeve rreth letrës së dhënë në ushtrimin 1. Pas përfundimit të punës zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth mënyrës së formulimit të një teksti të tillë dhe rëndësinë që ka ndjesa e sinqertë në forcimin e marrëdhënieve tona të përditshme në familje, klasë dhe komunitet.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Duke u bazuar në modelin e ushtrimit 1 dhe në fjalët e theksuara të pyetjeve të ushtrimit 2, udhëzohen nxënësit/et të shkruajnë një letër ndjese drejtuar një shoku, shoqeje, të afërmi ose familjari.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë letrat e shkruara me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es, nëse ka.

Veprimtaria e pestë

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës/e ndajnë çmimet për tri punimet më të mira.

Vlerësimi bëhet për:

- kur flet për ndjesën si një mënyrë reflektimi për gabimet tona ndaj shokëve, miqve, prindërve, të afërmeve;
- dallimin e strukturës së një letre ndjese;
- shkrimin e një letre ndjese drejtuar një shoku, shoqeje, të afërmi, familjari, duke u bazuar në modele;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një shkrim të shkurtër me temë: Pse është ndjesa e rëndësishme në jetën tonë të përditshme?

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Parafjala (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar parafjalët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon parafjalët në fjali;– vë në dukje se parafjalët janë fjalë që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali;– përcakton para cilave fjalë janë vendosur parafjalët në fjali;– bën dallimin e parafjalës nga ndajfolja;– formon fjali me parafjalë të ndryshme që qëndrojnë para një emri, përemri, numërori, ndajfolje;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve;– demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- parafjalë;- nga, me, pranë, për etj.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-etiketa me parafjalë;-mjete shkrimi, lapustila, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">- Shoqëria dhe mjedisi;- Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-rishikim në dyshe;-dallo-trego;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Orientohen ata/ato të vërejnë figurën në libër dhe të diskutojnë rreth saj. Në një tabak letre mësuesi/ja ka shkruar tekstin të cilin nxënësit/et e kanë të paraqitur në libër. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe të tregojnë se para cilave fjalë janë vendosur fjalët me të gjelbër. Nxiten të provojnë nëse mund t'i lakojnë ato.			

Mësuesi/ja sqaron se fjalët *me, pranë, nga, për* janë parafjalë.

*Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për parafjalën në rubrikën “Mbaj mend”.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje se *parafjalët qëndrojnë para një emri, numërori, përemri, ndajfolje. Ato nuk mund të ndërrojnë vend në fjali.*

*Lexohen dhe diskutohen shembujt të paraqitur në libër, kur disa fjalë përdoren si parafjalë dhe si ndajfolje në fjali.

Mos më rri afër. (ndajfolje) *Afër shkollës ishin mbledhur djem e vajza.* (parafjalë)

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me parafjalët e duhura.

Ushtrimi 2 synon që të nënvizojnë parafjalët në fjali dhe të përcaktojnë para cilave fjalë janë vendosur. Nxënësit/et punojnë individualisht. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Ushtrimi 3. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të dallojnë ndajfoljet dhe parafjalët në grupet e fjalëve. Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e parafjalëve në fjali;
- përcaktimin se para cilave fjalë janë vendosur parafjalët në fjali;
- dallimin e parafjalës nga ndajfolja;
- formimin e fjalive me parafjalë të ndryshme që qëndrojnë para një emri, përemri, numërori, ndajfolje;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave;
- bashkëpunimin në grupe.

Detyrë shtëpie: Shkruaj fjali ku të përdorësh parafjalët *për, me*, para emrit, para përemrit, para numërorit, para ndajfoljes.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Parafjala (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar parafjalët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – përcakton para cilave fjalë janë vendosur parafjalët në fjali; – dallon rastet kur e njëjta fjalë në fjali përdoret si parafjalë dhe kur përdoret si ndajfolje; – formon fjali me parafjalë të ndryshme që qëndrojnë para emrave; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe - parafjalë; - nga, me, pranë, për etj.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me parafjalë; -mjete shkrimi, lapustila, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -dallo-trego; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin nga nxënësit/et të detyrave të shtëpisë. <i>Punë në dyshe:</i> Mësuesi/ja shpërndan fleta në të cilat është shkruar një tekst i shkurtër (ose 4-5 fjali të ndryshme) dhe fton nxënësit/et të dallojnë parafjalët dhe të tregojnë para cilës fjalë ndodhen. Nxënësit/et punojnë në dyshe. Në përfundim, disa prej dysheve prezantojnë punën e bërë. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se çfarë dinë për parafjalën. Veprimtaria e dytë <i>Dallo-trego:</i> Ushtrimi 4. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të dallojnë në çiftet e fjalive, rastet kur e njëjta fjalë është përdorur si parafjalë dhe kur është përdorur si ndajfolje.			

Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth ushtrimit, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5. Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë emrat dhe parafralët e dhëna. Të shoqërojnë çdo emër me një parafralë dhe të ndërtojnë pesë fjali me to.

Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Në përfundim lexojnë fjalitë e krijuara.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- përcaktimin se para cilave fjalë janë vendosur parafralët në fjali;
- dallimin e rasteve kur e njëjta fjalë në fjali përdoret si parafralë dhe kur përdoret si ndajfolje;
- formimin e fjalive me parafralë të ndryshme që qëndrojnë para emrave;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- demonstrimin e vëmendjes dhe përqendrimit gjatë kryerjes së detyrave;
- bashkëpunimin në grupe.

Detyrë shtëpie: Shkruaj fjali ku të përdorësh fjalët *afër, larg, pas, pranë*, si parafralë dhe si ndajfolje.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Me gjithë shpirt		Situata e të nxënit: Në ç'mënyrë ke ndihmuar një person në nevojë? Solidariteti njerëzor me shokët e shoqet	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– dallon kujt i drejtohet poeti me këto vargje dhe çfarë i shpreh poeti atij;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë;– nxjerr mesazhin që përcjell poezia;– shpjegon me fjalë të thjeshta, domethënien poetike të vargjeve të poezisë;– ndan përvojat e tij/saj me të tjerët kur ka ndihmuar shokët/shoqe që janë gjendur në situata të vështira, apo kur është ndodhur vetë në situata të vështira dhe të tjerët i kanë ofruar ndihmë;– krijon një pesëvargësh për miqësinë;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson interpretimin e shokut/shoqes për poezinë;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– demonstroi besim në forcat e veta, respekt dhe tolerancë brenda grupit.		Fjalë kyçe: -miqësi; -shok.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Të drejtat e njeriut; -Bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -rishikim në dyshe; -bashkëbisedim; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve			

Veprimtaria e parë

Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth solidaritetit njerëzor me njerëzit në vështirësi përfshirë edhe shokun apo shokën, ndihmën që u kemi dhënë atyre për të kapërcyer problemet apo vështirësinë në të cilën janë ndodhur.

Veprimtaria e dytë

Dora e fshehtë: Nxënësit/et njihen me titullin e poezisë “Me gjithë shpirt”. Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet.

Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e poezisë.

Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet.

Veprimtaria e tretë

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë ilustrimet në libër.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Për çdo strofë u drejtohen nxënësve pyetje që nxisin diskutimin, duke u kujdesur që të punohen edhe pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe me rimë).

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

Nxiten nxënësit/et të shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për poezinë.

Veprimtaria e katërt

Rishikim në dyshe: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et lidhin me shigjetë vargjet me kuptimin përkatës.

Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim rreth vargjeve të vjershës me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

*Në grupe nxënësit/et nxjerrin mesazhin që përcjell kjo poezi dhe e lexojnë atë.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të ndajnë përvojat e tyre me të tjerët kur ata kanë ndihmuar shokët e tyre që janë gjendur në situata të vështira, apo kur janë ndihmuar nga të tjerët. Nxënësit/et recitojnë vargjet që u pëlqejnë më shumë dhe arsyen e përzgjedhjes.

Veprimtaria e gjashtë

Pesëvargësh: Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et në grupe krijojnë pesëvargësha për miqësinë.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë pesëvargëshat para klasës.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;
- nxjerrjen e mesazhit që përcjell poezia;
- shpjegimin me fjalë të thjeshta, të domethënies poetike të vargjeve të poezisë;
- formulimin e një pesëvargëshi për miqësinë;
- vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve për poezinë.

Detyrë shtëpie: Mëso vjershën përmendësh.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Lidhëzat		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar lidhëzat.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – dallon lidhëzat në fjali; – vë në dukje se lidhëzat janë fjalë që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali; – plotëson fjalitë duke vendosur lidhëzën e duhur; – tregon rastet kur lidhëzat lidhin dy gjymtyrë fjalie dhe kur lidhin dy pjesë fjalie; – përcakton nëse “e“ është përdorur në fjali si lidhëz, si trajtë e shkurtër apo si një e rasës gjinore; – shkruan fjali në të cilat përdor lidhëza të ndryshme; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve; – demonstroi vëmendje dhe përqendrim gjatë kryerjes së detyrave; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe -lidhëza; -e, dhe, edhe, por, apo, kurse, ndonëse, sikurse, meqenëse, etj	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -etiketa me lidhëza; -mjete shkrimi, lapustila, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -diskutim; -rishikim në dyshe; -dallo-trego; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimit. Orientohen ata/ato të vërejnë figurën në libër dhe të diskutojnë rreth saj. Në një tabak letre mësuesi/ja ka shkruar tekstin të cilin nxënësit/et i kanë të shkruar në libër. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë tekstin dhe të tregojnë se para cilave fjalë janë vendosur fjalët me të gjelbër. Nxiten të provojnë nëse mund t'i lakojnë ato dhe të tregojnë se përse shërbejnë këto fjalë.			

Mësuesi/ja sqaron se fjalët me të gjelbër janë lidhëza.

*Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth kuptimit për lidhëzat në rubrikën “Mbaj mend”.

Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje se lidhëzat janë fjalë që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali. Ato lidhin dy gjymtyrë fjalie ose dy pjesë fjalie.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të vendosin lidhëzën e duhur në fjali.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Ushtrimi 2. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të lexojnë fjalitë dhe të dallojnë rastet kur lidhëzat lidhin dy gjymtyrë fjalie dhe kur lidhin dy pjesë fjalie.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të përcaktojnë nëse “e” është përdorur si lidhëz, si trajtë e shkurtër apo si nyjë e rasës gjinore.

Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën rreth ushtrimeve, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të formojnë fjali në të cilat të përdorin lidhëzat: *prandaj, ose, por, as, kurse, meqenëse, ndonëse, sikurse*.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Në përfundim lexojnë fjalitë e krijuara.

Bëhen qortime drejtshkimore me ndihmën e mësuesit/es nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-dallimin e lidhëzave në fjali;

-plotësimin e fjalive duke vendosur lidhëzën e duhur;

-tregimin e rasteve kur lidhëzat lidhin dy gjymtyrë fjalie dhe kur lidhin dy pjesë fjalie;

-përcakton nëse “e” është përdorur në fjali si lidhëz, si trajtë e shkurtër apo si nyjë e rasës gjinore;

-shkrimin e fjalive në të cilat përdor lidhëza të ndryshme;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;

-bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një tekst të shkurtër me temë të lirë. Nënvizu lidhëzat në të.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Kur lulëzojnë mollët		Situata e të nxënit: Ndjesia që shkakton lulëzimi i pemëve në pranverë	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– dallon se çfarë përshkruhet në këtë poezi;– tregon me se e krahason poeti lulëzimin e mollëve;– shpreh ndjesitë që i përcjell leximi i vargjeve të poezisë;– shpjegon me fjalë të thjeshta, domethënien poetike të vargjeve të poezisë;– krijon një pesëvargësh për pranverën;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson interpretimin e shokut/shoqes për poezinë;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: -pranvera; -lulet e mollës.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fotografi të pemëve të lulëzuara në stinën e pranverës; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - Shoqëria dhe mjedisi; - Shkencat e natyrës; - Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -bisedë; -dora e fshehtë; -lexim dhe diskutim; -ditari dypjesësh; -dallo-trego; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja paraqet fotografi që tregojnë natyrën në stinën e pranverës, pemët e lulëzuara në këtë stinë. Nxiten nxënësit/et t’i vëzhgojnë dhe t’i komentojnë ato, duke u ndalur në ndjesinë që shkaktojnë pemët e lulëzuara në pranverë.			

Veprimtaria e dytë

Dora e fshehtë: Nxënësit/et njihen me titullin e poezisë “Kur lulëzojnë lulet e mollës”. Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, në të cilat janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet.

Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e poezisë.

Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet.

Veprimtaria e tretë

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë ilustrimet në libër.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Për çdo strofë u drejtohen nxënësve/eve pyetje që nxisin diskutimin.

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë.

Rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë se për cilën stinë bëhet fjalë, si dhe t’u përgjigjen pyetjeve rreth poezisë duke përzgjedhur alternativat e sakta.

Veprimtaria e katërt

Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë për llojin e rimës me të cilën është shkruar poezia.

Ditari dypjesësh. Nxënësit/et punojnë në grupe për të bërë komentin e vargjeve:

Vargjet	Komenti
Nga aroma që lëshojnë lulet e bukura, dehen njerëz, bletë, zogj e flutura...	Poeti në këto vargje shpreh jo vetëm bukurinë e luleve të mollës por edhe ndikimin që kanë ato tek njerëzit, bletët, zogjtë, fluturat. Aroma e luleve të mollës është e këndshme, e rrallë dhe dehëse. Fjalën “dehëse” poeti e përdor për të zmadhuar bukurinë, hijeshinë dhe mrekullinë e luleve të mollës.

Përfaqësuesit/et e grupeve lexojnë komentet.

Veprimtaria e pestë

Dallo-trego: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë ndjesitë që i përcjellin leximi i këtyre vargjeve.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të recitojnë poezinë. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e gjashtë

Pesëvargësh: Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et në grupe krijojnë pesëvargësha për pranverën.

Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë pesëvargëshat para klasës. Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- ndjesitë që i përcjell leximi i vargjeve të poezisë;
- shpjegimin me fjalë të thjeshta, të domethënies poetike të vargjeve të poezisë;
- krijimin e një pesëvargëshi për pranverën;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve për poezinë.

Detyrë shtëpie: Mëso vjershën përmendësh.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Shkruajmë për pranverën		Situata e të nxënit: Material i shkurtër filmik për natyrën në stinën e pranverës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – flet për natyrën në stinën e pranverës; – u përgjigjet pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e pranverës duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine; – shkruan për stinën e pranverës, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë; – shpjegon preferencën e tij/saj për stinën e pranverës; – përshkruan se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë; – shkruan për stinën e pranverës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të shkruarit; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -përshkruaj; -pranvera; -moti; -natyra; -njeriu; -frutat e perimet.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga natyra në stinën e pranverës; -mjete shkrimi, lapustila, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: -shikim i organizuar; -diskutim; -bashkëbisedim; -shkrim i lirë; -punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë			

Shikim i organizuar: Mësuesi/ja paraqit me anë të videoprojektorit një material të shkurtër filmik për stinën e pranverës, duke dëgjuar në sfond simfoninë e Vivaldit, “Katër stinët”.

Në mungesë të videoprojektorit paraqiten pamje nga natyra në stinën e pranverës.

Nxiten nxënësit/et t’i përshkruajnë ato, duke treguar edhe karakteristikat e stinës së pranverës. Nxënësit/et shprehin lirshëm ndjenjat dhe emocionet e tyre për stinën e pranverës.

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë përgjigjet e pyetjeve për stinën e pranverës duke përzgjedhur në fjalët në kllapa, fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të lexojnë përgjigjet e pyetjeve dhe të diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 2. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e pranverës, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë.

Disa nxënës/e lexojnë përshkrimet e tyre.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 3. Nxënësit/et bashkëbisedojnë rreth preferencave të tyre për stinën e pranverës, duke i shpjeguar ato me dy fjali.

Ushtrimi 4. Nxënësit/et përshkruajnë se ku u pëlqen të shkojnë dhe çfarë u pëlqen të bëjnë në këtë stinë.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 5. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e pranverës në vendin ku jetojnë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke respektuar këshillat e dhëna në libër për përshkrimin e kësaj stine.

Ata/ato punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkimore me ndihmën e mësuesit/es;

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

-përgjigjet e pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e pranverës, duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;

-përshkrimin për pranverën, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;

-shkrimin për stinën e pranverës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;

-respektimin e rregullave drejtshkimore gjatë të shkruarit;

-qortimet drejtshkimore me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj stinën e pranverës në një vend kodrinor.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexim jashtë klase (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe:	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.– (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja)– përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive.– (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja)– përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; ë– tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;– shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;– ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.		Situata e të nxënit: Leximi i librave jashtë klase	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es– libra jashtë klase		Lidhja me fushat e tjera: Lidhja me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none">• Prezantimi i titullit të librit dhe autori.• Leximi i pjesës.• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.• Tregimi i përmbajtjes së pjesës.• Personazhet dhe cilësitë e tyre.• Mesazhi që përcjell pjesa.• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.• Ilustrim i pjesës me vizatim.			
Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.			
Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do zgjedhë mësuesi/ja për të punuar.			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Vlerësim njohurish 2		Fjalë kyçe: -vlerësim njohurish; -test; -përcakto; -kthej; -shkruaj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.		Situata e të nxënit: Vlerësim njohurish 2	
Burimet dhe materialet didaktike – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; – fletët e testit, mjetet e shkrimit.		Lidhja me fushat e tjera: -Shoqëria dhe mjedisi. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none">Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur.Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit/et. Vlerësimi bëhet për: -plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.			

Projekti 2 (4 orë)

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT					
Titulli i projektit	Respektojmë nënat dhe mësueset		Kohëzgjatja	1 orë -- gjuhë shqipe (të shkruarit)	
				1orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)	
Lënda: Gjuhë shqipe		Mësuesi/ja:		1 orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)	
				1 orë -- gjuhë shqipe (të lexuarit)	
Lidhja me fushat e tjera:	Artet, Teknologji dhe TIK Shoqëria dhe mjedisi		Klasa:	V	
Ideja e projektit:	<p>Jeta e çdo fëmije është e mbushur me ditë të veçanta. Ata kanë dëshirë të luajnë, të këndojnë, të vizatojnë, të diskutojë në lidhje me historikun e këtyre ditëve. Pra, ata kanë dëshirë të festojnë.</p> <p>Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese, për të gjetur dhe lexuar dokumente që kanë të bëjnë me historikun e datës 7 dhe 8 Mars; aftësitë krijuese për të përgatitur postera, ftesa, vizatime; aftësitë interpretuese për vjersha, tregime, lojë me role, gjëza, etj.</p> <p>Çdo fëmijë ka një dashuri të pafundme për nënën që i dha jetën që e rriti dhe edukoi. Gjithashtu edhe mësuesja për to është si një nënë e dytë që me shumë durim, përkushtim i mëson dhe edukon. Në këto ditë të shënuara 7 e 8 Mars çdo nxënës uron nënën dhe mësuesen e tij me gjithë zemër, i shpreh mirënjohjen, respektin për të gjithë sakrificat, lodhjen, përkushtimin e tyre.</p>				
Ngjarjet hyrëse, që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve	<p>Filma të ndryshëm që kanë parë, histori që kanë dëgjuar apo lexuar do të frymëzojnë nxënësit për të kërkuar e zbuluar më shumë informacione në lidhje me 7 dhe 8 Marsin.</p> <p>Në këtë projekt, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme nxënësit do të shprehin mirënjohjen ndaj përkushtimit të nënave dhe mësueseve për rritjen dhe edukimin e tyre.</p> <p>Njohuritë paraprake të nxënësve si dhe përvojat e mëparshme të tyre në lidhje me këto ditë të shënuara, shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre në zotërimin e disa kompetencave.</p>				
Kompetencat kyçe që zhvillohen	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale	x	
	Kompetenca e te menduarit	x	Kompetenca qytetare	x	
	Kompetenca e të nxënit	x	Kompetenca digjitale	x	
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	x			
Temat e njohurive kryesore lëndore, të cilat do të rimerren në sajë të projektit	Shkruajmë ftesa për festat e 7 dhe 8 Marsit.		Lexojmë vjersha, tregime për festat e 7 dhe 8 Marsit.		
	Përgatitim kartolina, letra për nënën dhe për mësuesin/en.		Interpretojmë në role vjersha, tregime për festat e 7 dhe 8 Marsit.		

Rezultatet e të nxënës	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– mbledh informacione nga burime të ndryshme për festat e 7 dhe 8 Marsit;– përshkruan dashurinë dhe respektin që ka për nënën dhe mësuesen;– diskuton në grupe për festat e 7 dhe 8 Marsit;– identifikon përpjekjet e mësuesve dhe patriotëve shqiptarë në shekuj për të përhapur dijen dhe arsimin në masat e gjëra të popullit;– diskuton për punën e madhe, të palodhur dhe fisnike që bëjnë mësuesit për të mësuar dhe edukuar brezin e ri;– diskuton në grup për 8 Marsin si Ditën Ndërkombëtare të Gruas, historikun e saj, për natyrën e festimeve të kësaj dite në Shqipëri dhe në përgjithësi për rolin e grave në shoqërinë tonë, si nëna, gra, motra por edhe si protagoniste në jetën shoqërore dhe politike të vendit;– përgatit ftesa, kartolina, letra për festat e 7 dhe 8 Marsit;– interpreton poezi kushtuar nënave dhe mësueseve;– ndan me të tjerët përvojat e tij rreth kësaj feste;– përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të shkruarit;– prezanton duke e shoqëruar me mjete pamore filmime, fotografi etj.;– rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth festave të 7 dhe 8 Marsit;– demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;– demonstroi besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit.				
Metodologjia	(Individuale, në grup ose e gjithë klasa)	Diskutim	x	Hulumtim	x
		Bisedë	x	Lojë me role	x
		Punë në grup	x		x
Burimet e nevojshme	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi, nxënësit, prindërit.			
	Mjetet:	Aparat fotografik, bllok shënimesh, foto, videoprojektor, karton, letër, lapustila			
	Materiale dhe burime	Materiale të ndryshme nga interneti, fotografi dhe CD			
Pyetja kërkimore	A ju pëlqejnë festat? Dëshironi të organizojmë një aktivitet me rastin e 7-8 Marsit?				
Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit	<p>Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me “Ditën e mësuesit dhe të nënës”, foto/video nga aktivitete që i janë kushtuar këtyre ditëve.</p> <p>Gjuhë shqipe</p> <ul style="list-style-type: none">– Mësuesja ka ftuar në klasë prindër, të cilët do t’u bashkohen grupeve të fëmijëve.– Për secilin grup jepet nga një temë/detyrë. (Historiku i 7 Marsit; Historiku i 8 Marsit; kartolina, ftesa, letra, postera për 7 dhe 8 Marsin; poezi, këngë, tregime, filmime për 7 dhe 8 Marsin; interpretime, lojë në role për 7 dhe 8 Marsin).– Grupet diskutojnë rreth tyre duke u mbështetur në temat e mësipërme. Nxënësit ndalen në luftën dhe përpjekjet e rilindësve, patriotëve, mësuesve shqiptarë për të përhapur dritën dhe diturinë në masat e gjëra të popullit; në dëshirën e madhe të popullit për t’u arsimuar; në hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë më 7 Mars 1887.				

	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit diskutojnë në grup për rolin e mësuesit si edukator i brezit të ri si dhe për respektin që ato kanë për nënat dhe mësueset e tyre. Ata përshkruajnë dashurinë dhe respektin që kanë për nënën dhe mësuesen. Nxënësit diskutojnë në grup për 8 Marsin si Ditën Ndërkombëtare të Gruas, historikun e saj, për natyrën e festimeve të kësaj dite në Shqipëri dhe në përgjithësi për rolin e grave në shoqërinë tonë, si nëna, gra, motra por edhe si protagoniste në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Përgatitin ftesa, kartolina, letra, postera për festat e 7 dhe 8 Marsit dhe shprehin me shkrim respektin e mirënjohjen për nënën dhe mësuesen. Lexojnë dhe interpretojnë poezi, këngë, tregime kushtuar nënave dhe mësueseve. Ndajnë me të tjerët përvojat rreth kësaj feste duke kujtuar mësuesen e parë, lidhjen që kanë me të. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të luajnë me role situata të improvizuara të cilat kanë lidhje me festat e 7 dhe 8 Marsit. 	
Produktet kryesore	Në grup:	Festimi i 7 dhe 8 Marsit Përgatitja e posterave
	Individualisht:	Interpretime, lojë në role, etj. Përgatitja e kartolinave, ftesave e urimeve për nënat dhe mësueset
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit	Shkollë	X
	Klasë	X
Vlerësimet	Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)	Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> mbledhjen e informacioneve nga burime të ndryshme për 7 dhe 8 Marsin; diskutimin në grup për mesazhet që përcjellin këto festa dhe për mirënjohjen që shoqëria jonë duhet t'u shprehë mësueseve për rolin e tyre në edukimin e brezit të ri dhe nënave për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve; përgatitjen e posterave për 7 dhe 8 Marsin; ndarjen me të tjerët e përvojave rreth këtyre festave; prezantimin duke e shoqëruar me mjete pamore, filmime, fotografi etj.; rrëfimin e ngjarjeve, shprehjen e ndjenjave, përcjelljen e ideve rreth 7 dhe 8 Marsit; pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve të nxënësve në lidhje me festat e 7-8 Marsit; demonstrimin e pavarësisë së mendime dhe veprime; demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve; respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.
	Vlerësimet përmblledhëse (Në fund të projektit)	Prezantimi i punëve
Buxheti	Buxheti i detajuar Përse? Nga kush?	Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilave me ngjyra.

Shënim: Ky projekt mund të përshtatet nga mësuesit për çdo ditë feste.

Test 2

Kthimi i Skënderbeut në Krujë

Krujë, o qytet i bekuar,
prite, prite, Skënderbenë,
po vjen si pëllumb i shkruar
të shpëtojë mëmëdhenë.

Shqiptarët t'i shpëtojnë
nga zgjedh' e keqe e Turqisë
edhe ty të të nderojë,
që je kreu i Shqipërisë.

Ka pas trima shqipëtarë
që s'u trembet syri kurrë!
Në zemër të tij ka zjarr
është i urtë, trim e burrë!
[...]
Zbardhi fusha, ndriti mali,
nga armët e trimërisë!
Hingëllin e s'mbahet kali,
që sjell mbretinë e Shqipërisë.

Qarko përgjigjen e saktë.

1. Teksti i mësipërm është: (1 pikë)
 - a) vjershë
 - b) përrallë
 - c) fabul
2. Vargjet e mësipërme i kushtohen një: (1 pikë)
 - a) ngjarjeje historike
 - b) personazhi historik
 - c) qyteti historik
 - d) të gjitha bashkë
3. Skënderbeu po vinte në Krujë për: (1 pikë)
 - a) pushime
 - b) të luftuar turqit
 - c) të ndërtuar shtëpinë e tij
4. Autori fton shqiptarët të gëzohen sepse: (1 pikë)
 - a) shpreson në fitoren mbi turqit
 - b) do festojnë
 - c) turqit u larguan
5. Këto vargje janë shkruar sipas rimës: (1 pikë)
 - a) A-A-B-B
 - b) A-B-B-A
 - c) A-B-A-B
6. Shkruaj një titull tjetër. (1 pikë)
7. Shkruaj një karakteristikë të legjendës. (1 pikë)

8. Në vargun “Krujë, o qytet i bekuar,” gjej një emër dhe analizoje atë. (7 pikë)

Emri	Lloji	Konkret/abstrakt	Gjinia	Numri	Trajta	Rasa	Lakimi

9. Në strofën e parë gjej një mbiemër dhe analizoje atë. (5 pikë)

Mbiemri	Lloji	Numri	Gjinia	Rasa

10. Në tekstin e mëposhtëm gjej përemrat dhe vendosi në tabelë: (6 pikë)

Anila bisedon me Altinin.

Ajo e pyet: Ty të erdhën shokët për ditëlindje? Kush nuk erdhi?

Altini i tregoi se në ditëlindjen e tij kish munguar vetëm Elda.

Kështu bën gjithmonë kjo, - tha Anila. Edhe në ditëlindjen time nuk erdhi.

Trajtë e plotë e përemrit vetor	Trajtë e shkurtër e përemrit vetor	Përemër pronor	Përemër pyetës	Përemër dëftor

11. Shkruaj dy fjali duke e përdorur përemrin ai një herë si përemër vetor dhe një herë si dëftor. (2 pikë)

12. Në vargun “Zbardhi fusha, ndriti mali” gjej një folje dhe analizoje atë. (5 pikë)

Folja	Koha	Veta	Numri	Zgjedhimi

13. Shkruaj një fjali ku të përdorësh foljen *shoh* në kohën e kryer të thjeshtë, veta e tretë, numri shumës. (1 pikë)

14. Ndërto dy fjali me fjalën *afër*, ku ta përdorësh një herë si parafjalë dhe një herë si ndajfolje. (2 pikë)

15. Në fjalinë “Alma e Deni shkuan në kinema dhe panë një film të bukur” gjej lidhëzat. Trego cila lidhëz lidh dy gjymtyrë fjalie dhe cila lidh pjesë të fjalisë. (2 pikë)

16. Krahajo personazhet që të pëlqejnë më shumë. (5 pikë)

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-9	10-16	17-23	24-29	30-35	36-40	41-42

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Teksti dhe fjalia (ora I)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar fjalinë dhe tekstin.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan karakteristikat e fjalisë;– identifikon një tekst, duke përshkruar tiparet e tij;– bën dallimin ndërmjet fjalisë dhe një grupi fjalësh që nuk kanë lidhje kuptimore;– lidh grupe fjalësh ose fjalë sipas kuptimit dhe rregullave gramatikore për të krijuar fjali;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- tekst;- fjali;- fjalë;- lidhje kuptimore;- shkronjë e madhe;- shenjat e pikësimit: pikë, pikëçuditje, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;- teksti mësimor;- mjete shkrimi, fletore, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Metodologjia:

- lexo-diskuto;
- rishikim në dyshe;
- diskutim;
- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve/eve:

Veprimtaria e parë

Lexo-diskuto: Mësuesi/ja shkruan në tabelë 2-3 fjali të ndryshme, fton nxënësit/et t’i lexojnë dhe të tregojnë se çfarë janë ato.

Nxiten nxënësit të tregojnë se ç’dinë për fjalinë, duke rikujtuar njohuritë që kanë për të dhe duke lexuar rubrikën “Kujtoj”.

Përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja i paraqet në tabelë në formë kllasteri.

Shpreh një mendim.

Fillon me shkronjë të madhe.

Përfundon me (.) (?) (!)

Bashkim fjalësh që lidhen sipas kuptimit dhe rregullave gramatikore.

fjalia

*Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë figurën dhe të lexojnë fjalitë në libër.

Mësuesi/ja u drejton pyetjen nxënësve: *A formojnë tekst fjalitë që lexuat? Pse?*

Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin: *Fjalitë formojnë një tekst. Teksti përbëhet nga disa paragrafë. Secili paragraf përbëhet nga disa fjali të lidhura me njëra-tjetrën, që shprehin një mendim të plotë e të pavarur.*

Nxiten nxënësit që në dyshe të shkruajnë me një fjali mendimin që përcjell secili nga paragrafët e tekstit dhe në fund t'i lexojnë ato.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 synon që nxënësit të dallojnë grupet e fjalëve që formojnë fjali.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit të lidhin me shigjetë grupet e fjalëve të tri kolonave të dhëna për të krijuar fjali.

Nxënësit punojnë individualisht në libër. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es nëse fjalitë janë të kuptimta.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Punë në grup: Ushtrimi 3 synon që nxënësit të lidhin sipas kuptimit dhe rregullave gramatikore fjalët për të krijuar fjali. Nxënësit shkruajnë fjalitë e krijuara.

Përfaqësuesit e grupeve lexojnë fjalitë para klasës. Grupet japin mendime për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e karakteristikave të fjalisë;
- identifikimin e një teksti, duke përshkruar tiparet e tij;
 - dallimin ndërmjet fjalisë dhe një grupi fjalësh që nuk kanë lidhje kuptimore;
 - lidhjen e grupeve të fjalëve ose fjalëve sipas kuptimit dhe rregullave gramatikore për të krijuar fjali;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Teksti dhe fjalia (ora II)		Situata e të nxënit: Ndërtimi i një teksti duke renditur fjalitë sipas kuptimit.	
Rezultatet e të nxënit <ul style="list-style-type: none">– rendit paragrafët sipas kuptimit për të krijuar një tekst;– krijon një tekst duke renditur fjalitë në paragrafë dhe paragrafët ndërmjet tyre sipas kuptimit;– shkruan një tekst me temë të lirë, duke organizuar fjalitë në paragrafë;– bën qortimin e gabimeve drejtshkrimore më ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– vlerëson përpjekjet individuale dhe ato në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- tekst;- fjali;- fjalë;- lidhje kuptimore;- shkronjë e madhe;- shenjat e pikësimit: pikë, pikëçuditje, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit- teksti mësimor;- mjete shkrimi, fletore, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- rishikim në dyshe;- shkrim i lirë;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë Mësimi nis me leximin e detyrës që u është dhënë nxënësve/eve në orën e mëparshme. <i>Diskutim:</i> Punë në dyshe: Mësuesi/ja ka përgatitur fisha, në të cilat janë shkruar katër paragrafë të renditura jo saktë. Nxiten nxënësit të punojnë në dyshe për të krijuar një tekst duke renditur saktë paragrafët. Lexohet teksti nga përfaqësuesit e disa dysheve dhe nxënësit/et e tjerë gjykojnë nëse tekstet janë të kuptimita. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 5 synon që nxënësit të renditin fjalitë e secilit paragraf sipas radhës, duke shkruar para secilës prej tyre një numër dhe të renditin paragrafët për të krijuar një tekst. Nxënësit punojnë individualisht në libër. Në përfundim shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin e plotë me zë para klasës. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 6 synon që nxënësit të shkruajnë një tekst me temë të lirë, ku të organizojnë fjalitë në tre paragrafë.

Nxënësit/et punojnë individualisht. Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e lexojnë shkrimet e tyre.

Me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es bëhet korrigjimi i gabimeve drejtshkrimore.

Nxënësit/et vlerësojnë shkrimet e shokëve/shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- renditjen e paragrafëve sipas kuptimit për të krijuar një tekst;
- krijimin e një teksti duke renditur fjalitë në paragrafë dhe paragrafët ndërmjet tyre sipas kuptimit;
- shkrimin e një teksti me temë të lirë, duke organizuar fjalitë në paragrafë;
- qortimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- vlerësimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një tekst me temë: “Libri që më ka pëlqyer më shumë”, ku të organizosh fjalitë në katër paragrafë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Me ty, unë jam e lumtur		Situata e të nxënit 7-8-Marsi, Festa e Mësueses dhe e Nënës.	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none">– dallon elementet e poezisë si: strofa, vargu, rima;– lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;– u përgjigjet pyetjeve rreth poezisë;– shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë;– tregon vargjet në të cilat shprehet dashuria e poetes për nënën dhe mësuesen;– vlerëson rolin e nënës dhe të mësueses për rritjen dhe edukimin e fëmijëve;– shkruan një pesëvargësh për nënën dhe mësuesen;– reciton poezinë me ndjenjë;– komenton vargjet që i pëlqejnë më shumë;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- vjershë;- strofa;- nënë;- mësuese;- breza.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit- teksti mësimor;- foto ku nxënësit kanë dalë me nënën apo mësuesen e tyre;- mjete shkrimi, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none">- të drejtat e njeriut;- bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- diskutim;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- mendo-zbulo;- bashkëbisedim;- pesëvargësh;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Ftohen nxënësit/et të zhvillojnë një bisedë rreth festave të 7-8-Marsit, duke ilustruar dhe me fotografi, që kanë sjellë në klasë, ku kanë dalë me nënën si edhe me mësuesen e tyre. Njihen nxënësit me titullin e poezisë “Me ty, unë jam e lumtur” dhe autoren Mimoza Tola.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë figurën në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Nxiten nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për poezinë.

-Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje pasi lexuat këtë poezi?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe, me rimë).

Ushtrohen nxënësit në leximin me intonacion të poezisë. Recitohet poezia nga disa nxënës.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve rreth poezisë.

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe për përgjigjet e pyetjeve dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Mendo-zbulo: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë se në cilat vargje shprehet vlerësimi i poetes për nënën dhe për mësuesen.

Nxënësit punojnë në dyshe. Nxiten nxënësit të lexojnë vargjet që kanë nënvizuar dhe të diskutojnë rreth tyre.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Ftohen nxënësit/et të tregojnë pse u pëlqen kjo poezi, duke dhënë argumentet e tyre, të japin mendimin e tyre pse autorja mund ta ketë zgjedhur këtë titull dhe të tregojnë nëse poezia ka ndonjë lidhje me ta.

Veprimtaria e gjashtë

Pesëvargësh, ditari dypjesësh, punë në grupe: Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit të ndarë në grupe shkruajnë pesëvargësha për nënën dhe mësuesen dhe plotësojnë tabelën në libër me vargjet që i pëlqejnë më shumë duke dhënë edhe arsyen e përzgjedhjes.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

Grupet japin mendime për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- përgjigjet e pyetjeve rreth poezisë;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimet personale rreth poezisë;
- tregimin e vargjeve në të cilat shprehet dashuria e poetes për nënën dhe për mësuesen;
- shkrimin e pesëvargëshave për nënën dhe për mësuesen;
- komentin e vargjeve që i pëlqejnë më shumë;
- recitimin e poezisë me ndjenjë;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe ato në grup;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Mëso përmendsh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Fjalë dëftore dhe fjalë pyetëse (ora I)		Situata e të nxënit Improvizim i një interviste.	
Rezultatet e të nxënit <ul style="list-style-type: none">identifikon fjalitë dëftore dhe fjalitë pyetëse;dallon fjalitë pyetëse të pjesshme nga fjalitë pyetëse tërësore;ndërton fjali pyetëse për përgjigjet e dhëna, duke zbatuar rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit dhe duke vendosur shenjën e duhur të pikësimit;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">fjalë dëftore;fjalë pyetëse e pjesshme;fjalë pyetëse tërësore;shenjat e pikësimit: pikë, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësitteksti mësimor;mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fisha me fjalë pyetëse dhe dëftore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">lojë me role;mendo-diskuto;diskutim, rishikim në dyshe;shkrim i drejtuar;punë në çift, punë në grup, punë individuale, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Lojë me role:</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të improvizojnë një situatë, ku ata në dyshe intervistojnë njëri-tjetrin në rolin e gazetarit dhe të intervistuesit. Njihen nxënësit me temën e mësimi. Veprimtaria e dytë <i>Mendo-diskuto:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të rikujtojnë njohuritë që kanë për klasifikimin e fjalive sipas llojit të tyre, duke lexuar dhe diskutuar edhe rubrikën “Kujtoj”. Nxënësit/et vërejnë figurat në tekst dhe shkruajnë përgjigjet për pyetjet poshtë tyre. <ul style="list-style-type: none">Çfarë kupton nga kjo fotografi?Çfarë po bëjnë fëmijët?Kush e fiton garën? Lexohen përgjigjet e shkruara nga nxënësit/et.			

Nga bashkëbisedimi që zhvillohet me nxënësit/et dilet në konkluzionin se:

Pyetjet poshtë fotografive janë *fjali pyetëse*.

Përgjigjet që shkrove janë *fjali dëftore*.

Nxiten nxënësit/et të lexojnë dhe të përmbledhin në dyshe informacionin për fjalinë dëftore dhe fjalinë pyetëse dhe të diskutojnë rreth tyre.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et që në dyshe të lexojnë tekstin në ushtrimin 1 dhe të identifikojnë fjalitë dëftore dhe pyetëse.

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 synon që nxënësit të dallojnë fjalitë pyetëse të pjesshme dhe fjalitë pyetëse tërësore.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit të dallojnë fjalitë dëftore dhe pyetëse dhe të vendosin shenjat e duhura të pikësimit në fund të tyre.

Nxënësit/et do të punojnë individualisht në libër. Pas përfundimit të punës shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth fjalive dëftore dhe pyetëse dhe shenjave të pikësimit që vendosen në fund të tyre.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit të ndërtojnë fjali pyetëse, përgjigjet e të cilave janë fjalitë e ushtrimit 3. Nxënësit punojnë individualisht në fletore. Nxiten ata të lexojnë fjalitë pyetëse që kanë krijuar, duke vënë theksin në shenjat e pikësimit që kanë vendosur në fund të tyre.

Qortohen gabimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e fjalive dëftore dhe fjalive pyetëse;
- dallimin e fjalive pyetëse të pjesshme nga fjalitë pyetëse tërësore;
- ndërtimin e fjalive pyetëse për përgjigjet e dhëna, duke zbatuar rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit dhe duke vendosur shenjat e duhura të pikësimit;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ndërto një dialog, ku të përdorësh fjali pyetëse dhe dëftore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Fjalja dëftore dhe fjalja pyetëse (ora II)		Situata e të nxënit: Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar fjalitë dëftore dhe pyetëse.	
Rezultatet e të nxënit <ul style="list-style-type: none">dallon fjalitë dëftore dhe pyetëse;bën dallimin ndërmjet fjalive pyetëse tërësore dhe të pjesshme;krijon fjali pyetëse, duke përdorur pyetjet: <i>Ku? Kur? Kush? Çfarë? Si? Cili?</i>shkruan përgjigje për pyetjet;ndërton një tekst të shkurtër mbi bazën e figurës, duke përdorur fjali dëftore dhe pyetëse;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">fjali dëftore;fjali pyetëse tërësore dhe të pjesshme;dialog;pyes;përgjigjem;pyetjet: <i>Ku? Kush? Kur? Me kë? Cili? Çfarë?</i>shenjat e pikësimit: pikë, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;teksti mësimor;mjete shkrimi, lapustilë, fisha me fjali pyetëse dhe dëftore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">diskutim;rishikim në dyshe;shkrim i lirë;punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi nis me leximin e detyrës së shtëpisë. Mësuesi/ja ndan në çdo bankë nga një fletë në të cilën ka shkruar një dialog me pyetje dhe përgjigje. Nxiten nxënësit të dallojnë fjalitë dëftore dhe pyetëse, si dhe fjalitë pyetëse tërësore dhe të pjesshme. Përfaqësuesit e dysheve prezantojnë punën e bërë. Veprimtaria e dytë <i>Rishikim në dyshe:</i> Ushtrimi 5 synon që nxënësit të dallojnë llojet e fjalive dhe të vendosin shenjat e pikësimit në fund të tyre. Nxënësit punojnë në libër. Ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.			

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë me intonacionin e duhur dhe të diskutojnë për llojet e fjalive dhe shenjat e pikësimit të vendosura në fund të tyre.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 6 synon që nxënësit të formojnë fjali pyetëse që fillojnë me fjalët: *Cili? Ku? Si? Çfarë? Kur?* si dhe të shkruajnë përgjigjet për pyetjet e formuara.

Ushtrimi 7. Nxiten nxënësit/et të vërejnë figurën dhe të diskutojnë rreth saj. Ata do të punojnë individualisht për të shkruar tri pyetje për figurën dhe nga një përgjigje për secilën prej tyre.

Pas përfundimit të punës ftohen nxënësit të lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkimore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

(Këto dy ushtrime mund të punohen sipas niveleve të nxënësve.)

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e fjalive dëftore dhe pyetëse;
 - dallimin ndërmjet fjalive pyetëse të plota dhe atyre të pjesshme;
 - krijimin e fjalive pyetëse duke përdorur pyetjet: *Ku? Kur? Kush? Çfarë? Si? Cili?*
 - shkrimin e përgjigjeve për pyetjet;
 - ndërtimin e një teksti të shkurtër mbi bazën e figurës, duke përdorur fjali dëftore dhe pyetëse;
 - demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
 - bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ndërto një dialog ku të përdorësh fjali pyetëse dhe dëftore.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Lexojmë Në fletoren ku ti shkruan		Situata e të nxënit <i>Çfarë rruge bën fletorja derisa vjen në dorën tuaj?</i>	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – dallon elementet e poezisë, si: strofa, vargu, rima; – lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; – dallon gjuhën e përdorur nga poeti; – shpjegon domethënien e vargjeve të poezisë; – nxjerr mesazhin që përcjell poezia; – reciton poezinë me ndjenjë; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - poezi; - strofa; - fletore; -druvar; -sëpatë; -lis. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - teksti mësimor; - mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4; - foto ilustruese. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> - parashikim me anë të titullit, - dora e fshehtë; - lexim dhe diskutim; - rishikim në dyshe; - diskuto-analizo; - reflekto-nxirr mesazhin; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Parashikim me anë të titullit:</i> Mësuesi/ja shkruan titullin e poezisë në tabelë dhe vijon me pyetjen: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Si mendoni ju, çfarë rruge bën fletorja derisa vjen në dorën tuaj?</i> Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe japin alternativat e tyre. Mësuesi/ja prezanton titullin e poezisë “Në fletoren ku ti shkruan” dhe autorin e saj Odhise Grillo. Veprimtaria e dytë <i>Dora e fshehtë:</i> Udhëzohen nxënësit/et në secilin grup të tërheqin nga dora e fshehtë nga një fishë, ku janë shkruar vargjet e poezisë. Secili nga grupet ka për detyrë të renditë vargjet e poezisë, siç duhet. Çdo grup paraqet para klasës në fletë formati renditjen e poezisë. Mësuesi/ja lexon poezinë dhe del se cili nga grupet i ka renditur saktë vargjet. Lexim i poezisë nga disa nxënës. Leximi mund të bëhet dhe me vargje, pra një nxënës një varg.			

Veprimtaria e tretë

Lexim dhe diskutim: Nxënësit/et vërejnë dhe komentojnë pamjen në libër, në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

*Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Nxiten nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për poezinë.

- Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje pasi lexuat këtë poezi?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është e shkruar në vargje, përbëhet nga strofa, me rimë).

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

Veprimtaria e katërt

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

Nxënësit/et punojnë individualisht për të renditur sipas rrjedhës së poezisë fjalitë përmbledhëse për secilën strofë, duke vendosur numra.

Në përfundim, shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth detyrës.

Veprimtaria e pestë

Diskuto-analizo: Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë kuptimin e vargjeve të poezisë duke komentuar dhe analizuar secilin varg.

Përfaqësuesit/et e secilit grup prezantojnë punën e tyre para klasës. Mësuesi/ja përforcon mendimin e nxënësve në lidhje me kuptimin e vargjeve. Ajo ndalet në shpjegimin e “Përsëritjes” në poezi.

Veprimtaria e gjashtë

Reflekto-nxirr mesazhin: Nxënësit/et në grupe nxjerrin mesazhin që përcjell poezia. Përsëri në grupe orientohen të rindërtojnë katër strofa, duke zëvendësuar fjalën “fletore” me fjalën “kompjuter”. Diskutohet rreth ndryshimeve të tjera që bënë.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e elementeve të poezisë, si: strofa, vargu, rima;
- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;
- dallimin e gjuhës së përdorur nga poeti;
- shpjegimin e domethënies së vargjeve të poezisë;
- formulimin e mesazhit që përcjell poezia;
- recitimin e poezisë më ndjenjë;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”. Mëso përmendsh poezinë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Shkruaj një poezi		Situata e të nxënit Lexim dhe analizë poezish.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – shkruan për karakteristikat e një kafshe (qen, mace), veprimet e tij/saj, emocionet që të jep; – përzgjedh fjalët e duhura për të plotësuar vargjet e një poezie; – shkruan vargje për një tematikë të caktuar duke ndjekur udhëzimet; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; – vlerëson punën e shokëve e shoqeve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - poezi - varg - rimë - strofë - përshkrim 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -informacione nga interneti, revista për kafshët shtëpiake; -fotografi të kafshëve shtëpiake; - mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> - lexo-analizo; - shpjegim-diskutim-plotësim; - shkrim i lirë; - punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Lexo-analizo:</i> Mësuesi/ja ka të shkruara në fletë poezi të shkurtra. I shpërndan ato në çdo grup. Kërkon nga nxënësit/et t'i lexojnë dhe të përcaktojnë rimën e përdorur, numrin e strofave, vargjeve për çdo strofë, pra të zbulojnë rregullin që është ndjekur për shkrimin e atyre vargjeve. Një përfaqësues për grup do të lexojë vargjet me intonacion dhe do të përshkruajë hapat që ka ndjekur autori për shkrimin e vargjeve sipas mendimit të grupit. Mësuesi/ja saktëson dhe përforcon mendimet e nxënësve.		Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> – mjedisi. 	

Veprimtaria e dytë

Shpjegim-diskutim-plotësim: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit si dhe temën e poezisë që nxënësit/et do të shkruajnë. Ai/ajo ndalet në hapat që duhen ndjekur dhe drejton punën e nxënësve hap pas hapi. Orienton nxënësit të diskutojnë në grup për plotësimin e ushtrimeve 1-3 e më pas të punojnë të pavarur. Disa nxënës lexojnë poezinë për kafshën shtëpiake, për qenin.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 4. Orientohen nxënësit/et të shkruajnë vargje për macen duke ndjekur hapat e shtrimit 1-3. Diskutojnë në grup për të përcaktuar mbiemrat që e karakterizojnë një mace, foljet që do të përshkruajnë veprimet e saj si dhe emocionet apo ndjesitë që ajo u shkakton.

Më pas në grupe dyshe shkruajnë vargjet për kafshën shtëpiake, për macen.

Disa dyshe lexojnë para klasës vargjet e tyre duke përshkruar dhe hapat e ndjekur, numrin e vargjeve dhe të strofave.

*Ushtrimi 5. Nxiten nxënësit/et të shkruajnë një poezi, duke zgjedhur një nga temat e dhëna në tekst apo një temë tjetër që ata dëshirojnë.

Lexohen poezitë e nxënësve para klasës.

Vlerësimi bëhet për:

- përzgjedhjen e fjalëve të duhura për të plotësuar një poezi;
- shkrimin për karakteristikat e një kafshe (qen, mace), veprimet e tij/saj, emocionet që të jep;
- shkrimin e vargjeve për një tematikë të caktuar, duke ndjekur udhëzimet e dhëna;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- vërejtjet drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Nënë e madhe e kësaj bote		Situata e të nxënit Poster për Nënë Terezën.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – shpjegon fjalët e reja, duke ndërtuar fjali me to; – u përgjigjet pyetjeve rreth poezisë; – shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; – tregon vlerësimin që poetja i bën Nënë Terezës, duke e ilustruar me vargje nga poezia; – vlerëson veprimtarinë e Nënë Terezës në ndihmë të njerëzve të sëmurë dhe të varfër në Kalkutë të Indisë dhe vende të tjera të botës; – shpjegon me fjalët e tij/saj pse Nënë Tereza e bën atë dhe të gjithë shqiptarët të ndihen krenarë; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - poezi; - strofa; - Nënë Tereza; - shenjtore; - shëmbëlltyrë; - lëngata. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; - teksti mësimor; - informacione për jetën dhe veprimtarinë bamirëse të Nënë Terezës; - foto, thënie të Nënë Terezës; - mjete shkrimi, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Artet.	Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - të drejtat e njeriut; - bashkëjetesa paqësore.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -krijim i një posteri; -lexim-diskutim; -mendo-zbulo; -bisedë; -pesëvargësh; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve: Veprimtaria e parë <i>Veprimtari: Krijim i një posteri:</i> Nxënësit/et janë porositur nga mësuesi/ja të sjellin në klasë informacione për jetën dhe veprimtarinë bamirëse të Nënë Terezës në ndihmë të njerëzve të varfër dhe të sëmurë në Kalkutë të Indisë dhe në vende të tjera të botës, fotografi, thënie të saj etj. Ftohen nxënësit të përgatisin një poster dhe ta prezantojnë atë para klasës.			

Veprimtaria e dytë

Lexim-diskutim: Njihen nxënësit me titullin e poezisë “Nënë e madhe e kësaj bote” të autores Vitore Leka. Lexim i poezisë nga nxënësit/et në strofa.

Nxiten nxënësit/et të shprehin mendimet e tyre për poezinë.

- Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje pasi lexuat këtë poezi?

*Diskutohet në klasë për karakteristikat e poezisë (është shkruar në vargje, përbëhet nga strofa katërshe).

*Punohet rubrika “Fjalor”, ku shpjegohen fjalët që nxënësit/et nuk i kuptojnë dhe krijohen fjali me to.

*Lexim i poezisë me intonacion nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Mendo-zbulo: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”, ku nxënësit/et iu përgjigjen pyetjeve rreth poezisë.

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe për përgjigjet e pyetjeve dhe më pas me gjithë klasën.

Punë në grupe: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të zbulojnë se në cilat vargje shprehet vlerësimi i poetes për Nënë Terezën dhe t’i lexojnë ato.

Veprimtaria e katërt

Bisedë: Punohet rubrika “Reflektoj”. Ftohen nxënësit/et të tregojnë pse u pëlqen kjo poezi, duke dhënë argumentet e tyre me fjalë të thjeshta.

Në rubrikën “Mësoj më shumë”, nxënësit mësojnë më shumë për Nënë Terezën, jetën, veprimtarinë e saj në ndihmë të njerëzve të varfër në Kalkutë të Indisë dhe në vende të tjera, vlerësimin që i është bërë asaj si një nobeliste për paqen dhe shpalljen e saj shenjtore.

Ushtrohen nxënësit në leximin me intonacion të poezisë.

Recitohet poezia nga disa nxënës.

Veprimtaria e pestë

Pesëvargësh-punë në grupe: Nxiten nxënësit që në grupe të krijojnë pesëvargësh për Nënë Terezën. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë para klasës.

Nënë Tereza
nobeliste shenjto
ndihmoi përkrahu shërbeu
Nënë Tereza ishte simbol i humanizmit.
Gonxhe Bojaxhiu

Grupet vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e poezisë në mënyrë të rrjedhshme dhe me intonacionin e duhur;
- shpjegimin e fjalëve të reja, duke ndërtuar fjali me to;
- përgjigjet e pyetjeve rreth poezisë;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;
- tregimin e vlerësimit që poetja i bën Nënë Terezës, duke e ilustruar me vargje nga poezia;
- vlerësimin e veprimtarisë së Nënë Terezës në ndihmë të njerëzve të sëmurë dhe të varfër;
- shpjegimin me fjalët e tij/saj pse Nënë Tereza e bën atë dhe të gjithë shqiptarët të ndihen krenarë;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe ato në grup.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”. Mëso vjershën përmendësh

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Flasim Ndhimojmë njerëzit në nevojë		Situata e të nxënit Postera me thënie e fotografi të Nënë Terezës	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– bën një prezantim të shkurtër të veprimtarisë së Nënë Terezës;– komenton thënie të Nënë Terezës;– diskuton në grupe për temën “Ndhimojmë njerëzit në nevojë”;– përshkruan situata nga jeta e vet ku ka ndihmuar njerëz në nevojë;– demonstroi siguri kur flet në klasë;– shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth temës;– nëpërmjet bashkëbisedimit nxit të tjerët për të ndihmuar njerëzit në nevojë dhe për t’i bërë ata sado pak të lumtur;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">– poster,– mesazh,– tekst,– slogan,– bamirësi	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- foto që nxënësit/et kanë bërë në qendra të ndryshme sociale;- mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">- të drejtat e njeriut;- vendimmarrja morale;- bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësv/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- harta e konceptit;- lexo-komento-përzgjidh;- vëzhgo-diskuto;- lexo-diskuto;- trego-diskuto;- krijim i një posterit;- punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën.			

Veprimtaritë e nxënësve/eve

Veprimtaria e parë:

Harta e konceptit: Nxënësit kanë pasur për detyrë të krijojnë në grupe postera ku do të paraqitnin nëpërmjet një harte koncepti informacione, thënie dhe kuriozitete për jetën dhe veprën e Nënë Terezës.

Ata prezantojnë informacionet dhe fotografitë e paraqitura në postera, të cilët ekspozohen në muret e klasës.

Nxënësit lexojnë thëniet e Nënë Terezës që kanë paraqitur në postera dhe japin komentin e tyre lidhur me to.

Veprimtaria e dytë

Lexo-komento-përzgjidh: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të hapin librat dhe të njihen me posterin që ka krijuar klasa. Lexohen thëniet e Nënë Terezës. Në grupe diskutojnë rreth kuptimit të secilës prej tyre. Përfaqësuesi i grupit prezanton komentin e grupit në lidhje me ato thënie. (Ushtrimi 1)

Secili nxënës do të përzgjedhë një nga thëniet e Nënë Terezës që i pëlqen më shumë dhe tregojë pse i pëlqen. (Ushtrimi 2)

Veprimtaria e tretë

Vëzhgo-diskuto, organizues grafik: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotografitë në tekst.

Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe rreth tyre, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. Diskutimi orientohet në veprimtaritë që kryhen në ndihmë të njerëzve në nevojë duke u ndalur te nismat: “Dhuro një xhup” dhe “Dhuro një batanije”.

Mendimet e nxënësve/eve, mësuesi/ja i paraqet me anë të një diagrami në tabelë. (Ushtrimi 3)

Veprimtaria e katërt

Lexo-diskuto: Nxënësit/et lexojnë materialin që tregon për Lurën dhe diskutojnë rreth tij duke iu përgjigjur pyetjeve të ushtrimit 4, 5 në tekst.

Veprimtaria e pestë

Trego-diskuto: Nxënësit përshkruajnë një situatë reale nga jeta e tyre ku kanë ndihmuar njerëz në nevojë (ushtrimi 6) si dhe japin mendime se si mund ta lehtësojnë sadopak jetën e këtyre njerëzve. (ushtrimi 7)

Veprimtaria e gjashtë:

Krijim i një posterit: Nxënësit/et diskutojnë në grupe se çfarë nisme mund të ndërmarrin ata për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Mendimet e tyre i shkruajnë në postera, duke i shoqëruar me vizatime. Ata/ato shkruajnë mesazhe sensibilizuese për nxitjen e të gjithë individëve për të ndihmuar sadopak këtë grup njerëzish. Përfaqësuesi/ja e secilit grup prezanton posterin, duke e komentuar atë.

Vlerësimi bëhet për:

- diskutimin në grupe për temën “Ndihmojmë njerëzit në nevojë”;
- prezantimin e shkurtër të Nënë Terezës, kur ka lindur, ku ka jetuar dhe veprimtarinë e saj;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesitë e tij/saj rreth rëndësisë që ka ndihma që mund t’i japë njerëzve në nevojë me një gjuhë të saktë e të kuptueshme;
- nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për ndërgjegjësimin për të ndihmuar njerëzit në nevojë dhe për t’i bërë ata të lumtur;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Vjeshta		Situata e të nxënës	Imagjinatë e drejtuar – vjeshta
Rezultatet e të nxënës Nxënësi/ja: – dallon elementet e poezisë, si: strofa, vargu, rima; – lexon poezinë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth poezisë; – tregon detajet që janë përdorur për përshkrimin e natyrës dhe punëve të bujqësisë në vjeshtë; – shpjegon domethënien e vargjeve të poezisë; – nxjerr mesazhin që përcjell poezia; – shkruan fjali për vjeshtën sipas imagjinatës; – krijon pesëvargësh për vjeshtën; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe: - vjeshta - poezi ose vjershë - strofa; - vargje - imagjinatë - brymë - lëroj arën - bujk	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4; -foto me peizazhe vjeshte.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - të drejtat e njeriut; - vendimmarrje morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia - imagjinatë e drejtuar; - ditari dypjesësh; - pesëvargësh; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të mbyllin sytë dhe të mendojnë sikur janë në një lëndinë të mbushur me gjethe të arta. Në sfond vendos muzikë (një pjesë nga “4 stinët” e Vivaldit) -Çfarë ndjesie ju shkakton kjo situatë? Veprimtaria e dytë <i>Ditari dypjesësh:</i> Mësuesi/ja njeh nxënësit me titullin e vjershës dhe autorin e saj, Aleksandër Stavre Drenovën. Mësuesi/ja nxit nxënësit të lexojnë duke nënvizuar vjershën. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për përmbajtjen e vargjeve. Përsëri në dyshe ata do të plotësojnë një ditar dypjesësh ku do të shkruajnë një koment për çdo strofë të vjershës. Lexohen komentet nga disa nxënës. Punohen nën drejtimin e mësuesit/es rubrikat në tekst. Mesazhi: <i>Begatia e jetës e ka burimin te puna e përhershme.</i> Ushetrohen nxënësit në leximin me intonacion të vjershës. Recitohet vjersha nga disa nxënës.			

Veprimtaria e tretë

Pesëvargësh, Punë në grupe: Mësuesi/ja udhëzon nxënësit për të krijuar një pesëvargësh me fjalën vjeshta.

Vjeshta
e artë e begatë
zverdhon freskon begaton
Vjeshta është stina e të vjelave.
Stinë e artë

Plotësohet tabela në libër.

Vargjet që më pëlqejnë më shumë	Pse më pëlqejnë?

Lexohen krijimet e nxënësve para klasës.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e elementeve të poezisë, si: strofa, vargu, rima;
- leximin e poezisë rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth poezisë;
- tregimin e detajeve që janë përdorur për përshkrimin e natyrës dhe punëve të bujqësisë në vjeshtë;
- shpjegimin e domethënies së vargjeve të poezisë;
- formulimin e mesazhit që përcjell poezia;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj vjeshtën dhe paraqite me vizatim.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Fjalitë dëshirore dhe nxitëse (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar fjalitë dëshirore dhe nxitëse.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon fjalinë dëshirore dhe fjalinë nxitëse;bën dallimin ndërmjet fjalisë dëshirore dhe fjalisë nxitëse, duke treguar se çfarë shprehin secila prej tyre;shkruan fjali dëshirore dhe nxitëse, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit për secilin rast;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- fjali dëshirore;- fjali nxitëse;- dëshirë- urim;- mallkim;- këshillë;- lutje;- ftesë;- shenjat e pikësimit: pikë, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-mjete shkrimi, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-mendo-diskuto;-rishikim në dyshe;-shkrim i drejtuar;-diskutim;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Mendo-diskuto:</i> Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimi. Komentohen figurat në tekst nga nxënësit/et. Nxiten ata të lexojnë dialogët ndërmjet fëmijëve dhe të tregojnë llojet e fjalive që janë përdorur në këto dialogë. Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë rubrikën “Kujtoj”, ku rikujtojnë njohuritë e mëparshme rreth fjalive dëshirore dhe nxitëse. Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe nënvizojnë fjalitë dëshirore (që shprehin një dëshirë, një urim, një mallkim) dhe fjalitë nxitëse (që shprehin një këshillë, një lutje, një ftesë, një propozim) në rubrikën: “Mbaj mend”. Punohet rubrika “Kujdes” për dallimin e rastit të fjalive thirrmore.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 - synon që nxënësit të dallojnë pohimet e vërteta dhe të gabuara rreth fjalive dëshirore dhe nxitëse. Nxënësit punojnë individualisht. Ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë pohimet e vërteta dhe të gabuara.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 2 - synon që nxënësit të plotësojnë urimet dhe këshillat.

Në përfundim nxënësit lexojnë rimet dhe këshillat që kanë shkruar duke treguar shenjat e pikësimit që vendosin në fund të tyre.

Veprimtaria e katërt

Diskutim: Nxënësit/et do të punojnë në grupe për të shkruar fjali dëshirore dhe nxitëse në tabakë letre. Më pas përfaqësuesit e grupeve lexojnë fjalitë me zë para klasës.

Diskutohet rreth tyre me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxiten grupet të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e fjalive dëshirore dhe fjalive nxitëse;
- dallimin ndërmjet fjalisë dëshirore dhe fjalisë nxitëse duke treguar se çfarë shprehin secila prej tyre;
- shkrimin e fjalive dëshirore dhe nxitëse, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit për secilin rast;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Shkruani tri fjali dëshirore dhe tri fjali nxitëse.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Fjalitë dëshirore dhe nxitëse (ora II)		Situata e të nxënësve: Shkrimi i fjalive dëshirore dhe nxitëse.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon në një tekst fjalitë dëshirore dhe fjalitë nxitëse;tregon se çfarë shprehin fjalitë dëshirore dhe nxitëse;krijon fjali dëshirore dhe nxitëse;shkruan një tekst të shkurtër, ku të përdorë fjali dëshirore për të shprehur dëshirat apo urimet e tij/saj;shkruan një tekst të shkurtër, ku të përdorë fjali nxitëse për të shprehur këshillat apo propozimet e tij/saj;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: -fjali dëshirore; - fjali nxitëse; - shenjat e pikësimit: pikë, pikëpyetje.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;- teksti mësimor;- mjete shkrimi, fisha, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- tryezë e rrumbullakët;- shkrim i lirë;- konkurs;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve			
Veprimtaria e parë <i>Tryezë e rrumbullakët:</i> Të organizuar në gjashtë grupe, nxënësit/et vendosen në formë rrethore. Mësuesi/ja ndan detyrat: nxënësit/et e tri grupeve të para do të shkruajnë fjali dëshirore dhe nxënësit e tri grupeve të tjera do të shkruajnë fjali nxitëse. Nxënësit shkruajnë fjalinë e palosin fletën dhe ia pasojnë shokut që kanë pranë. Pasi përfundojnë të gjithë, nxënësit/et hapin fletët dhe lexojnë fjalitë. Zhvillohet një diskutim rreth kuptimit të fjalive dëshirore dhe nxitëse dhe shenjave të pikësimit që vendosim në fund të tyre, nën drejtimin e mësuesit/es.			
Veprimtaria e dytë <i>Shkrim i shpejtë:</i> Ndahet klasa në dy grupe. Nxënësit/et e grupit të parë do të punojnë ushtrimin 3 në të cilin do të punojnë individualisht për të krijuar një tekst të shkurtër, ku do të përdorin fjali dëshirore për të shprehur dëshirat apo urimet e tyre. Nxënësit/et e grupit të dytë do të punojnë ushtrimin 4 në të cilin do të punojnë individualisht për të krijuar një tekst të shkurtër, ku do të përdorin fjali nxitëse për të shprehur këshillat dhe propozimet e tyre. Nxiten nxënësit/ et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës. Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.			

Veprimtaria e tretë

Konkurs: Një juri e përbërë nga mësuesi/ja dhe dy nxënës ndan çmimet për shkrimet më të mira.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin në një tekst të fjalive dëshirore dhe fjalive nxitëse;
- krijimin e fjalive dëshirore dhe nxitëse;
- shkrimin e një teksti të shkurtër, ku të përdorë fjali dëshirore për të shprehur dëshirat apo urimet e tij/saj;
- shkrimin e një teksti të shkurtër, ku të përdorë fjali nxitëse për të shprehur këshillat apo propozimet e tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një tekst të shkurtër me temë: “Ditëlindja ime” me 7-8 fjali, ku të përdorësh fjali dëshirore e nxitëse.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një shpend i rrallë (ora I)		Situata e të nxënit Material i shkurtër filmik për pelikanin kaçurrel. (foto)	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe krijon fjali me to;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– përshkruan “pelikanin kaçurrel”, duke treguar faktorët që e kanë çuar atë drejt zhdukjes;– tregon masat që janë marrë për ruajtjen dhe shumimin e “pelikanit kaçurrel”, si dhe për ndalimin e gjuetisë së paligjshme të tij;– flet për rolin e tij/saj për ruajtjen e diversitetit të shpendëve dhe kafshëve në vendin tonë;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- pelikani dalmat- autokton;- specie;- habitat;- ligatina;- kalendar mjedisor.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;- teksti mësimor;- enciklopedi;- videoprojektor;- foto, informacione për pelikanin kaçurrel të marra nga interneti;- mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat e natyrës; TIK; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-mjedisi;-vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-shikim i organizuar;-lexo-përmbledh në dyshe;-marrëdhënie pyetje-përgjigje;-dallos-trego;-turi i galerisë;-shkrim i shpejtë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja ka gjetur filmime të shkurtra të pelikanëve në përgjithësi dhe të “pelikanit kaçurrel” në veçanti. I paraqet me anë të videoprojektorit. Zhvillohet një bisedë e shkurtër me nxënësit nën drejtimin e mësuesit/es rreth materialit filmik. (Në mungesë paraqiten foto.)			

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Mësuesi/ja njeh nxënësit me titullin e pjesës “Një shpend i rrallë”.

Orientohen nxënësit/et të vërejnë foton në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe përmbledhin me 3-4 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

*Punohet rubrika “Fjalor”. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit, duke përshkruar “pelikanin kaçurrel”, karakteristikat, mënyrën e jetesës dhe të ushqyerit e tij, masat që janë marrë për të ruajtur dhe mbrojtur atë.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë dhe duke dhënë shpjegimet përkatëse. (*Tekst informativ. Paraqet informacione të hollësishme për pelikanin kaçurrel*).

Nxiten nxënësit/et të tregojnë se cila është data e caktuar si “Dita e pelikanit kaçurrel” dhe të tregojnë rëndësinë e kësaj dite.

Veprimtaria e pestë


Turi i galerisë: Punë në grupe: Nxiten nxënësit/et që në grupe të krijojnë nga një poster për mbrojtjen e specieve të rralla, duke sensibilizuar njerëzit, por edhe administratën që të rrisë masat për ruajtjen e habitateve ku rriten dhe zhvillohen këto specie. Përfaqësuesit/et e grupeve prezantojnë posterat para klasës. Grupet japin mendimet e tyre për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja dhe krijimin e fjalive me to;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- përshkrimin e pelikanit kaçurrel, duke treguar faktorët që e kanë çuar atë drejt zhdukjes;
- tregimin e masave që janë marrë për ruajtjen dhe shumimin e tij, si dhe për ndalimin e gjuetisë së paligjshme;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie: Sill informacione nga interneti për pelikanët në përgjithësi dhe pelikanit kaçurrel. Vizato pelikanin kaçurrel.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Lexojmë Një shpend i rrallë (ora II)		Situata e të nxënit: Informacione për pelikanin kaçurrel.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin joletrar duke diskutuar në dyshe;– përshkruan karakteristikat e pelikanit kaçurrel dhe masat që janë marrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij;– tregon arsyet përse kjo specie ka qenë në rrezik zhdukjeje;– flet për rolin e tij/saj për ruajtjen e diversitetit të shpendëve dhe kafshëve në vendin tonë;– shkruan një letër drejtuar personave që merren me gjueti të paligjshme, ku të theksohet rëndësia e ruajtjes së specieve të rralla për të shtuar diversitetin e shpendëve dhe kafshëve dhe për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve vendas dhe të huaj;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- pelikani dalmat- autokton;- specie;- habitat;- ligatina;- kalendar mjedisor.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;- teksti mësimor;- enciklopedi;- foto, informacione për pelikanin kaçurrel të marra nga interneti;- mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat e natyrës; TIK; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-mjedisi;-vendimmarrja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-bashkëbisedim;-shkrim i lirë;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë informacionet për “pelikanin kaçurrel” të marra nga interneti. Nxënësit paraqesin vizatimet e pelikanit kaçurrel të cilat kanë përgatitur në shtëpi, në një kënd të klasës. *Lexim i tekstit nga nxënësit duke diskutuar në dyshe rreth tij. *Mësuesi/ja fton nxënësit/et të përshkruajnë karakteristikat e pelikanit kaçurrel dhe masat që janë marrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij. Nxënësit/et punojnë në grupe për t’i dhënë përgjigje pyetjeve:			



Përfaqësuesit/et se secilit grup prezantojnë përgjigjet e pyetjeve para klasës.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Ku nxënësit diskutojnë rreth pelikanit kaçurrel, pse është konsideruar një specie në zhdukje, kërcënimet ndaj tij dhe marrja në mbrojtje nga ana e shtetit.

Nxiten nxënësit të flasin rreth dëshirave të tyre, për të vizituar “pelikanin kaçurrel” në habitatin e vet dhe të japin arsyet përse duan ta vizitojnë atë.

Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë se çfarë mund të bëjë secili prej tyre për të mbrojtur këtë shpend të rrallë.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Punohet rubrika “Shkruaj”. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të shkruajnë një letër të cilën ua drejtojnë personave që merren me gjueti të paligjshme, ku të theksohet rëndësia e ruajtjes së specieve të rralla për të shtuar diversitetin e shpendëve dhe kafshëve dhe për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve vendas dhe të huaj.

Pas përfundimit të punës, disa nxënës/e lexojnë letrën e shkruar.

Nxiten nxënësit/et të japin mendime për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e karakteristikave të “pelikanit kaçurrel” dhe masave që janë marrë për ruajtjen dhe mbrojtjen e tij;
- diskutimin për arsyet përse kjo specie ka qenë në rrezik zhdukjeje;
- shkrimin e një letre drejtuar personave që merren me gjueti të paligjshme, ku të theksohet rëndësia e ruajtjes së specieve të rralla për të shtuar diversitetin e shpendëve dhe kafshëve dhe për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve vendas dhe të huaj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Fjalë pohore dhe fjalë mohore		Situata e të nxënësve Lojë me fjalitë pohore dhe mohore.	
Rezultatet e të nxënësve Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon fjalitë pohore dhe fjalitë mohore;përdor pjesëzat mohuese: <i>nuk, s', mos, as, pa, jo</i>; në fjalitë mohore;përdor fjalitë: <i>të gjithë, kudo, çdonjëri</i> etj për të krijuar fjalë pohore;shndërron fjalitë pohore në mohore dhe anasjelltas;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">fjalë pohore;fjalë mohore;fjalëzat mohuese: <i>nuk, s', mos, as, pa, jo</i>;shndërroj.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;teksti mësimor;mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">lojë;analizë;mendo-diskuto;rishikim në dyshe;shkrim i lirë;punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Lojë:</i> Nxënësit/et në çifte luajnë së bashku. Njëri thotë një fjalë pohore, tjetri e shndërron atë në fjalë mohore. Lexohet rubrika “Kujtoj”, në të cilat rikujtohen njohuritë e mëparshme për fjalitë pohore dhe mohore. Veprimtaria e dytë <i>Analizë:</i> Orientohen nxënësit/et të vëzhgojnë dy figurat e dhëna në libër dhe të lexojnë fjalitë e dhëna nën secilën figurë: <i>Zogjtë qëndruan mbi degën e pemës.</i> <i>Zogjtë nuk qëndruan mbi degën e pemës. (Ata fluturuan në qiell.)</i> Nxiten nxënësit/et të dallojnë fjalitë pohore dhe mohore. Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë informacionin në libër për fjalitë pohore dhe mohore.			

Lexohet dhe diskutohet rubrika “Kujdes” nga nxënësit, në të cilën flitet për praninë e fjalëve: *gjithandej, të gjithë, gjithkund* etj në fjalitë pohore dhe të fjalëve: *askush, askund, asnjëri* etj në fjalitë mohore.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit për paqartësitë që mund të kenë.

Nxënësit/et në dyshe lexojnë rubrikën “Mbaj mend” në të cilën theksohet përdorimi i fjalëve me kuptim mohues: *nuk, s’, mos, as, pa, jo*.

Veprimtaria e tretë

Mendo-diskuto: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et që në dyshe të diskutojnë me njëri -tjetrin për të identifikuar fjalitë pohore dhe mohore.

Diskutohet më pas me gjithë klasën rreth tyre si dhe për përdorimin e fjalëve pohuese dhe mohuese në to.

Veprimtaria e katërt

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2. Nxënësit/et individualisht shndërrojnë fjalitë pohore në mohore dhe anasjellas. Pas përfundimit të punës, nxënësit/et shkëmbejnë fletoret midis tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e pestë

Shkrim i lirë: Ushtrimi 3. Nxënësit/et udhëzohen të punojnë individualisht.

Ata/ato shkruajnë në fletore 5 fjali pohore sipas dëshirës dhe i shndërrojnë ato në fjali mohore.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e fjalive pohore dhe fjalive mohore;
- përdorimin e pjesëzave mohuese: *nuk, s’, mos, as, pa, jo*; në fjalitë mohore;
- përdorimin e përemrave: *të gjithë, kudo, çdonjëri* etj. për të krijuar fjali pohore;
- shndërrimin e fjalive pohore në mohore dhe anasjellas;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Lexojmë Shoku i udhës së njeriut (ora I)		Situata e të nxënit Material i shkurtër filmik për kuajt. (fotografi)	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe krijon fjali me to;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– përshkruan kalin, karakteristikat e tij, llojet e tij, lidhjet e hershme që ka me njeriun;– plotëson një skedë për kalin;– paraqet informacione për kuajt;– tregon pse kali është shoku i udhës së njeriut në punë, sport, luftëra, zbavitje etj;– vlerëson rëndësinë që ka kali në shërbim të njeriut;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- kali;- gjitar;- sanë;- ligament.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-enciklopedi;-videoprojektor;-foto, informacione, kuriozitete për kuajt të marra nga interneti;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat e natyrës; TIK; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim i organizuar;- lexo-përmbledh në dyshe;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- dallo-trego;- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Nxënësit/et shikojnë me anë të videoprojektorit një dokumentar të shkurtër për kuajt. Mësuesi/ja fton nxënësit të flasin shkurtimisht rreth dokumentarit që panë. (Në mungesë të videoprojektorit paraqiten fotografi të kuajve të llojeve të ndryshme dhe diskutohet rreth tyre.)			

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Orientohen nxënësit/et të vërejnë fotografinë në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe përmbledhin me 3-4 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me të gjithë klasën.

*Punohet rubrika “Fjalor”. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

*Lexim i kurioziteve për kuajt.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ata diskutojnë rreth përgjigjeve të pyetjeve në fillim në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë dhe duke dhënë shpjegimet përkatëse. (*Tekst informativ*).

*Nxiten nxënësit/et të plotësojnë individualisht një skedë për kalin dhe më pas e diskutojnë atë me gjithë klasën.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja dhe krijimin e fjalive me to;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- plotësimin e një skede për kalin;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Sill informacione nga interneti për kuajt e racave të ndryshme.

Vizato kuaj të racave të ndryshme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Lexojmë Shoku i udhës së njeriut (ora II)		Situata e të nxënit Informacione për kuajt.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin jolettrar duke diskutuar në dyshe;– përshkruan kalin, llojet e tij, lidhjet e tij të hershme që ka me njeriun;– tregon pse kali është shoku i udhës së njeriut në punë, sport, luftëra, zbavitje, etj;– paraqet kuriozitete për kuajt;– vlerëson rëndësinë që kanë kuajt në shërbim të njeriut;– demonstroi siguri kur flet në klasë;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">- kali;- gjiar;- sanë;- ligament;	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;- teksti mësimor;- fotografi, informacione, kuriozitete për kuajt të marra nga interneti;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat e natyrës; TIK; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- bashkëbisedim;- rishikim në dyshe;- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë informacionet për kuajt të marra nga interneti. Nxënësit paraqesin vizatimet e kuajve të racave të ndryshme të përgatitura në shtëpi, në një kënd të klasës dhe i komentojnë ato. Veprimtaria e dytë <i>Bashkëbisedim:</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë tekstin. Diskutohet në dyshe rreth informacionit që përcjell teksti. Punohet rubrika “Reflektoj”. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të japin mendimin e tyre pse kali është quajtur “shoku i udhës së njeriut” dhe të tregojnë kuriozitete të tjera për kalin. Veprimtaria e tretë <i>Rishikim në dyshe:</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të plotësojnë fjalitë që paraqesin kuriozitete për kuajt në mënyrë individuale. Më pas ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrit. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë e plotësuar dhe të diskutojnë rreth tyre. *Në foton e kalit të paraqitur në libër udhëzohen nxënësit të shkruajnë në kutiza fjalët e duhura dhe t’i lexojnë ato. Nxënësit/et japin mendime për punën e njëri-tjetrit.			

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit jolettrar rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- përshkrimin e kalit, karakteristikave të tij, llojeve të tij, lidhjet e hershme që ka me njeriun;
- diskutimin pse kali është shoku i udhës së njeriut në punë, sport, luftëra, zbavitje etj;
- paraqitjen e kuriozitetëve për kuajt;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të dalluar GE, GF.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali;dallon fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe fjalët që plotësojnë kallëzuesin;zgjeron grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">fjali e zgjeruar;fjalë plotësuese;fjalë më e vogël;grupe kryesore;grupi emëror i kryefjalës (GE);grupi foljor i kallëzuesit (GF).	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;teksti mësimor;fisha me fjali;mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">-diskuto-nxirr përfundimin;-mendo, puno në dyshe, shkëmbe;-rishikim në dyshe;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin:</i> Njihen nxënësit/et me temën e mësimi. Mësuesi/ja u drejton pyetjen nxënësve: Cilat janë grupet kryesore të fjalisë? Nxiten nxënësit të rikujtojnë njohuritë e marra rreth grupeve kryesore të fjalisë dhe fjalisë së vogël e fjalisë së zgjeruar, në rubrikën “Kujtoj”. *Nxënësit/et lexojnë në dyshe dhe diskutojnë rreth grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në rubrikën “Mbaj mend”. Mësuesi/ja jep sqarime për pyetjet që mund t’u lindin nxënësve/eve, duke vënë në dukje se GE përmban kryefjalën dhe fjalët që e plotësojnë atë dhe GF përmban kallëzuesin dhe fjalët që e plotësojnë atë.			



Përmban kryefjalën dhe fjalët që e plotësojnë atë. Përmban kallëzuesin dhe fjalët që e plotësojnë atë.

Veprimtaria e dytë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe: Ushtrimi 1 - synon që nxënësit/et të lidhin me shigjetë fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe ato që plotësojnë kallëzuesin.

Ushtrimi 2 - synon që nxënësit/et të dallojnë grupin emëror dhe grupin foljor në fjalitë e dhëna, duke i nënvizuar me ngjyra të ndryshme.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me të gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë punojnë në libër. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es për të treguar fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe fjalët që plotësojnë kallëzuesin, si dhe për të dalluar GE dhe GF në fjalitë e dhëna.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimet 3, 4, për të plotësuar fjalitë me grupin emëror të kryefjalës (U.3) dhe me grupin foljor të kallëzuesit (U.4).

Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë e plotësuar dhe diskutojnë rreth tyre me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në fjali;
- dallimin e fjalëve që plotësojnë kryefjalën dhe fjalëve që plotësojnë kallëzuesin;
- zgjerimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie

Në fjalitë e dhëna nënvizo me ngjyrë të kuqe grupin emëror dhe me blu grupin foljor. Gjej fjalitë e vogla.

1. *Vajza e vogël ndërton një shtëpi me kube.*
2. *Lumenjtë e vendit tonë vërshojnë vrullshëm në pranverë.*
3. *Lulet e limonit kundërmonin gjithandej një aromë të këndshme.*
4. *Zogjtë e vegjël cicërojnë ëmbël në pemë.*
5. *Piktori i talentuar vizatoi një peizazh nga natyra.*

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Grupet kryesore të fjalëve në fjali (ora II)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar GE, GF.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> identifikon grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor të kallëzuesit në fjali; dallon fjalët që plotësojnë kryefjalën dhe fjalët që plotësojnë kallëzuesin; zgjeron fjalinë më të vogël; shkruan fjali, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit; paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij; demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve; bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> fjali e zgjeruar; fjalë plotësuese; fjalë më e vogël; grupe kryesore; grupi emëror i kryefjalës (GE); grupi foljor i kallëzuesit (GF). 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me fjali; mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. 			
Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit/et i lexojnë ato dhe diskutojnë rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es. Mësuesi/ja shpërndan fisha në çdo bankë dhe udhëzon nxënësit të lexojnë fjalitë e shkruara në fisha dhe të dallojnë GE dhe GF. Përfaqësuesit e dysheve prezantojnë punën e bërë. Zhvillohet një diskutim rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es, duke theksuar se GE përmban kryefjalën dhe fjalët që e plotësojnë dhe GF përmban kallëzuesin dhe fjalët që e plotësojnë.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimin 5 synon që nxënësit/et të zgjerojnë fjalinë më të vogël sipas modelit. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Ata/ato shkëmbejnë fletoret ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë e zgjeruara dhe të dallojnë GE dhe GF.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5 synon që nxënësit/et të shkruajnë 5 fjali dhe të dallojnë GE dhe GF, duke ngjyrosur me të kuqe grupin e kryefjalës dhe me blu grupin e kallëzuesit. Nxënësit/et lexojnë fjalitë e krijuara dhe të tregojnë grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit në to.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e grupit emëror të kryefjalës dhe grupit foljor të kallëzuesit në fjali;
- zgjerimin e fjalisë më të vogël;
- shkrimin e fjalive, duke dalluar në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruaj 5 fjali, nënvizo në to grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Dëgjojmë Veshjet popullore		Situata e të nxënit Album me fotografi dhe vizatime të veshjeve popullore të krahinave të ndryshme të vendit tonë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon rreth veshjeve popullore, duke mbajtur shënime për çështjet më interesante; – diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj; – u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon; – tregon për shumëllojshmërinë e veshjeve tona popullore, mënyrën e prodhimit të tyre dhe se ku ruhen ato; – shpjegon interesin që ka brezi i ri për këtë trashëgimi kulturore kombëtare; – vlerëson veshjet popullore si thesar i rëndësishëm i trashëgimisë sonë kombëtare; – pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve/shoqeve rreth tekstit. 		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - veshje popullore; - traditë; - artizanalë; - coha; - fonde; - Muzeu Etnografik. 	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none"> - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - teksti mësimor; - CD; - albume, foto, vizatime me veshje popullore; - informacione nga interneti, revista të ndryshme për veshjet popullore; - mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - shoqëria dhe mjedisi; - arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; - të drejtat e njeriut; - bashkëjetesa paqësore. 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> - veprimtari; - krijo-prezanto; - diskutim; - bashkëbisedim; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë			

Veprimtari: Nxënësit/et janë porositur më parë nga mësuesi/ja të sjellin në klasë foto, vizatime të veshjeve popullore të krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të punojnë së bashku për të përgatitur një album me to. Prezantohet albumi nga nxënësit/et duke përshkruar veshjet popullore dhe duke vënë në dukje krahinat të cilave i përkasin këto veshje popullore.

Veprimtaria e dytë

**Krijo-prezanto:* Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit dhe fton nxënësit të vërejnë dhe të komentojnë fotot në libër.

Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të dëgjojnë/ lexojnë pjesën e parë të tekstit. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për çështjet më interesante dhe më të rëndësishme të tekstit.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet. Më pas diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth veshjeve popullore dhe rëndësisë së tyre.

**Dëgjohe*t pjesa e dytë të tekstit. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për çështjet më interesante dhe më të rëndësishme të tekstit.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre.

Më pas diskutojnë me gjithë klasën për shumëllojshmërinë e veshjeve tona popullore dhe mënyrën e prodhimit të tyre.

**Dëgjohe*t pjesa e fundit e tekstit. Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre. Më pas diskutojnë me gjithë klasën për arsyen përse veshjet tona popullore tërheqin vëmendjen e vizitorëve dhe të studiueseve ndërkombëtarë.

Veprimtaria e tretë

Diskutim: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë për veshjet popullore të krahinave që ata parapëlqejnë. Zhvillohet një diskutim rreth tyre.

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Ushtrimi 3. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth situatës në tekst, tregojnë se si ka vepruar Besa me kostumin e saj të njollosur, duke përzgjedhur njërin nga alternativat e dhëna.

**Nxiten* nxënësit/et të tregojnë se si do të kishin vepruar ata po të ishin në vend të Besës. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon rreth veshjeve popullore, duke mbajtur shënime për çështjet më interesante;
- diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;
- përgjigjet për pyetjet rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon;
- tregimin për shumëllojshmërinë e veshjeve tona popullore, mënyrën e prodhimit të tyre dhe se ku ruhen ato;
- shpjegimin për interesin që ka brezi i ri për këtë trashëgimi kulturore kombëtare;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrë shtëpie: Kërko informacione, ku përshkruhen lloje të veshjeve popullore në revista, enciklopedi ose në internet.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Veshjet popullore (ora I)		Situata e të nxënit Përshkrim i veshjeve popullore	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan një veshje popullore, duke treguar karakteristikat kryesore të saj;– plotëson tekstin informues me fjalët e dhëna;– dallon elementet e përshkrimit të një veshjeje popullore;– përshkruan një veshje popullore duke u mbështetur në foto dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna;– plotëson një skedë për një veshje, duke u bazuar te fotografia dhe njohuritë që ka për të;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- veshje popullore;- sfilatë;- përshkrim;- mëngë;- këpucë;	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- fotografi që nxënësit/et kanë bërë me veshje popullore;-informacione nga interneti për veshjet popullore;- videoprojektor;- material i shkurtër filmik ku jepen valle me veshje popullore;- mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4,veshje popullore.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">- të drejtat e njeriut;- vendimmarrja morale;- bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- sfilatë me veshje popullore nga treva të ndryshme të vendit;- vëzhgo-lexo-plotëso;- vëzhgo-diskuto në dyshe-plotëso;- shkrim i lirë;- punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Sfilatë me veshje popullore:</i> Mësuesi/ja fton të sfilojnë para klasës, nxënësit/et e veshur me veshje popullore nga treva të ndryshme. Në pamundësi, paraqet në videoprojektor një material filmik apo fotografi, ku paraqiten veshje popullore të ndryshme. Këto fotografi mund të sigurohen nga vetë nxënësit nëse porositen më parë.			

*Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et.

- Cilës treve i përket secila prej veshjeve popullore që patë?
- Cilat ngjyra mbizotërojnë në to?
- Çfarë materiali është përdorur për prodhimin e tyre?
- Çfarë modeli ka pjesa e sipërme e veshjes? Po pjesa e poshtme dhe mëngët?
- Si janë këpucët dhe çorapët?
- Çfarë zbukurimesh janë përdorur për shaminë apo kapelën?

Veprimtaria e dytë

Vëzhgo-lexo-plotëso: Nxënësit njihen me kërkesën e ushtrimit 1. Ata vëzhgojnë fotot, lexojnë tekstin dhe pas diskutimit në dyshe plotësojnë atë me fjalët e duhura.

Pasi përcaktojnë llojin e tekstit që plotësuan, mësuesi/ja paraqet në tabelë tekstin e plotësuar dhe fotot e veshjes me tirq. Ai/ajo tërheq vëmendjen në elementet që përshkruajnë veshjen (treva, ngjyrat, modeli, zbukurimet, etj.).

Veprimtaria e tretë

Vëzhgo-diskuto në dyshe-plotëso: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë në libër fotografitë e ushtrimit 2.

Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe rreth tyre, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es, duke u ndalur në elementet që përshkruajnë veshjen (treva, ngjyrat, materiali, modeli, zbukurimet, etj.).

Nxiten nxënësit/et të punojnë në mënyrë individuale për t'iu përgjigjur pyetjeve në libër rreth veshjeve të grave në zonën e Devollit. Më pas nxënësit shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin. Lexohen detyrat nga disa nxënës.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Nxënësit punojnë të pavarur për të plotësuar ushtrimin 3. Ata do të plotësojnë një skedë në lidhje me një veshje të Shqipërisë së Mesme duke përzgjedhur një prej fotove në libër (foton e gruas ose të burrit që paraqet veshjen e Shqipërisë së Mesme).

Lexohet detyra nga disa nxënës dhe diskutohet rreth tyre duke u ndalur përsëri në elementet e përshkrimit të një veshjeje popullore (treva, ngjyrat, materiali, modeli, zbukurimet etj.).

Vlerësimi bëhet për:

- përshkrimin e një veshjeje popullore, duke treguar karakteristikat kryesore të saj;
- plotësimin e tekstit informues me fjalët e dhëna;
- përshkrimin e një veshjeje popullore, duke u mbështetur në fotografi dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna;
- plotësimin e një skedë për një veshje, duke u bazuar te fotoja dhe njohuritë që ka për të;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;

Detyrë shtëpie: Kërko në revista, në enciklopedi ose në internet, informacione rreth veshjes popullore që të pëlqen më shumë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Veshjet popullore (ora II)		Situata e të nxënit Përshkrim i veshjeve popullore: Lojë “Gjej cilës trevë i përket”	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përcakton trevën të cilës i përket veshja popullore e përshkruar;– shkruan, duke u mbështetur në modelin e gatshëm dhe skedën e plotësuar, një tekst informues për një veshje popullore;– shkruan për veshjen popullore që i pëlqen duke përfshirë të gjitha elementet e duhura;– zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një tekst;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- veshje popullore;- tirq- përshkrim;- mëngë;- këpucë;	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- fotografi që nxënësit/et kanë bërë me veshje popullore;- informacione nga interneti për veshjet popullore;- videoprojektor;- material i shkurtër filmik, ku jepen valle me veshje popullore;- mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4, veshje popullore.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">- të drejtat e njeriut;- vendimmarrja morale;- bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- lojë “Gjej cilës trevë i përket”- shkrim i strukturuar;- shkrim i lirë;- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Lojë “Gjej cilës trevë i përket”:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit në lojën-gjëegjëzë. Në grupe do të përgatitin përshkrimin e një veshjeje popullore duke i bashkëlidhur dhe një foto apo skicë. Përshkrimit do t’i mungojë treva të cilën ajo veshje përfaqëson. Këtë element duhet ta gjejnë grupet e tjera.			

Veprimtaria e dytë

Shkrim i strukturuar: Nxënësit do të punojnë për të shkruar një tekst informues për njërën nga veshjet e paraqitura në fotografi, (fotografi të veshjeve të Shqipërisë së Mesme) duke u mbështetur në modelin e ushtrimit 1 dhe në skedën e ushtrimit 3, që kanë plotësuar në mësimin e kaluar. Disa nxënës lexojnë punimet e tyre të cilat diskutohen me gjithë klasën.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Mësuesi/ja orienton nxënësit për të punuar ushtrimin 5. Ata do të përshkruajnë veshjen që i pëlqen më shumë duke u mbështetur në modelet e ushtrimeve 1-4 si dhe në informacionet që kanë gjetur për këto veshje (detyra e shtëpisë). Ata do e shoqërojnë tekstin me fotografi ose vizatime.

(Për këtë detyrë mund të zgjedhin një nga veshjet e paraqitura në fotografi).

Mësuesi/ja kujdeset që të përfshijnë në përshkrim të gjitha elementet e veshjes. Për këtë ata mund të plotësojnë një skedë si ajo e ushtrimit 3 për veshjen që do të përshkruajnë.

Në përfundim, nxënësit do të lexojnë e prezantojnë punën e tyre.

Diskutohen punimet e tyre me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Vlerësimi bëhet për:

- përcaktimin e trevën të cilës i përket veshja popullore e përshkruar;
- shkrimin duke u mbështetur në modelin e gatshëm dhe skedën e plotësuar, e një teksti informues për një veshje popullore;
- shkrimin për veshjen popullore që i pëlqen duke përfshirë të gjitha elementet e duhura;
- zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një tekst;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Asgjë nuk hidhet (ora I)		Situata e të nxënit: Paraqitja me videoklip e këngës “Earth Song” të Michael Jackson	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– diskuton për fenomenin e shkatërrimit të Tokës;– identifikon arsyet e ndotjes në nivel ndërkombëtar dhe në vendin tonë;– lexon tekstin duke nënvizuar çështjet kryesore;– lidh pjesën me përvojën nga jeta e vet;– demonstroi siguri kur flet në klasë;– nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për ndërgjegjësimin e mbajtjes pastër të mjedisit;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">– mjedis;– ndotje;– riciklim;– qelq;– plastikë;– alumin;– letër.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- pamje nga vendet me ndotje të lartë mjedisore;- informacione nga interneti për riciklimin;- videoprojektor;- material i shkurtër filmik ku jepet kënga.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Shkencat e natyrës; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">– mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">- shikim/dëgjim i organizuar;- diskutim,- procedura pyet sërish;- analizo-shpjego;- lexo-diskuto;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim/dëgjim i organizuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë një videoklip të këngës Earth Song. Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et. <ul style="list-style-type: none">- Çfarë vutë re në materialin që ndoqët?- Si ndiheni pasi patë këto pamje që shoqërojnë këngën? Diskutohet për fenomenin e shkatërrimit të mjedisit që na rrethon. Veprimtaria e dytë <i>Kllaster-Ndotja e mjedisit:</i> Nxiten nxënësit/et të evidentojnë faktorët, që ndikojnë drejtpërdrejt ose jo, në ndotjen e mjedisit. Mësuesi/ja vë theksin te hedhja e mbeturinave vend e pa vend.			

Zhvillohet një diskutim se si duhet të bëhet hedhja e mbeturinave në kosha të veçantë dhe pse. Orientohen nxënësit të vlerësojnë rolin e riciklimit të tyre.

Veprimtaria e tretë

Procedura pyet sërish: Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimet në libër. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tyre.

Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Gjatë leximit, ata/ato nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalitë që u duken interesante për materialet që riciklohen. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth paragrafit dhe tjetri përgjigjet.

Për çdo paragraf të ri, nxënësit/et ndërrojnë rolet.

Mësuesi/ja kujdeset që në këtë veprimtari të punohen edhe pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

Veprimtaria e katërt

Analizo-shpjego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për llojin e tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë dhe duke dhënë shpjegimet përkatëse.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim me nxënësit rreth veprimtarive që mund të kryejnë ata për mbrojtjen e mjedisit.

Dalin në një përfundim: Riciklimi është i rëndësishëm në ruajtjen e mjedisit.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për:

- diskutimin e fenomenit të shkatërrimit të tokës;
- prezantimin e arsyeve pse ndodh fenomeni i ndotjes në nivel ndërkombëtar përfshirë edhe vendin tonë;
- lidhjen e pjesës me përvojën nga jeta e vet;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyre shtëpie: Gjeni dhe sillni në klasë materiale të riciklueshme dhe jo të riciklueshme.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Asgjë nuk hidhet (ora II)		Situata e të nxënit: Sa kosha plehrash keni në klasë? Po në shtëpi?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tekstin duke diskutuar në dyshe për të; – përshkruan procesin e riciklimit; – arsyeton për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve; – argumenton rëndësinë e riciklimit si domosdoshmëri jetësore; – demonstroi siguri kur flet në klasë; – nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për rëndësinë e riciklimit; – përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; – bashkëpunon në grup për të krijuar objekte me materiale të riciklueshme.		Fjalë kyçe: – diferencim; – grumbullim; – ripërdorim; – reduktim; – riciklim. –	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -kosha të hedhjes së diferencuar të mbetjeve; -informacione nga interneti për riciklimin; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: - diskutim; - lexo-diskuto në dyshe; - rrjet diskutimi; - vëzhgo-ndërto; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë: <i>Diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë rreth pyetjeve: Sa kosha plehrash keni në klasë? Po në shtëpi? Mësuesi/ja ka sjellë në klasë 2 kosha të vegjël mbeturinash (në mungesë, fotografi të tyre), të shoqëruar me etiketat: Të riciklueshme / Të pariciklueshme Diskutohet rreth emërtimeve që ato kanë dhe ngjyrave të ndryshme. Bëhet lidhja e ngjyrave me rolin e përmbajtjen e tyre. Ftohen nxënësit të prezantojnë në grupe materialet e riciklueshme që ato kanë sjellë. Secili tregon koshin ku duhet hedhur materiali dhe shpjegon arësyen.			

Nxënësit/et diskutojnë në grupe të vogla dhe më pas me gjithë klasën. Theksohet rëndësia e ndarjes së mbeturinave në koshat përkatës.

Veprimtaria e dytë:

Lexo - diskuto në dyshe: Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë tregimin e shkurtër 3- R-të e mjedisit. Diskutohet në dyshe rreth informacionit që përcjell tregimi.

Nxënësit njihen me mënyrën se si mund t'i ripërdorim shumë prej materialeve dhe sendeve që kemi për të hedhur. Kështu ne reduktojmë sasinë e mbetjeve që krijohet.

Veprimtaria e tretë

Rrjet diskutimi:

A është i rëndësishëm riciklimi në mbrojtjen e mjedisit? Pse?

Po

Jo

Diskutojnë dhe japin argumente pro dhe kundër rëndësisë së riciklimit në mbrojtjen e mjedisit. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Veprimtaria e katërt

Vëzhgo-ndërto: Orientohen nxënësit të krijojnë në grup një apo disa objekte me materiale të ricikluara. Ndiqen dhe udhëzohen nxënësit gjatë punës. Prezantojnë punimet e tyre. Japin mendime për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për:

- tregimin si mund të arrihet te riciklimi;
- arsyetimin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve;
- argumentimin e rëndësisë së riciklimit si domosdoshmëri jetësore;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- nxitjen e të tjerët të bashkëbisedojnë për rëndësinë e riciklimit;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- bashkëpunimin në grup.

Detyrë shtëpie: Bashkë me shokët, mësuesen dhe prindërit organizoni javën në mbrojtje të mjedisit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Gjymtyrët kryesore të fjalisë (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për përcaktimin e kryefjalës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon kryefjalën dhe kallëzuesin si gjymtyrë kryesore të fjalisë;përdor pyetjet: <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i> për të gjetur kryefjalën;përcakton kryefjalën në fjali duke treguar me çfarë shprehet ajo;gjen kryefjalën e nënkuptuar në fjali;ndryshon vendin e kryefjalës në fjali pa e prishur kuptimin e fjalisë;krijon fjali në të cilat kryefjala është e shprehur me emër, përemër, numëror, grup fjalësh;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij /saj;demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;bashkëpunon në grup kryerjen e një detyre;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">gjymtyrë kryesore;kryefjalë;pyetjet: <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i>kryefjalë e nënkuptuar.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;teksti mësimor;fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën;fisha me fjali;mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">diskutim për njohuritë paraprake;rishikim në dyshe;shkrim i drejtuar;shkëmbe një problemë;punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tekstin në libër të cilin e ka paraqitur në tabelë dhe të tregojnë se çfarë janë fjalët me ngjyrë të kuqe dhe çfarë janë fjalët me ngjyrë të gjelbër. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se fjalët me ngjyrë të kuqe janë kryefjalë dhe fjalët me ngjyrë të gjelbër janë kallëzues.			

Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të kujtojnë se çfarë dinë për kryefjalën dhe kallëzuesin, duke lexuar dhe diskutuar rubrikat “Kujtoj”. Mësuesi/ja thekson se kryefjala dhe kallëzuesi janë gjymtyrët kryesore të fjalisë. Kryefjala shprehet me emër, përemër, grup fjalësh, numëror.

*Nxiten nxënësit të gjejnë në tekstin e mësipërm kryefjalët e nënkuptuara.

Nxënësit punojnë në dyshe dhe diskutojnë me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es për kryefjalën e nënkuptuar.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimin 1 synon që nxënësit të shkruajnë nga një fjali për figurat dhe të dallojnë kryefjalë dhe kallëzuesin në to.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit të dallojnë kryefjalët në fjalitë e tekstit dhe të tregojnë me çfarë janë shprehur ato. Nxënësit/et punojnë individualisht. Ata/ato shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë ushtrimet me gjithë klasën.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimin 3 synon që nxënësit të rishkruajnë fjalitë duke i ndryshuar vendin kryefjalës pa prishur kuptimin e fjalisë.

Veprimtaria e katërt

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et do të punojnë në grupe. Secili grup do të shkruajë në fletë fjali dhe do t’ia japë grupit që ka afër për të dalluar kryefjalën, duke treguar pyetjen me të cilën gjendet, me se shprehet ajo dhe pozicionin e saj në fjali. Përfaqësuesit e grupeve lexojnë fjalitë duke treguar kryefjalën në secilën prej tyre, me se shprehet ajo dhe pozicionin që ka në fjali.


Nxiten grupet të japin mendime për punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e kryefjalës dhe kallëzuesit si gjymtyrë kryesore të fjalisë;
- përdorimin e pyetjeve: *Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?* për të gjetur kryefjalën;
- përcaktimin e kryefjalës në fjali duke treguar me çfarë shprehet ajo;
- gjetjen e kryefjalës së nënkuptuar në fjali;
- ndryshimin e vendit të kryefjalës në fjali pa e prishur kuptimin e fjalisë;
- krijimin e fjalive në të cilat kryefjala është e shprehur me emër, përemër, numëror, grup fjalësh;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij /saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijë 5 fjali. Nënvizë kryefjalën dhe trego me se shprehet ajo.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Njohuri për gjuhën Gjymtyrët kryesore të fjalisë (ora II)		Situata e të nxënit: Harta e konceptit për kryefjalën.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon kryefjalën në fjali duke përdor pyetjet: <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i>;– përcakton me çfarë është shprehur kryefjala në fjali;– ndërton fjali me grupe fjalësh duke treguar kryefjalën në të;– krijon fjali, në të cilat kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër, numëror, grup fjalësh;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij /saj;– demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- gjymtyrë kryesore;- kryefjalë;- pyetjet: <i>Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?</i>	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti mësimor;- fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën;- fisha me fjali;- mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- harta e konceptit;- dallo-diskuto;- shkrim i drejtuar;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve			
Veprimtaria e parë			
<i>Harta e konceptit:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë.			
Nxiten nxënësit që në grupe të plotësojnë hartën e konceptit për kryefjalën të cilën e përfaqësuesit e grupeve e prezantojnë para klasës.			



Veprimtaria e dytë

Dallo-diskuto: Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të punojnë në dyshe.

Mësuesi/ja shpërndan fisha, ku janë shkruar fjali të ndryshme. Udhëzohen nxënësit/et të dallojnë në fjali kryefjalën, duke bërë pyetjen përkatëse për gjetjen e saj. Nxiten nxënësit/et të tregojnë me se shprehet ajo dhe çfarë vendi zë në fjali. Përfaqësuesit prezantojnë punën e bërë.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën rreth detyrës, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 4 synon që nxënësit të ndërtojnë fjali me grupet e fjalëve të dhëna, të nënvizojnë kryefjalën në fjali dhe të tregojnë me se shprehet ajo.

Ushtrimi 5 kërkon që nxënësit të krijojnë fjali, në të cilat kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër, numëror, grup fjalësh.

Nxënësit punojnë individualisht në fletore. Nxiten të lexojnë fjalitë dhe të tregojnë pozicionin e kryefjalës në fjali dhe me se shprehet ajo.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e kryefjalës në fjali, duke përdor pyetjet: *Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?*;
- përcaktimin me se është shprehur kryefjala në fjali;
- ndërtimin e fjalive me grupe fjalësh dhe dallimin e kryefjalës në to;
 - krijimin e fjalive, në të cilat kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër, numëror, grup fjalësh;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij /saj;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo një tekst të shkurtër me 7-8 fjali të thjeshta me temë “Mbresa nga një ekskursion që keni zhvilluar me klasën”. Nënvido kryefjalën në fjali, trego me se shprehet.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Karriget “muzikore”		Situata e të nxënit Lojërat zbavitëse që luajmë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke dalluar elementet kryesore të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth organizimit dhe zhvillimit të lojës “Karriget muzikore”;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– demonstroi në praktikë përdorimin e një teksti udhëzues, gjatë ekzekutimit të lojës Karriget “muzikore”;– vlerëson rëndësinë e zbatimit të rregullave në lojë;– tregon për rëndësinë e lojërave zbavitëse për rritjen e përqëndrimit, vëmendjes, bashkëpunimit dhe krijimit të atmosferës zbavitëse, argëtuese;– shkruan për një lojë që luan me shokët, duke renditur rregullat e saj;– paraqet dhe komunikoi lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- loja Karrige “muzikore”;- lojtarë;- rregulla;- instrumente.	
Burimet dhe materialet didaktike -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti shkollor; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4; -CD; -magnetofon.		Lidhja me fushat e tjera: Edukim fizik, Sporte dhe shëndet; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- lexo-komento;- marrëdhënie pyetje-përgjigje;- trego-argumento;- bashkëbisedim;- veprimtari;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të zhvillojnë një bisedë rreth lojërave zbavitëse që ata/ato luajnë në kohën e lirë, në pushime etj.			

Veprimtaria e dytë

Lexo-komento: Nxënësit/et njihen me titullin e pjesës Karriget “muzikore”.

Orientohen nxënësit/et të vërejnë foton në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

Ftohen nxënësit/et të lexojnë tekstin. Ata /ato diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth tij.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ata i diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim me shokun/shoqen e bankës më pas me gjithë klasën.

Veprimtaria e katërt

Trego-argumento: Rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në grupe, tregojnë duke e argumentuar ç’lloj teksti është, duke dhënë disa karakteristika të tij (tekst udhëzues).

Nxiten nxënësit të lexojnë dhe të diskutojnë rubrikën “Mësoj më shumë” ku jepen karakteristikat e një teksti udhëzues.

*Nxiten nxënësit/et të krahasojnë rregullat e lojës në të dy variantet.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Rubrika “Reflektoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë nëse e kanë luajtur ndonjëherë këtë lojë dhe cili nga dy variantet iu duket më i lehtë për t’u luajtur.

Veprimtaria e gjashtë

Veprimtari: Luhet “loja e karrigeve” në të dy variantet në klasë, duke zbatuar rregullat e saj.

Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë njëri-tjetrin dhe të flasin për rëndësinë e lojërave në rritjen e përqendrimit, vëmendjes, bashkëpunimit dhe krijimit të atmosferës zbavitëse, argëtuese.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke dalluar elementet kryesore të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth organizimit dhe zhvillimit të lojës Karriget “muzikore”;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- demonstrimin në praktikë të përdorimit të një teksti udhëzues, gjatë ekzekutimit të lojës Karriget “muzikore”;
- diskutimin për rëndësinë e lojërave zbavitëse për rritjen e përqendrimit, vëmendjes, bashkëpunimit dhe krijimit të atmosferës zbavitëse, argëtuese;
- vlerësimin e rëndësisë së zbatimit të rregullave në lojë;
 - shkrimin e një loje që luan me shokët, duke renditur rregullat e saj;
- bashkëpunimin në grup.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kallëzuesi (ora I)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar kallëzuesin foljor dhe kallëzuesin emëror.	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon kallëzuesin si gjymtyrë kryesore e fjalisë;dallon kallëzuesin foljor dhe kallëzuesin emëror në fjali, duke treguar me se shprehet;vë në dukje se çfarë tregon kallëzuesi foljor dhe kallëzuesi emëror;tregon me anë të shembujve kur folja <i>jam</i> është një kallëzues foljor në fjali;plotëson fjalitë me kallëzues foljorë ose emërorë;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">gjymtyrë kryesore e fjalisë;kallëzues foljor;kallëzues emëror.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;teksti shkollor;fisha me pyetjet për të gjetur kallëzuesin;fisha me fjali;mjete shkrimi, fletore, fletë A4;		Lidhja me fushat e tjera Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskuto-nxirr përfundimin;-rishikim në dyshe;-dallos-trego;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë dhe të diskutojnë rreth fotos në tekst. Më pas udhëzohen ata të lexojnë tekstin në libër të cilin mësuesi/ja e ka paraqitur në tabelë, të tregojnë se çfarë janë fjalët me ngjyrë blu dhe çfarë tregojnë ato.			

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se: kallëzuesit: *ushtrohen, erdhi, gëzon*, tregon veprimin që bën kryefjala.

Kallëzuesit: *janë të përqendruar, është i gëzuar*, tregojnë si është kryefjala, pra gjendjen e saj.

Kallëzuesi: *është trajneri i tij i parë*, tregon ç'është kryefjala.

Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë dhe diskutojnë rubrikat “Mbaj mend”, në të cilat jepet kuptimi për kallëzuesin si gjymtyrë kryesore të fjalisë, llojet e tij (kallëzues foljor dhe emëror), me se shprehet secili prej tyre duke i ilustruar me shembujt përkatës.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit për paqartësitë që mund të kenë.

Lexohet dhe diskutohet rubrika “Kujdes“, ku jepet folja *jam* si kallëzues foljor, duke u ilustruar me anë të një shembulli.

Nxiten nxënësit të japin shembuj të tjerë, ku folja *jam* është një kallëzues foljor në fjali.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1, ku do të plotësojnë fjalitë me një kallëzues emëror.

Ata shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Dallo-trego: Ushtrimi 2 - synon që nxënësit të plotësojnë fjalitë e dhëna me nga një kallëzues dhe të përcaktojnë llojin e secilit prej tyre.

Ushtrimi 3 - synon që nxënësit të nënvizojnë kallëzuesin në fjali dhe të përcaktojnë çfarë tregon ai për kryefjalën. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në dyshe. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e shoqeve të tyre.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e kallëzuesit si gjymtyrë kryesore në fjali;
- dallimin e kallëzuesit foljor dhe kallëzuesit emëror në fjali, duke treguar me se shprehet;
- plotësimin e fjalive me kallëzues foljorë ose kallëzues emërorë;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyre shtëpie: Ushtrimi 4

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kallëzuesi (ora II)		Situata e të nxënit Manipulime me fjalë e fjali për të përcaktuar kallëzuesin foljor dhe kallëzuesin emëror.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përcakton kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali, duke treguar me se shprehen;– dallon kallëzuesin foljor dhe kallëzuesin emëror në fjali, duke treguar me se shprehen;– ndërton fjali, duke përdorur kallëzues foljor dhe emëror;– krijon fjali me foljen <i>jam</i>, kur ajo përdoret si kallëzues foljor dhe kur përdoret si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- gjymtyrë kryesore e fjalisë;- kryefjala;- kallëzues foljor;- kallëzues emëror.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti shkollor;- fisha me fjali;- mjete shkrimi, fletore, fletë A4;		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- diskutim;- rishikim në dyshe;- shkrim i drejtuar;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin dhe diskutimin e detyrave të shtëpisë. Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë fisha me nga dy fjali dhe fton nxënësit dallojnë kryefjalët dhe kallëzuesit në to. Të tregojnë me se shprehet kryefjala dhe kallëzuesi si dhe të përcaktojnë llojin e kallëzuesit.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 5 - synon që nxënësit/et të nënvizojnë kryefjalët dhe kallëzuesit në fjalitë e dhëna, të tregojnë me se shprehen dhe të përcaktojnë llojin e kallëzuesit. Nxënësit/et punojnë individualisht. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre, vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë rreth ushtrimit me gjithë klasën, nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 6 - synon që nxënësit të krijojnë katër fjali me foljen *jam*. Në dy prej tyre të përdoren kallëzues foljorë dhe në dy të tjerat kallëzues emërorë. Nxënësit punojnë individualisht. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë para klasës. Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e shoqeve të tyre.

Vlerësimi bëhet për:

- përcaktimin e kryefjalës dhe të kallëzuesit në fjali, duke treguar me se shprehen;
- dallimin e kallëzuesit foljor dhe kallëzuesit emëror në fjali, duke treguar me se shprehen;
- krijimin e fjalive me foljen *jam* kur ajo përdoret si kallëzues foljor dhe kur përdoret si pjesë përbërëse e kallëzuesit emëror;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Gjej dhe shkruaj pesë fjali të thjeshta. Nënvido kryefjalën dhe kallëzuesin në secilën prej fjalive. Trego me se shprehen. Përcakto llojin e kallëzuesit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Një lojë në klasë		Situata e të nxënit: Përshkrim i lojërave që luajnë fëmijët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin duke dalluar elementet kryesore të tij;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit;– dallon llojin e tekstit, duke vënë në dukje karakteristikat e tij;– plotëson fjalitë përmbledhëse rreth tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë;– flet për rëndësinë e zbatimit të rregullave në konceptimin, organizimin dhe zhvillimin e një loje;– diskuton për rolin që kanë lojërat në zhvillimin e fantazisë, krijimin e situatave të humorit, zbavitjes dhe atmosferës argëtuese;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">- përmbajtja e tekstit udhëzues;- gjuha në tekstin udhëzues;- aftësi telepatike;- bashkëpunëtor.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;- teksti shkollor;- mjete shkrimi, fletore, fletë A4;		Lidhja me fushat e tjera: Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">- bisedë;- lexo-përmbledh në dyshe;- rishikim në dyshe;- analizë;- bashkëbisedim;- veprimtari;- punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja shpërndan në çdo bankë nga një fletë, ku ka shkruar tituj lojërash të ndryshme, që luajnë fëmijët e kësaj moshe. Nxiten nxënësit të shkruajnë në dyshe rregullat e këtyre lojërave dhe t’i lexojnë ato. Mësuesi/ja prezanton temën e mësimi “Lojë në klasë”.			

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Nxënësit/et lexojnë dhe përmbledhin në dyshe informacionin për tekstin. Njëri bën dy pyetje rreth paragrafit të parë dhe tjetri u përgjigjet pyetjeve. Në paragrafin pasardhës nxënësit ndërrojnë rolet.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxiten nxënësit/et të plotësojnë fjalitë rreth përmbajtjes së tekstit, duke përzgjedhur alternativën e saktë.

Nxënësit/et shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Zhvillohet një diskutim në klasë rreth ushtrimit nën drejtimin e mësuesit/es.

Veprimtaria e katërt

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et në grupe tregojnë detaje në tekst që përshkruajnë se si mund të bindësh shokët për aftësitë e tua telepatike.

*Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke treguar disa karakteristika të tij.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit/et të japin mendimin e tyre nëse mund të ndryshojë radha e udhëzimeve, duke e argumentuar atë.

*Mësuesi/ja fton nxënësit/et të punojnë në grupe për të gjetur një titull tjetër për pjesën, duke shpjeguar pse është ai një titull i përshtatshëm.

*Nxënësit/et tregojnë nga përvoja e tyre raste, kur e kanë zhvilluar këtë lojë në shtëpi me pjesëtarët e familjes.

Veprimtaria e gjashtë

Veprimtari: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të luajnë në klasë lojën e përshkruar në tekst.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin dhe diskutojnë për rolin që kanë këto në zhvillimin e fantazisë, krijimin e situatave të humorit, zbavitjes dhe atmosferës argëtuese.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke dalluar elementet kryesore të tij;
- dallimin e llojit të tekstit, duke venë në dukje karakteristikat e tij;
- plotësimin e fjalive përmbledhëse rreth tekstit duke përzgjedhur alternativën e saktë;
- diskutimin për rëndësinë e zbatimit të rregullave në organizimin dhe zhvillimin e një loje;
- diskutimin për rolin që kanë këto lojëra në zhvillimin e fantazisë, krijimin e situatave të humorit, zbavitjes dhe atmosferës argëtuese;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Dëgjojmë Martina gatuan		Situata e të nxënit Receta ime e preferuar.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime për çështjet më kryesore; – diskuton rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura; – u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon; – tregon për recetën e tij/saj të preferuar; – shpjegon rëndësinë e respektimit të masave dhe radhës së veprimeve kur gatuajmë; – vlerëson të mirat që na sjell mësimi i gatimeve të disa recetave të thjeshta në jetën tonë të përditshme; – lidh tekstin që dëgjon me përvoja nga jeta e tij/saj për përgatitjen e recetave të thjeshta të gatimit me ndihmën e më të rriturve; – pranon dhe tregon respekt ndaj ideve dhe mendimeve të shokëve rreth tekstit që dëgjon.		Fjalë kyçe: - Martina; - mjeshtër në kuzhinë; - gatuan; - këshilla;	
Burimet dhe materialet didaktike: - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - teksti mësimor; - CD, magnetofon; - libri i gatimeve; - mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: - shoqëria dhe mjedisi; - teknologji. Lidhja me temat ndërkurrikulare: - të drejtat e njeriut; - vendimmarrja morale;	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: - bisedë; - dëgjo-komento; - marrëdhënie pyetje-përgjigje; - bashkëbisedim; - ditari dypjesësh; - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Cila është receta juaj e preferuar? Nga e ke mësuar atë? A keni provuar edhe ju të gatuani? Me ndihmën e kujt? Si jeni ndier kur keni gatuar diçka për veten, për prindërit apo për vëllanë/motrën më të vogël?			

Veprimtaria e dytë

**Dëgjo-komento:* Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimit.

Komentohen ilustrimet në libër nga nxënësit/et.

Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të dëgjojnë me anë të magnetofonit ose të leximit të tij/saj pjesën e parë të tekstit. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për çështjet më interesante dhe më të rëndësishme të tekstit.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet. Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth dëshirës së Martinës për të gatuar dhe përpjekjeve të saj për t'u bërë "mjeshtrë në kuzhinë".

**Dëgjohe*t pjesa e dytë të tekstit. Orientohen ata/ato që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime të shkurtra për çështjet më interesante dhe më të rëndësishme të tekstit.

Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre.

Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth mënyrës së përgatitjes së budingut me çokollatë.

**Dëgjohe*t pjesa e tretë e tekstit. Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre. Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth mënyrës së përgatitjes së mollëve të karamelizuara.

**Dëgjohe*t pjesa e fundit e tekstit. Nxënësit/et lexojnë pyetjet dhe diskutojnë në dyshe për përgjigjet rreth tyre. Më pas diskutojnë me gjithë klasën rreth mënyrës së përgatitjes së bukës me vezë.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve rreth radhës së veprimeve që kryejmë për të bërë një gatim të thjeshtë, rëndësishë së respektimit të kësaj radhe, si dhe elementeve të tjera të parashikuara në recetën e një gatimi etj.

Veprimtaria e katërt

Bashkëbisedim: Mësuesi/ja nxit nxënësit/et për një bashkëbisedim rreth përvojave të tyre në gatim.

Veprimtaria e pestë

Ditari dypjesësh: Nxënësit punojnë në grupe për të komentuar shprehjen: *Arti i gatimit nuk përvetësohet për një ditë, por me përpjekje të përditshme.*

Fjala	Komenti
Arti i gatimit nuk përvetësohet për një ditë, por me përpjekje të përditshme.	Të dish të gatuash është shprehje e një kulture të veçantë. Gatimi përvetësohet përmes ushtrimit praktik, sipas rekomandimeve të librave të njohur të kuzhinës, por edhe nga ndihma dhe këshillat e nënave dhe të gjysheve.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- ndjekjen me vëmendje tekstin që dëgjon duke mbajtur shënime për çështjet kryesore;
- diskutimin rreth pjesës që dëgjon, duke u mbështetur në shënimet e mbajtura prej tij/saj;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon;
- shpjegimin për rëndësinë e respektimit të masave dhe radhës së veprimeve kur gatuajmë;
- lidhjen e tekstit që dëgjon me përvoja nga jeta e tij/saj për përgatitjen e recetave të thjeshta të gatimit me ndihmën e më të rriturve;
- vlerësimin e të mirave që na sjell mësimi i gatimeve të disa recetave të thjeshta në jetën tonë të përditshme.

Detyrë shtëpie: Krijoni librin e gatimeve.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Receta gatimi		Cila është receta juaj e preferuar?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – shkruan dy të vërteta dhe një gënjeshtër në lidhje me recetën e preferuar; – lexon dhe komenton me shkrim recetat e dhëna; – shkruan recetën e tij të preferuar; – përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; – respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalët kyçe: - recetë - gatim - përbërës - masë - proces - kohë e përgatitjes	
Burimet dhe materialet didaktike: - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; - teksti mësimor; - libri i gatimit; - videoprojektor;		Lidhja me fushat e tjera: - shoqëria dhe mjedisi; - teknologji. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia - dy të vërteta një gënjeshtër; - ditari dypjesësh; - shkrim i lirë: - punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve (Nxënësit prezantojnë recetën e tyre të preferuar, për të cilën janë porositur më parë nga mësuesi/ja.) Veprimtaria e parë Dy të vërteta një gënjeshtër: Nxënësit do të shkruajnë në një fletë dy të vërteta dhe një gënjeshtër në lidhje me gatimin (recetën) e preferuar. Më pas i diskutojnë me shokët e grupit dhe gjithë klasën. Është mirë që gënjeshtër të mos jetë shumë e dukshme dhe të vërtetat të jenë befasuese. P. sh. 1. Mua më pëlqen keku me mollë. 2. Unë e gatuaj kekun me mollë. 3. Unë hëngra kek me mollë. Veprimtaria e dytë <i>Ditar dypjesësh:</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimin dhe fton nxënësit/et të lexojnë recetat në libër. Gjatë leximit, ata/ato nënvizojnë çështjet kryesore. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tyre. Pas diskutimit, nxënësit do të plotësojnë një ditar dypjesësh për çdo recetë të shkruar në tekst. Pra, ata të orientuar nga mësuesi/ja do të komentojnë në lidhje me strukturën e shkrimit të një recetë gatimi.			

Veprimtaria e tretë

Shkrim i lirë: Punohet ushtrimi 1. Nxënësit shkruajnë recetën e tyre të preferuar. Këmbejnë recetën e tyre me të shokut dhe diskutojnë në dyshe. Më pas ia prezantojnë recetat e tyre gjithë klasës.

Diskutohet rreth rregullave të përdorimit të zjarrit nën kujdesin e më të rriturve.

Veprimtaria e katërt

Punë në grup: Punohet ushtrimi 2. Nxënësit pasi prezantojnë recetat e tyre, i lidhin ato duke krijuar kështu librin e tyre të kuzhinës. Prezantohet puna e grupeve para klasës. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për:

- leximin dhe diskutimin e recetave të dhëna;
- tregimin me fjalë të thjeshta të recetës së tij të preferuar;
- përzgjedhjen e një recete nga libri i kuzhinës dhe shkrimin e saj;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Shkruani një recetë që të pëlqen, nga libri i gatimit dhe gatujeni bashkë me nënën.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Posta elektronike		Situata e të nxënit Fishë me fjalën <i>komunikim</i> .	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin informues duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– kupton rregullat e shkrimit të një mesazhi elektronik;– njeh rregullat e lundrimit të sigurt në internet;– u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;– demonstroi siguri kur flet në klasë;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- postë elektronike- sms- domein- e-mail- smiles-fytyrëzat- lundrim në internet	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -laptop.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-bisedë;-procedura pyet sërish;-analizë;-rrjeti i diskutimit;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve			
Veprimtaria e parë: <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja paraqit një fishë, ku është shkruar fjala: <i>komunikim</i> Mësuesi/ja pyet nxënësit/et mbi mjetet e komunikimit në ditët e sotme. Listohen disa nga format më të përdorura të komunikimit: bashkëbisedimi, letrat, rrjetet sociale përmes bisedave personale ose në grup dhe forma elektronike e komunikimit <i>e-mail</i> . Nxënësit/et nxiten të mendojnë në mënyrë kritike mbi përparësitë dhe anët negative të komunikimit elektronik.			
Veprimtaria e dytë <i>Procedura: pyet sërish:</i> Mësuesi/ja paraqet temën e mësimi dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimet në libër. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tyre. Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në pjesë. Gjatë leximit ata/ato nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalitë që i duken interesante për këshillat e shkrimit të një mesazhi (pjesa e parë e leximit) dhe për këshillat e sigurisë në internet (pjesa e dytë). Pas leximit të çdo pjese, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri prej tyre ndërton dy pyetje rreth pjesës dhe tjetri përgjigjet. Për çdo pjesë të re, nxënësit/et ndërrojnë rolet.			

Veprimtaria e tretë

Punë dyshe: Mësuesi/ja kujdeset që në këtë veprimtari të punohen pyetjet e rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.

Veprimtaria e katërt

Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për këshillat mbi përdorimin e postës elektronike dhe të sigurisë në internet.

Gjatë kësaj kohe mësuesi/ja kujdeset që të punohet rubrika “Shkruaj”. Këtu nxënësit lidhin emotikonët me kuptimin përkatës duke i diskutuar ndërmjet tyre.

Veprimtaria e pestë

Rrjet diskutimi- punë në grup: Punohet rubrika “Reflektoj”. Diskutojnë dhe listojnë llojet e veprimtarive që mund të kryejnë me kompjuter, dhe diskutojnë se sa i zbatojnë këshillat e mësuara më sipër gjatë lundrimit në internet. Dalin në një përfundim: Posta elektronike është domosdoshmëri, por gjatë lundrimit në internet duhen zbatuar këshillat. Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për:

- leximin e tekstit informues duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- kuptimin e rregullave të shkrimit të një mesazhi elektronik;
- njohjen e rregullave të lundrimit të sigurt në internet;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyre shtëpie: Shkruaj një *e-mail* për shokun/shoqen.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore: Lexojmë Magjia e librave		Situata e të nxënit Lojë: Dëgjo-vepro	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon tekstin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; – shpreh mendimet personale rreth një teksti-argumentues me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es; – tregon llojin e tekstit që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij; – ndan me të tjerët ndjesitë që ka provuar, kur ka lexuar një libër të bukur; – gjykon për rëndësinë e veçantë që ka një libër në formimin e tij; – paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; – vlerëson punën e të tjerëve.		Fjalë kyçe: – tekst-argumentues; – shkrim; – arsyetim.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrje morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -lojë; dëgjo-vepro; -lexo-diskuto në dyshe; -shpjegim-punë e pavarur; -diskuto- analizo; -bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Lojë: dëgjo-vepro:</i> Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve një fletë A4. I fton të mbyllin sytë dhe të kryejnë veprimet që ajo do t' u diktojë. Mësuesi/ja kërkon të palosin fletën dhe të grisin një pjesëz të saj. Vazhdohet kështu me dy-tre palosje. Më pas i fton nxënësit të hapin sytë dhe të të hapin fletët. Ata krahasojnë format e krijuara me njëri-tjetrin. Diskutohet rreth pyetjes: Pse format janë të ndryshme kur të gjithë kishin të njëjtin mjet dhe zbatuan të njëjtën komandë? Veprimtaria e dytë <i>Lexo-diskuto në dyshe:</i> Nxënësit lexojnë tekstin me paragrafë duke nënvizuar. Diskutojnë në dyshe për fjalët që nuk kuptojnë si dhe për përmbajtjen e tekstit. Më pas diskutimi shtrihet në gjithë klasën e drejtohet nga mësuesi/ja, e cila kujdeset për të bërë lidhjen e veprimtarisë së fillimit me përmbajtjen e tekstit.			

Veprimtaria e tretë

Shpjegim-punë e pavarur: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et bashkëbisedojnë në dyshe dhe më pas diskutojnë me gjithë klasën cilat janë përgjigjet e sakta. Mësuesi/ja prezanton para klasës llojin e këtij teksti (tekst-argumentues) si dhe karakteristikat e tij. Punohet rubrika “Mësoj më shumë”, ku merret një informacion më i zgjeruar për tekstin argumentues.

Veprimtaria e katërt

Diskuto-Analizo: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxënësit/et në mënyrë të pavarur do të gjejnë alternativën e saktë për llojin e tekstit (argumentues) dhe do të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Diskutohet me nxënësit për të evidentuar argumentet që autori kish përdorur për të bindur lexuesin e tij.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Zhvillohet një bashkëbisedim, ku nxënësit/et përshkruajnë ndjenjat dhe mendimet e tyre rreth magjisë së librave, duke veçuar librin që i ka magjepsur më shumë. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të japin mendime rreth shprehjes së dhënë në libër:

“Nuk përmbajnë vetëm gjëra të tjerëve, të përmbajnë edhe ty.”


Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- shprehjen e mendimeve personale rreth një teksti-argumentues me ndihmën dhe nxitjen e mësuesit/es;
- tregimin e llojit të tekstit që lexon, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij;
- ndarjen me të tjerët të ndjesive që ka provuar, kur ka lexuar një libër të bukur;
- gjykimin për rëndësinë e veçantë që ka një libër në formimin e tij;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Gjymtyrët e dyta të fjalisë (ora I)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar përcaktorët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– rendit gjymtyrët e dyta të fjalisë, përcaktorin, kundrinorin dhe rrethanorin;– identifikon fjalët plotësuese të kryefjalës dhe fjalët plotësuese të kallëzuesit;– tregon funksionin e përcaktorëve në fjali;– dallon përcaktorët në fjali, duke treguar me se shprehen ato;– plotëson emra me përcaktorë, duke treguar me se shprehen;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: -gjymtyrë të dyta; -përcaktorë; -kundrinorë; -rrethanorë.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskuto-nxirr përfundimin;-rishikim në dyshe;-mendo-puno në dyshe-shkëmbe;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin; a) Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimit. Fton nxënësit të vërejnë foton në libër dhe të diskutojnë rreth saj. Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin në libër të cilin e ka paraqitur në tabelë dhe t’u përgjigjen pyetjeve: <i>Cilave pyetje u përgjigjen fjalët dhe grupet e fjalëve me ngjyrë të gjelbër dhe të kuqe?</i></i> <i>Ç’rol kanë ato në fjali?</i> Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se fjalët me ngjyrë të kuqe janë fjalë plotësuese të kryefjalës, kurse fjalët me ngjyrë të gjelbër janë fjalë plotësuese të kallëzuesit. Nxiten ata të lexojnë dhe diskutojnë rreth njohurive të dhëna në rubrikën “Mbaj mend” për gjymtyrët e dyta të fjalisë.			

Gjymtyrët e dyta të fjalisë



b) Nxiten nxënësit të komentojnë foton e dytë në libër dhe të lexojnë fjalitë e dhëna rreth saj.

Udhëzohen nxënësit të heqin në fjalitë në libër, fjalët me ngjyrë blu dhe të tregojnë se çfarë vënë re. Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se këto fjalë plotësojnë kuptimin e emrave që përcaktojnë.

Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth njohurive të dhëna në rubrikën “Mbaj mend” për përcaktorët, të tregojnë përse shërbejnë dhe me se shprehen ato.

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 1 - synon që nxënësit/et të plotësojnë emrat e dhënë me përcaktorë.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër.

Shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Nxiten nxënësit të lexojnë përcaktorët që kanë përdorur duke treguar me se janë shprehur ato.

Veprimtaria e tretë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të dallojnë në fjalitë e dhëna fjalët plotësuese të kryefjalës dhe fjalët plotësuese të kallëzuesit.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me gjymtyrët e dyta në vendet bosh.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë, punojnë në libër. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimeve. Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.


Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e fjalëve plotësuese të kryefjalës dhe fjalëve plotësuese të kallëzuesit në fjali;
- tregimin e funksionit të përcaktorëve në fjali;
- dallimin e përcaktorëve në fjali, duke treguar me se shprehen ato;
- plotësimin e emrave me përcaktorë, duke treguar me se shprehen;
- plotësimin e vendeve bosh në fjali me gjymtyrë të dyta;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Në fjalitë e dhëna nënvizo përcaktorët dhe trego me se shprehen ato.

1. *Dallëndyshet bishtgërshëra fluturonin në qiellin e kaltër.*
2. *Anijet e vogla lundrojnë në detin e pafund.*
3. *Rrezet e diellit binin mbi kodrat e fshatit.*
4. *Shtëpia e saj gjendet në rrethinat e qytetit.*

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Gjymtyrët e dyta të fjalisë (ora II)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar përcaktorët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon përcaktorët në fjali duke treguar me se shprehen ato;– tregon funksionin e përcaktorëve në fjali;– vë në dukje se përcaktorët qëndrojnë pranë emrave që plotësojnë, mund të hiqen pa i prishur fjalisë kuptimi;– krijon fjali ku të përdorë grupe emërore;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– demonstroi aftësi të bashkëpunimit në grup;– vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-gjymtyrë të dyta;-përcaktorë;-kundrinorë;-rrethorë.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-fisha me fjali;-mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; <ul style="list-style-type: none">-arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-harta e konceptit;-diskutim;-shkrim i drejtuar;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Harta e konceptit:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutimin rreth tyre nën drejtimin e mësuesit/es. Në grupe nxënësit plotësojnë hartën e konceptit për përcaktorin të cilën e përfaqësuesit/et e grupeve e prezantojnë para klasës.			



Veprimtaria e dytë

Diskutim: Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të dallojnë përcaktorët në fjalitë e dhëna dhe të tregojnë me se shprehen ato.

Nxiten nxënësit të lexojnë përcaktorët në fjali, duke treguar me se janë shprehur.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 5. Nxënësit individualisht do të krijojnë fjali ku të përdorin katër nga grupet emërore të ushtrimit 1.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë me zë para klasës. Diskutohet rreth tyre me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e përcaktorëve në fjali duke treguar me se shprehen;
- përcaktimin e funksionit të përcaktorëve në fjali;
- krijimin e fjalive në të cilat të përdoren grupe emërore;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijo 5 fjali ku të përdorësh një nga grupet emërore:

djalë i shkathët, mal i lartë, dhoma ime, nxënësit e klasës sonë, mësuesja jonë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Kafshë në shtëpi?		Situata e të nxënit Përvoja personale me kafshët shtëpiake.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– përshkruan përvoja personale me kafshët shtëpiake;– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– përcakton tezën dhe argumentet në mbështetje të saj;– argumenton mendimin në lidhje me mbajtjen e një kafshe në shtëpi;– ndan idetë e tij/saj rreth kujdesit për kafshët.		Fjalë kyçe: -kafshë shtëpiake; -kujdes; -mace; -qen; -ritregim;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -informacione të shkurtra nga interneti në lidhje me kafshët shtëpiake; -album me foto; -foto të ndryshme kafshësh shtëpiake ose lodra; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shkencat e natyrës; TIK; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-shkrim i shpejtë;-lexim-diskutim;-vija e vlerës;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shkrim i shpejtë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë nëpërmjet një shkrimi të shpejtë përvoja personale me kafshët shtëpiake, si kujdesen, si sillen me to. Nxënësit sjellin përvojat e tyre duke i ilustruar me shembuj apo me foto të sjella në klasë të kafshëve që kanë në shtëpi. Diskutohet rreth pyetjes: Cilën kafshë shtëpiake do të donit të kishit në shtëpi? Veprimtaria e dytë <i>Lexo-diskuto në dyshe:</i> Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë tekstin me paragrafë duke nënvizuar. Diskutohet në dyshe rreth fjalëve të reja dhe përmbajtjes së tekstit. Nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth tekstit.			

Mësuesi/ja fton nxënësit në diskutim për të përcaktuar tezën e shprehur në tekst si dhe për të renditur argumentet në mbështetje të tezës. Ndalet të zgjidhjet që ofron teksti.

Plotësohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj” në tekst.

Mësuesi/ja nxit nxënësit të shtojnë argumente në mbështetje të tezës së dhënë.

Veprimtaria e tretë

Vija e vlerës: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit diskutojnë dhe japin argumente pro dhe kundër rreth pyetjes:

A duhet të mbajmë kafshë në shtëpi? Pse?

Nxënësit ndahen në dy grupe. Nxënësit e secilit grup ftojnë ata të grupit tjetër të ndryshojnë qëndrim duke u nisur nga argumentet që parashtron secili grup.

Në fund, ftohen nxënësit të vizatojnë një kafshë që kanë në shtëpi ose u pëlqen ta kenë.

Vlerësimi bëhet për:

- pëlqimet e tij /saj rreth kafshëve shtëpiake;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- demonstrimin e të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to;
- demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve;
- tregimin e mënyrave se si kujdesen për kafshët shtëpiake;
- shprehjen e preferencave të tij/saj për kafshët shtëpiake duke i argumentuar ato;
- respektimin e mendimeve individuale dhe atyre në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Punë në grup. Krijoni poster me kafshë shtëpiake.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Në qytet apo në fshat? Ora I		Situata e të nxënit Material filmik ose foto të qytetit dhe fshatit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– Komenton foto/pamje filmike që paraqesin fshatin e qytetin– zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një tekst argumentues;– shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth temës në një tekst argumentues;– bën një prezantim të thjeshtë të jetesës në fshat dhe në qytet nëpërmjet shkrimit argumentues;– mban qëndrim në lidhje me tezën e hedhur duke mbrojtur argumentet e tij/saj;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë shkrimit;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">-qytet;-fshat;-tekst argumentues;	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-foto që nxënësit/et kanë bërë në qytet dhe në fshat;-videoprojektor;-material i shkurtër filmik, ku tregohet jetesa në fshat;-material i shkurtër filmik, ku tregohet jetesa në qytet;-mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Shkencat e natyrës; TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-të drejtat e njeriut;-vendimmarrja morale;-bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënës/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none">-shikim i organizuar;-vëzhgo-diskuto-plotëso;-lexo-diskuto;-vija e vlerës;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë një video ku paraqitet një material i shkurtër filmik, ku tregohen pamje të fshatit dhe të qytetit. Në pamundësi të shfaqjes së një materiali filmik,			

nxënësit paraqesin foto të ndryshme të bëra nga vetë ata (apo të marra në revista e internet) në qytet dhe në fshat. Diskutohet rreth tyre duke u ndalur në elementët që e bëjnë të dallueshëm faktin që ato foto(pamje) janë bërë në qytet apo fshat.

Çfarë paraqet kjo foto?

Nga e kupton këtë?

Çfarë të bën më shumë përshtypje te kjo foto?

Veprimtaria e dytë

Vëzhgo-diskuto-plotëso: Ushtrimi 1. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotot në libër. Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe rreth tyre, më pas me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es. Diskutimi ndalet në udhëzimet e dhëna në libër për shkrimin e një teksti argumentues.

Më pas, nxënësit vazhdojnë të shkruajnë tekstin argumentues. Gjatë punës së pavarur mësuesja tërheq vëmendjen në ndjekjen hap pas hapi të udhëzimeve të dhëna në tekst.

Veprimtaria e tretë

Lexo-diskuto: Disa prej nxënësve lexojnë shkrimet e tyre. Diskutohet më gjithë klasën rreth shkrimeve të këtyre nxënësve duke u ndalur në argumentet dhe argumentet kundër, që kanë përdorur si dhe në qëndrimin që kanë mbajtur në fund të shkrimit.

Veprimtaria e katërt

Vija e vlerës: Mësuesja hap një diskutim me nxënësit/et rreth pyetjes:

-Ku ju pëlqen të jetoni në fshat apo në qytet? Pse?

Sipas qëndrimit që kanë mbajtur në shkrimin e tyre (ushtrimi 1) nxënësit ndahen në dy grupe:

- Grupi që dëshiron të jetojë në fshat;
- Grupi që dëshiron të jetojë në qytet;

Këto grupe pozicionohen në dy skaje të klasës. Përfaqësuesi i secilit grup bën një prezantim të shkurtër të argumenteve në favor jetesës në fshat apo qytet. Ata ftojnë anëtarët e grupit tjetër të ndryshojnë qëndrim.

Nxënësit që ndryshojnë mendim mund të kalojnë pranë grupit tjetër. Mësuesja i kushton rëndësi prezantimit të argumenteve prej secilit grup.

Vlerësimi bëhet për:

- Komentimin e fotove/pamjeve filmike që paraqesin fshatin e qytetin
- Zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një tekst argumentues;
- Shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth temës në një tekst argumentues;
- prezantimin e jetesës në fshat dhe në qytet nëpërmjet shkrimit argumentues;
- mbajtjen e qëndrimit në lidhje me tezën e hedhur duke mbrojtur argumentet e tij/saj;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë shkrimit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.
- Shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- **Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 2.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Në qytet apo në fshat? Ora e II		Situata e të nxënit Foto që paraqesin sporte të ndryshme (materiale filmike)	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – komenton foto/pamje filmike që paraqesin disa lloje sportesh; – zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një tekst argumentues; – shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth temës në një tekst argumentues; – mban qëndrim në lidhje me tezën e hedhur duke mbrojtur argumentet e tij/saj; – prezanton tezën e mbrojtur në një shkrim argumentues; – përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës; – respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë shkrimit; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es; 		Fjalët kyçe: -not; -kinema; -teatër; -libër; -film	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -videoprojektor; -foto ose material i shkurtër filmik ku tregohen disa lloje sportesh; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; Sport; Shkencat e natyrës; TIK.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale; -bashkëjetesa paqësore.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -shikim i organizuar-diskutim; -lexo-diskuto; -shkrim i strukturuar; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar-diskutim:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë një video ku paraqitet një material i shkurtër filmik, ku tregohen pamje të llojeve të ndryshme të sporteve. Në pamundësi të shfaqjes së një materiali filmik, nxënësit paraqesin foto të ndryshme të bëra nga vetë ata (apo të marra në revista e internet) ku paraqiten sporte të ndryshme.			

Nxënësit lexojnë detyrën e shtëpisë (ushtrimi 2). Mësuesja drejton diskutimin rreth argumenteve dhe argumenteve kundër, që kanë përdorur nxënësit në mbështetje të tezës si dhe në qëndrimin që secili prej tyre ka mbajtur në lidhje me temën.

Veprimtaria e dytë

Shkrim i strukturuar: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të vëzhgojnë fotot në libër e të lexojnë kërkesën e ushtrimit 3. Ata/ato diskutojnë në fillim në dyshe rreth tyre, më pas me gjithë klasën. Secili prej nxënësve zgjedh njërën prej temave për të shkruar.

Mësuesja tërheq vëmendjen në udhëzimet e dhëna në libër për shkrimin e një teksti argumentues. (ushtrimi 1 dhe 2) ajo orienton nxënësit të ndjekin hap pas hapi ato.

Më pas, nxënësit të shkruajnë të pavarur tekstin argumentues.

Veprimtaria e tretë

Lexo-diskuto: Disa prej nxënësve lexojnë shkrimet e tyre. Diskutohet me gjithë klasën rreth shkrimeve të këtyre nxënësve duke u ndalur në argumentet dhe argumentet kundër, që kanë përdorur si dhe në qëndrimin që kanë mbajtur në fund të shkrimit.

Vlerësimi bëhet për:

- Komentimin e fotove/pamjeve filmike që paraqesin fshatin e qytetin;
- zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një tekst argumentues;
- Shprehjen e opinioneve, mendimeve dhe ndjesive të tij/saj rreth temës në një tekst argumentues;
- prezantimin e jetesës në fshat dhe në qytet nëpërmjet shkrimit argumentues;
- mbajtjen e qëndrimit në lidhje me tezën e hedhur duke mbrojtur argumentet e tij/saj;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë shkrimit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.
- Shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst argumentues për një temë që ju pëlqen.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Firmëtari i parë i Deklaratës së Pavarësisë (ora I)		Situata e të nxënit Pjesë nga filmi “Nëntori i dytë“.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;– dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe krijon fjali me to;– pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;– flet për personalitetin e spikatur të Ismail Qemalit, aftësitë e tij si njeri i ditur, poliglot dhe patriot i kombit të tij;– ndan tekstin në pjesë të vogla duke shkruar nga një titull për to.– tregon për rolin e Ismail Qemalit për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">-Ismail Qemali;-kryeministër;-firmëtar;-Deklarata e Pavarësisë;-Shpallja e Pavarësisë;-administratë;-telegram;-e mosvarme;-trevë.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-flamuri ynë kombëtar;-magnetofon, CD;-videoprojektor;-materiali filmik;-foto, informacione për Ismail Qemalin dhe Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;-faksimile e aktit të firmosjes së pavarësisë nga delegatët pjesëmarrës të udhëhequr nga Ismail Qemali;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">-shoqëria dhe mjedisi;-arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-identiteti kombëtar;-vendimmarja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-shikim i organizuar;-lexo-përmbledh në dyshe;-marrëdhënie pyetje-përgjigje;-dallo-trego;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën, punë individuale.			

Veprimtaritë e nxënësve/eve**Veprimtaria e parë**

Shikim i organizuar: Nxënësit/et shikojnë me anë të videoprojektorit disa sekuenca nga filmi “Nëntori i dytë”. Më pas diskutojnë rreth tij.

Në mungesë të videoprojektorit, paraqiten foto të Ismail Qemalit dhe delegatëve të tjerë që morën pjesë në aktin e Shpalljes së Pavarësisë, si dhe procesverbali i aktit të firmosjes së Pavarësisë nga delegatët pjesëmarrës.

Diskutohet me nxënësit/et rreth Ditës së Shpalljes së Pavarësisë, 28 Nëntor 1912, kur Ismail Qemali dhe patriotët e tjerë shqiptarë shpallën Pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë vargje kushtuar Ismail Qemalit.

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Orientohen nxënësit/et të vërejnë foton në libër dhe të diskutojnë rreth saj.

*Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë.

*Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et në dyshe përmbledhin me 3-4 fjali informacionin e dhënë në tekst dhe më pas e ndajnë me gjithë klasën.

*Punohet rubrika “Fjalor”. Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë rreth kuptimit të fjalëve të reja në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe krijojnë fjali me to.

*Lexim i tekstit zinxhir nga nxënësit/et.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj”, nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit që ka të bëjë me jetën, shkollimin dhe veprimtarinë patriotike të Ismail Qemalit.

Veprimtaria e katërt

Dallo-trego: Punohet rubrika “Analizoj”. Nxiten nxënësit/et të tregojnë në cilën vetë është shkruar teksti dhe llojin e tekstit.

*Lexohet dhe diskutohet rubrika “Mësoj më shumë” në të cilën jepen disa veçori të biografisë.

Punë në grupe: Nxënësit/et punojnë në grupe për të ndarë tekstin në pjesë të vogla dhe për të formuluar një titull për secilën pjesë.

Përfaqësuesit e secilit grup prezantojnë punën e bërë.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë kërkesat e paraqitura të Ismail Qemalit pranë autoriteteve turke të kohës.

Nxiten nxënësit/et të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

-leximin e tekstit jolettrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

-dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

-shpjegimin e kuptimit të fjalëve të reja dhe krijimin e fjalive me to;

-demonstrimin e të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;

-ndarjen tekstin në pjesë të vogla duke shkruar nga një titull për to;

-paraqitjet dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;

-vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë shtëpie: Gjej informacione të tjera për Ismail bej Vlorën.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Firmëtari i parë i Deklaratës së Pavarësisë (ora II)		Situata e të nxënit Ismail Qemali, firmëtari i parë i Deklaratës së Pavarësisë.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– diskuton rreth jetës dhe veprimtarisë së Ismail bej Vlorës, duke u ndalur në etapat kryesore të jetës së tij;– flet për personalitetin e spikatur të Ismail Qemalit, aftësitë e tij si njeri i ditur, poliglot dhe patriot i kombit të tij;– tregon për rolin e Ismail Qemalit për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;– shkruan një tekst të shkurtër për Ismail Qemalin;– paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;– vlerëson punën e shokëve e të shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-Ismail Qemali;-kryeministër;-firmëtar;-Deklarata e Pavarësisë;-Shpallja e Pavarësisë;-administratë;-telegram;-e mosvarme;-trevë.	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-foto, informacione për Ismail Qemalin dhe Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;-tregime, vjersha, këngë popullore kushtuar Ismail Qemalit dhe Ditës së Shpalljes së Pavarësisë;-mjete shkrimi, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">-shoqëria dhe mjedisi;-arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-identiteti kombëtar;-vendimmarja morale.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-shkrim i lirë;-bisedë;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë Lexim i tekstit nga nxënësit/et. <i>Punë në grupe:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë rreth jetës dhe veprimtarisë së Ismail bej Vlorës, duke u ndalur në etapat kryesore të jetës së tij.			
<div><div><div>detyrat e para si kryeministër</div><div>ngritja e flamurit dhe Deklarata e Pavarësisë</div><div>përpjekjet për përgatitjen për Shpalljen e Pavarësisë</div><div>fëmijëria</div><div>Ismail bej Vlora</div><div>shkollimi</div><div>formimi intelektual, gjuhët e huaja</div><div>kërkesat i tij për hapjen e shkollave shqipe dhe alfabetit shqip</div></div></div>			

Veprimtaria e dytë

Shkrim i lirë: Rubrika “Shkruaj”. Nxënësit/et shkruajnë një tekst të shkurtër me 6-7 fjali, ku të përshkruajnë tiparet fizike e të karakterit.

Në përfundim, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortime të gabimeve drejtshkrimore nëse ka.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e tretë

Bisedë: Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë informacione të tjera për Ismail bej Vlorën, tregime, vargje kushtuar atij dhe Ditës së Shpalljes së Pavarësisë.

Vlerësimi bëhet për:

- diskutimin rreth jetës dhe veprimtarisë së Ismail bej Vlorës, duke u ndalur në etapat kryesore të jetës së tij;
- kur flet për personalitetin e spikatur të Ismail Qemalit, aftësitë e tij si njeri i ditur, poliglot dhe patriot i kombit të tij;
- tregimin për rolin e Ismail Qemalit për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë;
- shkrimin e një teksti të shkurtër për Ismail Qemalin;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Një program për kompjuterin		Situata e të nxënit Çfarë lojërash luani në kompjuter?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante; – tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; – dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; – tregon karakteristikat e tekstit autobiografik; – demonstroi të kuptuarit e fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to; – demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij; – krahason kompjuterët e sotëm me kompjuterët e parë; – shpreh preferencat e tij/saj për kompjuterët, duke i argumentuar ato; – respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup; – vlerëson punën e shokëve e të shoqeve. 		Fjalë kyçe: -tris; -kompjuter; -kaba; -tastierë; -komitet.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es -teksti mësimor; -informacione të shkurtra nga interneti në lidhje me kompjuterët; -enciklopedi; -kompjuter; -laptop; -videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shkencat e natyrës; -teknologjia dhe TIK-u; -arte.	Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -imagjinatë e drejtuar; -lexo-përmbledh në dyshe; -hartë koncepti; -diagram Veni, bashkëbisedim; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Imagjinatë e drejtuar:</i> Ftohen nxënësit/et të diskutojnë rreth pyetjes: Çfarë lojërash luani në kompjuter?			

Më pas mësuesi/ja fton nxënësit të mbyllin sytë për pak çaste e të kthehen pas në kohë në ato vite kur nuk kish kompjuter. Pasi hapin sytë nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe më pas me gjithë klasën për kohën kur nuk kish kompjuter si dhe për ndjesinë që ka shkaktuar shpikja e lojërave të para në kompjuter.

Veprimtaria e dytë

Lexo-përmbledh në dyshe: Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë ilustrimet. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tyre.

Udhëzohen të lexojnë tekstin me paragrafë duke nënvizuar fjalët e shprehjet e reja. Punohet rubrika “Fjalor”. Pas leximit të çdo paragrafi kërkohet të bëhet përmbledhja e tij nga njëri nxënës. Në paragrafin tjetër nxënësit ndërrojnë rolet.

Punohet rubrika “Mësoj më shumë”. Diskutohet rreth Bill Gejtsit.

Nxënësit plotësojnë alternativat e sakta në tekst dhe diskutojnë në dyshe pyetjet e rubrikës së parë.

Veprimtaria e tretë

Hartë koncepti: Mësuesi/ja ndalet në llojin e tekstit (*Tekst autobiografik*) dhe karakteristikat e tij të cilat i paraqet nëpërmjet një hartë koncepti në tabelë.

Veprimtaria e katërt:

Diagram Veni, Bashkëbisedim: Mësuesi/ja ndërton në tabelë një diagram Veni dhe plotëson atë gjatë bashkëbisedimit me nxënësit në lidhje me ndryshimin e kompjuterëve të sotëm me ato të shumë viteve më parë.

Punohet rubrika e fundit në tekst, ku nxënësit tregojnë përse e përdorin kompjuterin apo përvoja të tjera personale në lidhje me të.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;
- tregimin e karakteristikave të tekstit autobiografik;
- demonstrimin e të kuptuarit të fjalëve të reja, duke krijuar fjali me to;
- demonstrimin e të kuptuarit të përmbajtjes së tekstit, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth tij;
- tregimin e karakteristikave të kompjuterit të parë;
- shprehjen e preferencave të tij/saj për kompjuterët, duke i argumentuar ato;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyre shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Shkruajmë Autobiografia e Jezercës		Situata e të nxënit Karakteristikat e tekstit biografik.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– dallon një tekst autobiografik midis tre teksteve të dhëna;– rendit karakteristikat e një teksti autobiografik;– plotëson me fjalët e dhëna një tekst autobiografik;– plotëson autobiografinë e vet duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna;– shkruan duke u mbështetur në modelin e gatshëm dhe skedën e plotësuar, një tekst autobiografik (për veten);– zbaton udhëzimet e dhëna për të shkruar një tekst autobiografik;– shkruan një biografi për shokun/shoqen duke u nisur nga autobiografia e saj/tij;– respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë shkrimit;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.		Fjalë kyçe -autobiografi; -biografi; -tekst autobiografik;	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -foto që nxënësit/et kanë bërë gjatë jetës së tyre; -videoprojektor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte; TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -vendimmarrja morale; -bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-stuhi mendimesh;-lexo-plotëso-diskuto;-lexim dhe pyetje;-shkrim i strukturuar;-shkëmbe një problemë;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Stuhi mendimesh:</i> Mësuesi/ja ka përgatitur nga një fletë pune për çdo grup. Në të ka shkruar tre tekste (përshtatës, informues, autobiografik). Kombinimet e teksteve mund të jenë të ndryshëm mjafton që në secilën fletë të ketë një tekst të shkurtër autobiografik. Nxënësit do t'i lexojnë dhe pas diskutimit në grup do të përcaktojnë se cili është teksti autobiografik. Pas kësaj mësuesi/ja paraqet në tabelë një organizues grafik ku përmbledh mendimet e nxënësve për karakteristikat e tekstit autobiografik.			

Veprimtaria e dytë

Lexo-plotëso-diskuto; Mësuesi/ja i prezanton nxënësve temën e mësimit dhe kërkesën e ushtrimit 1.

Nxënësit do të punojnë të pavarur për të plotësuar autobiografinë e Jezercës me fjalët e dhëna (ushtrim 1).

Pas plotësimit të tekstit nxënësit do të diskutojnë në grup dhe më pas me gjithë klasën për të evidentuar elementët që e bëjnë autobiografik këtë tekst.

Veprimtaria e tretë

Lexim dhe pyetje; Mësuesi/ja orienton nxënësit të plotësojnë tabelën e ushtrimit 2, pasi të lexojnë pyetjet e dhëna në të. Disa nxënës lexojnë punën e bërë.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i strukturuar; Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shkruajnë një tekst autobiografik (ushtrimi 3) duke u bazuar në skemën e ushtrimit 2 dhe në modelin e dhënë në ushtrimin 1.

Në përfundim të punës nxënësit lexojnë autobiografitë e tyre.

Veprimtaria e pestë

Shkëmbe një problemë; Nxënësit do të shkëmbejnë me shokun/shoqen autobiografitë. Orientohen të shkruajnë një tekst biografik për shokun/shoqen duke u nisur nga shkrimi autobiografik që sapo shkëmbyen.

Në përfundim lexohen punimet e nxënësve dhe diskutohen ato me gjithë klasën.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e një teksti autobiografik midis tre teksteve të dhëna;
- renditjen e karakteristikave të një teksti autobiografik;
- plotësimin me fjalët e dhëna të një teksti autobiografik;
- plotësimin e autobiografisë së vet duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna;
- shkrimin duke u mbështetur në modelin e gatshëm dhe skedën e plotësuar, të një teksti autobiografik (për veten);
- zbatimin e udhëzimeve të dhëna për të shkruar një tekst autobiografik;
- shkrimin e një biografie për shokun/shoqen duke u nisur nga autobiografia e saj/tij
- respektimin e rregullave të drejtshkrimit;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- qortimet e thjeshta drejtshkrimore që bën me ndihmën e mësuesit/es.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 mund të përfundohet në shtëpi.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Pulë e pjekur		Situata e të nxënit Ç’ dini për zakonet e mikpritjes?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– lexon tekstin teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante;– shpjegon kuptimin e fjalëve të reja dhe krijon fjali me to;– demonstroi të kuptuarit e përmbajtjes së pjesës teatrale, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth saj;– dallon llojin e pjesës teatrale, duke u mbështetur nga toni i batutave;– tregon përmbajtjen e pjesës me fjalët e tij/saj;– përcakton numrin e skenave që ka pjesa teatrale dhe numrin e batutave që thuhet nga secili personazh;– analizon personazhet që marrin pjesë;– shpjegon pse i duket zbavitës dialogu ndërmjet personazheve;– formulon mesazhin që përcjell autori me këtë ngjarje;– interpreton një prej roleve në pjesën teatrale;– vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none">-darkë-pulë e pjekur;-brof në këmbë;-e ndërkryer;-incident;-duke dihetur;-fillikat.	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit;-teksti mësimor;-mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">-shoqëria dhe mjedisi;-arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-bisedë;-ndërveprim me tekstin;-marrëdhënie pyetje-përgjigje;-analizë;-bashkëbisedim;-dramatizim;-punë në grupe, punë në dyshe, punë me gjithë klasën, punë individuale. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et rreth mikpritjes në familje. Mësuesi/ja e orienton bisedën rreth zakonit të mikpritjes dhe dëshirës tonë për t’i pritur sa më mirë miqtë dhe për t’i bërë ata që të ndihen sa më të nderuar.			

Veprimtaria e dytë

Ndërveprim me tekstin. Mësuesi/ja njihet nxënësit/et me titullin e tekstit teatror.

Komentohet ilustrimet në libër nga nxënësit/et.

Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje tekstin dhe të nënvizojnë dialogët që i duken interesante.

Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tekst teatror).

Nxiten ata/ato të shpjegojnë fjalët e fjalorit dhe të ndërtojnë fjali me to.

Nxënësit/et e rilexojnë tekstin për të kuptuar më mirë dialogët mes personazheve.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.

Ata/ato i diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim me shokun/shoqen e bankës më pas me gjithë klasën.

*Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen në mënyrë të përmbledhur.

Veprimtaria e katërt

Punë në grupe: Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et do të punojnë në grupe për të treguar sa skena ka kjo pjesë teatrale dhe numrin e batutave që thuhet nga secili personazh.

*Nxiten nxënësit/et të tregojnë llojin e tekstit teatror, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

*Mësuesi/ja orienton që nxënësit/et në grupe, të formulojnë mesazhin që përcjell autori me këtë ngjarje.

Mesazhi: Mikpritja nuk bazohet në çdo rast tek begatia e tryezës, por te përziemërsia dhe atmosfera e singërtë që tregojmë ndaj mysafirit.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxiten nxënësit të tregojnë pse u duket zbavitës ky dialog dhe të japin preferencat e tyre për rolin që do të donin të interpretonin.

Veprimtaria e gjashtë

Dramatizim: Nxënësit/et të organizuar në grupe lexojnë tekstin teatror sipas roleve.

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante;
- shpjegimin e kuptimit të fjalëve të fjalorit dhe krijimin e fjalive me to;
- përgjigjet e pyetjeve rreth tekstit teatror;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës me fjalët e tij/saj;
- përcaktimin e numrit të skenave që ka pjesa teatrale dhe numrin e batutave që thuhet nga secili personazh;
- analizën e personazheve;
- formulimin e mesazhit që përcjell autori me këtë ngjarje;
- interpretimin e njërit prej roleve në pjesën teatrale;
- vlerësimin e interpretimit të shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Mësuesi/ja ndan rolet nxënësve dhe u jepet detyrë të mësojnë përmendësh fjalët e rolit përkatës.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kundrinorët (ora I)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar kundrinorët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon kundrinorin si gjymtyrë e dytë e fjalisë;tregon funksionin e kundrinorëve në fjali;dallon kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë, duke përdorur pyetjen përkatëse për gjetjen e tyre dhe duke treguar me se shprehen;plotëson fjalitë me nga një kundrinor, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përcaktuar llojin e tij;krijon fjali duke përdorur kundrinorë të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-gjymtyrë të dyta;-kundrinor i drejtë;-kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë;-kundrinor i zhdrejtë me parafjalë;-Kë? Çfarë? Cilin? Cilat?	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-fisha me fjali;-mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">-shoqëria dhe mjedisi;-arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">të drejtat e njeriut;bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskuto-nxirr përfundimin;-të nxënësit me këmbime;-shkëmbe një problemë;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimi:</i> Njihen nxënësit me temën e mësimit. Nxiten ata të vërejnë dhe të komentojnë figurën në libër. Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë tekstin në libër të cilin e ka paraqitur në tabelë dhe t’u përgjigjen pyetjeve: <i>Cilave pyetje u përgjigjen fjalët dhe grupet e fjalëve me ngjyrë blu?</i> Ç’rol kanë ato në fjali? Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën dhe dalin në përfundimin se:			

*Emri fshatin, që i përgjigjet pyetjes **Cilin?** drejtuar foljes është kundrinor i drejtë.*

*Emri ditës, që i përgjigjet pyetjes **Kujt?** drejtuar foljes është kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.*

*Grupet e fjalëve për ditën e re, pas shiut, që u përgjigjen pyetjeve **Për kë? Pas kujt?** drejtuar foljes, janë kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë.*

Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth njohurive të dhëna në rubrikën “Mbaj mend” për kundrinorët, funksionin që kanë në fjali, llojet e tyre, pyetjet që përdoren për t’i gjetur dhe me se shprehen ata sipas llojeve.

Tërhiqet vëmendja në rubrikën “Kujdes” se për të gjetur kundrinorët, drejtoji foljes pyetjet: *Kë? Për kë? Kujt? Nga kush? Prej kujt?*

Veprimtaria e dytë

Të nxënësit me këmbime: Nxënësit grupohen në grupe me nga 4 individë dhe secilit u caktohet nga një numër nga 1-4.

Nxënësve u ndahen detyrat:

Nxënësit me numrin 1 do të punojnë ushtrimin 1.

Nxënësit me numrin 2 do të punojnë ushtrimin 2.

Nxënësit me numrin 3 do të punojnë ushtrimin 3.

Nxënësit me numrin 4 do të punojnë ushtrimin 4.

Nxënësit sipas numrave që kanë do të rigrupohen dhe do të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ushtrimeve. Pas kryerjes së detyrave, ata do të shkojnë në grupet fillestare ku do t’ua shpjegojnë detyrën edhe anëtarëve të tjerë të grupit. Në fund diskutohet rreth çdo detyre me gjithë klasën.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë e plotësuara duke iu përgjigjur pyetjeve me nga një kundrinor dhe do të përcaktojnë llojin e kundrinorëve.

Nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Veprimtaria e tretë

Shkëmbe një problemë: Nxënësit/et do të punojnë në grupe. Secili grup do të shkruajë në fleta nga tri fjali ku të përdorin kundrinorë dhe do t’ia japë grupit fqinjë për të dalluar kundrinorët dhe për të përcaktuar llojin e tyre, duke treguar pyetjen me të cilën gjenden dhe me se shprehen ato.

Nxiten grupet të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e kundrinorëve si gjymtyrë të dyta të fjalisë;
- tregimin e funksionit të kundrinorëve në fjali;
- dallimin e kundrinorit të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë, duke përdorur pyetjet përkatëse për gjetjen e tyre dhe duke treguar me se shprehen;
- plotësimin e fjalive me nga një kundrinor, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përcaktuar llojin e tij;
- krijimin e fjalive duke përdorur kundrinorë të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Kundrinorët (ora II)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar kundrinorët	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> identifikon kundrinorin si gjymtyrë e dytë e fjalisë; dallon kundrinorin e drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë, duke përdorur pyetjen përkatëse për gjetjen e tyre dhe duke treguar me se shprehen; bën dallimin ndërmjet kundrinorit dhe kryefjalës; krijon fjali duke përdorur të njëjtin emër si kryefjalë, kundrinorë të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, kundrinor të zhdrejtë me parafjalë; paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup; vlerëson punën e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe: -gjymtyrë të dyta; -kundrinor i drejtë; -kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë; -kundrinor i zhdrejtë me parafjalë; -Kë? Çfarë? Cilin? Cilat?	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -diskutim; -rishikim në dyshe; -shkrim i drejtuar; -punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutimin e tyre. Nxiten nxënësit të tregojnë veçoritë e kundrinorëve. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fisha në çdo bankë dhe i nxit ata të punojnë në dyshe për të nënvizuar kundrinorët në fjali, të tregojnë pyetjen që kanë përdorur për t'i gjetur ata, të dallojnë llojin e tyre dhe me se shprehen.			

Veprimtaria e dytë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 6 synon që nxënësit/et të përcaktojnë nëse fjalët me ngjyrë blu janë kundrinorë apo kryefjalë. Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin e tabelës në libër. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin.

Nxënësit diskutojnë nën drejtimin e mësuesit/es rreth karakteristikave të kryefjalës dhe të kundrinorit.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore për të krijuar fjali me emrin **libër**, duke e përdorur si kryefjalë, kundrinor të drejtë, kundrinor të zhdrejtë pa parafjalë, kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.

Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë duke dhënë shpjegimet përkatëse sipas kërkesës.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e kundrinorit si gjymtyrë të dyta të fjalisë;
- dallimin e kundrinorit të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, të zhdrejtë me parafjalë, duke përdorur pyetjen përkatëse për gjetjen e tyre dhe duke treguar me se shprehen;
- dallimin ndërmjet kundrinorit dhe kryefjalës;
- krijimin e fjalive duke përdorur të njëjtin emër si kryefjalë, kundrinorë të drejtë, të zhdrejtë pa parafjalë, kundrinor të zhdrejtë me parafjalë;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijë një tekst me 6-7 fjali me temë “Pjesëmarrja në një veprimtari shkollore” nënvizo kundrinorët, trego llojin e tyre dhe me se shprehen ata.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexojmë Proverbi		Situata e të nxënit Si ju motivojnë prindërit për të pasur rezultate të larta?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon tekstin teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante; – u përgjigjet pyetjeve rreth pjesës teatrore; – tregon llojin e tekstit teatror; – tregon përmbajtjen e pjesës me fjalët e tij/saj; – analizon personazhet mbi bazën e veprimeve të tyre, duke treguar edhe ndjesitë që përcjellin ata nëpërmjet batutave të tyre; – interpreton një prej roleve në pjesën teatrore; – lidh pjesën teatrore me ngjarje të ngjashme nga jeta e tij/saj dhe si kanë ndikuar ato në ecurinë e tij/saj në shkollë; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none"> -proverb; -detyra; -gabime; -entuziazëm; 	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathhtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -bashkëjetesa paqësore; -vendimmarrja morale. 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -analizë; -bashkëbisedim; -dramatizim; -punë në grupe, punë në dyshe, punë me gjithë klasën, punë individuale. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë: Zhvillohet një bisedë me nxënësit/et. Mësuesi/ja iu drejton pyetjet:</i> <i>Si ju motivojnë prindërit për të pasur rezultate të larta? Sa ndikon kjo në ecurinë tuaj në shkollë?</i>			

Veprimtaria e dytë

Ndërveprim me tekstin. Mësuesi/ja njih nxënësit/et me titullin e tekstit teatror. Komentohej ilustrimet në libër nga nxënësit/et. Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje tekstin dhe të nënvizojnë dialogët që i duken interesante.

Nxënësit/et tregojnë llojin e tekstit, duke vënë në dukje disa nga karakteristikat e tij (tekst teatror).

Nxiten ata/ato të shpjegojnë fjalët e fjalorit dhe të ndërtojnë fjalë me to.

Nxënësit/et e rilexojnë tekstin për të kuptuar më mirë dialogët mes personazheve.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ata/ato i diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim me shokun/shoqen e bankës më pas me gjithë klasën.

*Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen.

Veprimtaria e katërt

Punë në grupe: Analizë: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et do të punojnë në grupe për të treguar personazhet që shfaqen në këtë pjesë teatrale, duke i analizuar ato, numrin e batutave që thuhën nga secili personazh. Nxiten nxënësit/et të tregojnë llojin e tekstit teatror, duke përzgjedhur alternativën e duhur.

Veprimtaria e pestë

Bashkëbisedim: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit/et tregojnë preferencat e tyre për rolin që duan të interpretojnë, duke treguar arsyen e përzgjedhjes.

*Mësuesi/ja fton nxënësit të flasin rreth ndjesive që u ngjallin personazhet nëpërmjet batutave të tyre, duke treguar se cilin rol do të kishte dëshirë ta interpretonte, si dhe duke treguar ndonjë lidhje që mund të ketë me të kjo pjesë.

Veprimtaria e gjashtë

Dramatizim: Nxënësit/et të organizuar në grupe lexojnë tekstin teatror sipas roleve. (Piero, babai, tregimtari).

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante;
- përgjigjet për pyetjet rreth pjesës teatrale;
- tregimin e përmbajtjes së pjesës me fjalët e tij/saj;
- analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre, duke treguar edhe ndjesitë që përcjellin ata nëpërmjet batutave të tyre;
- interpretimin e një prej roleve në pjesën teatrale;
- lidhjen e pjesës teatrale me ngjarje të ngjashme nga jeta e tij/saj dhe si kanë ndikuar ato në ecurinë e tij/saj në shkollë;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Mësuesi/ja ndan rolet nxënësve dhe u jepet detyrë të mësojnë përmendësh fjalët e rolit përkatës.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Rrethanorët (ora I)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar rrethanorët	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon rrethanorët si gjymtyrë të dyta të fjalisë;tregon funksionin e rrethanorëve në fjali dhe me se shprehen ato;përdor pyetjet: <i>Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç'shkak?</i>për të dalluar rrethanorët e vendit, kohës, mënyrës, sasisë, qëllimit, shkakut;vë në dukje se rrethanorët lëvizin lirshëm në fjali, mund të zhvendosen ose mund të hiqen;krijon fjali duke përdorur rrethanorë të llojeve të ndryshme;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: -gjymtyrë të dyta; -rrethanorë; - <i>Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç'shkak?</i>	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskuto-nxirr përfundimin;-mendo-puno në dyshe-shkëmbe;-rishikim në dyshe;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskuto-nxirr përfundimin;</i> Nxiten nxënësit të lexojnë tekstin në libër të cilin e ka paraqitur në tabelë dhe t'u përgjigjen pyetjeve: <i>Cilave pyetje u përgjigjen fjalët dhe grupet e fjalëve me ngjyrë blu? Ç'rol kanë ato në fjali?</i> Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin nën drejtimin e mësuesit/es dhe dalin në përfundimin se: <i>grupet e fjalëve me ngjyrë blu janë rrethanorë.</i> Nxënësit/et lexojnë dhe diskutojnë informacionin në rubrikën “Mbaj mend“ për rrethanorët. Nxiten nxënësit që në grupe, të përcaktojnë rrethanorët dhe të dallojnë llojet e tyre në fjalitë e dhëna si dhe të provojnë të ndërrojnë vendet e tyre në fjali.			

Veprimtaria e dytë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe Ushtrimi 1, 2 synon që nxënësit/et të dallojnë në fjalitë e dhëna rrethanorët duke shënuar në kllapa llojin e tyre.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë punojnë në libër. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es rreth rrethanorëve.

Veprimtaria e tretë

Rishikim në dyshe: Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të plotësojnë fjalitë me rrethanorët e duhur.

Nxënësit punojnë individualisht.

Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe kontrollojnë njëri-tjetrin. Nxiten nxënësit të lexojnë fjalitë.

Zhvillohet një diskutim me gjithë klasën nën drejtimin e mësuesit/es rreth ushtrimit.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

-identifikimin e rrethanorëve si gjymtyrë të dyta të fjalisë;

-tregimin e funksionit të rrethanorëve në fjali dhe me se shprehen ato;

-përdorimin e pyetjeve: *Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç'shkak?* për të dalluar rrethanorët e vendit, kohës, mënyrës, sasisë, qëllimit, shkakut;

-krijimin e fjalive duke përdorur rrethanorë të llojeve të ndryshme;

-demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;

-vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Gjej rrethanorët në fjalitë e dhëna dhe trego ç'lloj janë.

Në mesditë dielli ndriçon fort.

Autobusi shkoi në Durrës.

Shiu binte me rrëmbim.

Sot futbollistët e klasës u lodhëm pak, por fituan.

Zogu po dridhej nga të ftohtit.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Njohuri për gjuhën Rrethanorët (ora II)		Situata e të nxënit Manipulim me fjalë e fjali për të dalluar rrethanorët.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">identifikon rrethanorët si gjymtyrë të dyta të fjalisë;tregon funksionin e rrethanorëve në fjali dhe me se shprehen ato;përdor pyetjet: <i>Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç'shkak?</i>për të dalluar rrethanorët e vendit, kohës, mënyrës, sasisë, qëllimit, shkakut;vë në dukje se rrethanorët lëvizin lirshëm në fjali, mund të zhvendosen ose mund të hiqen;krijon fjali duke përdorur rrethanorë të llojeve të ndryshme;paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;demonstron aftësi të bashkëpunimit në grup;vlerëson punën e shokëve/shoqeve.		Fjalë kyçe: -gjymtyrë të dyta; -rrethanorë; - <i>Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç'shkak?</i>	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -fisha me fjali; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-diskutim;-mendo-puno në dyshe-shkëmbe;-shkrim i drejtuar;-punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Diskutim:</i> Mësimi fillon me leximin e detyrave të shtëpisë dhe diskutimin e tyre. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve fisha në çdo bankë dhe udhëzohen ata të punojnë në dyshe për të nënvizuar rrethanorët në fjali dhe të dallojnë llojin e tyre. Nxiten nxënësit t’u ndërrojnë vendin rrethanorëve në fjali dhe të tregojnë se çfarë vënë re.			

Veprimtaria e dytë

Mendo, puno në dyshe, shkëmbe Ushtrimi 4 synon që nxënësit/et të gjejnë rrethanorët në fjali dhe të përcaktojnë ç’lloj janë.

Mësuesi/ja i lë nxënësit/et të lirë të mendohen për disa çaste. Pastaj mendimet e tyre i shkëmbejnë me shokun/shoqen e bankës dhe në fund me gjithë klasën. Pasi binden për përgjigjen e saktë punojnë në libër. Zhvillohet një diskutim në klasë nën drejtimin e mësuesit/es për rrethanorët që gjetën në fjalitë dhe llojit të tyre.

Veprimtaria e tretë

Shkrim i drejtuar: Ushtrimi 3. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore për të krijuar fjali ku të përdorin rrethanorët dhe të përcaktojnë llojin e tyre.

Në përfundim, nxënësit lexojnë fjalitë dhe përcaktojnë llojin e rrethanorëve.

Nxënësit/et vlerësojnë punën e shokëve e të shoqeve.

Vlerësimi bëhet për:

- identifikimin e rrethanorëve si gjymtyrë të dyta të fjalisë;
- tregimin e funksionit të rrethanorëve në fjali dhe me se shprehen ato;
- përdorimin e pyetjeve: *Ku? Kur? Si? Sa? Përse? Për ç’shkak?* për të dalluar rrethanorët e vendit, kohës, mënyrës, sasisë, qëllimit, shkakut;
- krijimin e fjalive duke përdorur rrethanorë të llojeve të ndryshme;
- demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin e punës së shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Krijë një tekst me 6-7 fjali me temë “Një ngjitje në mal” nënvizo rrethanorët, trego llojin e tyre.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa V	Data
Tema mësimore Lexojmë Tre muskëtierët		Situata e të nxënit Pse më pëlqejnë filmat dhe librat me aventura?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – lexon tekstin teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante; – u përgjigjet pyetjeve rreth pjesës teatrale; – dallon llojin e tekstit teatror; – tregon ku duket në tekst roli i muskëtierëve në ndihmë të njerëzve të thjeshtë dhe të pambrojtur para kërcënimeve të ndryshme; – analizon personazhet mbi bazën e veprimeve të tyre, duke treguar edhe ndjesitë që përcjellin nëpërmjet batutave të tyre; – shpjegon pse triumfojnë gjithnjë muskëtierët; – formulon mesazhin që përcjell pjesa; – interpreton një prej roleve në pjesën teatrale; – bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre; – vlerëson interpretimet e shokëve/shoqeve. 		Fjalë kyçe <ul style="list-style-type: none"> -muskëtierë; -miqësi; -solidaritë; -moto. 	
Burimet dhe materialet didaktike <ul style="list-style-type: none"> -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit; -teksti mësimor; -libra me aventura; -mjete shkrimi, fletore, fletë A4. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> -shoqëria dhe mjedisi; -arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> -të drejtat e njeriut; -vendimarrja morale. 	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve: Metodologjia <ul style="list-style-type: none"> -bisedë; -ndërveprim me tekstin; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -dallo-trego; -ditari dypjesësh; -dramatizim; -punë në grupe, punë në dyshe, punë me gjithë klasën, punë individuale. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Bisedë:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë rreth librave dhe filmave me aventura që u kanë pëlqyer më shumë. Nxiten ata të tregojnë pse u pëlqejnë librat dhe filmat me aventura duke komentuar shkurtimisht personazhet e preferuar të tyre.			

Veprimtaria e dytë

Ndërveprim me tekstin. Mësuesi/ja njih nxënësit/et me titullin e tekstit teatror dhe autorin e tij, kohën kur zhvillohet ngjarja dhe titullin e romanit prej nga është shkëputur fragmenti.

Komentohet ilustrimet në libër nga nxënësit/et. Orientohen nxënësit/et të lexojnë në heshtje tekstin dhe të nënvizojnë dialogët që i duken interesante.

Nxiten ata/ato të shpjegojnë fjalët e fjalorit dhe të ndërtojnë fjali me to.

Nxënësit/et e rilexojnë tekstin për të kuptuar më mirë dialogët mes personazheve.

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Mësuesi/ja fton nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. Ata/ato i diskutojnë përgjigjet e pyetjeve në fillim me shokun/shoqen e bankës më pas me gjithë klasën.

*Disa nxënës/e tregojnë ngjarjen.

Veprimtaria e katërt

Dallo- trego: Punë në dyshe: Punohet rubrika “Analizoj”, ku nxënësit/et të tregojnë llojin e tekstit, numrin e batutave të secilit personazh.

Nxënësit punojnë për të gjetur në tekst ku duket roli i muskëtierëve. Nxiten nxënësit të lexojnë pjesët dhe të diskutojnë rreth tyre.

Veprimtaria e pestë

Ditari dypjesësh: Punohet rubrika “Reflektoj”. Nisur nga teksti nxënësit/et arsyetojnë se ku qëndron sekreti i triumfit të përhershëm të muskëtierëve.

Në grupe nxënësit komentojnë shprehjen e tre muskëtierëve dhe formulojnë mesazhin.

Fjala	Komenti
Një për të gjithë, të gjithë për një.	Fryma e miqësisë, solidaritetit, besnikëria dhe sakrifica për njëri-tjetrin.

Mesazhi: Miqësia i bën njerëzit të fortë dhe të pathyeshëm para çdo pengese.

Veprimtaria e gjashtë

Dramatizim: Nxënësit/et të organizuar në grupe lexojnë tekstin teatror sipas roleve. (*tregimtari, babai i vajzës, D’Artaniani, muskëtierët*).

Vihet theksi në leximin me intonacion.

Nxënësit/et japin mendime rreth leximit sipas roleve të shokëve/shoqeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- leximin e tekstit teatror duke mbajtur shënime për dialogët që i duken interesante;
- përgjigjet për pyetjet rreth pjesës teatrore;
- tregimin ku duket në tekst roli i muskëtierëve në ndihmë të njerëzve të thjeshtë dhe të pambrojtur para kërcënimeve të ndryshme;
- analizën e personazheve mbi bazën e veprimeve të tyre, duke treguar edhe ndjesitë që përcjellin ata nëpërmjet batutave të tyre;
- formulimin e mesazhit që përcjell pjesa;
- interpretimin e një prej roleve në pjesën teatrore;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin e interpretimeve të shokëve/shoqeve.

Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.

Mësuesi/ja ndan rolet nxënësve dhe u jepet detyrë të mësojnë përmendësh fjalët e rolit përkatës.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Dëgjojmë Gazmore		Situata e të nxënit Pse na pëlqejnë gazmoret?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje;– zgjedh një prej gazmoreve për të interpretuar, duke shpjeguar zgjedhjen e tij/saj;– tregon pse i pëlqejnë gazmoret;– shpreh ndjesitë që provon kur dëgjon një gazmore;– interpreton në role një prej gazmoreve;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: -gazmore; -interpreto; -kënaqësi; -gëzim.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -gazmore; -CD, magnetofon; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi; Arte. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -të drejtat e njeriut; -mjedisi; -bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve -diskutim për njohuritë paraprake; -dëgjim i drejtuar; -marrëdhënie pyetje-përgjigje; -diskutim; -lojë në role; -bashkëbisedim; -punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.			
Veprimtaritë e nxënësve/eve:			
Veprimtaria e parë <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Mësuesi/ja fton disa nxënës të tregojnë nga një gazmore. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et rreth pyetjes: Pse na pëlqejnë gazmoret?			
Veprimtaria e dytë <i>Dëgjim i drejtuar:</i> Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të dëgjojnë një nga një gazmoret në magnetofon. Orientohen nxënësit/et që gjatë dëgjimit të mbajnë shënime për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje. Komentohen nga dyshet e nxënësve fotot në libër si dhe përmbajtja e gazmoreve duke u ndalur në pyetjet e ushtrimit 1.			

Veprimtaria e tretë

Marrëdhënie pyetje-përgjigje: Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'u përgjigjen pyetjeve rreth gazmoreve. Nxënësit diskutojnë për përgjigjet në fillim në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.

Veprimtaria e katërt

Diskutim: Ushtrimi 2 synon që nxënësit/et të veçojnë gazmoren që u pëlqeu më shumë dhe të shpjegojnë zgjedhjen e tyre.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit/et të tregojnë një gazmore që dinë shokëve të tyre.

Veprimtaria e pestë

Lojë në role: Mësuesi/ja fton nxënësit/et (ushtrimi 4) të zgjedhin një shok ose shoqe si dhe gazmoren që i pëlqeu më shumë për ta luajtur në role. Pasi praktikohen për pak minuta do të dalin para klasës për të shfaqur interpretimin e tyre.

Veprimtaria e gjashtë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 5, 6. Nxiten nxënësit/et të lidhin pjesët e fjalive me shigjetë dhe të diskutojnë rreth tyre.

Ata diskutojnë me njëri-tjetrin për ndjesitë që provojnë kur lexojnë gazmore.

Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- ndjekjen me vëmendje të tekstit që dëgjon, duke mbajtur shënime të shkurtra për fjalitë që i bëjnë më shumë përshtypje;
- tregimin pse i pëlqejnë gazmoret;
- shprehjen e ndjesive që provon kur dëgjon një gazmore;
- interpretimin e gazmoreve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data:
Tema mësimore Flasim Albumet me fotografi të familjes sime		Situata e të nxënit Paraqitja në monitor e fotove nga festa e abetares.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– diskuton për temën “Albumet me fotografi të familjes sime”;– bën një prezantim të thjeshtë të albumit të vet personal;– shpreh opinionet, mendimet dhe ndjesitë e tij/saj rreth një albumi fotografish personal dhe familjar;– krahason fëmijërinë e gjyshërve, prindërve me të tijën duke u nisur nga fotot;– ofron zgjidhje për një situatë të caktuar;– nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për rubrikat në libër;– përdor një fjalor të përshtatshëm rreth temës;– demonstroi siguri kur flet në klasë;– respekton rregullat e të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;– bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.		Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none">-album fotografish;-fotografi digjitale;	
Burimet dhe materialet didaktike: <ul style="list-style-type: none">-njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;-teksti mësimor;-foto që nxënësit/et kanë bërë me familjen;-video e festës së abetares-videoprojektor;-material i shkurtër filmik ku jepet foto të nxënësve gjatë festës së abetares;-mjete shkrimi, lapustilë, fletore, tabakë letre, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none">-shoqëria dhe mjedisi;-arte;-shkencat e natyrës;-teknologjia dhe TIK-u. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none">-të drejtat e njeriut;-vendimmarrja morale;-bashkëjetesa paqësore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-shikim i organizuar;-lexo-diskuto;-bashkëbisedim;-punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shikojnë një video dhe fotografitë digjitale të festës së abetares që ka organizuar klasa para 4 viteve. <i>*Zhvillohet një diskutim me nxënësit/et.</i> <ul style="list-style-type: none">-Çfarë ju bëri përshtypje në fotot e para 4 viteve?-Si ndiheni pasi patë këto pamje?-Po në familje ku i ruani fotografitë? Si ndihesh kur i shikon fotot e viteve të mëparshme?			

Veprimtaria e dytë

Lexo-diskuto: Mësuesi/ja prezanton temën e mësimit. Nxënësit lexojnë tekstin dhe diskutojnë në dyshe për punën që kanë bërë dy personazhet e pjesës Jehona dhe Ivesti bashkë me gjyshen për sistemimin e albumeve me foto të familjes. Ata japin mendimin e tyre në lidhje me këtë mënyrë të kalimit të kohës së lirë, (Ushtrimi 1). Më pas, duke iu referuar kërkesës së (Ushtimit 2) nxënësit/et do të tregojnë elementet që i kanë bërë përshtypje kur kanë parë foto të tyre kur kanë qenë më të vegjël, duke prezantuar një foto të atyre viteve. Ushtrimi 3 kërkon të tregojnë përshtypjet që u kanë lënë fotot e prindërve kur kanë qenë në moshën e tyre. Diskutojnë më shokët e më pas me gjithë klasën rreth fëmijërisë së prindërve të tyre duke u nisur nga fotot e tyre. I njëjti diskutim do të bëhet në lidhje me fëmijërinë e gjyshërve duke u nisur nga fotot e tyre.

Në grupe nxënësit diskutojnë rreth situatës të Ushtrimi 5 dhe japin mendime në lidhje me përgjigjet dhe zgjidhjet që i ka dhënë babai i Jehonës shqetësimit të nënës së saj. Prezantojnë zgjidhjet e tyre para klasës. Përgjigjet e nxënësve/eve, mësuesi/ja i paraqet me anë të një kllasteri në tabelë.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Nxiten nxënësit/et të tregojnë mendimet dhe ndjesitë që kanë rreth fotove personale dhe të familjes, duke u ndalur në ndonjë incident të vogël. Ata tregojnë si e zgjidhën problemin brenda grupit. Një përfaqësues tjetër i grupit tregon historinë para klasës.

Vlerësimi bëhet për:

- diskutimin në grupe për temën “Albumet me fotografi të familjes sime”;
- prezantimin e albumit të vet personal;
- demonstrimin e sigurisë kur flet në klasë;
- shprehjen e opinionëve, mendimeve dhe ndjesitë e tij/saj rreth një albumi fotografish personal dhe familjar;
- nxitjen e të tjerëve të bashkëbisedojnë për rubrikat në libër;
- përdorimin e një fjalori të përshtatshëm rreth temës;
- respektimin e rregullave të folurit gjatë komunikimit me të tjerët;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuhë shqipe	Klasa V	Data:
Tema mësimore Shkruajmë Shkruajmë për verën		Situata e të nxënit Material i shkurtër filmik për natyrën në stinën e verës.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">– flet për natyrën në stinën e verës;– u përgjigjet pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e verës duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;– shkruan për stinën e verës, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;– shpjegon preferencën e tij/saj për stinën e verës;– përshkruan se ku i pëlqen të shkojë dhe se çfarë i pëlqen të bëjë në këtë stinë;– shkruan për stinën e verës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;– respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;– bën qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;– shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;– vlerëson punën e shokëve e shoqeve.		Fjalë kyçe: -përshkruaj; -vera; -moti; -natyra; -njeriu; -frutat e perimet.	
Burimet dhe materialet didaktike: -njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; -teksti mësimor; -pamje nga natyra në stinën e verës; -mjete shkrimi, lapustilë, fletore, fletë A4.		Lidhja me fushat e tjera: -shoqëria dhe mjedisi; -shkencat e natyrës. Lidhja me temat ndërkurrikulare: -mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: <ul style="list-style-type: none">-shikim i organizuar;-diskutim;-bashkëbisedim;-shkrim i lirë;-punë individuale, punë me gjithë klasën, punë në dyshe, punë në grup. Veprimtaritë e nxënësve/eve Veprimtaria e parë <i>Shikim i organizuar:</i> Mësuesi/ja paraqit me anë të video-projektorit një material të shkurtër filmik për stinën e verës, duke dëgjuar në sfond simfoninë e Vivaldit “Katër stinët”. Në mungesë të video-projektorit paraqiten pamje nga natyra në stinën e verës. Nxiten nxënësit/et t’i përshkruajnë ato, duke treguar edhe karakteristikat e stinës së verës. Nxënësit/et shprehin lirshëm ndjenjat dhe emocionet e tyre për stinën e verës.			

Veprimtaria e dytë

Diskutim: Njihen nxënësit/et me temën e mësimit.

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shkruajnë përgjigjet e pyetjeve për stinën e verës duke përzgjedhur në fjalët në kllapa, fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine.

Nxënësit/et punojnë individualisht në libër. Mësuesi/ja nxit nxënësit/et të lexojnë përgjigjet e pyetjeve dhe të diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 2. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e verës, duke organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë.

Disa nxënës/e lexojnë përshkrimet e tyre.

Veprimtaria e tretë

Bashkëbisedim: Ushtrimi 3. Nxënësit/et bashkëbisedojnë rreth preferencave të tyre për stinën e verës, duke i shpjeguar ato me dy fjali.

Ushtrimi 4. Nxënësit/et përshkruajnë se ku u pëlqen të shkojnë dhe çfarë u pëlqen të bëjnë në këtë stinë.

Veprimtaria e katërt

Shkrim i lirë: Ushtrimi 5. Nxënësit/et përshkruajnë stinën e verës në vendin ku jetojnë, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje, duke respektuar këshillat e dhëna në libër për përshkrimin e kësaj stine.

Ata/ato punojnë individualisht në fletore.

Pas përfundimit të punës, nxënësit/et lexojnë shkrimet e tyre me zë para klasës.

Bëhen qortime drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;

Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi bëhet për:

-përgjigjet e pyetjeve për natyrën, motin, njeriun, frutat dhe perimet në stinën e verës, duke përzgjedhur fjalët që tregojnë karakteristikat e kësaj stine;

-përshkrimin për verën, duke i organizuar përgjigjet e pyetjeve në paragrafë;

-shkrimin për stinën e verës në vendin ku jeton, sipas strukturës: hyrje-zhvillim-mbyllje;

-respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

-qortimet drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;

-vlerësimin e punës së shokëve/ shoqeve.

Detyrë shtëpie: Përshkruaj stinën e verës në një vend bregdetar.

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Lexim jashtë klase (sipas zgjedhjes së mësuesit/es)		Fjalë kyçe	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëgjëza etj. – (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja) – përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. – (sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesi/ja) – përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; – tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; – shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; – ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; – pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.		Situata e të nxënit Leximi i librave jashtë klase	
Burimet dhe materialet didaktike: – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es – libra jashtë klase		Lidhja me fushat e tjera: Lidhja me temat ndërkurrikulare:	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Metodologjia: diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaritë e nxënësve/eve <ul style="list-style-type: none">• Prezantimi i titullit të librit dhe autori.• Leximi i pjesës.• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.• Tregimi i përmbajtjes së pjesës.• Personazhet dhe cilësitë e tyre.• Mesazhi që përcjell pjesa.• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.• Ilustrim i pjesës me vizatim. Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.			
Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do zgjedhë mësuesi/ja për të punuar.			

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa: V	Data
Tema mësimore Vlerësim njohurish 3		Fjalë kyçe: -vlerësim njohurish; -test; -përcakto; -kthej; -shkruaj.	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi/ja: – plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst; – shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; – respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.		Situata e të nxënit Vlerësim njohurish 3	
Burimet dhe materialet didaktike – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; – fletët e testit, mjetet e shkrimit.		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur. Veprimtaritë e nxënësve/eve – Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur. – Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit/et. Vlerësimi bëhet për: -plotësimin e kërkesave të ushtrimeve në tekst; -shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit; -respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.			

Projekti 3 (4 orë)

PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT				
Titulli i projektit	Teatri ynë		Kohëzgjatja	1 orë -gjuhë shqipe (të shkruarit)
				1orë -gjuhë shqipe (të lexuarit)
Lënda: Gjuhë shqipe		Mësuesi:		1 orë --gjuhë shqipe (të lexuarit)
				1 orë --gjuhë shqipe (të lexuarit)
Lidhja fushat e tjera:	Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi		Klasa:	E pestë
Ideja e projektit:	Fëmijët pëlqejnë të lexojnë libra e të shohin teatër. Kështu që bashkohen këto dy pjesë (libri dhe teatri) në një projekt që do Të jetë nxitje e mëtejshme për të lexuar dhe për t’u argëtuar duke krijuar. Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të kërkuar e gjetur pjesë nga librat që kanë lexuar; aftësitë krijuese për t’i përshtatur e për t’i interpretuar në një teatër për fëmijë.			
Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve:	Dëshira për t’u argëtuar duke marrë kënaqësi nga leximi, nga shfaqjet për fëmijë (teatri i kukullave dhe shfaqje të tjera) shfrytëzohen si nxitje për zotërimin e disa kompetencave. Njohuritë paraprake të nxënësve si dhe përvojat e mëparshme të tyre në lidhje me këtë temë, shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre në zotërimin e disa kompetencave.			
Kompetencat kyçe që zhvillohen:	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.	x	Kompetenca personale	X
	Kompetenca e te menduarit	x	Kompetenca qytetare	X
	Kompetenca e të nxënit	x	Kompetenca digjitale	x
	Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.	x		
Temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit:	Lexojmë sipas roleve pjesë teatrore		Interpretojmë sipas roleve pjesë teatrore	
	Interpretojmë sipas roleve pjesë teatrore		Diskutojmë rreth personazheve, ngjarjes, interpretimeve të shokëve	

Rezultatet e të nxënit:	<ul style="list-style-type: none">• nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme• pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit• lexon sipas roleve• luan me role pjesën• shkruan batutat e pjesës teatrale• shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur shkruan• pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij• lidh pjesën që lexon me përvoja personale• demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime• demonstroi besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve• respektoi përpjekjet individuale dhe ato në grup• demonstroi besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit				
Metodologjia:	(Individuale, në grup ose e gjithë klasa)	Diskutim	x	Hulumtim	X
		Bisedë	x	Lojë me role	X
		Punë në grup	x		
Burimet e nevojshme:	Njerëzit e përfshirë	Mësuesi, nxënësit, prindërit.			
	Mjetet:	Maska ose veshje për personazhet, bllok shënimesh, foto videoprojektor, karton letër, lapustilë, CD, magnetofon, skenë e improvizuar.			
	Materiale dhe burime	Libra për fëmijë, filmime nga shfaqje me kukulla.			
Pyetja kërkimore:	Si mund të luajmë një pjesë teatrale?				
Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit:	<p>Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me teatrin për fëmijë dhe pjesë nga këto shfaqje.</p> <p>Gjuhë shqipe</p> <ul style="list-style-type: none">• Nxitet diskutimi për librat dhe teatrin për fëmijë. Analizohen librat dhe shfaqjet teatrale. Përgjatë diskutimeve mësuesja e orienton diskutimin tek lidhja e këtyre dy gjinive me njëra-tjetrën.• Mësuesja ndan për çdo grup një pjesë letrare që është përshtatur për teatër. Mund të përdoret një nga pjesët e librit ose një pjesë tjetër e zgjedhur nga mësuesja apo vetë nxënësit.• Nëpërmjet leximit të drejtuar diskutohet përmbajtja e kësaj pjese dhe fjalët e reja.• Nxënësit të ndarë nëpër grupe me aq nxënës sa janë edhe personazhet e pjesës ndajnë rolet dhe përgatiten duke e lexuar sipas roleve pjesën.• Secili nxënës shkruan batutat dhe mëson të interpretojë pjesën e tij të rolit. Bëhen shumë prova në të cilat nxënësit përmirësojnë lojën e tyre në role.				

	<ul style="list-style-type: none"> • Me ndihmën e prindërve bëhet i mundur improvizimi i një skene, përgatitja e maskave ose veshjeve të personazheve të pjesës dhe vija melodike që do të shoqërojnë shfaqjen. • Jepet shfaqja . • Të ftuar janë prindër, mësues e drejtues të shkollës dhe nxënës të klasave të tjera. • Nëpërmjet intervistave të thjeshta “aktorët” dhe spektatorët e shfaqjes pyeten për personazhin që interpretuan, lojën në role, lidhjen e kësaj pjese me jetën e tyre, mesazhin e shfaqjes si dhe vlerësimin që kanë për interpretimin e shokëve. 	
Produktet kryesore:	Në grup:	Teatri për çdo grup
	Individualisht:	Loja e personazhit të tyre
Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit:	Shkollë	X
	Klasë	X
Vlerësimet:	Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)	Vlerësimi bëhet për: <ul style="list-style-type: none"> • leximin sipas roleve • interpretimin e pjesës sipas roleve • shkrimin e batutave të përzgjedhura • shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit • bashkëpunimin në grup
	Vlerësime përmblendhëse (Në fund të projektit)	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimin e teatrit për çdo grup.
Buxheti:	Buxheti i detajuar Përse? Nga kush?	<ul style="list-style-type: none"> • Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilëve me ngjyra për maskat, veshjet dhe skenën.

Shënim: Mësuesi/ja mund të përdorë pjesët e tekstit ngaqë u është lënë në plan vetëm një orë mësimore në dispozicion. Mësuesi është i lirë të përdorë pjesë të tjera që i zgjedh vetë nga teksti mësimor apo nga libra artistikë. Pjesët mund t'i zgjedhin edhe vetë nxënësit.

Test 3

Teatri

Ishim në klasë. Lajmi se do të shkonim në teatër u përhap me një shpejtësi të madhe. Nuk mbahej mend që kur nuk kisha shkuar në teatër. U hodha përpjetë nga gëzimi.

– Urra! – thirrëm të gjithë njëzëri. Sa në pëlqenin shfaqjet teatrore!

Në këtë çast mësuesja hyri në klasë.

– Fëmijë, mendoj që nesër të shkojmë në teatër. A jeni dakord? – pyeti ajo.

– Po, – u përgjigjëm njëzëri, duke ngritur të dyja duart lart.

– Sa fëmijë do të vijnë?

Të gjithë donin të vinin në teatër. Ne shikonim njëri-tjetrin me sytë që shkëlqenin nga gëzimi.

Jeta në shkollë për ne është shumë e bukur. Ne shkojmë në shkollë me shumë gëzim, veçanërisht kur kemi veprimtari. Na pëlqen shumë të argëtohem!

Qarko përgjigjen e saktë.

1. **Teksti i mësipërm ka:** (1 pikë)
 - a) 1 paragraf;
 - b) 2 paragrafë;
 - c) 3 paragrafë.
2. **Fëmijët u gëzuan sepse:** (1 pikë)
 - a) do të shkonin në ekskursion;
 - b) do të shkonin në teatër;
 - c) do të shkonin në kinema.
3. **Mësuesja ftoi për në teatër:** (1 pikë)
 - a) nxënësit e dalluar;
 - b) gjithë nxënësit;
 - c) vetëm vajzat.
4. **Mësuesja i ftoi me:** (1 pikë)
 - a) *e-mail*;
 - b) letër.
 - c) asnjërën.
5. **Fëmijëve u pëlqen shumë:** (1 pikë)
 - a) shkolla
 - b) argëtimi
 - c) të dyja bashkë
6. **Shkruaj një karakteristikë të një teksti biografik.** (1 pikë)

7. Në tekstin e mësipërm gjej një fjali: dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, pohore, mohore. Shkruaji në tabelën e mëposhtme: (7 pikë)

Fjali dëftore	
Fjali pyetëse tërësore	
Fjali pyetëse e pjesshme	
Fjali dëshirore	
Fjali nxitëse	
Fjali pohore	
Fjali mohore	

8. Shndërro fjalinë pohore në fjali mohore. (1 pikë)
Të gjithë donin të vinin në teatër.

9. Në fjalinë “*Motra e vogël e Edlirës pikturon me penela një peizazh nga natyra*”. Ngjyros me të kuqe grupin emëror të kryefjalës dhe me blu grupin foljor të kallëzuesit. Shkruaj fjalinë më të vogël. (3 pikë)

10. Gjej kryefjalën në fjalitë e mëposhtme dhe shkruaj me se është shprehur ajo. (4 pikë)

Fjali nga teksti	Kryefjala	E shprehur me
Koha që kalojmë në shkollë na pëlqen shumë.		
Ne shkojmë në shkollë me shumë gëzim.		

11. Gjej në tekst një fjali ku kryefjala nënkuptohet. Rishkruaje fjalinë duke e shprehur kryefjalën. (1 pikë)

12. Në fjalinë “*Altini është atlet i shkëlqyer*” nënvizo dhe emërto kallëzuesin. Trego me se shprehet. (2 pikë)

13. Në fjalinë e mëposhtme, nënvizo grupet emërore. Dalo përcaktorët dhe trego me se shprehen. (3 pikë)

Djemtë e klasës luajnë futboll në sheshin sportiv.

14. Krijë fjali me emrin *libër*, duke e përdorur si kryefjalë dhe si kundrinor të drejtë. (2 pikë)

15. Plotëso fjalitë e mëposhtme me nga një kundrinor. Përcakto llojin e tij. (4 pikë)

U hodha përpjetë _____.

Mësuesja i foli ëmbëlsisht _____.

16. Gjej rrethanorët dhe përcakto se ç'lloj janë.

(4 pikë)

Në këtë çast mësuesja hyri në klasë.

 Arta stërvitej çdo ditë pa u lodhur.

17. Përshkruaj stinën e verës.

(5 pikë)

Vlerësimi	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-10	11-17	18-23	24- 29	30-34	35 -39	40-42